

Mimoza Gjokutaj

Anila Mullahi

Flora Koleci

Tereza Babasuli

Elsa Skënderi

Melihatë Zeqiri

# Gjuhë shqipe

# 8



BOTIME

pegi



Prof. dr. Mimoza Gjokutaj

Prof. as. dr. Anila Mullahi

Prof. as. dr. Flora Koleci

Msc. Tereza Basho Babasuli

Dr. Elsa Skënderi Rakiplari

Dr. Melihate Zeqiri

# GJUHË SHQIPE 8

Për klasën e 8-të të arsimit 9-vjeçar

**BOTIME**



Prishtinë, 2024



## BOTIME



Drejtoi botimin: Arlinda RRUSHI  
Recensentë të MASHTI-t:  
?????????????  
Redaktore letrare: Aida BARO  
Korrektorë letrarë: Arlon LIKO, Oriada DAJKO  
Paraqitja grafike dhe kopertina: Elvis BEJTJA  
Ilustrues: Elidor KRUIJA, Florinda ZONJA  
Shtypi: Shtypshkronja Pegi, Lundër, Tiranë  
ISBN: 978-9951-843-20-1

© Botime Pegi sh.p.k., dega në Kosovë, maj 2024  
Të gjitha të drejtat për këtë botim në gjuhën shqipe janë tërësisht të zotëruara nga Botime Pegi shpk. Ndalohet çdo riprodhim, fotokopjim, përshtatje, shfrytëzim ose çdo formë tjetër qarkullimi tregtar, pjesërisht ose tërësisht, pa miratimin paraprak nga botuesi.

*Të gjitha tekstet letrare dhe jolettrare të këtij libri janë përshtatur dhe redaktuar për qëllime didaktike.*

---

**Botime Pegi:** tel: +355/ 042 468 833; cel: +355/ 069 40 075 02;  
**e-mail:** botimepegi@botimepegi.al; web: www.botimepegi.al  
**Spektori i shpërndarjes:** cel: +355/ 069 20 267 73; 069 60 778 14;  
**e-mail:** marketing@botimepegi.al  
**Shtypshkronja Pegi:** cel: +355/ 069 40 075 01;  
**e-mail:** shtypshkronjapegi@yahoo.com

---

# Hyrje

Teksti *Gjuha shqipe 8* mbështetet në kërkesat dhe kriteret e caktuara nga programi i lëndës së Gjuhës shqipe, shpallur nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit e Kosovës, dhe zbërthen kompetencat kyçe dhe ato të lëndës, të strukturuar sipas fushave të studimit.

*Gjuha shqipe 8* synon t'i përfshijë nxënësit/et në veprimtari të gjera të të nxënit, përmes së cilave pritet të fitojnë aftësi, shprehi dhe vlera të gjithanshme.

Përmes këtij teksti, nxënësit/et do të aftësohen për ta përdorur gjuhën në situata të larmishme dhe do të fitojnë shprehi që lidhen me aftësitë e tyre për ta dëgjuar, folur, lexuar dhe shkruar atë në një nivel të përshtatshëm për moshën e tyre.

Kjo gjë do të arrihet përmes përfshirjes së tyre në veprimtari të gjera ndërvepruese dhe bashkëpunuese, në veprimtari krijuese dhe në projekte, duke i zhvilluar dhe rritur intelektualisht dhe gjuhësisht.

Përmes këtij libri, synohet aftësimi i nxënësve/eve për zhvillimin e kulturës së përgjithshme dhe të shkathtësive të komunikimit krahas përdorimit të drejtë të gjuhës në situata të ndryshme. Gjithashtu, synohet formimi i mëtejme kulturor e gjuhësor, përvetësimi i dijeve dhe formimi i personalitetit, duke përfshirë këtu edhe kulturën e sjelljes dhe të komunikimit. Për të përmbushur synimet e mësipërme, të shpalosura në program, struktura e këtij teksti i orienton nxënësit/et drejt pasurimit të fjalorit, përdorimit të drejtë të gjuhës, hartimit të tregimeve, përshkrimeve, udhëzimeve, argumentimeve, zhvillimit të imagjinatës dhe kreativitetit, si dhe drejt kultivimit të aftësive për të gjykuar e vlerësuar.

Teksti përbëhet nga dy pjesë.

**Pjesa e parë** përfshin fushat përmbajtësore të programit, që lidhen me: zhvillimin e shkathtësive të komunikimit: **të lexuarit, të shkruarit, të dëgjuarit** dhe **të folurit**, të cilat, të gërshetuara me njëra-tjetrën, krijojnë një ansambël njohurish dhe praktikash ndërvepruese në tërë rrjedhën e tekstit.

**Pjesa e dytë** e tekstit, e emërtuar "Njohuri për gjuhën", zbërthen në mënyrë shkencore dhe didaktike tema dhe kompetenca, të cilat lidhen me leksikologjinë, gramatikën (fonetikën, morfologjinë dhe sintaksën e shqipes), në vazhdimësi të programit të klasës së shtatë.

Kjo pjesë krijon mundësinë për ta njohur dhe përdorur drejt sistemin morfo-sintaksor dhe drejtshkrimor të shqipes. Gërshetimi i pjesës së parë të lëndës me pjesën e dytë është një tipar tjetër i *Gjuhës shqipe 8*, i cili mundëson dhe lehtëson punën me llojet e teksteve dhe me njohuritë për gjuhën.

Ju urojmë rrugëtim të mbarë në eksplorimin e gjuhës sonë!

# PËRMBAJTJE

## TEKSTI LETRAR

### Tekste nga letërsia popullore

Rrëfime nga e kaluara	9
Sfiksi	9
Dhelpra me bark të fryrë	10
Legjenda e Syrit të Kaltër	10
Kush e solli Doruntinën?	12
Mençuria e popullit	15
Ciklopi	19
Urtësia e popullit	23
Djaloshi i gurtë	25

### Tekste nga jeta reale

Kujtimet	28
Një jetë e vështirë	33
Kthimi i Skënderbeut në Krujë	36
Komandanti i klasës	41
Një medalje për madhësinë	45
Bora e fëminisë	48
Purpuranti	50
Origjina e murtajës	54
Shuarja e humorit	58

### Tekste me fantazi dhe aventura

Liliputët	62
Të rrethuar nga ujëqit e kuq	66
Përleshja e kryetrimtimit me kryepiratin	71
Nëndhesja	75

Një mik i paharruar	79
Borfor – provat e Askanos	82
Roboti që donte të flinte	87
Busulla e artë	92

## Tekste poetike

Kur nëna ime...	96
Shpell' e Dragobisë	98
Vrull	100
Ora e Shalës	102
Kosovës	105
Shkëndijë e diellit ndaj manushaqes	107
Mëma	109
Shqiponja	111
Yjeve të pashuara	112
Të dua baltë shqiptare	114
Leni lumejt...	116

## Tekste dramatike

Besëlidhja shqiptare	118
I sëmuri për mend	121
Krijesat e pazakonta	125
Prometeu i mbërthyer	131

## TEKSTI JOLETRAR

### Tekste rrëfyese

Nanë e dashtun!	136
Idriz Ajeti, babai i albanologjisë në Kosovë	139
Erza, shqiptarja me famë botërore, nga muzika drejt kinematografisë	142
Gjirokastra	147

### Tekste informuese-paraqitëse

Kulti i disa gjallesave të natyrës	151
Zogjtë	154

## Tekste udhëzuese

Gjashtë këshilla për të rritur pasionin për të lexuar	156
Shkruajmë një plan për një projekt	158

## Tekste argumentuese

Përparësitë dhe të metat e shpyllëzimit	160
A duhet të lejohen celularët në shkolla?	163

## Tekste përshkruese

Përshkruajmë në mënyra të ndryshme	166
Vendi me më shumë libra sesa banorë	168
Si të krijojmë një revistë	170

## Njohuri për gjuhën

### Histori gjuhe

Historik i shkurtër i gjuhës shqipe të shkruar	174
--	-----

### Fonetikë

Ndryshimet pozicionale dhe kombinatorë të fonemave në gjuhën shqipe	178
Ndërrimet historike të fonemave në gjuhën shqipe	180

### Drejtshkrim

Përdorimi i pikës dhe i pikëçuditjes	184
Përdorimi i drejtë i dy pikave, thonjzave, pikëpresjes dhe kllapave	186
Përdorimi i trepikëshit (...)	189



## Leksikologji

Fjalët me ngjyrim emocional	191
Kuptimet e drejtpërdrejta dhe të figurshme të fjalëve	193
Dialektet e gjuhës shqipe	195
Gjuha standarde dhe dialektet	196
Fjalët shqipe dhe fjalët e huaja	198
Fjalë dhe forma gjuhësore që përdoren gjatë të folurit dhe që dëmtojnë gjuhën	200

## Morfologji

Përemri pronor	202
Përemri vetvetor dhe përemri pyetës	207
Përemri i pacaktuar	209
Folja në mënyrat kushtore dhe habitore	212
Folja në mënyrat dëshirore dhe urdhërore	215
Zgjedhimi jovepror në mënyrat: dëftore, habitore, lidhore, kushtore, dëshirore dhe urdhërore	217
Pasthirrma	219
Pjesëza	222

## Sintaksë

Ndërtimi i fjalisë dhe analiza gramatikore e saj	225
Funksionet gramatikore të fjalëve në fjali	228
Fjalitë e përbëra me bashkërenditje dhe ato me nënrenditje	231
Fjalitë e përbëra me bashkërenditje, llojet e tyre	234
<b>DREJTSHKRIM</b> Përdorimi i presjes në fjalitë me bashkërenditje	236
Fjalitë e përbëra me nënrenditje fthilluese: kryefjalore, kundrinore	237
Fjalitë e përbëra me nënrenditje, rrethore: kohore, vendore	240
Fjalitë e përbëra me nënrenditje, rrethore: shkakore, qëllimore	242
Fjalitë e përbëra me nënrenditje, rrethore: mënyrore, rrjedhimore	245
Fjalitë e përbëra me nënrenditje, rrethore: kushtore, lejore	248
Fjalitë e përbëra me nënrenditje, rrethore: krahasore	251
Fjalitë e përbëra me nënrenditje, përcaktore	253
<b>DREJTSHKRIM</b> Përdorimi i presjes në fjalitë me nënrenditje	255
Fjalor	256
Referenca	

# TEKSTI LETRAR

**Teksti letrar ka funksion artistik.  
Ai na emocionon dhe na nxit  
imagjinatën krijuese.**

<i>Teksti letrar</i>		
<i>Tipi i tekstit</i>	<i>Karakteristika</i>	<i>Lloji</i>
tekst rrëfimtari letrar	Tregon ngjarje, përvoja, ka personazhe, me anën e të cilave organizohet dhe tregohet ngjarja dhe vlerat njerëzore.	fabul, përrallë, legjendë, tregim, novelë, roman etj.
tekst poetik	Përcjell ide, emocione, mbresa. Organizohet në vargje dhe strofa.	poezi, poemë etj.
tekst dramatik	Historia shkruhet në formë dialogu dhe marrin pjesë shumë personazhe.	tragjedi, komedi, dramë etj.

# Rrëfime nga e kaluara

## Para leximit

Folklori përfshin brenda tij gjithë krijimtarinë artistike, gojore, popullore të një kombi. Në të bashkëjetojnë shumë lloje letrare, të cilat sa ngjajnë, aq edhe ndryshojnë. Miti, përralla, legjenda dhe fabula janë forma të ndryshme, të hershme, të krijimit popullor, të cilat shfaqin kufij shumë të brishtë mes tyre. Imagjinata e lulëzuar, fantazia e skajshme shfaqet në tërë këto krijime, duke na futur në realitete fantastike, ku shndërrimet, hiperbolizimet, shfaqjet nga hiçi dhe zhdukjet në hiç, shpirtëzimi i natyrës etj., janë dukuri krejtësisht normale.

## Sfinksi

Në Tebë, pas vdekjes së Lajit, ishte bërë mbret Kreonti. Por i gjori nuk kishte mundur ta gëzonte mbretërinë, se njerëzit e vendit të vet i kishte gjetur një e keqe e madhe. Pak më tej qytetit, mbi malin Fokios, kishte zënë vend një përbindësh i frikshëm. Kokën dhe kraharorin i kishte të ngjashëm me atë të një gruaje, krahët si zog dhe trupin si të luanit. Atë përbindësh e quanin Sfinks. Çdo udhëtari që kalonte andej, ai i thoshte një enigmë dhe e ftonte për ta zgjidhur, ndryshe e kërcënonte se do ta hante. Gjithë sa u kishte rënë rruga nga mali, i kishte ngrënë, sepse askush nuk kishte mundur ta zgjidhte enigmën e tij.

Sfinks i kishte shpërndarë tmerr e frikë në tërë Tebën. Si të shpëtonin nga përbindëshi i frikshëm, që pak nga pak do t'i hante të gjithë? A s'do të gjendej ndokush që ta zgjidhte enigmën? Duhet të themi se Sfinks i do të gremisej nga mali përposh e do të vritej, me t'u gjetur e fshehta e enigmës.

Kreonti, për të shpëtuar tebanët fatkëqij, shpalli se ai që do të zgjidhte enigmën e Sfinksit, do të merrte për grua Iokastën dhe do të bëhej mbret i Tebës.

Edipi, tek po udhëtonte për në Tebë, kaloi nga mali Fokios, ku sundonte Sfinks i. Përbindëshi e ndali dhe e ftoi të zgjidhte enigmën. Dhe ja se ç'pyetje i bëri:

– Cila është ajo krijesë që, në mëngjes shkon me të katra, në mesditë me të dyja e në mbrëmje me të katra, e sa më shumë këmbë të ketë, aq më me vështirësi ecën?

Edipi iu përgjigj në çast:

– Njeriu! Dhe ja përse. Kur është foshnjë, ecën me këmbë e duar, do të thotë me të katra; tek

Pjesë të mitologjisë greke janë edhe krijesa si: Feniksi, Pegaso, Minotauri, Kimera, Ciklopi, të cilët janë shumë të njohur në letërsinë greke. Sfinks i – qenie imagjinare në mitologjinë greke me krahë shpendi, me kokë gruaje, me trup luani ose qeni e me bisht gjarpri, që u jepte kalimtarëve gjëegjëza të vështira dhe i gëlltiste ata, kur nuk i zgjidhnin dot. Në kulturën egjiptiane, sfinks i ishte një krijesë e madhe prej guri, që paraqiste një luan të shtrirë me kokë gruaje ose me kokën e një faraoni për të simbolizuar fuqinë e këtij të fundit.



rritet, ecën vetëm me dy këmbët e tij; dhe, kur plaket, mban edhe shkop. Kur zvarritet me këmbë e duar mundohet shumë në të ecur, kur mban shkop, heq më pak; dhe kur ecën vetëm me këmbë, nuk ndien asnjë vështirësi.

Dhe, gjithë gëzim e krenari, shpalli: – Përbindësh i frikshëm, të munda. Thyej qafën tani!

E vërtet, në të njëjtin çast, Sfinksi u gremis teposhtë malit dhe u vra. Populli i Tebës kishte shpëtuar! Kreonti, sipas zotimit, ia dha Edipit për grua motrën e tij Iokastën dhe hoqi dorë nga froni. Edipi u bë mbret i Tebës.

## Dhelpira me bark të fryrë

Një dhelpër e uritur, që gjeti në një zgavër lisi bukë e mish, lënë aty nga ndonjë bari, hyri me shpejtësi brenda dhe i përlau. Por iu fry barku aq shumë, sa nuk mundi të dalë dot prej andej dhe vuri *kujën*.

Një dhelpër tjetër, që e solli rruga në ato anë, e pyeti se ç'po ndodhte, dhe kur e mësoi, i tha: – Tani duhet të rrish aty brenda, derisa të bëhesh aq sa ishe kur hyre. Kështu do të dalësh fare lehtë.



### Fjalor

*kujë* – klithmë e fortë, të qash me zë të lartë.

*eshkë* – material i thatë dhe shumë i rrudhur që përdoret për të ndezur zjarrin.

*briti* – thirri, bërtiti.

*proftasën* – (nga greq.) arritën.

## Legjenda e Syrit të Kaltër

Njëherë e një kohë, fryu një erë kaq e fortë, sa tundi detin nga fundi dhe deti nxori një gjarpër... Ra një re dhe gjarprin e hodhi në malin e Sopotit... Gjarpri gjigant hante kafshët e njerëzit dhe të mbjellat i prishte...

U ngrit një plak, ngarkoi një gomar me thasë me *eshkë* dhe vajti afër lubisë e i vuri zjarrin eshkës. Kur gjarpri hëngri gomarin, zjarri i eshkës përbrenda e dogji. Bisha *briti*: “Ku je ti det, që më bërë kokën dhe ti lumë, vëllai im...!”. E u shtri për vdekje.

U nis deti nga Vivari dhe lumi nga Sopot, por s’e *proftasën* dot. Në agoninë e ngordhjes, gjarpri përplaste bishtin në faqen e malit, ku mbetën shenjat që duken. Qysh nga ajo kohë, deti me malin janë të lidhur me njëri-tjetrin si babë e bir.

## Studim teksti


## Kuptojmë tekstin

- 1 Lexoni mitin dhe përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme.
  - a) Çfarë fatkeqësie u kishte rënë në kokë tebanëve dhe mbretit të tyre Kreont?
  - b) Ku qëndronte Sfinksit dhe çfarë u kërkonte udhëtarëve?
  - c) Cili do të ishte fati i Sfinksit, nëse zgjidhej enigma?
  - ç) Kush e gjeti përgjigjen e saktë të enigmës dhe a e mbajti fjalën Kreonti?
  - d) Çfarë shpërblimi mori ai që zgjidhi enigmën e Sfinksit?
- 2 Nga vinte gjarpri i legjendës së Syrit të Kaltër? Cilat ishin dëmet që u shkaktonte njerëzve?
- 3 Cili është problemi i personazhit kryesor të fabulës? Çfarë zgjidhjeje i propozohet?
- 4 Në cilin prej këtyre teksteve flitet për një vend gjeografik të identifikueshëm?
- 5 Çfarë pasoje ka lënë deri më sot ajo që i ndodhi gjarprit të frikshëm?

## Analizojmë tekstin




- 6 Bëni përshkrimin e Sfinksit dhe dalloni tri elementet që shkrihen në një, në figurën e Sfinksit.
- 7 Çfarë cilësish tregoi heroi i mitit, Edipi, përballë Sfinksit, përbindëshit të frikshëm?
- 8 Cilat nga veprimet e jashtëzakonshme tregojnë si u krijua Syri i Kaltër?
- 9 Pasi të keni lexuar fabulën, gjeni mesazhin ose mesazhet që përcjell ajo.
- 10 Në disa prej krijimeve të mësipërme, janë të pranishme kafshë dhe shpendë, të cilat kryejnë veprime të pazakonta. Diskutoni rreth këtyre veprimeve dhe pamundësisë që ato të jenë të pranishme në krijime me natyrë të ndryshme nga miti, përralla, fabula dhe legjenda.

## Gjuha e tekstit

- 11 Shënoni me  alternativat e sakta që karakterizojnë gjuhën e krijimeve popullore.
 

<input type="checkbox"/> gjuhë e thjeshtë	<input type="checkbox"/> situata fantastike
<input type="checkbox"/> gjuhë e ndërlikuar	<input type="checkbox"/> fjali të gjata
<input type="checkbox"/> përsëritja e fjalëve	<input type="checkbox"/> situata që synojnë një moral të caktuar
<input type="checkbox"/> fjali të shkurtra	
- 12 Gjeni një krahasim në legjendën e mësipërme dhe analizoni në klasë të dyja anët e krahasimit.

## Detyrë

-  Gjeni në internet informacione dhe imazhe se si e përfytyronin figurën e Sfinksit në mitologji.
-  Syri i Kaltër është shpallur monument natyror. Pse? Përshkruani bukurinë e tij.
-  Me ndihmën e prindërve, gjeni ndonjë legjendë tjetër që rrëfen për Syrin e Kaltër. Krahasojeni me legjendën e dhënë në libër.

## Kush e solli Doruntinën?

## Para leximit

“Kush e solli Doruntinën?” është një baladë shumë e vjetër, qindrvjeçare. Përmes saj, populli shpreh një nga cilësitë e tij më të vyera, mbajtjen e fjalës së dhënë përmes kapërcimit të çdo pengese e çdo vështirësie që mund të dalë rrugës. Ndryshe ajo quhet edhe “Balada e Besës”.



## Fjalor

*okë* – masë peshe, afërsisht 1,5 kg.  
*avlli* – mur rrethues i oborrit të shtëpisë.  
*shpiket* – këtu: shfaqet.  
*stëhi* – qenie mitologjike (përfytyrohet si gjarpër që u bën të këqija njerëzve).  
*zhurit* – përvëlloj, djeg.  
*gjëma* – lajm i keq, mandatë.  
*rrasa* – guri i varrit.  
*gjeraqinë* – një lloj skifteri. Populli e përdor si krahasim për gratë e bukura, të shkathëta e të veshura mirë.  
*kallogre* – grua e mjerë, e veshur me të zeza.

Vajta mora një **okë** mish  
dhe e hodha në kusi  
me vrap dolla në **avlli**,  
të marr një kërcu të zi,  
Të më **shpiket** një **stëhi**  
me vrap m’u hodh në kusi,  
më helmoi djemt e mi –  
nëntë djem e nëntë nuse,  
të nënta me djem në duar!  
Nëntë djepe ç’m’i përmbyse,  
nëntë pajë ç’m’i **zhurite**  
nëntë dyfeqe ç’m’i shite!  
Kostandin, të ardhte **gjëma**  
martove Doruntinën larg,  
larg e larg mërguar  
tri male kaptuar!  
Kostandini u ngrit nga varri:  
**rrasa** iu bë kalë,  
balta iu bë shalë!  
Vrap e vrap e te Doruntina  
– Mirë se erdhe, o im vëlla!  
Në ke ardhur për të mirë,  
të vishem si **gjeraqinë**,  
në ke ardhur për të keq,  
të vishem si **kallogre**.  
– Jo, motër, sikundër je!  
E hipi në vithe të kalit,  
zogjtë udhës seç po thoshin:  
“Cili-viu, viu-viu,  
kush ia bën, ia bën vetiu!  
Keni parë a s’keni parë?  
Shkon një zogëz bishtbardhë,  
I vdekuri me të gjallë”!  
Vete gjer te dera e kishës  
– Ik tani, o moj Doruntinë,  
se kam punë në **ajodhimë**,  
se aty e kam shtëpinë.

## Balada

Në **balada** gjejmë rrëfimin e autorit dhe shprehjen e ndjenjave të tij për ngjarje, të cilat tregojnë një veprim që kërkon trimëri të veçantë. Ato tregojnë edhe botën emocionale të personazhit. Karakteristikë e baladave janë elementet fantastike. Ndër më të njohurat janë: “Balada e murimit”, “Balada e Ymer Agës” etj.

Vajti e trokiti te dera,  
 – Ç’je ti që kërcet në portë?  
 Mos je **bushër** a **murtajë**?  
 A mos je zonja murtajë,  
 që më hëngre djemt’ e mi?  
 – Hap, moj nënë, derën,  
 jam Doruntin’ e vetëm!  
 – Me cilë erdhe, moj Doruntinë?  
 – Unë ardhsh me Kostandinë!  
 – Ç’Kostandin, moj të ardhhtë gjëma!  
 Kostandin i vdekur,  
 ç’bën tre vjet pa tretur?!  
 Një në prak e një në derë  
 plasën si **qelqe** me verë.


### Onomatopeja

Onomatopeja realizohet nëpërmjet imitimit të zhurmave të zërave të natyrës dhe të qenieve të gjalla.



### Fjalor

*ajodhimë* – vend, pjesë e kishës.  
*bushër* – këtu: grua e keqe.  
*murtajë* – sëmundje e tmerrshme  
 vdekjeprurëse.  
*qelqe* – shishe.



## Studim teksti

## Kuptojmë tekstin

- 1 Lexoni baladën dhe përgjigjuni pyetjeve:
- Çfarë ndodhi pasi nëna vuri mishin në kusi?
  - Ku duken shenjat e gjëmës?
  - Jepni detajet që tregojnë se nëna nuk arrin ta besojë ardhjen e Doruntinës.
  - Çfarë tregojnë pyetjet që bën nëna, kur dëgjon trokitjen në derë?
  - Çfarë tregon nxitimi i vëllait?
  - Nga buron gëzimi i Doruntinës?
  - Ç'loj marrëdhëniesh familjare shtjellon kënga?
  - Për cilin virtut të lashtë të popullit shqiptar bën fjalë balada?

## Analizojmë tekstin

- 2 Pse nëna e lidh humbjen e djemve të saj me djepet? Si jepet përmasa e tragjedisë së humbjes përmes numrit 9?
- 3 Gjeni disa krahasime në këngë dhe thoni rolin e tyre.
- 4 Gjatë këngës, ndeshim vargje dyshe që tingëllojnë si refren i kënduar nga një kor. Gjejini ato dhe shpjegoni rolin që luajnë në ngjarje. Ç'mesazh përcjellin?
- 5 Gjeni në baladë dy momentet kur nëna mallkon. Kujt i drejtohet mallkimi i parë? Po i dyti?
- ▣ Pse ato e tensionojnë atmosferën e ngjarjes?
- 6 Ç'përfytyrim ju ngjall onomatopeja: "Cili-viu, viu-viu, / kush ia bën, ia bën vetiu"?

## Gjuha e tekstit

- 7 Identifikoni tiparet e gjuhës së kësaj balade nëpërmjet pyetjeve:
- ▣ Nga se karakterizohet dialogu vëlla-motër?
  - ▣ Shpjegoni rolin e kontrastit në shembujt:  
i gjallë/i vdekur dhe jeta/vdekja.
  - ▣ Gjeni nga një fjalë sinonime në gjuhën standarde për dy fjalët dialektore:  
dyfek \_\_\_\_\_ cilë \_\_\_\_\_

## Detyrë

- ▣ Kthejeni baladën në prozë, duke ruajtur karakteristikat e saj.
- ▣ Gjeni materiale për besën dhe diskutoni rreth tyre. Ndaluni te lidhja mes besës dhe ringjalljes.

## Shkruajmë

Rrëfeni një përvojë personale që lidhet me besën.

Mbani parasysh që jo vetëm të tregoni në vetë të parë faktet dhe ngjarjet që vendosen në një hapësirë dhe kohë të mirëpërcaktuar, por mbi të gjitha të shprehni përjetimet dhe ndjenjat tuaja, duke i përcjellë në mënyrë sa më origjinale. Sigurohuni që shkrimi të ketë: hyrjen, zhvillimin dhe mbylljen.



# Mençuria e popullit

## Para leximit

Teksti i mëposhtëm është një kallëzim popullor që, ashtu si dhe përralla, tregohet nga populli. Ky tekst ndryshon prej përrallës, sepse ngjarjet që tregohen në të janë reale, kanë ndodhur ose mund të ndodhin, si dhe personazhet e tyre janë njerëz të zakonshëm, që i takojmë në jetën e përditshme. Ndërsa ngjarjet e përrallave janë të trilluara, me elemente fantastike, me personazhe që kanë karakteristika ose dhunti të jashtëzakonshme.

Na ishte njëherë një gjysh e një mbesë, bareshë, që jetonin vetëm në malësi. Gjyshi plak me një barrë dru në shpinë, u kthye atë mbrëmje vere i lodhur në shtëpi. Shkarkoi drutë në oborr dhe, duke lëshuar një “uf” të thellë, u ul mbi një gur te pragu.

Baresha, që në atë çast po rregullonte bagëtinë, e dëgjoi, mbylli portën e vathës dhe, duke iu afruar atij, e pyeti me ëmbëlsi:

– A u lodhe fort sot, o gjysh?

– Nga pak, bija ime! E po, plak jam tash, edhe lodhem. Por kur të shoh ty të gëzuar, më përtërihen forcat.

Ajo u ul pranë tij dhe ky i vuri mbi kokë dorën e rreshkur e nyje-nyje.

– Po si e kalove ditën? – pyeti përsëri vajza.

– Mirë e kalova. Bëra drutë dhe, kur po kthehesha në shtëpi, takova në rrugë një njeri të çuditshëm. Ndoshta ishte i lodhur shumë, sepse nga fjalët që më tha, nuk m’u duk njeri me mend.

– Po pse? Çfarë të tha? – e pyeti me kureshtje baresha.

– Kur u takuam në rrugë, u gëzua shumë dhe, pasi më dha një dorë duhan për llullë, më tha: “Sa mirë që të gjeta, more mik, se kështu do ta bajmë me radhë njëri-tjetrin”. Dëgjon ti? Unë mezi po ecja i lodhur nga barra e druve dhe ai më thoshte ta bajmë njëri-tjetrin!

Baresha qeshi.

– Gjysh i dashur, – i tha atëherë, – ti nuk e ke kuptuar atë që ka dashur të thotë ai. Ato fjalë duhen kuptuar kështu: “Sa mirë që të takova, or mik, se duke qenë së bashku, do t’i heqim mërzinë njëri-tjetrit me fjalë”.

– Ashtu?! Po, mirë e ke ti. Kështu do të ketë dashur të thotë.

– Po tjetër, çfarë të tha udhëtari? – pyeti mbesa.

– Kur arritëm te përroi që zbret nga mali, më pyeti: “Ky përrua çfarë sjell me vete, ar e argjend apo lot e helm?”. Kjo më habiti më shumë dhe iu përgjigja aty për aty: “Përroi vetëm ujë sjell me vete dhe asgjë tjetër.” Hë, si thua, ti, u përgjigja mirë?

– Jo, gjysh! Prapë nuk e ke kuptuar çfarë ka dashur të thotë. Ajo pyetje duhet kuptuar kështu: “A e ka kanalizuar fshati këtë ujë, që të ujitë arat e mbjella dhe t’u shtojë prodhimin, apo e keni lënë pas dore që, në dimër, kur të fryhet, t’ju marrë edhe kasollet?”

Gjyshi e pa përsëri mbesën.

– Shiko, shiko, sa bukur e gjete! Vërtet kështu do të ketë dashur të thotë.



## Fjalor

*vathë* – vend i rrethuar me gardh, zakonisht i pambuluar, ku mbahet a ku rri bagëtia.

*kureshtje* – dëshirë e madhe për të parë, për të dëgjuar ose për të mësuar diçka të panjohur ose gjëra të reja.

*kanalizoj* – hap një rrjet kanalesh ujitëse, kulluese që uji të mos përmbytë vendin.

– Po ndonjë gjë tjetër nuk të pyeti? – i tha prapë mbesa.  
 – Kur kaluam pranë varrezave, më tha edhe këtë që më ka mbetur në mendje: “Në këto varreza, a ka shumë të vdekur që jetojnë apo janë shuar njëherë e mirë?”  
 – Po ti, si u përgjigje?  
 – Në varreza vetëm të vdekurit qëndrojnë.  
 – As kësaj radhe nuk e paske kuptuar, o gjysh. Ai, me ato fjalë, të ka pyetur, o gjysh: “Në varrezat tuaja a keni njerëz, të cilët, me veprat, zotësitë e trimëritë e tyre, kanë lënë gjallë emrin e tyre, apo janë vetëm nga ata që s’kanë lënë asnjë kujtim?” Ai burrë, gjysh, duket se do të ketë qenë njeri i ditur. Po ku shkoi? Përse nuk e ftove në shtëpi?  
 – I thashë të vinte, po nuk desh. “Nuk dua të trazoj asnjë”, m’u përgjigj. “Më mirë, po shkoj në mulli ta kaloj natën.”  
 Vajza u mendua pak, pastaj u ngrit dhe i tha gjyshit: – Gjysh, ai nuk njeh njeri këtu. Ndoshta s’ka as të hajë. Si të bëjmë? T’i dërgojmë diçka për të ngrënë?  
 Gjyshi u ngrit dhe tha: – Ia çoj unë. Bëja gati bukën!  
 Vajza hyri brenda dhe, pas pak, doli me një bukë të rrumbullakët në dorë, mbi të cilën kishte vënë edhe gjashtë kokrra vezë.



– Ja, gjysh! Çoja, po mos harro të pyesësh: “Si ishte hëna? Gjysmë apo e plotë dhe sa yje duken në qiell?” Në qoftë se do të dijë të përgjigjet, ai njeri është me të vërtetë i mençur.

Plaku mori bukën e të gjashta vezët, i futi në trastë dhe u nis për te mulliri. Rrugës mendoi: “Një darkë është kjo! Ai i huaji nuk besoj ta hajë të gjithë bukën sonte.”

U ul në një gur, ndau bukën për gjysmë dhe e hëngri së bashku me tri kokrra vezë.

Kur arriti te mulliri e gjeti të huajin, që po qëndronte mbështetur te një shkëmb. Duke i dhënë bukën e vezët i tha: – Mbesa më porositi të bëj një pyetje: “Si është hëna, gjysmë apo e plotë dhe sa yje duken në qiell?”

I huaji iu përgjigj: – I thuaj mbesës se hëna është gjysmë dhe në qiell duken vetëm tri yje.

U kthye plaku dhe i tregoi përgjigjen mbesës. Ajo e pyeti:

– Po ti, gjysh, si ia dhe bukën, gjysmë apo të plotë?

– Jo, – iu përgjigj gjyshi, – i çova gjysmën e bukës dhe tri vezë!

– Gjysh i dashur, – foli baresha, – ai njeri qenka shumë i ditur, veçse më duket se një nevojë e madhe e ka shtrënguar të marrë rrugët nëpër male. Eja të vemi ta takojmë, se mbase e ndihmojmë.

Kur arritën te mulliri, e pyetën të huajin:

– Na trego, çfarë nevoje të ka sjellë deri këtu, se ndoshta mund të të ndihmojmë!

Ai i vështroi me mirënjohje dhe u tregoi:

– Sundimtari i vendit një ditë më tha: “Ty të gjithë të quajnë njeri të ditur. Por unë ende nuk e kam provuar diturinë tënde. Prandaj, dua që brenda muajit të më sjellësh një dash të paqethur, që të ketë në shpinë një mbulesë të përgatitur nga leshi i tij. Në qoftë se nuk e sjell, të shkon koka”.

Baresha duke qeshur iu përgjigj:

– Nuk është edhe aq e vështirë. Ne do të të japim një dash. Do ta qethim në shpinë, ndërsa barkun do t’ia lëmë pa qethur. Me leshin e qethur, unë do të bëj një **velenxë**, që t’ia hedhësh dashit në shpinë. I huaji u mahnit nga kjo përgjigje e mprehtë dhe, duke e falënderuar me gjithë zemër, i tha:

– Të falemnderit, moj bijë! Ta marrë vesh ai **gjakësor** se dituria më e madhe gjendet në mendjen e popullit.



## Fjalor

*velenxë-a* – mbulesë e trashë leshi.

*gjakësor* – njeri i etur për gjak e mizor; vrasës e gjakderdhës.

*Kallëzim popullor*

## Studim teksti

## Kuptojmë tekstin

- 1 Lexoni përrallën dhe përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme.
  - a) Nga sa persona përbëhej familja e bareshës? Cilët ishin ata?
  - b) Kë kishte takuar gjyshi i bareshës rrugës së kthimit për në shtëpi? Çfarë i kishte bërë përshtypje prej bisedës me të?
  - c) Si iu përgjigj i huaji, ftesës së bërë nga gjyshi për të kaluar natën në shtëpinë e tij?
  - ç) A i kuptoi baresha pyetjet e të huajit?
  - d) Çfarë kuptoi baresha rreth të huajit nisur nga mënyra sesi fliste ai?
  - e) Çfarë kuptoi i huaji nga ndihma që i dha baresha në fund të kallëzimit?

## Analizojmë tekstin

- 2 Ndani tekstin në tri pjesë. Dalloni hyrjen, zhvillimin dhe mbylljen e tij.
- 3 Duke analizuar me kujdes bisedën e gjyshit me të huajin:
  - a) gjeni dhe shënoni më poshtë enigmat që fshihen në të;
  - b) si e zbërtheni secilën prej enigmave që fshihet në bisedë.

Enigmat	Zbërthimi
1.	
2.	
3.	
4.	

- 4 Cila ishte "nevoja e madhe" që e kishte sjellë të huajin në ato anë të malësisë?
- 5 Në çfarë mënyre e ndihmoi baresha të huajin në hall?

## Interpretojmë tekstin

- 6 I huaji e quan "gjakësor" sundimtarin e tij. Shpjegoni arsyet e përdorimit të kësaj fjale.

## Gjuha e tekstit

- 7 Si mund ta quani gjuhën që përdor i huaji? Shpjegoni pse përdor ai këtë lloj gjuhë? Ai duket sikur i vë njerëzit në provë. Çfarë po kërkon ai?

## Reflektojmë rreth tekstit

- 8 Vajza e kallëzimit të mësipërm tregohet shumë e mençur. Çfarë simbolizon vajza e re?
- 9 Reflektoni rreth mesazhit të tekstit "... dituria më e madhe gjendet në mendjen e popullit".

## Detyrë

- ▣ Gjeni rrëfime të tjera popullore, të cilat përcjellin mesazhe në fund të tyre.

# Ciklopi

## Para leximit

Kjo pjesë është përshtatje në prozë e veprës "Ciklopi" të Euripidit. Në qendër të saj është një ciklop i fuqishëm dhe i frikshëm me emrin Polifem, i cili shfaqet si një gjigant i egër, që ushqehet me kafshë e njerëz. Ai jeton në një shpellë të madhe ku ka robëruar plakun Silen dhe bijtë e tij, satirët, të cilët i shërbejnë dhe i rrisin bagëtitë. Gjatë peripecive për t'u kthyer në atdheun e tij, Odiseja dhe shokët e tij do të ndalojnë në ishullin e Polifemit, Sicilia e sotme. Ata do t'i shpëtojnë Ciklopit vetëm falë zgjuarsisë dhe dinakërisë së Odisesë.

Ciklopi shfryn.

Shtrihet përmbys mbi bar dhe e pyet Odisenë:

– O i huaj, si e ke emrin?

– "Askushi" më quajnë!

– A, emër i bukur!

– Pa më thuaj, – e pyet Odiseja, – s' do të më bësh ndonjë nder për hir të verës që të dhashë?

– Do të të bëj që ç'ke me të! Do të të ha të fundit!

Pastaj i thotë plakut Silen:

– Hidh verë e sillmë të pi! Ç'më rri?

Ia mbush gotën dhe Ciklopi e zbraz.

– Oh, oh! Hopa! Qielli po më vjen rrotull. Po shoh Zeusin dhe tërë hyjnitë!

**Satirët** fillojnë të kërcëjnë. Ciklopi rrëmben Silenin në krahë dhe, duke kërcyer, humbasin të dy brenda në shpellë. Bashkë me të hyn edhe Odiseja, por pas ca kohësh, del përsëri e u thotë satirëve:

– Të gjitha janë në rregull, o djem! Ciklopi po gërhet në këtë kohë. Sa për **hellin**, gati është! Tani, përpara, dua të tregoheni burra të vërtetë!

Gjunjëzohet e falet:

– **Hefest**, hyjni i Etnës! Na ndihmo të shpëtojmë nga kjo egërsirë, para se të na gllabërojë të gjithëve! Gjynah është që të na hajë një Ciklop ne që na nderoi një Trojë e tërë!

Odiseja hyn për pak në shpellë për të parë se ç'bëhet dhe del përsëri. Me gishtin në buzë u bën shenjë satirëve të heshtin.




## Fjalor

**satirë** – qenie mitologjike, që u ofronin njerëzve verë dhe i ftonin në argëtim (këtu ata janë robëruar prej Ciklopit).

**hell** – shkop i hollë me majë, nëpër të cilin kalohet mishi që të piqet.

**Hefesti** – perëndia e zjarrit, vullkaneve dhe farkëtimit.

**Euripidi** është një nga tre përfaqësuesit më të mëdhenj të tragjedisë së antikitetit grek, së bashku me Eskilin dhe Sofokliun. Ai shkroi mbi 90 vepra, nga të cilat janë ruajtur të plota 18 tragjedi, 1 komedi, si dhe fragmente pjesësh të tjera. Temat e tragjedisë bazohen në mite dhe legjenda. Ka të veçantë faktin që perënditë i paraqet si njerëz të zakonshëm me problemet, me dashuritë e xhelozitë e tyre. Në veprat e tij, ai krijoi karaktere, ngjarje e situata nga më të çuditshmet. Janë shumë të njohura tragjeditë e tij: si "Medea", "Elektra" dhe "Ciklopi".





## Shënim

Ciklopët janë figura të mitologjisë, të paraqitur kryesisht si gjigantë me një sy të vetëm e të rrumbullakët në qendër të ballit.

Në varësi të miteve, ciklopët janë bij perëndish të ndryshme (Urani, Poseidoni) dhe paraqiten si farkëtarë, artizanë apo barinj.

– Shëëët! As frymë mos merrni! Bëni kujdes mos kollitet ndonjëri! Po fle në gjumë të thellë...

– Mirë, do ta mbajmë frymën.

– Ejani tani të kapim hellin të gjithë bashkë.

Atëherë disa prej tyre thonë:

– Oh, oh, ne po çalojmë! Nuk futemi dot!

– Oh, – thonë të tjerët, – edhe ne po këtë gjë pësuam. S’hyjmë dot. Shikoni këmbët tona qysh u shtrembëruan...

– Po, po! Na u mbushën sytë me pluhur. Si të hyjmë?

Odiseja nxehet e u thotë:

– Dredharakë qenkeni të gjithë!

– Si është e mundur? – i përgjigjen. – Dinakë qenkemi se nuk kemi oreks të hyjmë brenda e të na i bëjë turinjtë përsesh Ciklopi?

– Mjaft! – u thotë me të egër Odiseja. – Ju mora vesh mirë. S’e dua ndihmën tuaj. Do të më dalin krah shokët e mi.

Odiseja hyn në shpellë. Satirët fillojnë të këndojnë e të bëjnë gjeste:

– Shtyjeni, o trima, sa më thellë të mundni hellin dhe digjeni syrin e bishës!

Pas pak, nga brenda shpellës dëgjohej ulërime të forta të Ciklopit.

– Oh, oh, më iku syri!

– Sa bukur po këndon, o Ciklop! Këndo përsëri, – i thonë me të tallur satirët.

– Oh, oh! – çirret pa ndaluar Ciklopi. – Këta hiç njerëz më poshtëruan. Por unë do t’ua rregulloj mirë qejfin. Do të qëndroj te dera, do ta ruaj me duar e asnjëri s’do të më shpëtojë.

Ndërkohë shkon te hyrja dhe e zë me duar. Fytyrën e ka me gjak dhe syrin të djegur.

– Ah, ah, oh!

– Pse po bërtet, o Ciklop? – e pyet një satir.

– Mora fund, unë i ziu!

– Ç’pësove! Mos vallë re në zjarr siç ishe i dehur?

– S’rashë në zjarr, por më verboi Askushi!

– Gjersa s’të verboi askush, përse çirresh?

– Më verboi Askushi, po ju them!

– Dhe ku është tani ai që të verboi?


**Fjalor**

çirret – thërret fort me zë të ngjirur.

terr – errësirë.

profeci – diçka e paralajmëruar, e parathënë.

– E ku ta di unë? Mos vallë e patë ju gjekundi? Ata të huajt janë ende brenda apo ikën?

– Janë fshehur në skutat e shpellës e gëk nuk bëjnë.

– Në ç'drejtim?

– Nga e djathta jote!

Ciklopi lë hyrjen e shpellës dhe në **terr** e duke u lëkundur shkon në brendësi të saj. Kërkon me duar nëpër shkëmbinj, por Odiseja me shokë rrëshqasin me mjeshtëri, dalin nga shpella dhe përgatiten të ikin drejt detit, ku kanë lënë anijen e tyre. Ciklopi vijon të kërkojë nëpër shpellë. – Po ku janë? – pyet.

Atëherë i thërret Odiseja:

– Larg teje ndodhem unë, Odiseja!

– Po, po, tjetër emër paske tani, o i mallkuar?

– Këtë emër më dha nuni im. Dhe mëso se, pa hakmarrje, nuk do të të lija unë, fitimtari i Trojës, ty bishë që më hëngre shokët!

– Medet për mua! – rënkon Ciklopi. – Tani po i kujtoj të gjitha.

Një **profeci** e vjetër më kishte thënë se do të më verboje ti, kur të ktheheshe nga Troja. Por edhe për ty, o i mjerë, më tha se shumë do të heqësh nëpër dete, para se të mbërrish në ishullin tënd.

– Mos u shqetëso për mua! – i përgjigjet Odiseja. – Ti qaj fatkeqësinë tënde. Unë po shkoj në anije për t'u nisur drejt vendit tim.

– Mos u ngut aq shumë, – i thotë Ciklopi. – Diçka po të përgatit. E sheh këtë shkëmb? – Shkul një shkëmb vigan. – Do ta flak mbi anije e do t'ju fundos të gjithëve, pa le të jem i verbër!

Odiseja me shokët nisen për tek anija.

*“Euripidi në prozë”, përshtatur nga J. Benekos*

### Analiza e një personazhi

Kur bëhet analiza e një personazhi, duhet të ndiqet një rend logjik. Në fillim duhet të trajtohen aspekte të përgjithshme, më pas të ndalohej në analizën e detajuar. Analiza duhet të përmbajë dy elemente: përshkrimin e portretit fizik dhe zbulimin e karakterit.

☑ Analiza e portretit fizik të personazhit synon aftësimin e lexuesit/es për ta imagjinuar atë. Në të përfshihen: ngjyra e lëkurës, sytë (forma, ngjyra, shprehja), goja dhe buzët (forma dhe madhësia), trupi (gjatësia dhe pesha), flokët (ngjyra, gjatësia, dendësia e tyre), por dhe mustaqet, mjekra, rrobat, këpucët (materiali, stili dhe ndonjë shenjë dalluese).

☑ Në analizën e karakterit përfshihen cilësitë morale, mendore, shpirtërore etj. Ndër këto cilësi radhiten ndershmëria, dinjiteti, mendjemprehtësia, mençuria, përpikëria, toleranca, mirësia, guximi, mirënjohja, mikpritja, drejtësia, zemërgjerësia etj.

Pjesë e analizës së personazheve bëhet edhe marrëdhënia e tij me familjen, miqtë dhe armiqtë e tij.

## Studim teksti

### Kuptojmë tekstin

- 1 Lexoni tekstin dhe përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme.
  - a) Me cilin emër i prezantohet Odiseja Ciklopit?
  - b) Odiseja i jep Ciklopit për të pirë verë. Si do t'ia kthejë ai këtë nder? Po Odiseja, çfarë plani ka?
  - c) Duke qenë se Ciklopi është gjigant, përballja me të është betejë e humbur. Çfarë rruge zgjedh Odiseja për të shpëtuar prej tij?
  - ç) Si e quan Ciklopi Odisenë në fund? Po Odiseja Ciklopin?
  - d) Cilat janë dy parashikimet që përmenden në tekst? Cili prej tyre u realizua? Cili realizohet në të ardhmen?

### Analizojmë tekstin


- 2 Duke u nisur nga personazhet dhe ndodhitë e tekstit, në çfarë kohe mendoni se zhvillohen ngjarjet?

## Studim teksti

- 3 Odiseja njihet si personazh dinak dhe shumë i zgjuar. Pse nuk ia tregon emrin e tij të vërtetë Ciklopit?
- Duke i thënë këtë emër, mund t'i shkaktojë frikë atij.
  - Ka frikë se Ciklopi e di profecinë që dikush me emrin Odise do ta verbojë.
  - Të gjithë e dinë që Odiseja është më i fortë fizikisht se Ciklopi.
- 4 Odiseja nuk pranon t'u nënshtrohet rrethanave. Ai vendos të luftojë kundër Ciklopit. Satirët kanë pranuar robërinë dhe i shërbejnë Ciklopit. Ata i thonë Odisesë: "nuk kemi oreks të hyjmë brenda e të na i bëjë turinjtë përshesh Ciklopi". Ç'anë të karakterit tregojnë ata nëpërmjet këtyre fjalëve? Pse autori i vendos satirët përballë Odisesë?
- 5 Pse Ciklopi i quan "hiç njerëz" Odisenë dhe shokët e tij?

## Interpretojmë tekstin

- 6 Dalloni fjalët përqeshëse që i drejton Ciklopi Askushit. Si mendoni, cilat janë arsytet që ai flet në këtë mënyrë?
- 7 Odiseja është ndeshur dhe ka fituar luftëra. Në këtë përballje, ai nuk përdor armët, por mendjen. Megjithatë ai u lutet perëndive: "Hefest, hyjni i Etnës! Na ndihmo të shpëtojmë nga kjo egërsirë para se të na gllabërojë të gjithëve". Pse?
- 8 Lidhni me shigjetë veçoritë dalluese në portretizimin e dy personazheve. Bëni analizën e portretit fizik dhe të karakterit të secilit prej tyre.

Odiseja	dinak gjigant mendjemprehtë i guximshëm i pamëshirshëm i mbifuqishëm i egër i panënshtuar		Ciklopi
---------	--	---	---------

## Gjuha e tekstit

- 9 Shpjegoni kuptimin e secilës prej këtyre shprehjeve:
- Qielli po më vjen rrotull. \_\_\_\_\_
  - ...gëk nuk bëjnë. \_\_\_\_\_
  - ...shumë do të heqësh... \_\_\_\_\_
- 10 Dialogu me fjali të shkurtra rrit tensionin e ngjarjes. Çfarë shton përdorimi i shpeshtë i pasthirmave? Nënvizojini ato në tekst.

## Bashkëbisedojmë

- Duke u nisur nga historia e Odisesë me Ciklopin, reflektoni mbi raportin e forcës fizike me forcën mendore. Më mirë i fortë apo i zgjuar?

Po

Pse?

Jo



# Urtësia e popullit

## Para leximit

Proverbi është një fjali e shkurtër, që shpreh një mendim të plotë e të figurshëm, i cili përgjithëson përvojën e shumë brezave e përmban një mësim të urtësisë popullore. Proverbat quhen edhe fjalë të urta. Ato janë shprehje të njohura me kuptim të njësishtëm e zakonisht të figurshëm, që përgjithësojnë një vëzhgim a një vlerësim për dukuritë e ndryshme të jetës. Proverbat mund të jenë krijim popullor ose krijim autorial (kur i përkasin një autori të caktuar).



## ■ Proverba për diturinë

Fol pak, por mendo, shiko e dëgjo shumë.

I mençuri tregon shumë gjëra me pak fjalë, *i marri* flet gjithë ditën e s'tregon asgjë.

Më mirë të dish, sesa të kesh.

Trimëria pas luftës dhe mençuria pas kuvendit nuk vlejnë më.

## ■ Proverba për punën

Dora me baltë, buka me mjaltë.

Kullote dhinë, të të mbushë *kusinë*.

S'bëhet vreshti me *urata*, po me shata e lopata.

Ku ka bletë, ka dhe mjaltë.

Rrëfen puna, s'rrëfen guna.

Ku ke punën, shtro (edhe) gunën.

Kush luan këmbët, luan dhëmbët.



## Fjalor

*i marri* – i çmendur, i shkalluar.  
*kusi* – enë e metalit, e rrumbullakët dhe e thellë, me dorezë si të kovës, që përdoret për të ngrohur ujë.  
*uratë* – lutje.

## ■ Proverba për koprracinë

Koprraci humbet çdo gjë nga lakmia për të pasur gjithçka.

Të varfrit i mungojnë shumë gjëra, koprracit i mungon gjithçka.

As gurë s'të jep koprraci.

## ■ Proverba nga "Meshari"

Proverbat janë pjesë e letërsisë gojore, por ato i gjejmë të shkruara që në librin e parë shqip "Meshari" i Gjon Buzukut (1555).

Disa nga proverbat që përmban "Meshari" janë renditur më poshtë:

Qish mos do të jetë bam ty, ti mos e bajnsh kujnjaj. (Çfarë nuk do që të të bëhet ty, mos ia bëj askujt.)

Mos del dëshmi reshim, askujnaj. (Mos dil dëshmitar i rrejshëm ndaj askujt.)

Gjithëkush të jetë i drejtë me zemër, e gjithkush atë të ndjekë. (Gjithkush të jetë i drejtë me zemër, e gjithkush atë të ndjekë.)

Mos ini të pritem me xanë. (Mos përtoni me nxënë.)

Kush rall mbiell, rall kuorën. (Kush rrallë mbjell, rrallë korr.)

Populli it mbë vend të vet. (Populli yt, në vend të vet.)



## ■ Proverba për miqësinë

Hekuri njihet në zjarr, miku në nevojë.  
Miku i mirë njihet në ditë të vështirë.  
Thuamë ç'shokë ke, të të them cili je.  
Në rrezik e në nevojë, shoku shokun ta ndihmojë!

### Studim teksti



#### Kuptojmë proverbat

- 1 Në proverbat për punën: "Dora me baltë, buka me mjaltë" dhe "Ku ka bletë, ka dhe mjaltë", çfarë kuptimi ka fjala *mjaltë*?
- 2 Çfarë kuptimi ka shprehja *luan këmbët* në proverbin "Kush luan këmbët, luan dhëmbët"?
- 3 Çfarë mesazhi përcjell proverbi "Trimëria pas luftës dhe mençuria pas kuvendit nuk vlej në më"?
- 4 Përse miku i mirë nuk mund të njihet në një ditë të zakonshme, por në ditë të vështirë?

#### Analizojmë proverbat

- 5 Si e kuptoni proverbin "Të varfrit i mungojnë shumë gjëra, koprracit i mungon gjithçka"? Cilat janë ato vlera që u mungojnë njerëzve koprracë?
- 6 Si e kuptoni fjalën e urtë "Më mirë të dish, sesa të kesh"? Përshkruani një situatë ose ngjarje që lidhet me thelbin e këtij proverbi.

#### Gjuha e proverbave

- 7 Gjeni në listën e mësipërme, dy proverba që kanë folje në mënyrën urdhërore.
- 8 Nënvizoni të gjithë emrat që përmbajnë proverbat e renditur më lart dhe tregoni cilët prej tyre janë emra konkretë dhe cilët abstraktë.
- 9 Vëreni me kujdes në çfarë kohe janë foljet e proverbave. Si mendoni, përse është përdorur kjo kohë e foljes? Çfarë tregon kjo për vlerën e proverbave?

#### Detyrë

- ▣ Gjeni në *Fjalorin e gjuhës shqipe* fjalë të urta për atdhedashurinë, zgjuarsinë, të mirën, të keqen. Punoni në grupe.
  - Grupi 1:** Gjen, lexon dhe komenton fjalët e urta që flasin për atdhedashurinë.
  - Grupi 2:** Gjen, lexon dhe komenton fjalët e urta që flasin për zgjuarsinë.
  - Grupi 3:** Gjen, lexon dhe komenton fjalët e urta që flasin për të mirën.
  - Grupi 4:** Gjen, lexon dhe komenton fjalët e urta që flasin për të keqen.
- ▣ Gjeni në *Fjalorin e gjuhës shqipe* proverba, personazhet e të cilave janë kafshë, p.sh.: gomari, kali, ujku, qeni. Për secilin proverb, tregoni ç'anë të karakterit të njeriut simbolizon kafsha.

# Djaloshi i gurtë

## Para leximit

Një grup fëmijësh vizitojnë studion e një skulptori, i cili është duke gdhendur një vepër arti. Gjatë kohës që ai punon, fëmijëve u bën përshtypje mënyra si e trajton djaloshin që po gdhend, gjithë përkushtim dhe dashuri. Si të ishte i gjallë. Në momentin që duhet të realizojë duart, skulptori ndalet dhe mendohet çfarë të vendosë në to. Fëmijët i bëjnë disa sugjerime, të cilat ai i vlerëson shumë dhe i merr parasysh.

Nëpër një *deriçkë* të vogël hymë në një kopsht të bukur. Aty, në një kënd po rrinte një njeri me kostum pune, me duar *të përvjelura*. Ish ulur mbi një karrige dhe shikonte një gur të gdhendur në trajtën e njeriut. Rrinte pa lëvizur dhe vetëm nganjëherë kruante kokën pas veshit me *latues* të hekurt.

– Mirëdita, xha Demo! – e përshëndeti shoku ynë, që na çoi aty e mandej e nderuam edhe ne gati njëzëri.

Në fillim u duk sikur u tremb dhe deshi ta mbronte atë shkëmb të gdhendur.

Kushedi. Ndoshta i shkoi ndër mend se mund t’ia prishnim. Por, pas pak, bëri sikur na njohu. U ngrit në këmbë për të na pritur.

– Urdhëroni, mirë se vini... Përshëndetuni edhe me Djaloshin.

Unë kujtova se mund të ishte edhe dikush tjetër aty, por sado që e kërkova me sy, s’e pashë dot.

– Djaloshi i gurtë s’mund të flasë, xha Demo,  
– ia bëri Besniku, i cili e kishte hetuar hutimin e plakut.

– Si s’flet, or bir? Unë po bisedoja me të, kur erdhët ju.

– E ç’thoshte?

– Thoshte: më bëj të bukur, që të më duan fëmijët.



## Fjalor

*deriçkë* – derë e vogël.  
*të përvjelura* – të përveshura.  
*latues* – ai që gdhend gurin ose drurin.



**Vehbi Kikaj** (1942 – 1986) është një ndër shkrimtarët kosovarë më të njohur të letërsisë shqipe për fëmijë. Ndër veprat e tij përmendim “Gurrat”, “Zogu i argjendtë”, romanin për fëmijë “Sarajet e bardha”, si dhe përmbledhjen “Shtëpia ime ka sy”, e cila ndahet në dy pjesë. Në pjesën e parë ka 34 poezi, ndërsa në të dytën, 5 tregime dhe 5 vjersha. Vehbi Kikaj ka qenë redaktor i gazetës “Rilindja për fëmijë” dhe më pas i revistës “Pionieri”.



Besniku më shkeli syrin. Më shkoi mendja se mund t'i bënte ndonjë sherr plakut, prandaj nxitova të flas para tij.

– Qenka djalosh i mrekullueshëm, xhaxha. Si e ka emrin?

– Djalosh. Ky është Djaloshi i Lirisë, a ju pëlqen?

– Emër i bukur. E gëzoftë!

– Do të jetë i lumtur, kur ta vendosim para Pallatit të Fëmijëve. Aty do të qëndrojë gjithë jetën dhe do t'u japë fëmijëve ujë me ibrik të argjendtë. A s'është kështu, Djalosh?

– Iu drejtua në fund gurit të gdhendur.

Por ai heshte.

Djaloshi i Lirisë kishte shtat të hedhur dhe qëndronte në këmbë mbi një copë shkëmbi.

Kokën e mbante lart me krenari të dukshme.

Shikonte ëmbël nën dy vetulla të drejta. Këmbët i

kishte të forta, por duart i mungonin. Në vend të tyre, ishte

një copë shkëmb i pagdhendur.

– Pse s'ia nxirrni edhe duart, xhaxha?

– Eh, duart është vështirë t'ia punoj. S'di si t'ia bëj. Njërën e kam menduar, do të mbajë me të ibrikun e argjendtë. Nga ibriku do të rrjedhë ujë i kulluar, i cili na i shëron plagët e luftës, por ju nuk dini ç'është lufta... Në dorën tjetër s'di çfarë t'i gdhend.

– Unë mendova diçka tjetër, – i thashë me *drojë*.

Ai ktheu përtueshëm kokën dhe më shikoi. Pastaj ma mbylli njërin sy dhe tha:

– Fol!

– Në dorën e djathtë, bëjini librin!

– Librin, thua?

– Po, librin, xhaxha. Ai është si qiriu i Naim Frashërit, që na bën dritë në jetë, thotë mësuesi ynë, – i thashë.

Mjeshtri dëgjonte i habitur.

– Rrini këtu pranë meje, – tha më në fund. – Kur ju shoh juve, e gdhend më bukur në mendje Djaloshin e Lirisë. Edhe duart më dëgjojnë më mirë. [...]

Ne ishim të lumtur që mund ta ndihmonim një artist.

– Nesër do të jetë gati Djaloshi, – pëshpëriti si për vete xha Demoja.

– Edhe pushkën thua?

– Jo pushkën, – tha Besniku. – Ky është në liri.



## Fjalor

*drojë* – druajtje, frikë.

*kaploj* – e pushtoj dhe e mbuloj me krahë.

– Por duhet ta mbrojë lirinë, – tha plaku dhe drodhi kokën.  
Të dy sytë i flakëruan prej gëzimit. Na e shtrëngoi dorën të gjithëve dhe filloi punën. Sillej rreth Djaloshit dhe herë-herë e përqafonte si i luajtur mendsh nga gëzimi. Edhe mua më kaploi një gëzim i pafund. Dhe kisha të drejtë: Djaloshi i Lirisë u zbukurua edhe nga fjalët e mia.

## Studim teksti

### Kuptojmë tekstin

- 1 Përgjigjuni pyetjeve rreth tekstit:
  - ▣ Ku shkuan fëmijët dhe kë takuan atje?
  - ▣ Çfarë po bënte xha Demoja në atë moment?
  - ▣ Çfarë u kërkoi mjeshtri fëmijëve, që i bëri ata të habiteshin?
  - ▣ Çfarë ishte *Djaloshi i Lirisë* me të cilin bisedonte plaku?
  - ▣ Për çfarë i pyeti xha Demoja fëmijët? Pse mjeshtrit i pëlqeu shumë përgjigjja e djalit?
  - ▣ Ku dëshironte ta vendoste statujën xha Demoja?

### Analizojmë tekstin

- 2 Pse xha Demoja ia ka vënë emrin statujës *Djaloshi i Lirisë*?
- 3 Për çfarë ranë dakord fëmijët me xha Demon?
- 4 Pse mjeshtri i vendosi një pushkë në dorë *Djaloshit*?
- 5 Gjeni në tekst fjalitë që tregojnë përkushtimin dhe dashurinë e artistit për veprën e tij. Shpjegoni pse ndodh kjo.
- 6 Si ndikuan fëmijët në punën e skulptorit?
- 7 Në tekst përmendet emri i një shkrimtari të madh të letërsisë shqipe. Çfarë synon të sjellë autori nëpërmjet tij?

### Gjuha e tekstit

- 8 Në këtë pjesë, dialogët janë të shpeshtë. Kjo nxit të vepruarin apo të menduarin?
- 9 Autori e krahason librin me qiriun. Pse?
- 10 Në tekst vërejmë se fjalët *Djaloshi i Lirisë* janë shkruar me germë të madhe. Çfarë mesazhi synon të përcjellë autori në këtë rast?

### Reflektojmë rreth tekstit

- 11 Çfarë nevojitet më shumë për ndërtimin e një shteti të fortë, pushka apo libri?
- 12 Po në ditët e sotme, çfarë i duhet më tepër Kosovës: libri apo pushka?

### Detyrë

- ▣ Lexoni poezinë "Fjalët e qiririt", të Naim Frashërit. Diskutoni në klasë rreth mesazhit që përcjell ajo.

# Kujtimet

## Para leximit

Fragmenti i mëposhtëm është shkëputur nga tregimi "Nën myshk". Në të vihen pranë njëra-tjetrës dy faza të ndryshme të rrjedhës së jetës së njeriut. Fëmijëria, periudha e mbushur me lojëra, por që është vendimtare në krijimin e karakterit të tij, dhe stadi i pjekurisë, kur njeriu ka mundësinë për të reflektuar mbi jetën, mbi gjithçka që ka ndodhur. Fëmijëria shihet si periudha më e bukur e jetës dhe kujtimet e saj i sjellim vazhdimisht në mendje, me shumë mall.

– Nuk dua më! – Hajt, tash ti bëhu kalë!...

*Ngojca* u hoq nga goja dhe u qit për tokë. Mandej edhe të tjerët i hodhën veglat e lojës. Të gulshuar prej vrapimit të hovshëm nëpër rrugët me pluhur të qytetit, fëmijët u rreshtuan nëpër bar të vyshkur.

– Tash e tutje, unë do t'i marr *frenjt* e t'i mbaje ngojcën, – bërtiti ai që pak parandej ishte kalë.

– E unë do ta shtyj këtë rrotën tënde, – i tha tjetri fqiu të vet dhe e muar veglën.

U bë një zhurmë e madhe, ndërsa po merreshin vesh ndër vete se çka do të ndiqte secili prej tyre. Më në fund, çdo gjë u zgjidh. U ndërruan rolet dhe veglat e lojës. Vargu i hasharinjve rishtas vrapon. Me hov e potere. Me sy të ngulur në veglat e tyre, sikur të donin t'ua cikin tërë ëmbëlsinë e lojës.

Kur pak më vonë u gjetën pranë dyqanit të pemëshitësit Ymer, papritmas fryu një erë e furishme. Malli i tij, i rregulluar për bukuri, përpara *dugajës* së vogël, fluturoi rrugës teposhtë... Shportat e vjetra, arkat e luhatshme dhe teneqetë e ndryshkura, bënë të qeshë bota me rrokullisjet e tyre buçitëse.

– Të vraftë Zoti që të bëri! – e mallkoi erën pemëshitësi *bablok*, duke shikuar mallin e vet të mjerë nëpër kalldrëmin e çarshisë. ...

Ndërsa ai shtrëngonte dëshpërueshëm grushtet nga e keqja që e gjet dhe pa mundur të bëjë gjë, fëmijët e muarën situatën në dorë.



**Hivzi Sulejmani** (1910-1975) është një ndër shkrimtarët e parë të Kosovës, që vuri bazat e letërsisë në prozë. Lindi dhe u rrit në Mojtir (Sanxhak), por jetoi e punoi në Kosovë deri në fund të jetës. Studioi për një degë që nuk kishte lidhje me letërsinë, por ia kushtoi gjithë jetën asaj. Kontribuoi në fushën e prozës, të publicistikës, të përkthimeve etj. Veprimtaria e tij letrare përfshin jo vetëm poezi, tregime, novela e romane, por edhe krijime në dramaturgj. Ndër veprat më të njohura të këtij shkrimtari përmendim romanet "Njerëzit" dhe "Fëmijët e lumit tim", novelën "Era dhe kolona", vëllimin me tregime "Ëndrra e korbit".



Me shkathtësi i fërfëlluan veglat e lojës dhe si anza u turrën në pemët e derdhura, duke grabitur sa më shumë që mundën. Duke i parë se si po shtyhen për tokë duke ia rrëmbyer mallin si grykës, pemëshitësi u nguros prej mjerimit.

– Leni aty, bre shejtana! – u bërtiti me hidhërim. – Mos ma prekni mallin...

Fëmijët u trembën dhe menjëherë ikën. Ikën, por me xhepa dhe gji plot. Duke e parë në hall, pemëshitësit plak iu afruan dyqanxhinjtë fqinjë. Ndërsa i mblidhnin enët, perimet dhe pemët, fëmijët qëndronin anash dhe shikonin veglat e tyre të lojës, të cilat kishin mbetur atje ku filluan të grabisnin pemët.

– S'ka hajr prej fëmijëve të sodit! – pikllueshëm i ankohej Ymeri fqiu, i cili e ndihmonte për rregullimin e mallit. Gjysmën e pemëve ma kanë rrëmbyer, bre *hajnat* që janë!...

Duke i ndëgjuar këto fjalë, fëmijët shikuan njëri-tjetrin. Duart u shkuan pavetëdijshtëm kah xhepat, kah gjinjt. U erdh keq për të shkretin bablok.

– T'ia kthejmë! – tha njëri gjallërisht dhe u hodhi shokëve një shikim pyetës.

– Por tash s'guxojmë t'i afrohem! – tha tjetri mendueshëm. – Unë po shkoj i pari! – shtoi më i guximshmi dhe u nis me hapa të vendosur. Ndërsa ai kalonte rrugën në anën tjetër, sytë e të tjerëve e shoqëronin ngultas. Me frigë pritej momenti kur do ta kapte pemëshitësi për ta rrahur. Por babloku ishte i qetë dhe mirrej me rregullimin e mallit të mbledhur.

– Qe pemët tuaja, *mixhok!* – i tha fëmija gazmueshëm dhe filloi t'i shprazë xhepat.

### Fabula

Fabula shënon vetëm vargun e ngjarjeve kryesore, pra jo gjithçka që përmban vepra. Një vepër letrare përfshin brenda saj ngjarje, përshkrime, një shumësi ndjenjash, mendimesh, qëndrimesh etj. të gjitha këto përbëjnë përmbajtjen e veprës. Përmbajtja përfshin gjithë materien e veprës, madje edhe titullin, ndërsa fabula shënon vetëm rrjedhën e ngjarjeve.



### Fjalor

*ngojca* – pjesa e hekurt ose nyja e frerit, që i vihet në gojë kalit.

*frenjt* – mjet për ta ndalur dikë që të mos sillet a të mos veprojë keq, pengesë.

*dugajë* – dyqan.

*bablok* – babai, gjyshi a dikush tjetër, kur i drejtohem me dashuri, me përkëdheli ose me dashamirësi.

*hajnat* – hajdut.



Plaku ktheu kryet dhe e shikoi me bisht të syrit. Mandej buzëqeshi miqësisht dhe shtoi i kënaqur:

– Ashtu, ashtu, biri im! Duket se je prej shtëpisë së mirë, fisnik... Hajde, mbama këtë shportë që t'i rregulloj specat njëherë. Gjithçka është përzjerë dhe pluhuruar...

Duke parë shokun se si po punonte me pemëshitësin, ata si të urdhëruar vrapuan kah ai.

– Gjysh, ku t'i qesim pemët? – bërtiti me zhurmë e gjallëri, ndërsa sytë i shkëlqenin gëzueshëm.

E pemëshitësi plak, njeri shtatshkurtër dhe pak i çalë në njëren këmbë, me mosbesim dhe tashmë krejt i hutuar, u hodhi një shikim të zgurdhuar.

– Edhe ju keni prurë, a?! ... Sa të mirë janë fëmijët e sodit!... Qe, qitni këtu *sugarët* e mi. Vetëm jo të gjitha në një vend. Dardhat veç, mollat veç. Të gjitha veç e veç.

– E kalamaj! – u mahnit plaku dhe buzëqeshi. – Kush është më punëtor, unë apo ju?

– Ti, mixhë! – bërtitën fëmijët gëzueshëm e sikur një zë.

– Jo, jo! – vazhdoi plaku. – Edhe ju jeni të zellshëm. Po edhe djem të mirë. Hajdeni pra dhe secili merrni nga dy kokrra pemë! Mollë, dardhë... çka t'ju dojë zemra.

Të hutuar pak, fëmijët vetëm shikuan shoqi-shoqin. Mandej lëshuan sytë teposhtë dhe mbetën si qirinj.

## Fjalor

*mixhok* – xhaxha.

*sugar* – fëmijë i vogël, djalë i vogël.

*çare* – medoemos, me domosdoshmëri.



– Hajt, hajt!... S'keni **çare** pa marrë. E keni hak.

Pasi asnjëri nuk u afrohej pemëve, plaku kapi të parin përdore, i priu kah shportat dhe i urdhëroi:

– Merr, babo! Merr prej cilave të duash!

Dora më në fund lëvizi dhe kapi ngurrueshëm një kokërr dardhë. Mandej ju desht' të marrë edhe të dytën.

– Ashtuuuu! – bëri pemëshitësi i kënaqur. – Hajt, tash dhe ju!

Njëri pas tjetrit, të gjithë bënë kështu. E pastaj vrapuan fluturim kah lodrat e tyre.

Tashmë janë duke kërcyer nëpër rrugë. Pemët e dhuruara i kafshojnë me ëndje.

Kush është më i shpejtë, era apo fëmijët?...

\* \* \*

Shumë vjet kanë kaluar prej atyre ditëve. Krejt një jetë e plotë. Një jetë me brenga, përpjekje të rënda, luftëra. Jetë në shtangim e përpëlitje...

E njëri prej fëmijëve të atëhershëm rri sot para hotelit. Rri i pikëlluar pranë tavolinës dhe i kundron kalimtarët mu prej këtij vendi ku dikur ishte hani i famshëm i Hasan Agës. I kundron njerëzit e rinj dhe pleq. I kundron me dëshirë që të njohë ndokënd. Që të gjejë pamjen e tjetrit, të heqë perden e së kaluarës... Por, pas kaq vjetësh, pas dyzet vjetëve të jetuara gjetiu, ai është tash i huaj në vendlindjen e tij. Kurrkund nuk janë më as pemëshitësi bablok, as teneqexhiu plak. Po as vargu i gazmueshëm i fëmijëve. Tashmë nuk janë edhe shumë dyqane e shtëpi, shumë rrugë e rrugica.

Rri fëmija i dikurshëm dhe shikon botën që ecën. Shikon njerëzit dhe mendon. E lumi gurgullon, gurgullon... Mu ashtu si dikur – plot hare dhe gjallëri. Në lumin që natë e ditë rrjedh në *amshueshmëri*. [...]

Çlodhet fëmija i dikurshëm dhe mendon. Çlodhet dhe përpiqet të përtërijë kujtimet, të pasqyrohet në të kaluarën.

### Subjekti

Subjekti ka të bëjë me rendin që ndjek një vepër dhe me mënyrën se si janë zhvilluar dhe lidhur ngjarjet me njëra-tjetrën. Nëse priset ky rend, atëherë humbet kuptimi i veprës. Shpesh ndodh që subjekti barazohet me fabulën. Në të vërtetë, fabula përfaqëson ngjarjet në rrjedhën e tyre, ndërsa subjekti është mënyra se si rrjedhin ngjarjet në veprën letrare.



### Fjalor

*amshueshmëri – përjetësi.*

## Studim teksti

### Kuptojmë tekstin

- 1 Përgjigjuni pyetjeve rreth tekstit.
  - ▣ Çfarë po bënin fëmijët nëpër rrugët e qytetit?
  - ▣ Çfarë i bëri fëmijët të ndalonin lojën?
  - ▣ Cilat ishin pasojat e erës së fortë? Si u sollën fëmijët me pemëshitësin?
  - ▣ Çfarë ndikimi pati mërzia e pemëshitësit te njëri prej fëmijëve? Çfarë bëri ai më pas?
  - ▣ Po fëmijët e tjerë?
  - ▣ Pse u hutuan fëmijët kur pemëshitësi donte t'i dhuronte fruta secilit prej tyre?

## Studim teksti

## Analizojmë tekstin

- 2 Me çfarë luajnë fëmijët?
  - a) me lodra të blera;
  - b) me lodra që i kanë sajuar vetë.
    - ▣ Diskutoni rreth lojërave që bëjnë ata.
- 3 Përshkruani ndjesitë e fëmijëve pas veprimit të tyre ndaj pemëshitësit.
- 4 Teksti është i ndarë në dy pjesë. Sa është diferenca kohore mes ngjarjeve që përshkruhen në pjesën e parë dhe atyre në pjesën e dytë?
- 5 Ai që rrëfen historinë e fëmijërisë është larguar nga vendlindja e tij. Gjeni në tekst fjalitë që tregojnë:
  - ▣ si e sheh vendlindjen pas kaq vitesh;
  - ▣ A ka ndryshuar ajo dhe sa?
- 6 Çfarë nuk ka ndryshuar aspak në vendlindjen e tij?
- 7 Çfarë nuk ka ndryshuar tek ai, fëmija i dikurshëm?
- 8 Në fillim, fëmijët përfitojnë nga era e fortë dhe rënia e frutave në tokë, disa çaste më vonë ata pendohen për sjelljen e tyre. Çfarë mesazhi përcjell kjo situatë?

## Gjuha e tekstit

- 9 Çfarë simbolizon lumi në fjalinë: "... Lumin që natë e ditë rrjedh në amshueshmëri"?
- 10 Në cilin prej kuptimeve të mëposhtme është përdorur në tekst fjala *fisnik*?
  - a) Njeri i mirë, me karakter të mirë.
  - b) Njeri me origjinë nga një familje me tradita dhe me vlera.  
Shpjegoni alternativën që zgjodhët.

## Detyrë

- ▣ Përshkruani një ngjarje të veçantë që ju ka ndodhur dhe që ju ka bërë të ndryshoni mendim apo edhe të pendoheni.

## Bashkëbisedojmë

Tregoni histori personale nga fëmijëria juaj. Dëgjoni njëri-tjetrin dhe vlerësoni historitë e treguara duke iu përgjigjur pyetjeve:

- ▣ A është interesante historia që dëgjuat?  
\_\_\_\_\_
- ▣ Pse ju duket e tillë?  
\_\_\_\_\_
- ▣ A ju duket e drejtë mënyra se si është zgjidhur situata e historisë që dëgjuat?  
\_\_\_\_\_
- ▣ Ju pëlqyen argumentet e përdorura për zgjidhjen e situatës?  
\_\_\_\_\_
- ▣ Po ju, si do ta kishit zgjidhur këtë situatë?  
\_\_\_\_\_

# Një jetë e vështirë

## Para leximit

Personazhi i këtij tregimi është fara e një bime. Aty përshkruhet rruga nëpër të cilën kalon kjo farë, nga çasti që mbillet deri në momentin që piqet dhe jep frytet e saj. Trebeshina përshkruan ciklin jetësor të farës, të gjitha shndërrimet dhe vështirësitë që kalon ajo. Këto vështirësi nuk vijnë vetëm nga natyra, si: errësira, lagështira, i ftohti, por edhe nga gjallesa të tjera më të forta. Pavarësisht këtyre, ajo, me historinë e jetës së saj, arrin të ndihmojë edhe të tjerët. Simbolika e bimës në këtë tregim është shumë e rëndësishme, sepse nëpërmjet saj kuptojmë se çdokush në jetë përballlet me shumë vështirësi. Dhe janë pikërisht këto vështirësi që të kalitin dhe të bëjnë më të fortë. Gjithkush ka historinë e jetës së tij, e rëndësishme është që secili të ndihet krenar për rrugën në të cilën ecën dhe rritet.

## Errësirë.

Në tokën e hapur nga *plugu* ishte mbjellë edhe fara e një bime...

Dhe shirat e vjeshtës filluan të binin!...

Lagështira e tokës nuk e linte ajrin të hynte në thellësinë e mbjelljes!... Dhe kokrra e vogël e bimës zbutej dhe zmadhohej nga lagështira, por nuk po e çante dot cipën e hollë që po i qëndronte forcës për të çelur.

Më në fund, një *bisk* në nisje e çau cipën e hollë dhe u godit me tokën!... Bisku i porsaçelur u mbulua me baltë!...

*Bisku* u mundua të mënjanohet dhe qau. *Bima e mjerë*, porsa u përplas me jetën, u godit prej saj!...

Koha kalonte ... *Bima e vogël* dalëngadalë i nguli rrënjët thellë dhe kokën po e ngrinte gjithnjë e më lart përmes tokës me lagështi. Ashtu filloi të shihte rrotull dhe ashtu nisi të shihte dritën e diellit dhe të ndiente të ftohtin që vinte duke u shtuar.

Një ditë, fryu një erë aq e ftohtë, sa bima kujtoi se mbaroi... Dhe sikur të mund të tregonte, do të thoshte se ajo që dita më e zezë në jetën e saj.

Por nuk ishte e vërtetë! Ditë më të këqija dhe vuajtje më të mëdha po e prisnin!...

Dhe, prapëseprapë, bima e vogël gjithnjë rritej duke e drejtuar me guxim kokën e saj përmes erërave dhe shirave që sa vinin e shtoheshin.

Një ditë, pas një shiu me erë, gati sa nuk mbaroi dhe u shtri mënjanë. Shiu që vazhdonte të binte e ngjiti përtokë aq keq, sa, kur filloi të ndihej më mirë, kujtoi se e kishin varrosur të gjallë!... Me dhembje dhe e kërrusur filloi të ngrihej... Dhe vetëm pas disa ditësh nisi të ndihej më e gjallëruar!...

Ashtu jeta po shtyhej më tej me dhembje dhe mundime.

**Kasëm Trebeshina** (1926-2017) i botoi krijimet e tij të para letrare në fillim të viteve '50, më pas iu ndalua e drejta e botimit. Ai kërkonte të shkruante një letërsi të lirë, larg ndikimeve politike. Pavarësisht censurës dhe presionit të kohës, Trebeshina vazhdoi të shkruante poezi, tregime, novela, si dhe romane e drama.



Krisi të ftohtit e dimrit...

Një natë, kur re *të murrme* kishin mbuluar qiellin, filloi të binte borë me flokë gjithnjë e më të mëdhenj. Një shtresë e madhe bore mbuloi tokën. *Bima e shkretë* u gjend e mbështjellë me një mbulesë të bardhë... Dhe rrotull nuk dukej gjë prej gjëje!...

Kur... Aty afër saj u bë e gjallë një krijesë tjetër si ajo!... Ishte një gjë e mirë kur ndjenë se nuk ishin vetëm në atë shkreti të bardhë. Të lodhura dhe me shpresë, ranë në një gjumë të thellë.

Dëborërat vazhdonin të binin njëra pas tjetrës gjatë gjithë dimrit dhe bimët vazhdonin gjumin të patrazuara.

Prill. Livadhet ishin mbuluar me blerim. Dëbora po shkrinte dhe niste *tatëpjetë* rrëketë e pranverës. Vjollcat çelën anës livadheve dhe shpërndanin një aromë të këndshme. *Ogiçat* blegërinin dhe hanin barin e njomë. Larg, dikush i binte një borie shelgu. Bima, dita-ditës, po rritej në mënyrë të habitshme... Dhe, duke u rritur, mendonte se për të kishin mbaruar kohët e këqija.

Por jo!... Një ogiç i vogël hyri në arë dhe e hëngri bimën gjer në rrëzë!... Qau *bima e gjymtuar*... Dhe nuk kishte më shpresë që ta ngrinte kokën!... Me dhembje shikonte shoqet e saj që ishin tri herë më të mëdha!... Por përsëri edhe ajo po rritej!... Me kohë, plagët iu shëruan ... Edhe trupi filloi t'i lartohej dhe forcohej!...

Maji e gjeti të barabartë me shoqet e tjera. Bima dukej sikur u tregonte shoqeve historinë e asaj që kishte përjetuar dhe dëgjonte prej tyre histori që ngjanin dhe nuk ngjanin me njëra-tjetrën.

Vapë qershori. Gjinkallat ia kishin krisur këngës me tërbim!...

*Grunjërat* filluan të piqeshin... Ashtu edhe ajo bima që nuk i kujtonte më hallet e jetës që kishte kaluar. Në lumturi, të gjitha harrohen.

Flladi i pasdrekës po i freskonte të gjitha bimët. Në mes të asaj freskie, bima kujtonte me krenari se jeta e saj nuk kishte qenë e kotë!... Ajo e kishte gjetur vendin e saj në jetë dhe, me jetën e saj, mund të ndihmonte edhe të tjerët!...

Dielli po perëndonte... Por ajo ishte e sigurt se ai do të lindte për atë vetë dhe për të tjerët, që jeta të shtyhej në jetë!



*plug* – vegël bujqësore për të punuar tokën.

*bisk* – filiz, bimë e vogël.

*e murrme* – ngjyrë gri në të zezë.

*tatëpjetë* – drejtim i një rruge nga lart-poshtë.

*ogiç* – qengj i urtë e i mësuar, që i shkon pas bariut a një fëmije, manar.

*e gjymtuar* – që i është prerë ose i është dëmtuar rëndë një gjymtyrë.

*grunjërat* – gruri nëpër ara.

### Rrëfimtari

Rrëfimtari (tregimtari) është dikush i krijuar prej autorit, për të treguar rreth ngjarjeve e personazheve që marrin pjesë në veprën letrare. Tregimtari ndonjëherë është personazh i ngjarjeve që rrëfen. Ndonjëherë, ai nuk ka lidhje me ngjarjen, por thjesht funksionin ta tregojë atë. Herë-herë, tregimtari paraqitet si dëshmitar pa qenë pjesë e ngjarjeve (kronikan), herë të tjera rrëfen diçka që ia kanë treguar të tjerët.

Në disa raste rrëfimi bëhet **në vetën e parë**. Ai që tregon është vetë pjesë e zhvillimit të ngjarjeve, një personazh pjesëmarrës në ngjarje, i cili ndërvepron me personazhet e tjerë. Lexuesi/ja i i nje ngjarjet dhe marrëdhëniet mes personazheve nëpërmjet syve të tij. Ky tip rrëfimtari flet nga brenda historisë; *e di, pashë, e kuptova* etj., ndaj ndryshe quhet **rrëfimtari i brendshëm**. Kur tregimtari përfaqësohet vetë në veprën e tij letrare, ndihet roli subjektiv i tij, megjithatë ai nuk mund të njëjtësohet me vetë autorin, sepse është një krijim letrar.

## Studim teksti

## Kuptojmë tekstin

- 1 Përgjigjuni pyetjeve.
  - ▣ Për kë rrëfëhet në këtë pjesë?
  - ▣ Kur zhvillohen ngjarjet?
  - ▣ Cilat ishin ditët më të vështira që kaloi bima?
  - ▣ Si u gjymtua bima në prill?
  - ▣ Arriti bima të rritej, aq sa të prodhonte?

## Analizojmë tekstin

- 2 Pse ky tregim mban titullin "Një jetë e vështirë"?
- 3 Pse autori flet për *ndjenja* të lules, si të ishte njeri? A gjeni të përbashkëta (paralelizëm) mes jetës së lules dhe jetës së shkrimtarit? Ku duket kjo? Nënvizoni në tekst fjalët që tregojnë ndjenja apo përjetime të tilla.
- 4 Kur bima zbuloi se kishte edhe të tjera si ajo në dëborë, u ndie e lumtur. Interpretoni nevojën për shoqëri që shfaq bima, duke vënë në dukje tiparin kryesor të njeriut si genie shoqërore.
- 5 Si e kuptoni fjalinë: "Në lumturi, të gjitha harrohen"? Tregoni një rast nga jeta juaj.
- 6 Bima personifikon njeriun dhe ecurinë e tij në jetë përmes vështirësive. Po stinët e vitit, çfarë përfaqësojnë?
- 7 Në çfarë mënyre *mund t'i ndihmonte edhe të tjerët* bima, kur u rrit? A mund të ndikojë apo të ndihmojë dikë historia e të tjerëve? Diskutoni rreth rasteve të tilla që mund të keni dëgjuar dhe argumentoni.

## Gjuha e tekstit

- 8 Autori përdor shumë mbiemra për të dhënë gjendje dhe përjetime të bimës. Gjejini në tekst këta mbiemra dhe nënvizojini.
- 9 Teksti është ndërtuar me një gjuhë të pasur e të figurshme, për të shprehur përjetimin emocional. Gjeni në të dhe shënoni shprehje të tilla, si: *Ishin vetëm në atë shkretëti të bardhë. Të lodhura dhe me shpresë...* \_\_\_\_\_

## Detyrë

Përkruani ciklin tuaj jetësor, që nga momenti që keni lindur (nëpërmjet kujtimeve që ju kanë treguar prindërit) deri në ditët e sotme, duke pasur parasysh këto elemente:

- ▣ Kur ju ka lindur, nëna juaj ka pasur një lindje të thjeshtë?
- ▣ Keni qenë fëmijë i shëndetshëm, apo keni pasur nevojë për ndihmë shëndetësore?
- ▣ A ju ka ndodhur ndonjë ngjarje e veçantë gjatë fëmijërisë?
- ▣ Si jeni ndier, kur dikush ka vepruar padrejtësisht me ju?
- ▣ Si jeni ndier, kur keni kuptuar se problemet tuaja i kanë edhe fëmijë të tjerë?
- ▣ A jeni ndier mirë, kur keni kuptuar se problemet tuaja janë pjesë e rritjes?
- ▣ A ndiheni krenar për mënyrën se si i keni kaluar vështirësitë?

# Kthimi i Skënderbeut në Krujë

## Para leximit

Kjo pjesë është shkëputur nga romani "Historia e Skënderbeut", i shkrimtarit Odhise Grillo. Romani është një përshtatje për fëmijë e poemës epike historike "Istori e Skënderbeut" e Naim Frashërit. Në roman, rrëfohen ngjarjet e jetës së heroit tonë kombëtar, që nga lindja e tij, më tej marrja peng prej osmanëve, kthimi i tij në Krujë dhe betejat që ai bën. Pjesa e mëposhtme rrëfen pikërisht kthimin e Skënderbeut në Krujë dhe harenë e madhe që ka kapluar mbarë vendin, falë ardhjes së kryetrimtimit në Arbëri.



## Fjalor

si do t'u vinte filli – si do të shkojë më tej, si do të shkojë puna.

Gëzohu, o Arbëri, se po të vjen dita e lirisë! Zbukurohu me kurora plot me lule e dafina! Shpalosi flamurët e kuq me shqiponjën dykrenare në mes! Zhvishi rrobat e zisë që ke mbajtur veshur për aq vjet!

Mirë se na vjen, o verë, në viset arbërore!

Ardhsh përherë e gëzuar, për shekuj e shekuj të tërë, ashtu siç po vjen sivjet! Ngrehuni edhe ju, o të vdekur nga varri dhe gëzoni tok me të gjallët, se Arbërisë po i buzëqesh liria!

Po vjen Skënderbeu, prandaj po zbardh fusha e po ndrit mali nga armët e trimërisë. Po vjen Skënderbeu, prandaj hingëllin kali e s'mbahet dot, se po sjell mbretin e Arbërisë në atdhe!

\* \* \*

Skënderbeu me trimat e vet nga pas, hipur në kuaj e armatosur si jo më mirë, u futën në qytet me këngë në gojë dhe me britma gëzimi e hareje. Osmanët, që ndodheshin në Krujë në fillim, deshën të mos i pranonin e t'i kundërshtonin, por kur morën vesh se cili kishte ardhur në krye të tyre, ngritën përpjetë flamurin e bardhë dhe po rrinin sus. Pritnin me ankth **si do t'u vinte filli...**

Nga të katër anët e qytetit, u lëshuan si përrenj të vegjël krutanët dhe në qendër formuan një lumë të madh njerëzor, që po i ngjitej kalasë duke brohoritur:

- Rroftë liria!
- Rroftë atdheu!
- Rroftë Skënderbeu!



**Odhise Grillo** (1932-2003) është autor i mirënjohur i letërsisë shqipe për fëmijë. Ai i ka lëvruar të gjitha gjinitë e llojet letrare: vjershën, poemën, fabulën, tregimin, novelën, përrallën, romanin. Ka përshtatur për fëmijë vepra shumë të rëndësishme si: "Lahuta e malësisë" e Gjergj Fishtës, "Historia e Skënderbeut" e Naim Frashërit etj.



Nga gjithë vendi u nisën me qindra e mijëra vetë për në Krujë, për të parë mbretin, për të përshëndetur Gjergjin, për të përgëzuar shpëtimtarin, për të parë Skënderbeun, birin e madh të Arbërisë.

Pleqtë që e kishin njohur qysh kur ishte i vogël dhe e kishin përcjellë në Adrianopojë me lot në sy, vajtën dhe e puthën në duar dhe në ballë duke qarë. Fëmijët e rrethuan, e mbushën me tufa lulësh dhe morën valle tok me të. Gëzim e hare më të madhe s'kishte parë kurrë Kruja me sy. As këngë e as valle nuk kishte dëgjuar e parë si atë ditë!

Skënderbeu i priti, i **ngjatjetoj** e i falënderoi të gjithë me radhë, të mëdhenj e të vegjël, dhe pastaj tha:

– Më sillni këtu komandantin e fortesës!

Sakaq, komandanti osman u dha në shesh kokulur e sypërdhe.

– Më dëgjo mirë, o Osman, – se kështu quhej. – Sulltani e hëngri fjalën që i dha tim eti dhe e pushtoi Arbërinë, – tha Skënderbeu.

– Vrau, dogji e shkrettoi dhe mua nuk më rrëfeu asgjë. M'i mbajti të fshehta të gjitha **mynxyrat** që mbuluan Arbërinë. M'i mbajti të fshehta gjëmat që gjetën prindërit e vëllezërit e mi. Ja, kështu m'i shpërbleu mundimet e mia dhe fitoret që korra në Azi e Evropë. Më goditi me thikë pas shpine! Më gjakosi e ma bëri me pabesi. Dhe e dini pse ndodhi kështu? Se sulltani për ligj ka djallëzinë, ligësinë dhe poshtërsinë.

Unë nuk jam si Murati. As pendë nuk do t'ju prek, po të më dëgjoni fjalën. Qysh nesër, të ngriheni e të shkoni në punën tuaj, larg Arbërisë! Dëgjove? Dhe mos guxoni të ktheheni më, se nuk do t'ju lë as nam, as nishan. Do t'ju hanë korbat e këtyre **gërxheve**!

Osmani nuk bëri as gëk, as mëk, po uli kokën dhe doli jashtë. Të nesërmen në mëngjes, mori rrugën për në Adrianopojë, në krye të ushtarëve të vet. Disa që nuk dëgjuan fjalën e Skënderbeut, po ngritën **jataganin** kundër tij, hëngrën dhe.

Sa morën vesh këtë lajm, edhe në fortesat e tjera të Arbërisë nuk mbeti më këmbë osmani.



## Fjalor

*ngjatjetoj* – përshëndet dikë duke i thënë “tungjatjeta”.

*mynxyrë* – fatkeqësi apo e keqe shumë e madhe.

*gërxh* – shkëmb i ashpër e me thepa; vend me shkëmbinj të tillë.

*jatagan* – shpatë me majë të kthyer, me dorezë zakonisht të stolisur.



Arbëria e hoqi shaminë e zezë, që e kishte të ulur gjer poshtë te sytë, dhe nisi të priste e të përcillte miqtë që po i vinin nga të katër anët e Evropës. Erdhën të dërguar nga të gjitha mbretëritë, me urime e **kanisqe**.

Kur u kthyen shoqëruesit në kështjellë, Skënderbeu tha:

– Më ka marrë malli për shtëpinë. Dua ta shoh edhe një herë. A është si e kam lënë, kur isha fëmijë?

E **shpunë** para shtëpisë, që ishte bërë gërmadhë, dhe në cep të syrit i ndriti një pikë lot.

U ul në gjuhë e puthi pragun, ashtu si do të kishte puthur të ëmën e të atin.

Sa u ngrit, përpara i dolën të pesë motrat, veshur këmbë e kokë me të zeza. E përqaftuan me mallin e madh të motrave, se vetëm ai u kishte mbetur, se atë e kishin si dritën e syve. Qanin e s'pushonin dot. I kishte mbytur mallëngjimi.

– O motra të dashura! – u tha Skënderbeu. – I fshini lotët, hiqni rrobat e zisë dhe merrni pjesë në këtë gëzim që ka tërë Arbëria. Gëzoni edhe për vëllezërit që na ikën. Gëzoni edhe për prindërit që na lanë.

Dhe ato, në atë çast, u veshën me të bardha, ashtu siç u vesh gjithë Arbëria atë ditë.

Në sheshin e kalasë u mbledhën të mëdhenj e të vegjël. Pa kishin ardhur edhe princat e komandantët nga e gjithë Arbëria dhe pritnin Skënderbeun. Kishin ardhur Lekë Dukagjini me nam e Zaharia Gropa trim, Tanush Topia i urtë e mendjeshumë dhe Gjon Shpata i dëgjuar. Pa kishin ardhur Lato Gjata nga Labëria, Maneshi nga Berati, Moisiu nga Dibra, Kont Urani e Bashdar Nartioti, Pal Dushmani e Gjon Koka, të gjithë trima e të gojës, që u priste shpata e gjuha në të dy anët. Osmanët e njihnin mirë trimërinë e tyre, se e kishin provuar në kurriz.

A e keni parë diellin si ndriçon në qiell? Ashtu ndriçonte edhe mbreti i Arbërisë, Skënderbeu!

Skënderbeu erdhi e zuri vend në mes të tyre si i barabarti në mes të barabartëve, i thjeshtë e i dashur, i urtë e burrë i fjalës dhe i shpatës, si gjithë të tjerët që kishte përreth.

Tërë sheshi **buluriti**:

– Rroftë Skënderbeu!

U ngritën në këmbë princa e komandantë dhe thirrën:

– Rroftë Skënderbeu!

## Fjalor

*kanisk* – peshqesh a dhuratë që i dërgon dhëndri nuses.

*shpunë* – çuan dikë a diçka në një vend, e përcollën a shoqëruan diku.

*buluriti* – buçet.

*dolli* – ngritja e shëndetit për dikë në një dasmë, në një gosti.



U ngritën në këmbë ushtarët e populli që mbushnin sheshin dhe thirrën:

– Rroftë Skënderbeu!






Dhe komandantë e ushtarë, princa e popull shkuan dhe e zunë për dore. I dhanë fjalën e besën e arbrit se do ta ndiqnin nga pas gjithë jetën, se me të në krye do të fitonin mbi çdo armik, se anembanë Arbërisë do të valonte i lirë flamuri ynë.

Sa morën vesh këtë lajm, vrapuan mbretërit e Evropës dhe e mbuluan me lëvdata e dhurata. E uruan Skënderbeun, se donin ta kishin edhe mik, edhe mburojë kundër furisë e egërsisë osmane.

Në Krujë e kudo nisi kënga e vallja, u ngritën **dollitë** e mirësitë dhe festa s'pushonte as natën e as ditën. Festonte Kruja e festonte Arbëria. Festonin ditët e lirisë.

### Kompozicioni

Kompozicioni është mënyra sesi ndërtohet vepra letrare, si paraqitet subjekti dhe gjuha, si grupohen e si zbërthehen, si bashkohen në një tërësi të vetme të gjitha elementet e veçanta të veprës. Në kompozicion dallohet:

-  Hyrja (parashtrimi), e cila na njeht me mjedisin ku do të zhvillohet veprimi, si dhe rrethanat që e kanë nxitur atë. Në hyrje njihemi me personazhet që marrin pjesë në veprën dhe me situatën fillestare.
-  Thurja (pika e lidhjes), e cila krijohet në momentin kur fillon veprimi i veprës dhe në saje të së cilës lindin ngjarjet e mëvonshme në veprën letrare. Këtu përshkruhet konflikti dhe kontradiktat që ndodhin në veprë, të cilat karakterizohen përmes personazheve që veprojnë aty.
-  Zhvillimi i veprimit, i cili paraqet ecurinë e ngjarjeve në një veprë letrare. Zhvillimi i veprimit kryhet përmes karaktereve, ngjarjeve të lidhura mes tyre, në mënyrë që të krijohet intriga (apo ngatërresa).
-  Kulminacioni, i cili është momenti kur subjekti a ngjarja arrijn kulmin e tensionit. Zakonisht, këtu zbulohet plotësisht thelbi i temës qendrore, ideja poetike dhe karakteri i personazheve kryesore.
-  Zgjidhja e veprimit, e cila simbolizon përfundimin e natyrshëm të subjektit. Shpesh zgjidhja vjen menjëherë pas çastit kulmor.

## Studim teksti

### Kuptojmë tekstin

- 1** Lexoni tekstin dhe përgjigjuni pyetjeve.
  - a) Përse gëzojnë Kruja e Arbëria?
  - b) Kush e shoqëronte Skënderbeun gjatë kthimit të tij në atdhe?
  - c) Çfarë i tha Skënderbeu Osmanit?
  - ç) Me çfarë veprimi e shpreh Skënderbeu mallin për shtëpinë e tij?
  - d) Përse janë të veshura me të zeza motrat e Skënderbeut?
  - dh) Kush u mblodh në shesh për të festuar ardhjen e kryetrimt?
  - e) Si përshkruhet natyra në tekst? A dalloni ngjashmëri midis natyrës dhe gjendjes shpirtërore të krutanëve?

### Analizojmë tekstin

- 2** Qarkoni alternativën që tregon kuptimin e secilës thënie.

Lekë Dukagjini me nam.

- a) Lekë Dukagjini ishte shumë i njohur.
- b) Lekë Dukagjini bënte dëme.

## Studim teksti

Tanush Topia, i urtë e mendjeshumë.

a) Tanush Topia ishte i heshtur dhe mendjemadh.

b) Tanush Topia ishte i mençur dhe i ditur.

Gjon Shpata i dëgjuar.

a) Gjon Shpata ishte njeri që dëgjonte me vëmendje.

b) Gjon Shpata ishte shumë i njohur.

3 Gjeni në tekst mbiemrat që përdoren për të treguar cilësitë e Skënderbeut.

## Interpretojmë tekstin

4 Pse thuhet se Skënderbeu ishte i barabartë mes të barabartëve?

5 Si e kuptoni thënien “Të gjithë trima e të gojës, që u priste shpata e gjuha në të dy anët”?

6 Përse Skënderbeu i thotë Osmanit se ai nuk ishte si sulltani?

7 Bashkëbisedoni rreth figurës së Skënderbeut dhe argumentoni përse ai konsiderohet heroi ynë kombëtar.

8 Gjeni në internet kreun VI të poemës “Istori’ e Skënderbeut” të Naim Frashërit, që nis me vargjet: “Kruj’, o qytet i bekuar!/Prite, prite Skënderbenë,/ Po vjen si pëllump i shkruar,/ Të shpëtonjë mëmëdhenë”. Krahasoni vargjet e poemës me pjesën që lexuat. A i qëndron besnik autori poemës që ka ritreguar?

## Detyrë

▣ Gjeni pjesë të tjera letrare që i kushtohen heroit tonë kombëtar. Bëni një përmbledhje, duke i klasifikuar sipas llojit.

## Shkruajmë

Shfrytëzoni figurat që shoqërojnë këtë pjesë letrare për të shkruar një tregim të shkurtër për Skënderbeun.

- Organizojeni rrëfimin sipas strukturës hyrje – zhvillim – mbyllje.
- Përcaktoni personazhet e rrëfimit tuaj.
- Përcaktoni vendin dhe kohën ku do t’i vendosni ngjarjet. Përdorni sa më shumë mbiemra dhe ndajfolje për ta arritur këtë.
- Zgjidhni të rrëfeni:
  - ▣ në vetën e parë, kur jeni edhe vetë pjesëmarrës në ngjarje;
  - ▣ në vetën e tretë, kur tregoni për të tjerë dhe nuk jeni pjesëmarrës në ngjarje;
  - ▣ përmes dialogut, kur rrëfeni në ligjëratë të drejtë.
- Gjeni një titull tërheqës për lexuesin/en.
- Kur të përfundoni, rishikojeni tregimin për të verifikuar të gjitha elementet e tij.

# Komandanti i klasës

## Para leximit

Si veproni për të fituar vlerësimin e shokëve dhe të shoqeve të klasës?

Në këtë tregim, autori austriako-hebre Jozef Roth rrëfen historinë e Antonit, një nxënës i rregullt e me rezultate të larta, që mban brenda vetes një qëllim e dëshirë të fshehur: të bëhet senator. Si do të veprojë Antoni për t'i zënë vendin shokut të klasës?

Anton Vancli vishej gjithnjë me sqimë dhe teshat i shndritnin nga pastërtia. As edhe një kokrrizë pluhuri nuk të zinte syri në xhaketën e tij, as edhe një vrimë sado të vogël në çorape, as edhe një të gërvishtur a ndonjë blanë në fytyrën e zbehtë e të lëmuar. Antoni rrallë merrte pjesë në lojë, nuk kacafytej kurrë me djemtë dhe kurrë nuk shkonte të vidhte mollë kuqalashë në pemëtoren e fqinjtit. Antoni nuk e ngrinte kokën nga librat. Studionte nga mëngjesi deri natën vonë. Librat dhe fletoret i kishte të mbështjella me letër borë të bardhë dhe, në faqen e parë, me një shkrim aq të kujdesshëm e të imët për një fëmijë, ishte shkruar emri i tij. Dëftesat, tërë nota të shkëlqyera, ishin palosur për merak në



## Fjalor

**sqimë** - kujdes i madh për të pasur një pamje të hijshme e të zgjedhur.

**blanë** - shenjë që mbetet në trup nga një plagë, nga një goditje a nga një sëmundje.



**Joseph Roth (Jozef Roth)** (1894 –1939) ka qenë gazetar dhe shkrimtar i mirënjohur austriak. Ai njihet për veprat e tij që përshkruajnë jetën dhe peripecitë e familjeve hebraike, që u zhvendosën nga Evropa Lindore drejt asaj Perëndimore gjatë Luftës së Parë Botërore.

Shkrimet e tij gazetareske janë të gjalla edhe plot ngjyra.

Ai madje ka botuar edhe shkrime me kujtime nga udhëtimi në Shqipëri.

Në shekullin XXI, kritika letrare e riktheu vëmendjen te vepra e tij letrare dhe te mesazhet e rëndësishme që ajo përcjell.



një zarf të madh ngjyrë tulle dhe ishin vendosur tërë kujdes pranë albumit të pullave të postës, të cilin shokët ia kishin më shumë zili se dëftesat e shkëlqyera.

Antoni ishte djali më i urtë i shkollës dhe i lagjes. Në shkollë ulej pa fjalë me krahët e “lidhur”, siç e kërkonte rregullorja, dhe e ndiqte çdo fjalë të mësuesit me sytë e gjithëdijshëm. Kuptohet që ishte i pari i klasës. E merrnin gjithnjë si shembull në klasë, fletoret s’kishin shenja të kuqe korrigjimi, përveç notës dhjetë që rregullisht shkëlqente poshtë detyrave të tij. Antoni përgjigjej me qetësi e maturi, ishte gjithnjë i përgatitur, kurrë nuk shtirej si i sëmurë. Rrinte në bankë si ta kishin gozhduar pas ndenjës. Gjëja që e mërziste më shumë ishin pushimet mes orëve të mësimit. Të gjithë duhet të dilnin, të ajrosej klasa, vetëm “komandanti i klasës” qëndronte. Antoni rrinte në oborr, strukej i ndrojtur pas murit dhe s’guxonte të bënte **çap** nga frika se mos e përplaste dhe e rrëzonte përdhe ndonjë nga shokët që bridhnin **potershëm**. Dhe kur binte zilja, Antoni merrte frymë i lehtësuar. Me hap të përmbajtur e të rregullt, njëlloj si drejtori, ndiqte pas turmën e vogël poteremadhe të nxënësve, ulej tërë kujdes në bankë, nuk këmbente fjalë me askënd, ngrihej i drejtë si qiri dhe ulej si robot në ndenjësë sapo mësuesi jepte komandën “Uluni”.

Por... Antoni nuk ishte fëmijë i lumtur. Një ambicie përvëluese po e hante të gjallë. Një vullnet i hekurt për të shkëlqyer, për t’ua kaluar tërë shokëve, thujse ia shteronte krejt ato pak fuqi që kishte. Antoni kishte një qëllim dhe vetëm një: donte të bëhej “komandant klase”. Tani ishte një tjetër, në fakt, një nxënës “më pak i shkëlqyer”, por që ishte më i madhi i klasës dhe mosha më e madhe kishte ngjallur besimin e mësuesit. “Komandanti i klasës” ishte, në njëfarë mënyre, zëvendësi i mësuesit. Në mungesë të tij, ky nxënës kaq i privilegjuar duhet të kujdesej për shokët, “të **piketonte**” ata që bënin zhurmë dhe t’i kallëzonte te mësuesi, të kujdesej që tabela e zezë të ishte gjithnjë e fshirë, shtupa që fshinte tabelën të ishte përherë e njomë dhe shkumësi majëmprehtë; gjithashtu duhet të mblidhte paratë për fletoret, **kallamarët**, për riparimin e mureve të ciflosura dhe xhamave të thyer. Një detyrë e tillë i linte mbresë të thellë Antonit të vogël. Netëve pa gjumë kurdiste plane të djallëzuara hakmarrjeje, duke vrarë mendjen pa fund se si t’i vinte bërnylin “komandantit të klasës” për ta marrë ai këtë detyrë kaq të nderuar.

Një ditë, i shkrepri në mendje ideja e duhur. “Komandanti i klasës” i kishte fort për zemër lapsat dhe bojërat me ngjyra; gjithashtu kishte dobësi për kanarinat, pëllumbat dhe zogjtë e pulës. Me të tilla dhurata mund t’ia prishje mendjen lehtë dhe dhuruesi mund ta kthente klasën përmbys, po të donte e t’ia hidhte pa lagur. Pikërisht këtë dobësi duhet të shfrytëzonte Antoni. Ai nuk bënte kurrë dhurata. Por, këtë herë



## Fjalor

*çap* - hap.

*potershëm* - zhurmshëm.

*piketonte* - këtu: shihte.

*kallamar* - kuti ku mbahej boja e shkrimit.

## Portreti

Portreti është paraqitja e pamjes së jashtme të njeriut (fytirës, trupit, veshjes etj.).

Herë-herë thuhet “Portret i brendshëm” ose “Portret moral”, duke nënkuptuar bashkësinë e tipareve të karakterit të njeriut, botën e ndjenjave e të mendimeve të tij.

veproi ndryshe. Në klasë ish një djalë aq i varfër, saqë nuk paguante as detyrimet e shkollës. Ja, pikërisht kjo ishte zgjidhja. Antoni i kishte të gjitha mundësitë të kryente një operacion të shkëlqyer. Ai vetë do t'i jepte djalit të varfër një dhuratë për komandantin e klasës. Djali i varfër ishte në të vërtetë viktimë e përditshme e vesit që kishte komandanti i klasës për të kallëzuar, por në këtë rast ai do ta mbyllte gojën.

“Komandanti i klasës” nuk mund ta kallëzonte Antonin, sepse askujt s'i shkonte mendja se mund të bënte prapësi. Askujt s'i shkonte mendja që synonte vendin e “komandantit të klasës”. Ai do ta mbante afër djalin e varfër dhe do t'i zbulonte mësuesit **korrupsionin** e tiranit të klasës. Kështu, të gjithë do ta gjykonin veprimin e tij si të drejtë, të respektueshëm dhe guximtar. Dhe pas kësaj, askush tjetër s'do të kishte gojë ta kërkonte vendin e lirë të “komandantit të klasës” përveçse Antonit. Nuk vonoi dita kur Antoni mori zemër dhe ia çori maskën “komandantit të klasës”. Ai u shkarkua menjëherë nga detyra dhe Anton Vancli u caktua tërë **pompozitet** “komandant klase”. Më në fund, ia doli mbanë.



## Fjalor

**pompozitet** – diçka që bëhet për dukje a për bujë.

## Personazhet

Personazhet janë krijuar nga shkrimtari për të thurur (gjeneruar) historinë që tregohet në roman. Ata kryejnë veprimet në ngjarje dhe në rrethana të caktuara. Në disa raste, janë personazhet që e tregojnë historinë dhe marrin rolin e rrëfyesit. Personazhet mund të jenë kryesorë ose dytësorë, në varësi të rëndësisë që kanë në subjektin e veprës. Ata mund të jenë protagonistë ose antagonistë, në varësi të karakteristikave të tyre psikologjike dhe veprimeve që kryejnë.

## Studim teksti

### Kuptojmë tekstin

- 1 Cila ishte ambicia e Antonit?
- 2 Çfarë i pengonte planet e tij?
- 3 Cilat ishin detyrat e komandantit të klasës?
  - Shkruani nga një fjali përmbledhëse për dy paragrafët e fundit të tregimit.

---

  - Ritregojeni pjesën duke u mbështetur në përgjigjet e mësipërme.


### Analizojmë tekstin

- 4 Në tabelën e mëposhtme janë zgjedhur disa nga shprehjet me të cilat autori përshkruan paraqitjen e jashtme të Anton Vanclit. Duke plotësuar tabelën, bëni lidhjen ndërmjet paraqitjes së jashtme dhe botës së brendshme të personazhit kryesor.

Përshkrimi në tekst	Çfarë tregon për karakterin e personazhit?
vishej ... me sqimë	
teshat i shndritnin nga pastërtia	

## Studim teksti

Përshkrimi në tekst	Çfarë tregon për karakterin e personazhit?
As edhe një kokrrizë pluhuri ... në xhaketën e tij	
as edhe një vrimë ... në çorape	
as edhe një të gërvishtur ... në fytyrë	
Rrinte në bankë si ta kishin gozhduar pas ndenjës...	
ulej pa fjalë me krahët e "lidhur", siç e kërkonte rregullorja...	
strukej i ndrojtur pas murit... s'guxonte të bënte çap	
me hap të përmbajtur e të rregullt, njëlloj si drejtori...	
ulej tërë kujdes në bankë... ngrihej i drejtë si qiri	

**5** Nga mbiemrat e mëposhtëm, zgjidhni me  ata që shprehin cilësi të Antonit.

- |                                      |  |  |
|--------------------------------------|--|--|
| <input type="checkbox"/> ambicioz    | <input type="checkbox"/> bujar         | <input type="checkbox"/> i ndërgjegjshëm |
| <input type="checkbox"/> indiferent  | <input type="checkbox"/> shpirtngushtë | <input type="checkbox"/> guximtar        |
| <input type="checkbox"/> shpirtgjerë | <input type="checkbox"/> i ndershëm    |  |

## Gjuha e tekstit




**6** Gjeni në tekst pesë shprehje të figurshme që përshkruajnë cilësi të Antonit.

## Shembull

Cilësia	Shprehje e figurshme
studioz	... nuk e ngrinte kokën nga librat...

## Shkruajmë

Për secilin nga llojet e mëposhtme të shkrimit, është dhënë një situatë. Zgjidhni si detyrë atë që ju pëlqen më shumë.

-  Një letër drejtuar mësuesit/es në të cilën i kërkoni falje për mungesën e singeritetit në një situatë.
-  Një rrëfim të shkurtër nga përvoja juaj, kur keni bërë plane të pandershme për të arritur një qëllim.
-  Një shkrim argumentues në të cilin mbroni tezën se ambicia e tepruar shpesh të çon në rrugë të gabuar.

# Një medalje për madhështinë

## Para leximit

*Pjesa e mëposhtme është shkëputur nga libri "Mrekullia", i Rakel Haramilo Palasio. Agustini ka lindur me disa deformime të rënda në fytyrë, por ai ëndërron të jetë një fëmijë si gjithë të tjerët. Në moshën 11-vjeçare, kur shkon për herë të parë në shkollë, zë fill sfida e tij: A do ta besojnë të tjerët që ai është njësoj si ata, përtej pamjes së jashtme? Në këtë fragment, personazhi ynë bëhet fitues i një çmimi të rëndësishëm në shkollën e tij.*

Fjalimi i drejtorit më pëlqeu, vetëm se, duhet ta pranoj, gati sa nuk më zuri gjumi gjatë fjalimeve të tjera.

Vëmendja m'u kthye sërish kur zonja Rubini filloi të lexonte emrat e nxënësve që ishin në listën e të dalluarve, ngaqë duhej të ngriheshim më këmbë kur të na përmendej emri. Kështu që prita duke mbajtur vesh për emrin tim, ndërsa ajo lexonte listën me emra sipas alfabetit. Rid Kingsli. Maja Markoviç. Agustin Pullman. U ngrita më këmbë. Pastaj, kur ajo mbaroi së lexuari listën e emrave, na tha të ktheheshim me fytyrë nga salla dhe të përkulnim trupin për të përshëndetur dhe, atëherë, të gjithë duartrokitën.

Nuk e kisha fare idenë ku mund të qenë prindërit e mi mes gjithë asaj morie. Shihja vetëm dritat e bliceve të aparateve fotografike. E parafytyrova mamin që ma bënte me dorë diku nga salla, megjithëse nuk e shihja dot.

Pastaj zoti Vithemadh u ngjit përsëri në foltore për të paraqitur medaljet për rezultate të shkëlqyera shkollore dhe e kuptova se Xheku kish pasur të drejtë: Shimena Çin fitoi medaljen e artë për rezultate të shkëlqyera akademike në tërësi për klasën e pestë. Charlota fitoi medaljen e argjendtë. Charlota fitoi edhe medaljen e artë për lëndën e muzikës. Amosi fitoi medaljen për rezultate të shkëlqyera në tërësi në sporte, çka më gëzoi, sepse, që pas ekskursionit, e konsideroja Amosin si një prej shokëve të ngushtë në shkollë. Por m'u bë shumë, po shumë ama, qejfi kur dëgjova zotin Vithemadh të thoshte emrin e Verës për medalje të artë në krijimtari. Pashë Verën që vuri dorën në gojë kur iu tha emri dhe, kur hipi në skenë, bërtita me sa zë kisha, megjithëse nuk mendoj se më dëgjoi:

– Bravo, Vera!



**R. J. Palacio (Rakel Haramilo Palacio)** është autore bashkëkohore amerikane. Ajo ka një eksperiencë të gjatë pune si drejtore artistike dhe dizajnatore kopertinash për autorë të ndryshëm. "Mrekullia" është libri i saj i parë. Falë suksesit të jashtëzakonshëm, ai u pasua edhe nga dy libra të tjerë, të frymëzuar nga i pari.





Pasi u thirr emri i fundit, të gjithë fëmijët që kishin marrë medalje qëndruan më këmbë në rresht në skenë dhe zoti Vithemadh iu drejtua të pranishmëve të ulur në sallë:

– Zonja dhe zotërinj, kam nderin t’ju prezantoj nxënësit e shkëlqyer të shkollës “Biçer Prep” për këtë vit. Urime të gjithëve!

Duartrokita, ndërsa nxënësit në skenë u përkulën. M’u bë shumë qejfi për Verën.

– Çmimi i fundit për sot, – tha zoti Vithemadh, pasi fëmijët me medalje qenë kthyer nëpër vendet e tyre, – është medalja “Henri Uord Biçer”, që nderon ata nxënës, të cilët kanë qenë të dalluar ose shembullorë në fusha të caktuara gjatë gjithë vitit shkollor. Zakonisht, me këtë medalje kemi vlerësuar **vullnetarizmin** ose shërbimin ndaj shkollës.

Menjëherë e mora me mend se këtë medalje do ta merrte Sharlota, sepse ajo organizoi mbledhjen e rrobave për bamirësi këtë vit, prandaj sikur m’u largua përsëri vëmendja. Pashë orën: 10:56. Që tani po më hahej drekë.

– ... Henri Uord Biçeri ka qenë, pa dyshim, një **aktivist** i flaktë kundër skllavërisë dhe një mbrojtës **i paepur** i të drejtave të njeriut. Prej tij e ka marrë emrin edhe kjo shkollë, – po thoshte zoti Vithemadh, kur u përqendrova përsëri.

– Teksa po lexoja për të mësuar më shumë për jetën e tij, për t’u përgatitur për këtë çmim, hasa në një pasazh të shkruar prej tij, i cili m’u duk se përputhej veçanërisht me temat që preka më lart, tema të cilat nuk më janë hequr nga mendja gjatë gjithë vitit. Jo thjesht natyra e mirësisë, por natyra e mirësisë që tregon njeriu. Forca e miqësisë së njeriut. Sprova e karakterit të njeriut. Fuqia e guximit të njeriut...

Dhe atë çast ndodhi diçka e paparë: zotit Vithemadh iu drodh zëri, sikur diçka ta kish shtrënguar në grykë. Madje u kollit për të qëruar fytin dhe piu gjatë nga gota me ujë. Fillova të tregoja vëmendje prej vërteti tani, për të dëgjuar çfarë do të thoshte.

– Fuqia e guximit të njeriut, – përsëriti ai me zë të ulët, duke tundur kokën dhe duke buzëqeshur. Ngriti dorën e djathtë për të numëruar. – Guximi. Mirësia. Miqësia. Karakteri. Këto janë cilësitë që na karakterizojnë si qenie njerëzore dhe që na shtyjnë, në raste të caktuara, drejt madhësisë. Dhe për këtë është edhe medalja “Henri Uord Biçer”: për të vlerësuar madhësinë.

– Po si t’ia bëjmë? Si ta matim diçka si madhështia? As për këtë nuk ka një metër me të cilin ta matim. Po si ta përkufizojmë, pa mirë? Në fakt, shkolla “Biçer Prep” e ka gjetur përgjigjen.



## Fjalor

**vullnetarizëm** – parimi i pjesëmarrjes së njerëzve në veprimtari të ndryshme bazuar në vullnetin a dëshirën e vet.  
**aktivist** – pjesëmarrës i gjallë në veprimtarinë e një organizate shoqërore a të një kolektivi.  
**i paepur** – që nuk trembet nga vështirësitë, pengesat etj.



I vuri përsëri syzet e leximit, shfletoi një libër dhe filloi të lexonte.

– “Madhështia”, shkruante Biçeri, “nuk qëndron te fuqia, por te përdorimi i drejtë i fuqisë... I madh është ai, fuqia e të cilit ngre peshë zemrat e shumicës së njerëzve...”

Dhe përsëri, krejt befas, sikur ia zuri diçka grykën. Vuri gishtin tregues mbi buzë për një sekondë, përpara se të vazhdonte.

– “I madh është ai” – vazhdoi, më në fund, – “fuqia e të cilit ngre peshë zemrat e shumicës së njerëzve thjesht përmes zemrës së vet.”

Pa u vonuar më, këtë vit e kam për krenari që medaljen “Henri Uord Biçer” t’ia jap nxënësit, fuqia e urtë dhe e qetë e të cilit ka ngritur peshë zemrat e shumicës prej nesh.

I lutem Agustin Pullmanit të vijë këtu për të marrë këtë çmim.

## Studim teksti

### Kuptojmë tekstin

- Lexoni pjesën dhe përgjigjuni pyetjeve:
  - Kush ishte Henri Uord Biçeri? Në cilat raste jepej medalja “Henri Uord Biçer”? Çfarë kishte bërë ky njeri, aq sa të krijohej një çmim me emrin e tij?
  - Si zbulohet ëndrra e Agustinit në këtë fragment?
  - Duke lexuar paragrafin e fundit, plotësoni fjalinë: *Pullmani e merr çmimin falë\_\_\_\_\_ dhe \_\_\_\_\_ së tij.*

### Analizojmë tekstin

- Në tekstin e mësipërm, thuhet: *Po si t’ia bëjmë? Si ta matim diçka si madhështia? As për këtë nuk ka një metër me të cilin ta matim. Po si ta përkufizojmë, pa mirë?*
  - Shpjegoni pse madhështia është e vështirë të vlerësohet.
- Shkruani me një fjali kuptimin e fjalës *madhështi*, duke u nisur nga fjalët kyçe: *madhështia, guximi, mirësia, dashuria.*

### Interpretojmë tekstin

- Përshkruani emocionet dhe ndjesinë e Pullmanit deri në momentin e marrjes së çmimit.
- Pse ai ngrii peshë zemrat e të gjithë nxënësve të shkollës?
- Si i kuptoni fjalët e drejtorit të shkollës pak përpara dhënies së çmimit?

### Gjuha e tekstit

- Gjeni në tekst shprehjet që tregojnë humanizëm dhe vlera pozitive.

### Detyrë

- Tregoni raste në shkollën tuaj të dhënies së çmimeve për vullnetarizëm apo shërbime të ndryshme ndaj shkollës dhe komunitetit.
- Sillni në vëmendjen e të gjithëve disa lloje çmimesh që mbajnë emra të personave të njohur, rrëfeni kontributet e tyre dhe shpjegoni lidhjen e emrit të çmimit me kontributin.

# Bora e fëminisë

## Para leximit

Tregimi "Bora e fëminisë" përshkruan kujtimet e fëmijërisë, lojërat e bukura në dëborën e parë dhe harenë e një mjedisi të çiltër, ku mbizotërojnë dashuria dhe gëzimi i sinqertë i të vegjëlve. Çdokush mund të gjejë copëza të kujtimeve të fëmijërisë së vet në këtë tregim.



Kur flokët e para t'borës niseshin për me e përçafue tokën, gzimi jonë s'kish t'përthekuem!

I mbaronim detyrat shpejt e shpejt... mandej gjellën me lakna, turshi, bukën e kallamojtë, pasulin me mish të terun, kungullin e pjekun, piten me djath, kosin, votë me mjaltë... kreeejt, kreeejt i kemi hongër, veç me na lonë me dal jashtë....

Me kapuç e doreza, me *sajën* e bacit n'kurriz i ngjisnim shkallët plot borë n'oborr t'dajve! Nana ish mas neve, na rujke derisa na dilnim n'krye t'*mahallës*!

Si ushtri, rreshtoheshim dy nga dy, e nisnim me rrëshkit n'borën e parë! Rrzhoheshim e çoheshim me lotët e gazit e tuj ia kapun dorën njani-tjetrit e vazhdonim lojën! Herë mas here, n'çdo ballkon e oborr t'lagjes, dilte nana a motra e madhe e njanit prej nesh, me na kontrollue se a ishim të tanë mirë...

Natyra, Kiki, Doni, Floriana, Sihana, Allma, Tuki, Lena, Trimi, Lenti, Albana, Ilja, Valoni, Besa, Shpresa, Parlotja, Gresa, Gramosi, etj. etj. etj... sa shumë jena kanë! *Hala* ma shumë jena knaq!

Jemi idhnu - jemi pajtu: kemi qesh e kemi gzu, me topa bore e *dardaleca*! I kemi nda copat e bukës; e gjithë kemi pasë! Shumë ama kemi pasë! Kemi kërkue falje e jemi knaq me pak!

Me fjolla bore kur kërceshim n'*sokak*!

Shpija e bacit (gjyshit Hamdi) gjithmonë ka qenë e bardhë, e madhe, e paqtë! Aty mblidheshim të tanë, t'qullo sun e pak t'mavijosun! Bajshim zhurmë derisa fillonin lajmet! Kur e kthente baci kryet me na kqyrë, na e kuptojshim se kish ardhë koha me u shtri... pak protestë tuj i ngjitun shkallët e katit t'dytë; pastaj ploot t'qeshuna derisa na mbylleshin sytë!

Ca ma vonë, baci u thojke çikave t'veta (tezeve t'mija) që munden me dalë me saja, se fmijtë i kqyr ai vet... Atëherë, prej sipër e nigjojshim t'kërsitunën e derës së oborrit edhe gzimin e 'fëmijëve' që ia falnin dimnit t'qeshunat pa hile, prej loçkës së zemrës!

## Fjalor

*përthekoj* – 1. lidh thek më thek; 2. mbërthej, kopsit.  
*sajë* – slitë.  
*mahallë* – lagje.  
*hala* – ende.  
*dardaleca* – dordolecë.  
*sokak* – rrugë e shtruar me kalldrëm.  
*tutë* – frikë.



**Fjolla Spanca** lindi në Mitrovicë, në vitin 1993. Është aktiviste e shoqërisë civile dhe të të drejtave të grave. Ajo ka shkruar shumë artikuj artistikë e publicistikë dhe është vlerësuar me çmime për veprimtarinë e saj krijuese.

Ishin kohnat kur mahalla ish shpija jonë! Kohnat kur dashnija ka jetu pa kushte! Kur fëmijë me çizme plastike e çorape prej leshi, rriteshin pa *tutë*... kohna t'lehta, t'mira, t'thjeshta! Kohna t'patrazueme për shpirtin njomak! Kohna t'varfnisë! Stinë t'pasunisë, së patundshme!! Stinë dashnish t'vockla; andrrash t'mdhaja!

## Studim teksti

### Kuptojmë tekstin

- 1 Lexoni tekstin dhe përgjigjuni pyetjeve.
  - a) Në cilën stinë zhvillohen ngjarjet e përshkruara në tregim?
  - b) Në shtëpinë e kujt kishin shkuar fëmijët për të bujtur?
  - c) Kush kujdesej për ta se mos lëndoheshin teksa luanin?
  - ç) Cila ishte loja që i gëzonte më tepër fëmijët?
  - d) Çfarë ndanin së bashku fëmijët?
  - dh) Si e kuptonin fëmijët se kishte ardhur ora e gjumit? Pse protestonin ata?

### Analizojmë tekstin

- 2 Në tregim thuhet: "I kemi nda copat e bukës; e gjithë kemi pasë! Shumë ama kemi pasë!" Çfarë tregon kjo për pasurinë e vërtetë gjatë atyre viteve të fëmijërisë?
- 3 Ç'loj ushqimesh janë ato që hanin fëmijët?
- 4 Kur të vegjlit flinin, cilët ishin "fëmijët" që dilnin të luanin me slitë?
- 5 Çfarë ndjesie ju ngjall ky shkrim? Shënoni me ✓.
 

<input type="checkbox"/> Qetësi.	<input type="checkbox"/> Nostalgji.	<input type="checkbox"/> Ankth.
<input type="checkbox"/> Frikë.	<input type="checkbox"/> Ëndërrim.	<input type="checkbox"/> Gëzim.

### Interpretojmë tekstin


- 6 Si e kuptoni frazën "gzimi jonë s'kish t'përthekuem"?
- 7 Cila është figura autoritare, por e dashur, që përmendet në tregim?
- 8 Gjeni në tekst ku paraqitet antiteza mes anës materiale dhe anës shpirtërore.
- 9 Rilexoni paragrafin e fundit të tregimit. Si mendoni, a ekziston sot realiteti i fëmijërisë që ka përshkruar autorja?

### Gjuha e tekstit

- 10 I gjithë teksti është i shkruar në dialekt. Çfarë efekti krijon përdorimi i këtij varianti gjuhësor? Shënoni me ✓ dhe argumentoni alternativat që keni zgjedhur.
 

<input type="checkbox"/> Ngjall më tepër emocion te lexuesi/ja.
<input type="checkbox"/> Asnjë efekt.
<input type="checkbox"/> Shpreh karakter intim të përshkrimit.
<input type="checkbox"/> Ruan më mirë gjurmët e vendit ku kanë ndodhur ngjarjet.

### Detyrë

-  Shkruajeni tregimin duke e kthyer në shqipen standarde, aq sa është e mundur, pa ia prishur kuptimin.

# Purpuranti

## Para leximit

Pas vdekjes së Skënderbeut, kur duket se çdo gjë ka marrë fund, kalorësi Stresi vendos të kthehet në shtëpi. Gjatë rrugës së kthimit, natyra e nxit për meditim. Pas një periudhe lavdie kishte ardhur rënia. Atëherë kur trishtimi dhe pesimizmi e ka përfshirë, ai dëgjon melodinë e një kënge të lashtë që e kthen prapa në kohë, ndërsa fjalët e këngës krijojnë vetvetiu një gjendje tjetër: besimin për të ardhmen.

## Fjalor

**komb** – nyje, pengesë si nyjë në të folur.

**arqipeshkëv** – arqipeshkëv: titull në kishën katolike, më i lartë se peshkopi.

**kungullujës** – lloj kungulli, i cili, pasi i hiqet tulli, përdoret si enë për ujë.

**myll** – mill: këllëf që shërben për të futur në të shpatën, thikën, hanxharin etj.

Një dëshirë e thellë, tërë mall e dhembshuri e shtynte të kthente edhe një herë kokën nga deti, nga fushat, po nuk e ktheu. Në grykë iu mbloodh një **komb**. E dinte se po i linte lamtumirën dikujt, diçkaje, lamtumirë përgjithmonë. Po kujt? Fushave? Hapësirës së detit? “Po ngryset!” – mendoi përsëri dhe e dinte se këtë nuk e mendonte për muzgun, për mbrëmjen dhe për natën që po vinte pas mbrëmjes, po për një gjë tjetër... Ai solli në mend takimin që pati atë mëngjes me **arqipeshkvin** e Durrësit, Pal Engjëllin. Njëri nga vëllezërit e arqipeshkvit kishte qenë oficer, bashkë me Stresin, në gardën e Skënderbeut, dhe ishte vrarë disa muaj më parë, në luftimin e fundit të gardës kundër turqve. Ndërsa po jepte shpirt, ai i ishte lutur Stresit që të shkonte në Durrës, kur t’i vinte rasti, dhe t’i tregonte arqipeshkvit hollësitrat se si ish zhvilluar ky luftim i fundit. Sipas të tilla njoftimeve, që vëllai ia kish sjellë gjithmonë vetë, drejtpërdrejt nga fushat e betejave, arqipeshkvi Pal Engjëlli po shkruante një libër mbi historinë e luftërave të Skënderbeut. Tani kjo histori kish marrë fund dhe historianit nuk do t’i vinin më njoftime. Me sytë e përplotur, ai e dëgjonte Stresin në heshtje, pastaj iu lut që t’i tregonte se si vdiq vëllai i tij, ku i kish marrë plagët, çfarë kish thënë para se të jepte shpirt...

Atje ishte një krua dhe në krua mbushte ujë një malësore. Më tej, në kënd të një livadhi, dukej nëpër fletët e bredhave fasada e një kishe. Ca lule të trëndafila vjeshte kishin mbirë në livadh dhe mbi pyllin me bredha e me ahe rrinin pezull shtëllungëza me re të buta, si engjëj të pikturuar në kubetë e kishave. Gruaja e mbushte buljerën me anën e një **kungullujsi** si të çarë përgjysmë. Ajo ktheu kokën nga Stresi dhe sytë e saj të mëdhenj i ngulën atij një vështrim të çuditshëm, në fillim me habi, pastaj me afrmim e butësi. I dha ujë me kungullujsin e çarë dhe i tha se e kishte edhe ajo një djalë në ushtri. Mos e njihte ndoshta ai djalin e



**Bilal Xhaferri** Shkrimtari Bilal Xhaferri (1935-1986) ka shkruar vëllimin me tregime “Njerëz të rinj, tokë e lashtë”, vëllimin me poezi “Lirishta e kuqe” dhe romanin “Krastakraus”. Pas internimit nga regjimi i kohës, ai arratiset dhe shkon në Boston, ShBA. Atje themelon revistën “Krahu i shqiponjës”, ku boton shumë artikuj publicistikë, poezi, tregime, pjesë romanësh, skeçe, karikatura etj.

saj? E quanin Ndre, Ndre Piroli, dhe ishte kalorës. Stresi ndjeu një dridhje të ftohtë. E shikoi malësoren me vështrim të ngulur, pastaj i tha se nuk e njihte djalin e saj. Megjithatë kërkoi të njihte hollësitrat: Ç’moshë kishte ai, si i kish flokët, mos ishte mëngjarash?

Kur po largohej, ktheu kokën pas dhe pa se gruaja e ngarkuar me buljerë hyri në derën e kishës së vjetër, të humbur në pyll. “Ajo pret djalin!” – tha me vete. “Sa do të presë akoma?” Mori frymë thellë dhe ajri ishte mbushur me aromën e bimëve e të dheut, me aromën vjeshtake të pyllit, me atë aromë të përzier ku nuhatja mezi e dallon njëren erë nga tjetra. “Ajo pret djalin!” – tha përsëri ai. “Pret t’i kthehet djali i saj!... Po mua kush më pret? Kujt i kthehem unë?... Në fshat është një rrugë që s’më shpie asgjekundi...”

Natën e kaloi në një shpellë. Shpatën me gjithë myll e vuri nën kokë dhe u mbështoll me pelerinën e purpurt. Nga hyrja e shpellës dukej qielli me yje dhe nëpër gjethet e rënda të bredhave të errësuar përkundej dhe pikonte drita flori e hënës. E zuri gjumi. Kur u zgjua ishte akoma natë, po nga ca shenja e kuptoi se së shpejti do të zbardhte drita. Tani hëna kishte perënduar. Mbi pyllin që nxinte, hapej qielli i thellë dhe në horizontin e largët të lindjes, sipër kreshtave të maleve, sikur buronte një ndriçim i purpurt, pakëz i ftohtë. Ai mërdhiu. U mbështoll mirë me pelerinën e tij, ndjeu në gushë e në faqe të fërkuarit e asaj rrobe të kushtueshme dhe ajo e prekur iu duk si një përkëdhelje e butë, e ëmbël. Ndonëse për vete ishte mbajtur gjithnjë thjesht, pa salltanete e stolira, oficerët dhe ushtarët e tij, Skënderbeu mendohej t’i mbante sa më mirë, sa më të pajisur, sa më të veshur e të mbathur. Oficerët më të shkëlqyer mbanin pelerina elegante të purpurta. Sa e shenjtë i dukej tani Stresit kjo pelerinë e butë që e përkëdhelte kështu në gushë. Ajo ishte e vetmja trofe e një çerek shekulli luftë, ishte e vetmja shenjë e një lavdie të fituar me shpatë. Tani kish marrë fund çdo gjë dhe vetëm ajo ruante akoma kujtimin e gardës së hekurt, kujtimin e ushtrisë krenare, kujtimin e amshuar të një kombi që ishte ngritur dhe kish ndriçuar në mes të gjitha kombeve të zhytura në errësirën mesjetare. Po tani kish marrë fund çdo gjë dhe Stresi e dinte se ky komb i dashur e i shtrenjtë, që të ndriçonte një çerek shekulli në mes të errësirës, ishte djegur e përvëlur i tëri, kishë shkrirë të gjitha energjitë e tij dhe, për t’i vënë në vend ato energji, kushedi sa kohë do t’i duhej.

Kur u zgjua, kishte kohë që kish dalë dielli. Dita ishte e kthjellët, me një shkëlqim të bardhë vjeshtak, po ai ndjente akoma në shpirt hijen e rëndë të natës. U vu të ecte dhe sipas dredhimeve e ngjitje-zbritjeve që merrte rruga, i dukej sikur rrotull tij lëviznin ngadalë majat e maleve, drurët e pyjeve, horizontet e afërta, fletët e florinjta që binin e s’kishin të sosur. E ndjente veten të përgjumur. Sa i thellë kish qenë ky gjumi i mëngjesit!

Si në fëmijëri. Dëgjohej përsëri cicërima e gushëkuqve me gushë të verdhë, ajri ishte zbutur e ishte ngrohur dhe s’lëvizte e s’pipëtinte asgjë. Pastaj filloi të frynte një erë e vagët, që rënkonte e psherëtinte në rrugët e largëta.

Nëpër murmurimën e saj, atij iu bë sikur dëgjoi një tingull të njohur. Vuri veshin dhe përsëri dëgjimi i kapi dridhjen e atij tingulli të njohur që vinte s’di se nga, thellë nga pylli, nga grykat e maleve, nga nëntoka ose nga qielli. Dikush i binte fyellit larg. Melodia mezi arrinte, e këpotej si duke pikuar tingull pas tingulli.





## Fjalor

*thellukë* – vend i thellë krahasuar me pjesën tjetër të relievit.

*Torvioll* – fusha mbi të cilën është ndërtuar qyteti i sotëm i Përenjasit, ku u zhvillua një nga betejat e suksesshme të Skënderbeut, por me humbje të mëdha në njerëz.

## Proza historike

Proza historike rrëfen ngjarje të vendosura në të kaluarën, shpesh gjatë një periudhe kohore të lavdishme.

Në prozën historike mund të përfshihen karaktere imagjinare, figura të njohura historike ose një përzierje mes tyre. Karakteret e krijuara, imagjinare, ndërtohen sipas imazhit të shoqërisë në periudhën historike për të cilën bën fjalë vepra. Subjekti ndërtohet në bazë të një përzierjeje mes ngjarjeve reale dhe imagjinare. Paraqiten ngjarje të rëndësishme historike, por edhe ngjarje të vogla, të përditshme. Personazhet përfshihen në një konflikt që është tipik, real për kohën kur zhvillohen ngjarjet. Dialogët dhe monologët e personazheve janë në përputhje me mendimet dhe nivelin e kohës për të cilën flitet.

Vendi ku zhvillohen ngjarjet është një vendndodhje gjeografike e njohur, reale.

Në prozat historike, i kushtohet vëmendje përshkrimit të detajeve (veshjes, ambientit etj.) për t'u siguruar që ato përshatën me periudhën kohore për të cilën rrëfëhet.

Ishte melodia e një kënge të lashtë, kaq të lashtë sa nuk mbahej mend. “Kur të mbarohen të gjitha, atëherë do të rrëzojmë shkëmbinjtë e maleve mbi kryet e armiqve, dhe do të hapim ngastra toke, për vreshta e grunore, në rrënjët e shkëmbinjve.”

Që nga fëmijëria Stresi nuk e kishte dëgjuar më këtë këngë dhe tani ndjeu të ngjethura në tërë trupin.

Nga vërshimi i gjakut në dej i buçisnin veshët dhe i bëhej sikur melodia e fyellit gjëmonte nëpër goditjet e mijëra kambanave, nëpër oshtimën e lumenjve dhe dallgëve të detit, nëpër furtunat e pyjeve dhe gjëmimet e betejave. Më në fund, arriti në lartësinë e një qafe. Përpara, në një **thellukë**, i doli një arë e vogël, si arenë e hapur në mes të pyllit. Në krye të arës ishin ulur të çlodheshin tre malësorë. Nga sëpatat që i kishin hedhur përpara këmbëve dhe nga drurët e pyllit që sapo ishin prerë, kuptohej se ata punonin atje për të zgjeruar kufijtë e asaj toke të vogël. Njëri prej tyre që mbështetur pas një lisi dhe i binte fyellit. Ai i ngjante shumë trungut ku ishte mbështetur. Vinte i gjerë, i mbushur, me kokë të madhe dhe qafë të shkurtër, të trashë, si të demit. Gjoksi i tij i zbërthyer, leshtor, dukej si një copë shkëmb i veshur me myshk, kurse koka me flokë të gjatë dhe fytyra e parruar dukeshin sikur ishin mbështjellë me lëmyshk. Kjo pamje e tij e ashpër bënte kontrast me melodinë e ëmbël të fyellit të tij, ashtu siç bënte kontrast trungu i ashpër i lisit dhe shushurima e butë e erës nëpër fletët delikate, që këputeshin e binin si tinguj.

Dy malësorët e tjerë, djem të rritur, ishin ulur aty pranë dhe dëgjonin, me duart lidhur te gjunjët. Nga shtegu i pyllit doli një nuse e re, me një fëmijë në duar. Ajo u thirri burrave që të shkonin e të hanin bukë dhe ata u ngrenë ngadalë, të lodhur, morën sëpatat e u nisën drejt saj. Fëmija qeshte i gëzuar dhe zgjatej nga malësori me fyell. – O babë! O babë! – thërriste me një zë si të kanarinës. Të pestë së bashku, ata humbën në pyll, te shtegu ku ngrihej hapësirës fjolla e tymit të një oxhaku.

Stresi qëndroi në këmbë aty, në krye të qafës dhe veshët i buçisnin akoma nga vërshimi i gjakut. “Dhe do hapim ngastra toke... në rrënjët e shkëmbinjve!” – kujtoi përsëri fjalët e harruara të këngës. Ai shikonte arën e vogël të hapur në mes të pyllit, dhe mendonte se në pranverën e ardhshme atje do të mbinte gruri i ri, kallinjtë do të hidhnin shtat pranë njëri-tjetrit dhe do të dukeshin si një kuadrat trupash. “O babë! O babë!” – thërriste fëmija në shtegun e pyllit. Ndoshta babai i saj sapo ishte kthyer nga ushtria, kish lënë shpatën dhe kish marrë sëpatën. “O babë!” Kjo thirrje e jetës ishte si një puls që i rrihte pa pushim nëpër këto vise të larta malore, nëpër këto rrënoja vigane malesh të egra, dhe Stresi mendoi se nuk kish marrë fund çdo gjë, ashtu siç i ishte dukur natën në shpellë. Jo! Pikërisht tani fillonte lufta më e vështirë, lufta e gjatë, e përjetshme, qëndresa për jetë a vdekje. “Ne do të kemi **Torviollë** të tjerë, – mendoi, – do të kemi fillime të tjera. Ne kemi rrënjë në këtë tokë dhe nuk shkulemi kurrë”. Mori përsëri rrugën për në fshatin e tij. Veshët i buçisnin dhe i dukej sikur dëgjonte akoma këngën e fyellit që dridhej nëpër jehonat e mijëra kambanave, nëpër oshtimat e mijëra betejave të kaluara e të ardhme.

## Studim teksti

## Kuptojmë tekstin

- 1 Pasi të lexoni pjesën, përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme.
  - Kush është historiani që po shkruan një libër për Skënderbeun?
  - Kë takon Stresi gjatë rrugëtimit të tij, pranë burimit?
  - Stresi “ndjeu një dridhje të ftohtë”, kur dëgjoi emrin e Ndre Piroilit. Pse?
  - Cili është trofeu i vetëm i luftës që i kishte mbetur Stresit?
  - Sa vjet kishte zgjatur lufta dhe lavdia?
- 2 Renditni sipas rrjedhës së rrëfimit të ngjarjeve fjalitë e mëposhtme rreth Stresit.
  - Stresi shfaq mërzinë nëpërmjet meditimeve të tij.
  - Stresi ngushëllon dikë.
  - Stresi përballet me imazhe shpresëdhënëse të një familjeje.
  - Stresi beson tek e ardhmja.
  - Stresi tregon mosbesim për të ardhmen.
  - Stresi kërkon informacion rreth dikujt.
  - Stresi ndien mall për atë që shkoi.

## Analizojmë tekstin

- 3 Cila është tema kryesore e tregimit?
- 4 Gjeni në tekst fjalitë në të cilat rrëfimtari shpreh:
  - trishtimin e heroit për atë që la pas;
  - trishtimin për faktin që s’e pret askush;
  - shpresën që jo gjithçka ka marrë fund;
  - besimin se e ardhmja do të jetë e bukur.

Analizoni mënyrën se si ndryshon gjendja emocionale e protagonistit gjatë udhëtimit.

## Interpretojmë tekstin

- 5 Në tekst ndeshim edhe vargjet e një kënge. Gjejini ato dhe shpjegoni kuptimin e tyre duke i lidhur me situatën.
- 6 Për çfarë lufte – “*më e vështirë, e gjatë, e përjetshme*” – flet Stresi në fund të tregimit?
- 7 Stresi në fund të tregimit mendon: “*Ne do të kemi Torviollë të tjerë*”. Çfarë nënkupton Torviollë në këtë kontekst?

## Gjuha e tekstit

- 8 Teksti karakterizohet nga prania e shpeshtë e monologut apo e dialogut? Si shpjegohet një gjë e tillë?
- 9 Rrëfimtari ka ndërtuar kontraste të forta, të shprehura në tekst. Gjejini dhe shpjegojini ato.
- 10 Tregimi “Purpuranti” është i karakterizuar nga dendësia e metaforave dhe e krahasimeve. Gjeni të paktën pesë metafora dhe pesë krahasime në tekst.
- 11 Rrëfimtari ka krijuar një paralelizëm mes gjendjes shpirtërore të poetit dhe natyrës. Shpjegojeni me shembuj këtë pranëvënie.

## Detyrë

- Gjeni një tregim tjetër që flet për kohën e Skënderbeut. Tregoni përmbajtjen e tij në klasë.

# Origjina e murtajës

## Para leximit

*Kjo pjesë është shkëputur nga romani "Shënimet e Gjon Nikollë Kazazit", në të cilin përshkruhet gjendja e një qyteti shqiptar në shekullin XVIII, kërcënuar me zhdukje nga sëmundja e murtajës. Ngjarjet rrëfohen nga Gjon Nikollë Kazazi, një figurë e njohur atdhetare. Në roman përshkruhet gjendja e krijuar prej përhapjes së epidemisë, e cila shoqërohet me frikë, pasiguri, dyshime. Situata bëhet dramatike, kur përflitet se epidemia është shkaktuar nga pushtuesit osmanë, me qëllim nënshtrimin e Gjakovës. Në njërën anë, pushtuesit duan të shpallen si mbrojtës të qytetit për të luftuar sëmundjen, nga ana tjetër, e përhapin atë tinëzishit. Me qëllim "përkujdesjeje", qyteti vihet në shtetrrëhim.*

Kisha vazhduar i vetmuar përgjatë Çarshisë së Madhe për të dalë në pjesën e Mulla Isufit, ku po ashtu jehona e zanit të tellallve mbushte çdo skutë me atmosferën e vdekjes. Ndoshta kisha menduar se ndodhesha në një hapsirë ku tashma jeta kishte prajtur, po të mos ishte një besimtar plak, që më doli përpara dhe më tha diçka si përcartë rreth asaj se nuk ishte e thanë që mortja të merrte çdo frymë, ngaqë dinte se herën e fundit kishin shpëtuar shumë nga ata që i kishte prekur... Ai më tha se frika e tepruar ishte vetë mortja... Njerëzve u duhet hequr frikën...

Nuk e di pse fjalët e atij që më nuk e kisha pranë, më banë për pak me u ndalë përpara trysnisë mortore, që më kishte mbërthyer fund e krye. Në të vërtetë, në atë gjendje trishtuese, fjalët për përballimin e mortjes, që më erdhën aq papritmas, më bëhej se nuk ishin të vërteta, se ato as që ishin thanë nga ndokush, siç më bahej, por ato ishin pjesë e një përftimi të çuditshëm, që u shfaqet të pashpresëve në çastet e fundit...

Megjithatë, besimtari plak nuk ishte përftim... Ai më shoqëroi një copë herë dhe më foli qetë-qetë rreth përballimit të murtajës, si dhe për frikën si murtajë...

"Murtaja mundet!... Frika ashtë murtajë!"

Kur koka m'u kishte mbushur me kërcënimin për frikën si murtajë dhe rrezikoja të shembesha, për habi, aty për aty, ishte një shënim i një misionari, që kisha lexuar gjatë studimeve në arkivin e Selisë së Shenjtë në Romë, që më mbajti në këmbë. Bahej fjalë për një shkrim në të cilin thuhej se murtaja që kishte shpërthyer në viset tona, kishte sjellë përgjysmë më pak viktima.



**Jusuf Buxhovi** (1946). Në vitin 1968, u diplomua në Universitetin e Prishtinës, dega e Gjuhës dhe e Letërsisë Shqipe. Ka shkruar një numër të madh veprash, si: "Cirku" (tregime), "Dinozauri" (dramë), "Loja" (roman), "Shënimet e Gjon Nikollë Kazazit" (roman), "Nata e shekujve" (roman), "Galeria e të vdekurve" (roman), "Libri i të mallkuarve" (roman triptik), "Vdekja e Kolonelit" (roman), "Vera e fundit e Gjin Bardhit" (roman), "Kujtimet e zonjës

Von Braun" (roman), "Kodi i dashurisë" (roman), "Romanet" (roman), "Dosja B" (roman), "Dushkaja" (roman), "Mona" (roman), "Rrushja" (roman) etj.



Dyshohej se dikush atje kishte përdorur një ilaç që askush nuk kishte ditur se për çfarë ashtë fjala, meqë e gjitha ishte ba nën mbikëqyrjen e disa plakave, të cilat ishin marrë me disa grithje në lëkurë. Meqë edhe misionari, shënimin e kishte cilësuar si thashetheme, si duket e gjitha kishte mbetur pa jehonë, veçmas kur dihej se murtajës askush deri më atëherë nuk kishte mundur për me i dalë para...

Por, në atë gjendje më shkoi mendja edhe te plakun Mic Shpendi, i cili gjatë shoqërimit nga Tropoja deri në Gjakovë më kishte thënë se si fëmijë e kishte larë mortjen...

Mund të kishte, vallë, ndonjë ndërlidhje midis shënimit të misionarit të Romës, rreth numrit të përgjysmuar të të vdekurve gjatë murtajës së fundit në viset tona, që nuk e kishte besuar askush, dhe dëshmime të plakut Mic Shpendi rreth përballimit të murtajës?...

Një copë herë theva mendjen me ato mëdyshje dhe sa më shumë që merresha me to, më bahej se e gjitha ishte një përfitim mashtrues, ngase ne ishim të dënuar për vdekje, dhe se, në atë gjendje, duhej për me ba çmos që e liga me u përballue me sa ma shumë durim dhe me bindjen se lufta për mbijetim ashtë pjesë e përpjekjeve të paprajshme që i takon secilës qenie dhe secilës shoqëri...

Kur po i afrohesha kishës, paksa i liruem nga trysnia që më kishte rrokur çastin që tellallët po kumtonin lajmin e ligë, megjithatë, mendja ma tha se duhej me besue se ilaç kishte edhe kundër murtajës, dhe se, më binte barra që për këtë të punoja me gjithë qenien. Tek e fundit, mendova, bindja se sëmundja mund të shërohet, ashtë ilaçi ma i mirë, qoftë ajo edhe mortje...

Te dera e kishës më priste patër Coli i zverdhur. Lajmi i murtajës e kishte ba shuk saqë i trishtuar kishte dalë jashtë.

– Parandieja, atë, të ligën... E parandieja... Nuk ishin shenja të mira ato që shfaqeshin ditëve të fundit.

Zinte ngojë lëvizjet e qerreve natën, gjëmimet në to, shfaqjen e qenve endacakë si dhe minjve të ngordhur nëpër rrugët e skajshme...

– Mos u shqetëso, gjithaq. Mos u shqetëso, biro, ngaqë kjo nuk ashtë hera e parë që ballafaqohemi me sëmundje të tmerrshme... Por, edhe këtë herë, në emër të zotit, kemi me u ba ballë atyre që vinë prej robit...

Fola ashtu pa ditë se ato fjalë po i thosha unë apo pjesa e atij përfitimi që më ishte ngjizur nga shfaqja e besimtarit plak që kishte kthyer te rruga e mullinjve.

– Domethënë, atë, edhe ju dyshoni se kjo ashtë vepër e robit?

Po fliste sikur me u pasë liruuar nga një barrë e rëndë.

– Dihet se njeriu ka edhe pjesën e ligë, që nuk pranë së vepruari për ma të kegen... Po mos me qenë kjo, atëherë bota do të ishte ndryshe...

– Kush kishte me thanë se njeriu shfaros njeriun?... A nuk ashtë kjo shuarje e jetës... Si mund ta lejojë këtë i madhi?... Si?...

Atë pyetje e shtroi gjatë gjithë kohës sa po i ngjitnim shkallët e drunjta, të cilat lenin pas kërcëllimën e hollë të drurit të tharë.

Në dhomë, Coli u nemit fare. Shikonte qiririn e hollë dhe thyente gishtat. Mendja ma thoshte se edhe në atë gjendje, gishtin e kishte te drejtuar nga Zoti

ynë, gjë që m'u desh me i thanë se kjo nuk kishte të bante me të, por me të ligën njerëzore, pikërisht me atë që njeriun e ban ujk kundër njeriut... Në atë përpëlitje me të ligën, tërthoras hapa edhe çashtjen e pranisë së sëmundjes midis nesh pa dijen tonë, veçmas kur besimtarët tanë nëpër xhami, teqe e kisha kurdoherë dhe në çdo kohë hapnin shpirtin e tyre edhe rreth gjanave ma të rëndomta e lene ma për një sëmundje të tillë të tmerrshme...

– Pushteti zyrtarisht shpall praninë e sëmundjes bashkë me masat mbrojtëse dhe ato të tjerat për parandalimin dhe përballimin e saj, ndërsa ne nuk dimë gja për të?

– Të sëmurët mund të kenë qenë nëpër qerret që lëviznin natën në drejtim të Shkuzës?... Prej tyre përhapeshin klithjet dhe gjëma e të sëmurëve...

– Qerret e mbuluara dhe lëvizjet e tyre të natës kah Shkuza nuk ishin pa gja. Por, kush ishin ata të shkretë në to dhe prej nga vinin, kur nuk ishin prej nesh?... Këto hamendje fshehin të vërtetën e sëmundjes, siç hapin atë se ajo i duhej dikujt për qëllime të caktuara...

– Lufta nuk zgjedh mjete, biro. Mikrobi i padukshëm vret me mijëra herë më shumë se arma më e fuqishme dhe nuk len gjurmë... Tek e fundit, përdorimi i sëmundjes për qëllime luftarake njihet ngaherë...

– Këtë nuk ma hante mendja!....

– Ka dëshmi të shumta për përdorimin e saj, sado që ato përherë janë përshkruar si epidemi që shkojnë e vijnë...

Për me e qetësue, i thashë se as mikrobi nuk ashtë i gjithëfuqishëm. Vjen koha kur edhe ai dorëzohet.

– Mikrobi dorëzohet kur kryen punë.

– Duhet me e pengue me i krye të gjitha punët.

– Po si, kur ashtë i padukshëm dhe i gjithëfuqishëm?

– Pse e kemi mendjen, biro?... Duhet me e vu në veprim prore... Pushteti i së ligës fillon çastin që i dorëzohemi asaj...

I tregova se murtaja e fundit në viset tona kishte dhanë përgjysmë ma pak viktimat nga ç'pritej. I thashë se neve na takon me gjetë njerëz që dinë diçka për murtajën e fundit dhe t'i pyesim se ç'ishte ajo që kishte ndikuar që viktimat të përgjysmohen... Mund të merret me mend se ashtë përdorur ndonjë ilaç...

– Dashtë zoti me e gjetë atë ilaç!

– Kena me e kërkue ditë e natë, në tokë e në qiell... Nuk kemi me heqë dorë nga kërkimi... Këtë e kemi për detyrë...

Gatishmërinë për me veprue po e theksoja tej mase ndonëse kisha frikë se ato që po i thosha mund të ishin pjesë e një ngushëllimi që na duhej të dyve në ato çaste të vështira...

– Po si me i gjetë ata njerëz, kur prej sot kurrkush nuk guxon me dalë apo me hy në qytet?

– Këtë nuk do ta kemi të lehtë, por mendja ma thotë se gjenden burra që mund ta shpërthejnë rrethimin. Rreziqet nuk duhet të na ndalin... Ato janë pjesë e punës sonë...

Marrë nga “Shënimet e Gjon Nikollë Kazazit”,  
Prishtinë 2021

## Studim teksti

## Kuptojmë tekstin

- 1 Përgjigjuni pyetjeve në lidhje me tekstin.
  - ▣ Zëri i kujt dëgjohej gjatë gjithë kohës në qytet?
  - ▣ Çfarë i tha besimtari i paemër tregimtarit të kësaj historie?
  - ▣ Për çfarë fliste shkrimi të cilin tregimtari e kishte gjetur në arkiva?
  - ▣ Çfarë dyshohej se i kishte shpëtuar shqiptarët nga murtaja?
  - ▣ Kush ishte Mic Shpendi? Çfarë i kishte thënë tregimtarit që e kishte futur në mendime?

## Analizojmë tekstin

- 2 Në tekst jepet një hipotezë se kush e solli epideminë. Gjeni se cila ishte kjo hipotezë.
- 3 Çfarë mjeti ka përdorur pushtuesi këtë radhë për të vvarë dhe për të mbajtur nën kontroll shqiptarët?
- 4 Në një shkrim të vjetër që kishte lexuar, shkruhej: "... murtaja që kishte shpërthyer në viset tona para... kishte sjellë përgjysmë më pak viktime", "ma pak viktime se pritej". Si e interpretoni këtë pjesë për përgjysmimin e numrit të viktimave?
- 5 Nga ato që lexoi, por edhe nga ato që dëgjoji nga njerëz të popullit, Gjon Kazazit i lindi dyshimi se ekzistonte një kurë shërimi. Çfarë vendosi të bënte ai?

## Interpretojmë tekstin

- 6 Interpretoni fjalët e besimtarit të paemër që del nga hiçi e që duket si përfitim, por s'ishte i tillë:
  - ▣ *Frika e tepruar ishte vetë mortja.*
  - ▣ *Murtaja mundet!.. Frika asht murtajë!*
- 7 Si mendoni, është e rastësishme përmendja e besimtarëve nëpër xhami, teqe e kisha, që "hapnin shpirtin rreth gjanave më të rëndomta", por që s'dinin asgjë për atë epidemi. Kur vjen e keqja, a bën dallim se kë godet?

## Gjuha e tekstit

- 8 Shpeshherë, fjalitë mbarojnë me figurën e reticencës (heshtjes). Gjeni në tekst disa fjali të tilla dhe shpjegoni funksionin e përdorimit të tyre të shpeshtë.
- 9 Në roman ka disa elemente që krijojnë besueshmëri në atë që tregohet. Cila nga këto alternativa tregon arsyen e besueshmërisë:
  - ▣ ai që rrëfen në roman, është edhe pjesëmarrës në situata a ngjarje;
  - ▣ përmendja e datave në tekstin artistik;
  - ▣ ai që rrëfen, është Gjon Nikollë Kazazi, një figurë historike reale;
  - ▣ të gjitha arsyet e mësipërme.

## Reflektojmë rreth tekstit

- 10 Analizoni dhe diskutoni rreth shprehjes që përmendet në tekst: *Pushteti i së ligës fillon në çastin që i dorëzohemi asaj.*

## Detyrë

- ▣ Analizoni pasojat që shkakton izolimi te njerëzit, të mira ose të këqija, sipas rastit.

# Shuarja e humorit

## Para leximit

Ky tregim është shkruar nga Dritëro Agolli, i njohur për stilin e tij të veçantë që karakterizohet nga notat e spikatura të humorit. Në qendër të tregimit janë letrat që këmbëjnë dy shokë të vjetër fëmijërie. Ai që rrëfen, i shkruan shokut të tij një letër të mbushur me humor, në të cilën i kujton çapkënlleqet e së shkuarës, kur ishin fëmijë. Në vend të një përgjigjeje me humor, siç ndodhte zakonisht në letrat e mëparshme, ai merr një letër të ftohtë, në të cilën toni miqësor është zëvendësuar me seriozitet fals dhe me kritikë për mosrespektimin e pozitës shoqërore.



## Fjalor

*andrallë* – kokëçarje, telash.

*llagap* – këtu: nofkë.

*abrash* – me flokë e vetulla të bardheme.

*rrufjan* – ai që bën punë të këqija dhe që vepron me dredhi e me pabesi.

Unë kurrë nuk i kam pasur qejf letrat serioze të shokëve, letrat me gjuhë zyrtare. Që kur isha i ri, më pëlqente humorit, historitë zbavitëse, shakatë që gjeja në letrat e miqve të mi dhe tek i lexoja, shkrihesha në gaz, duke harruar disa çaste **andrallat** e jetës. Edhe unë kur merrja pendën për të shkruar, mundohesha të krijoja ngjarje për të qeshur. Ky zakon më ka mbetur edhe sot e kësaj dite, kur flokët më janë thinjur dhe ka filluar të më dalë pak kurrizi.

Një mbrëmje, më vanë sytë te një njeri që ecte në rrugë vetëm.

"U Zalu! Ore, ç'do Zalu këtu?", thashë me vete dhe hapa dritaren për të vështruar më qartë. Sa kohë kishte që ishim ndarë me të! Sa kohë kishte që nuk kishim shkëmbyer ndonjë letër! Unë e dija që ai jetonte mirë e bukur dhe vinte duke u rritur në përgjegjësira. "Bukur, Zalo, bukur," thosha me vete kur dëgjoja fjalë të mira për të nga ndonjë shok apo nga ndonjë artikull gazete. Me të vërtetë, më bëhej qejfi.

– Tani paska ardhur në Tiranë! – thashë dhe u përkula në dritare. Por isha gabuar. Njeriu që ecte në rrugë, nuk ishte ai që kujtoja.

Kjo u bë shkak të ulesha e t'i shkruaja një letër mikut tim të vjetër, Zalo Nemërçkës, të mirit të mullixhiut të fshatit tonë, atij fytyrë pikaloshit, që i kishte aq qejf mëllenjat dhe lepujt. Dhe kur i shkruan ndonjë shokut tënd, duke radhatur gërat dhe fjalët, të del përpara gjithë fëminia, të kujtohen gjithë peripecitë, shkolla, mësuesit, vajzat...



**Dritëro Agolli** Ka qenë shkrimtar, publicist, anëtar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Ka lëvruar me sukses poezinë dhe prozën. Disa nga titujt e librave të tij me poezi janë: "Hapat e mija në asfalt", "Devoll-Devoll", "Baballarët", "Udhëtoj i menduar", "Pelegri i vonuar" etj. Poezia e tij sundohet nga bota e gjallë, shpirtëzimi i mjedisit dhe shenjtërimi i natyrës. Disa nga titujt e librave të tij në prozë janë: "Zhurma e erërave të dikurshme", "Komisari Memo", "Trëndafili në gotë", "Arka e djallit" etj. Kontributi më i rëndësishëm letrar në prozë i Agollit, konsiderohet romani "Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo".

“Isha aty përpara në fshat, – i shkruaja unë Zalos, – dhe tek shkoja arave m’u kujtua bostani i mulla Elmazit. Të bie në mend, kur na e lëshoi qenin atë natë që u futëm të vjedhim? Sa herë e kujtoj, më qeshet, se ti e pësove më keq se unë. Ty, ai qeni i mallkuar, t’i grisi pantallonat, bile edhe brekët... Po mësuesi, kur i futëm në xhep një zhapi të mbështjellë me shami të hundëve? Të kujtohet si u hodh përpjetë në orën e mësimit të natyrës, kur u zgjidh shamia dhe kërceu zhapiu nga xhepi? A të vjen në mend kur të thërrisnim me **llagapin** “**abrash**” dhe ti nxeheshe e na ndiqje me gurë? Oh, ç’**rrufjanë** kemi qenë, more Zalo!”

E kështu i shkrova një letër të gjatë sa një tregim, që botohet në “Drita” apo “Hosteni”. Ajo ishte nga ato letrat e mia plot humor që nuk të mërzitnin duke i lexuar, përkundrazi, të zbavitnin. E mbylla në një zarf dhe ia nisa me postë për në Vlorë, se atje jetonte me gruan dhe fëmijët e tij.

Pas nja dhjetë ditëve, erdhi postieri tek unë dhe më dha një zarf me ca pulla të bukura. Ishte nga Zalo Nemërçka. E hapa me një frymë. I thirra edhe gruas të vinte ta lexonim bashkë, se asaj i pëlqenin letrat e dikurshme të Zalos, pasi ai dinte të tregonte edhe se si e shoqja i kërkonte fustane të mira, e si vinin të dy në **mapo**, e si ziheshin, pasi nuk binin dakord për ngjyrën e materialit që do të blinin.

Dhe tani përsëri, ne kishim në dorë letrën e mikut tonë të dashur. Kokë për kokë me gruan filluam të lexonim. Po ç’patëm vallë, që pas dy-tri radhëve e premë fytyrën, i hoqëm sytë nga geramat dhe shikuam shoku-shokun? Nuk është e mundur! Ku vajti gjithë ai humor i tij? Ku fluturoi gjithë ai gaz i tij që buronte nga çdo radhë e letrave? Nuk është e mundur.

“Shoku Hysen, – shkruante ai, – duke studiuar me seriozitet letrën tuaj, drejtuar në adresën time më datën 14 maj të vitit në vazhdim, jam i detyruar t’ju përgjigjem si më poshtë vijon:

E para: ne jemi tani njerëz të rritur, kemi punë me përgjegjësi, drejtojmë sektorë të ndryshëm të ekonomisë apo të kulturës sonë popullore dhe nuk është aspak e hijshme të merremi me gjëra që nuk janë serioze. Ju akoma jetoni me kujtimet e shkuara dhe s’keni sensin e kohës. Nuk është etike të më përmendni në letër në mënyrë banale as bostanet e **mulla** Elmazit, të atij njeriu **anadollak** që i përket së kaluarës, dhe as të shpifni në mënyrë djallëzore, se gjoja unë, kur isha i vogël, qenka sjellë keq me mësuesit e mi dhe paskam përdorur mjete dhe metoda rrugaçësh për të ulur autoritetin e tyre, siç janë zhapinjte, apo lloje të tjera të botës shtazore.



## Fjalor

**mapo** – kështu quheshin dikur disa dyqane.

**mulla** – titull i lartë që i jepet një hoxhe të ditur.

**anadollak** – ai që ndjek zakone të vjetruara e pranike.



E dyta: llagapin “abrash” nuk dua të ma përmendni nëpër letra, edhe nëse ky llagap i përket së kaluarës. Ju duhet ta dini se unë kam fëmijë. Po ta marrin vesh ata këtë llagap, si do të reagojnë? A nuk do të më vini në pozita të vështira para tyre?

E treta: në qoftë se letra të tilla diskriminuese do të bien në dorë të vartësve të mi, gjë që nuk e kini marrë mirë parasysh, dua të them të punonjësve të sektorit që unë drejtoj, atëherë ç’do bëhet me autoritetin tim?

Shoku Hysen! Ju lutem mos përfitoni nga familjariteti ynë dhe nga shoqëria jonë e fëminisë. Shikojini gjërat dhe fenomenet në mënyrë **dialektike**, në zhvillim, në formë spirale. Në qoftë se do të shkruani, mos e teproni me shakara me zarar. Me nderime. Zalo Nemërçka”.

Ne qëndruam pa folur një çerek ore. E vërtitëm letrën nëpër duar, e lexuam dy-tri herë, u munduam të marrim me mend çastet në të cilat mund të jetë ndodhur Zaloja kur e ka shkruar këtë letër, e ngushëlluam veten, duke thënë se ai ka dashur të bëjë shaka, por më kot. Të dy me gruan mbetëm të trishtuar.






## Fjalor

*dialektike – që ka të bëjë me dialektikën, një shkencë e metodë shkencore.*

### Struktura e tregimit

Tregimi është një krijim që rrëfen për një ngjarje të vetme, pa përmendur me hollësi se çfarë ka ndodhur para kësaj ngjarjeje ose pas saj. Subjekti është i thjeshtë, por me konflikt të ngjeshur.

Tregimi është një tekst që ka tri pjesë themelore: hyrjen (ekspozicionin), zhvillimin brenda të cilit është dhe kulmimi, dhe mbylljen (shthurjen).

-  Në hyrje të tregimit paraqiten personazhet, koha dhe rrethanat ku do të zhvillohet ngjarja.
-  Në zhvillimin e tregimit trajtohen më gjerësisht personazhet ose situata që janë paraqitur në hyrje. Zhvillimi është shumë i shkurtër dhe ndonjëherë është thjesht paraqitja e pikës kulmore të një situatë.
-  Mbyllja e tregimit gjendet në fund të tij. Këtu jepen përfundime për personazhet ose zgjidhja për situatën e paraqitur.


## Studim teksti

## Kuptojmë tekstin

- 1 Lexoni pjesën dhe përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme.
  - Për sa letra flitet në tregim? Kush i dërgon ato?
  - Çfarë i bashkon dy personazhet e tregimit, rrëfimtari dhe Zalon?
    - Jetojnë në të njëjtin qytet.
    - Kanë lidhje gjaku.
    - Janë shokë fëmijërie.
    - Kanë qenë shokë në universitet.
  - A takohen shpesh me njëri-tjetrin personazhet kryesore të tregimit?
  - Në ç'mënyrë komunikon rrëfimtari me Zalon?

## Analizojmë tekstin

- 2 Gjeni në tekst fjalët me të cilat rrëfimtari:
  - a) shpreh mallin për fëmijërinë (të shkuarën);
  - b) përshkruan Zalon fëmijë.
- 3 Rrëfimtari rrëfen për kohën e shkuar, atë të fëmijërisë, dhe kohën e tashme, kur personazhet janë të rritur dhe bëhet shkëmbimi i letrave. Për çfarë shërben një pranëvënie e tillë?
- 4 Çfarë karakteristikash të karaktereve zbulohen nga dy letrat e protagonistëve të tregimit?



## Interpretojmë tekstin

- 5 Përshkruani gjendjen emocionale të rrëfimtarit dhe të gruas së tij, kur lexojnë letrën e Zalos. Si mund ta shpjegoni habinë e tyre?
- 6 Duke lexuar tekstin e letrës së Zalos, kuptoni edhe ndryshimet e karakterit të tij. Si mendoni, pse kanë ndodhur këto ndryshime?

## Gjuha e tekstit

- 7 Duke u nisur nga toni i letrës, konstatoni se Zalo:
  - e këshillon me dashamirësi shokun e tij;
  - e kritikon ftohtë atë.
- 8 Në ç'vetë rrëfëhet ngjarja? Po letrat, në ç'vetë janë shkruar?
- 9 Gjeni në letrën e dytë fjalë të stilit juridiko-administrativ.

## Detyrë

- Gjeni dhe komentoni dy thënie që tregojnë vlerën e shoqërisë së vërtetë.

# Liliputët

## Para leximit

Ky tekst është shkëputur nga libri "Udhëtimet e Guliverit" i shkrimtarit anglez Xhonatan Suift. Në qendër të këtij romani është udhëtimi i personazhit kryesor, Guliverit, të cilit i mbytet anija dhe përfundon në një ishull ku jetonin liliputët. Guliveri, i lodhur dhe i uritur, zgjohet i rrethuar prej këtyre banorëve të çuditshëm të këtij ishulli, të cilët janë shumë të ndryshëm prej tij, veçanërisht për sa i përket përmasave. Pasi kanë vënë re se Guliveri nuk ishte aspak i dhunshëm, atë e shpien para perandorit të tyre. Të gjithë e shikonin Guliverin si një qenie shumë të çuditshme. Ai ishte njeri, por me përmasat e një gjiganti.

Nuk e di se ç'u bënë shokët e mi të barkës, ata që iu qepën shkëmbit, dhe ata që mbetën në anije. Sa për mua, notova në tym dhe për fat më shtyu era nga ana e tokës. U shtriva në një lëndinë, ku bari ishte fare i njomë dhe i butë, si mëndafshi; dhe pas një çike më mbërtheu një gjumë i rëndë, që s'e kam bërë kurrë në jetë; dhe fjeta pothuaj nëntë orë, sa kur u zgjova, dielli ishte ngritur lart. Bëra të ngrihesha, po nuk u ngrita dot; i shtrirë siç isha në kurriz, ndjeva që këmbët e krahët i kisha të lidhur nga të dy anët përtokë; po kështu ishin lidhur edhe flokët, që i kam pasur të gjatë e të trashë. Madje pashë plot fije shumë të holla rreth trupit, nga sqetullat e gjer te kofshët.

Papritmas ndjeva se më lëvriu diçka te këmba e majtë, nga ku më kaloi ngadalë në kraharor e po më ngjitej pak nga pak në mjekër. Pashë një njeri të gjallë, që nuk e kishte shtatin as gjashtë gishtërinj të gjatë, që mbante në duar një hark e një shtizë. Po në këtë kohë pashë se e ndiqnin pas edhe të paktën nja dyzet të tjerë. I habitur siç mbeta, lëshova ca britma aq të forta, sa të gjitha ato krijesa të vockla u larguan të llahtarisura.

Kur pushuan britmat, dëgjova njërin prej tyre që thirri: – Tolgo Fonak! – dhe në atë çast ndjeva se ma shpuan dorën e majtë më se



**Jonathan Swift (Xhonatan Suift)** (1667-1745) poet dhe satirist irlandez. Fillimisht, i botoi veprat e tij me pseudonime ose në mënyrë anonime. Suifti u bë i famshëm kryesisht për librin e tij "Udhëtimet e Guliverit" (1726), i cili në fillim ishte një libër për të rritur. Ai vlerësohet nga Enciklopedia Britanike si satiristi kryesor në prozë i gjuhës angleze, dhe është më pak i njohur për poezinë e tij. Në librin e tij përshkruhen aventurat e një udhëtimi të fantazuar. Krijon një imazh satirik të oborrit mbretëror me të mirat dhe veset e tyre. Nëpërmjet situatave zbavitëse dhe figuracionit të ngjeshur, shkrimtari do të bëhet edhe kritik e moralizues ndaj jetës politike të kohës.



njëqind shigjeta të vockla e të holla si gjilpëra. Pastaj lëshuan në erë një breshëri tjetër shtizash që më binin në trup, sido që nuk i shikoja, dhe plot të tjera më nguleshin në fytyrë, që përpiquesha t'i largoja me dorën e djathtë.

Kur e panë ata **komicë** se po rrija urtë, i prenë të shtënat, po nga zhurma e **poterja**, që sa vinte e shtohet, kuptova se edhe ata **po roitnin** si bleta.

Përballë veshit të djathtë, për më tepër se një orë, dëgjova zhurmë njerëzish që punonin. Kur ktheva kokën nga ajo anë, aq sa më lejonin kunjat e kordonët, pashë se kishin ngritur një **tribunë** ndonjë këmbë e gjysmë të lartë, që mund të nxinte nja katër nga këta **xhuxhmaxhuxhër** – dhe nja dy a tri palë shkallë për t'u ngjitur. Së andejmi njëri prej tyre, që dukej njeri me rëndësi, më mbajti një ligjëratë të pasosur, që nuk e kuptova fare.

Iu përgjigja me pak fjalë, po me një theks të përlurur, duke ngritur dorën e majtë dhe sytë ndaj diellit sikur t'i qaja hallin se po vdisja urie, meqë s'kisha vënë gjë në gojë prej shumë orësh, para se të mbytej anija.

Ai zbriti nga tribuna, urdhëroi të vendosnin plot shkallë në të dy brinjët e mia, nëpër të cilat u ngjitën ndo njëqind veta, që pastaj m'u drejtuan nga goja, të ngarkuar me **kofinë** plot me mish, që ishin grumbulluar e dërguar atje me urdhër të mbretit, me t'u marrë vesh se kisha arritur unë. Vura re se kishte çdo lloj mishi, nga kafshë të ndryshme, po nuk i dallova dot se ç'ishin, kur i shijova.

Kishte kofshë, shpatulla, brinjë që dukeshin si prej dashi, të gatuar mirë, por më të vockla se krahët e një laureshe. Gllabëroja njëherësh nja dy a tri të atilla bashkë me tri bukë të mëdha sa plumbat e pushkës. Tek m'i binin gjithë këto të ngrëna, ata dukeshin shumë të habitur e të mahnitur, që shikonin trupin tim sa një mal dhe atë urinë time të pasosur.

Bëra një shenjë tjetër për t'u treguar se kisha etje; duke parë se s'kisha të ngopur në të ngrënë, ata menduan se edhe etja ime nuk



## Fjalor

*liliput-i* – njeri me përmasa shumë të vogla.

*komici* – gishta, personazh përallë.

*potere* – zhurmë e madhe e shkaktuar nga zërat e njerëzve.

*po roitnin* – këtu: zukat, gumëzhin.

*tribuna* – vend i ngritur para një sheshi, ku qëndron mbreti, perandori, udhëheqësi.

*xhuxhmaxhuxh* – njeri shumë i shkurtër, shkurtabiq.

*kofin* – kosh i thurur që përdoret për të mbajtur rrush, fiq.

**Fjalor**

*vozë* – enë e madhe, e rrumbullakët e me bark të gjerë, që përdoret për të mbajtur verë.  
*këmba* – këtu: masë gjatësie a thellësie, e barabartë me 30,5 centimetra.  
*faltore* – ndërtesë ku falen besimtarët.

mund të shuhej lehtë dhe gjetën një marifet të bukur: ngritën me mjeshtëri një nga **vozat** më të mëdha që kishin sjellë me verë, e rrokullisën gjer te dora ime, pastaj e ngritën më këmbë dhe i hapën grykën. E rrëkëlleva njëherësh pa mundim, se nuk kishte më tepër se një gjysmë litri; i përngjante disi verës së Burgonjës, por ishte edhe më e shijshme. Më sollën një fuçi tjetër, e piva dhe ua bëra me shenjë të më binin ca të tjera, po i kishin mbaruar. Si panë që bëra gjithë këto mrekullira, zunë të thërrisnin nga gëzimi dhe të hidhnin valle mbi kraharorin tim.

Pas një copë here, kur panë se isha ngopur, para meje doli një nga të parët e vendit, që e kishte dërguar Madhëria e tij, mbreti. Ai e mori vesh që i lutesha të më zgjidhnin; më dha të kuptoja se do të më shpinin ashtu siç isha, po duke m'u zotuar me ca shenja të tjera se do të më jepnin të haja e të pija sa të më shihnin sytë, dhe se do të më mbanin shumë mirë.

Pas pak kohe, dëgjova një breshëri duartrokitjesh, që ndërpritej dendur nga brohoritma. Ai popull e ndan qimen më katërsht në matematikë e në mekanikë, shkenca që perandori i tyre i nxit e i përkrah. Perandori ka ca makina të mrekullueshme për mbartje, që mund të ngrenë anije luftime (nganjëherë nëntë **këmbë** të gjata) dhe t'i shpien nga pyjet ku janë ndërtuar, gjer në bregdet. Pesëqind inxhinierë e zdrukthëtarë u ngarkuan të stisnin një prej këtyre makinave, që të më mbartte mua. Ishte një qerre shtatë këmbë e gjatë e katër e gjerë, që mbahej mbi njëzet e dy rrota, e ngritur një gjysmë këmbë nga dheu. Një mijë e pesëqind nga kuajt më të mirë të perandorit më tërhoqën gjer në kryeqytet, sipas nesh, nja gjysmë milje më tutje.

Ecëm pa reshtur tërë ditën e ditës dhe natën e gdhiva në fushë, me pesëqind roja përçark, gjysma me pishtarë dhe gjysma me harqe dhe shigjeta, gati të më gjuanin po të merrja arratinë. Ndaj të gdhirë vazhduam udhën dhe aty nga dreka arritëm afër kryeqytetit. Gjithë oborrtarët, me perandorin në ballë, kishin dalë të më shikonin, po oficerët madhorë nuk e lanë Madhërinë e tij ta vinte kokën në trastë, duke hipur mbi trupin tim.

Nuk e them dot me fjalë habinë e poteren e popullit, kur më panë që u ngrita e po barisja. Meqë vargonjtë e këmbës së djathtë ishin afro gjashtë këmbë të gjata, jo vetëm mund të veja e të vija në një hapësirë gjysmë rrethi, po kisha mundësi të hyja barkas gjer te dera e madhe dhe të shtrihesha në **faltore**.

## Letërsia me fantazi dhe aventura

Letërsia me fantazi dhe aventura karakterizohet nga:

- ▣ rrëfime të historive me magji;
- ▣ rrëfime ku ndodhin mrekulli;
- ▣ prania e dukurive mbinatyrore.

Në letërsinë me fantazi dhe aventura gjejmë një sërë elementesh që janë vazhdimisht të pranishme:

1. **Udhëtimi:** heroi ose heroina ndërmarrin një udhëtim të rrezikshëm.  
Në këtë udhëtim, ata janë në kërkim të një thesari, të ndonjë objekti magjik, të zgjidhjes së ndonjë enigme.  
Gjatë udhëtimit, atyre iu duhet të kapërcejnë pengesa të shumta apo të përballen me rreziqe të mëdha për jetën.
2. **Lufta:** Heronjtë luftojnë me forca të panjohura apo edhe përtej moshës e përmasave të tyre fizike.
3. **Konflikti:** Shpesh ai merr përmasat e përballjes mes së mirës dhe së keqes.

## Studim teksti

### Kuptojmë tekstin

- 1 **Përgjigjuni pyetjeve rreth tekstit:**
  - a) Çfarë e papriture e priste Guliverin, kur u zgjua nga gjumi në mes të lëndinës?
  - b) Si ishte sjellja e banorëve të vendit, ku kishte përfunduar Guliveri?
  - c) Përse liliputët e ndaluan luftën kundër Guliverit?
  - d) Çfarë kërkoi Guliveri prej vendasve?

### Analizojmë tekstin

- 2 Përshkruani pamjen fizike të liliputëve.
- 3 Përshkruani mënyrën me të cilën u ushqye Guliveri. Me çfarë u ushqye?
- 4 Përshkruani mënyrën se si e shoi etjen Guliveri. Çfarë tregon për përmasat e tij, mënyra se si u ushqye dhe se si piu ai?
- 5 Në këtë libër gërshetohen bukur ngjarjet reale me ato fantastike. Duke u nisur nga fragmenti i mësipërm, shënoni me po/jo, cilat janë elementet që e klasifikojnë këtë vepër letrare si letërsi me fantazi dhe aventura.

Personazhet ndërmarrin udhëtime të rrezikshme.	
Personazheve u duhet të kapërcejnë pengesa të shumta, të jashtëzakonshme.	
Personazhet përballen me rreziqe të mëdha për jetën.	
Personazhet luftojnë me forca të panjohura, si magjistarë, forca të mbinatyrshme.	
Konflikti merr përmasat e një përballjeje mes së mirës dhe së keqes.	

- 6 Si ishte ndërtuar karroca me të cilën e transportuan liliputët, Guliverin? Çfarë tregon për liliputët ndërtimi i këtij mjeti?
- 7 A do të dëshironit të jetonit në ishullin e liliputëve? A do të përfitonit nga fakti se ju jeni shumë më i madh se ata?

### Detyrë

- ▣ Lexoni pjesën ku Guliveri shkon në ishullin e gjigantëve, ku raportet në përmasa përmbysen. Më pas, diskutoni në klasë sjelljen e Guliverit në të dy vendet.

# Të rrethuar nga ujqit e kuq

## Para leximit

Kjo pjesë është shkëputur nga romani "Bijtë e Kapitenit Grant". Një mesazh në shishe transmeton një lutje urgjente nga dikush që rezulton i humbur për një kohë të gjatë. Ky është kapiteni Grant. Anija e tij, "Britania", është mbytur, por ai është gjallë dhe mbahet peng. Fëmijët e kapitenit Grant, Meri dhe Robert, së bashku me mikun e tyre, Z. Glinaven, nisin një ekspeditë shpëtimi. Duke sfiduar kohën dhe duke vënë në rrezik jetën e tyre, ata janë të vendosur për të gjetur dhe për të shpëtuar kapitenin Grant. Në këtë pjesë, autori rrëfen për një nga rreziqet e mëdha që u kanoset atyre gjatë rrugëtimit në kërkim të kapitenit Grant.

Pllakosi nata. Ish hëna e re dhe atë natë gjithë banorët e atij vendi nuk do ta shihnin yllin e argjendtë. Vetëm shkëlqimi i drithëruar i yjeve e ndriçonte fushën.

Edhe Glinaveni, Roberti dhe Talkavi i qenë nënshtruar asaj ligjësie të përbashkët. Të shtrirë në shtratin e trashë me tërfil, i kish zënë një gjumë i rëndë. Kuajt, të këputur nga të lodhurit, kishin rënë përdhe; vetëm Tauka, vërtet kalë race, po flinte ngritur mbi të katër këmbët, krenar si në pushim, edhe në veprim, dhe gati të sulej posa t'i bënte i zoti shenjën më të vogël.

Por ndaj orës dhjetë, pas një gjumi të shkurtër, indiani u zgjua. Sytë iu bënë qelq nën vetullat e vrenjtura dhe veshët i zgjati nga fusha. Sikur donte të rrëmbente ndonjë tingull të pandijshëm. Sakaq një shqetësim i vagëlluar iu duk në fytyrë, sado që e kish zakon të qëndronte gjithnjë gjakftohtë. Mos kish ndier të afroreshin indianë endacakë, ose jaguarë, tigra uji ose shtazë të tjera të hatashme, që nuk mungojnë në afërsi të lumenjve? Duket se ky do të kishte qenë shkak, se u hodhi një sy të shpejtë lëndëve djegëse që ndodheshin në atë vathë dhe shqetësimi iu shtua ca më shumë.

(...) Nuk priti gjatë. Një klithmë e çuditshme, një përzjerje të lehurash dhe ulërimash gjëmoi në Pampas. Krisma e pushkës iu përgjigj dhe u ndoq nga njëqind klithma të hatashme. Glinaveni dhe Roberti, që u zgjuan befaz, brofën në këmbë.



**Jules Verne (Zhyl Verni)** lindi në vitin 1828, në Nantë të Francës. Fillimisht ndoqi studimet për drejtësi në Paris, por i ndërpreu ato për të filluar karrierën si shkrimtar. Zhyl Verni ka shkruar 58 romane, ndër të cilët më të njohurit janë: "Ishulli misterioz", "Rreth botës për 80 ditë", "20 milje nën det", "Nga Toka në Hënë", "Udhëtim në qendër të Tokës", "Aventurat e kapitenit Hateras", "Fari në fund të botës", "Sfinksi i akujve", "Bijtë e kapitenit Grant", "Kapiteni pesëmbëdhjetëvjeçar", "Dy vjet pushime" etj. Pas suksesit të veprave të tij, Zhyl Verni fitoi popullaritet në të gjithë botën. Vdiq në Amien, më 24 mars 1905.

– Ç’është? – pyeti djaloshi Grant.  
 – Indianë? – tha Glinaveni.  
 – Jo, – iu përgjigj Talkavi, – aguaras.  
 Roberti vështroi Glinavenin në sy.  
 – Aguaras? – pyeti.  
 – Po – iu përgjigj Glinaveni, – ujqit e kuq të Pampasit.  
 – Glinaveni e kuptoi aty për aty se me këtë emër, indianët e Pampasit quajnë ujkun e kuq.

Ky mishngrënës, *canis jubatus* i natyralistëve, e ka shtatin sa të një qeni të madh dhe kokën si të dhelprës, e ka qimen të kuqe kanellë dhe në shpinë i valëvitet një krifë e zezë në tërë **peshkun** e kurrizit. Kjo shtazë është shumë e shkathët dhe e fuqishme...

Glinaveni dhe Roberti u vendosën të hyrja e ramadës. Kishin ngritur pushkët dhe qenë gati të shtinin kundër radhëve të para të aguarasve, kur Talkavi ua mbajti me dorë armët që kishin në sy.

– Ç’kërkon Talkavi? – tha Roberti.  
 – Na ndalon të shtiem! – u përgjigj Glinaveni. – Po pse?  
 – Mbase sepse nuk i duket që ka ardhur çasti i volitshëm.  
 Po s’qëndronte këtu shkakun që e bënte indianin të vepronte kësisoj; kish një arsye shumë të rëndë dhe Glinaveni e kuptoi kur Talkavi ngriti thesarin e barutit, e përmbysi dhe ia tregoi se qe pothuaj bosh.  
 – Ahere? – i tha Roberti.

– Ahere na duhet të kursejmë barutin. Gjahu i sotëm na kushtoi shtrenjtë dhe tani jemi ngushtë me saçma e barut. S’na mbeten as njëzet të shtëna.

Djaloshi nuk u përgjigj.

– A ke frikë, Robert?

– Jo, milord.

– Rrofsh, biri im.

Në atë çast u dëgjua një krismë tjetër. Talkavi kish vrarë një armik shumë guximtar; ujqit, që po vinin grumbuj-grumbuj, u prapsën dhe u mblodhën kokë më kokë ndo njëqind çapa nga vatha.

Sakaq Glinaveni, si pas një shenje që i bëri indiani, zuri vendin e tij; ky mblodhi kashtën, barin, tërë lëndën djegëse që gjeti, e grumbulloi në hyrje të ramadës dhe hodhi përsipër një thëngjill që ish akoma ndezur. Pas pak, një perde flakësh u ndeh në sfondin e nxirë dhe nëpër plasat e tyre u duk fusha që po ndriçonte nga xixëllima të lëvizshme. Ahere Glinaveni e pa sa të shumta ishin këto kafshë dhe sa vështirë ishte t’u bëhej ballë.



## Fjalor

*peshk* – këtu: sharra e kurrizit.

– Për një orë, – tha ai, – s’do kemi as barut, as saçma, as zjarr. Mirëpo nuk duhet të presim atë çast për të marrë një vendim të prerë.

Iu drejtua, pra, indianit dhe, me ato pak fjalë spanjolle që i kishin mbetur ndër mend, ia nisi me të një bisedimi që u ndërpre dendur nga të shtënat e pushkëve. Ata, të dy burra, mezi merreshin vesh. Për fat të mirë, Glinaveni i dinte zakonet e ujëve të kuq. Po të mos kish ditur, s’do kish mundur të kuptonte fjalën dhe lëvizjet e tij.

– Po ç’u përgjigj ai? – pyeti Robert Granti.

– Më tha që, me çdo kusht, duhet të qëndrojmë gjersa të zbardhë drita, se në atë kohë ky farë ujku hyn në strofkën e tij.

[...] Ndaj orës dy të mëngjesit, Talkavi hodhi në zjarr edhe krahun e fundit me lëndë djegëse dhe nuk u mbeteshin më veç edhe pesë të shtëna. [...]

Befas u dëgjuan kthetrat e tyre të ngulen në dërrasat gjysmë të kalbura. Nëpër hunjtë e lëkundshëm po kalonin këmbët e tyre të fuqishme, zverku i tyre i përgjakur. Kuajt, të çakërdisur, këputën litarët dhe po rendnin brenda vathës si të tërbuar nga frika. Glinaveni e rroku në krahët e tij djaloshin, që ta mbronte gjer në pikën e fundit. Mbase po mendonte të sulej përjashta duke kërkuar shpëtim në një ikje të pamundur, kur sytë i vajtën tek indiani.

– Po na lë! – thirri ai, kur e pa Talkavin që po mblidhej te freri, si një kalorës që është gati t’i hidhet kalit në shalë.

– Ai, kurrën e kurrës! – tha Roberti.

Dhe vërtet, indiani po bënte çmos tani, jo që t’i linte miqtë, po që t’i shpëtonte duke bërë fli vetveten.

Tauka qe gati: kafshonte frerin me dhëmbë, hidhej përpjetë; sytë e tij, tërë zjarr, lëshonin xixa; e kish kuptuar të zonë.

– Robert, mor bir! A po dëgjon? Kërkon të bëhet fli për ne! Kërkon të sulet në Pampas, që t’i largojë ujëqit nga ne dhe t’i tërheqë pas vetes!

– Talkav, – iu përgjigj Roberti, duke i rënë ndër këmbë Patagonasit, mik i dashur, mos na lër!

– Jo! – tha Glinaveni, – nuk do na lërë.

Dhe iu kthye indianit:

– Hajt të nisemi bashkë, – i tha duke i treguar kuajt të trembur dhe të rrasur pas hunjvet.

– Jo, – iu përgjigj indiani, që i kuptoi fare mirë ato fjalë. – Shtazë e keqe. Frikë. Tauka. Kali i mirë.

– Ashtu qoftë! – tha Glinaveni. – Talkavi nuk do largohet nga ti, Robert! Ai po më mëson se ç’duhet të bëjë! Po nisem unë! Ai le të mbetet me ty. Pastaj rroku frerin e Taukës.

– Do nisem unë! – i tha.

– Jo, – iu përgjigj Patagonasi me gjakftohtësinë më të madhe.

– Unë, të them, – i thirri Glinaveni duke i rrëmbyer frerin nga dora. – Unë, të them! Shpëtoje këtë djalë! Ta kam lënë amanet, Talkav.

[...] Glinaveni dhe Talkavi mezi patën kohë t’ia hidhnin sytë Robertit, kur ky, i kapur pas krifës së Taukës, u zhduk në errësirë.

– Robert! Mor qyqar! – i thirri Glinaveni.

Po këto fjalë s'i dëgjoi dot as indiani vetë. Shpërtheu një ulërimë e llahtarshme. Ujqit e kuq, që u sulën pas gjurmëve të kalit, ia mbathën nga perëndimi me një shpejtësi fantastike.

[...] Në orën katër të mëngjesit zuri të zbardhë drita. Kish ardhur çasti për t'u nisur.

– Hajt, për udhë, – tha indiani.

Për një orë të tërë, ata ecën kështu vetëtimthi, duke kërkuar me sy dhe duke pasur frikë se mos takonin kufomën e tij të përgjakur. Glinaveni ia bëri copë ijët kalit të tij me *mamuzet* e veta. Më në fund u dëgjuan ca krisma pushke.

– Ata janë, – thirri Glinaveni.

Talkavi dhe ai i nganë kuajt edhe më tepër dhe, pas pak, hasën çetën e vogël të udhëhequr nga Paganeli. Një klithmë doli nga gjoksi i Glinavenit. Roberti ish me të, i gjallë, tamam i gjallë, kaluar mbi Taukën madhështor që hingëllinte tërë gëzim duke parë të zonë. [...] [...] – Pse mor bir, pse nuk e le Talkavin ose mua të bënim orvatjen e fundit që të të shpëtonim?

– Milord, – iu përgjigj djali me theksin më të thellë të mirënjohjes.

– A nuk qe detyra ime për t'u bërë fli? Talkavi më shpëtoi një herë jetën, kurse ju, ju po më shpëtoni babanë.



## Fjalor

*mamuze* – kllapë hekuri në trajtë potkoi, të cilën kalorësit e mbërthejnë pas thembrës së çizmes për të shpuar kalin që të ecë më shpejt.

## Studim teksti

### Kuptojmë tekstin

- 1 Përgjigjuni pyetjeve rreth tekstit.
  - ▣ Kur zhvillohen ngjarjet e rrëfyera në këtë pjesë?
  - ▣ Çfarë po bënin personazhet para se të dëgjonin krismen e pushkës?
  - ▣ Kush prej tyre e zbuloi rrezikun që po u kanosej?
  - ▣ Çfarë përdorën në fillim për të sprapsur rrezikun?
  - ▣ Pse u shqetësua aq shumë Talkavi?
  - ▣ Çfarë rreziku përbënte për ta prania e aguarasve?

### Analizojmë tekstin

- 2 Plotësoni tabelën me veçoritë fizike dhe ato të sjelljes së aguarasve.

Veçoritë fizike	Veçoritë e sjelljes

- 3 Në ç'mënyrë mund të shpëtojnë personazhet tona prej aguarasve?

## Studim teksti

- 4 Gjeni në tekst momentin që duket sikur situata është pa asnjë rrugëdalje.
- 5 Duke u nisur nga pjesa që lexuat, çfarë moshe mendoni se është Roberti?
- 6 Kush ishte i gatshëm në një moment shumë të vështirë, të rrezikonte dhe të flijohej për të shpëtuar shokët? Shënoni me ✓ përgjigjen e saktë.

Talkavi  Glinaveni  Roberti

- 7 Kush prej personazheve të lartpërmendura rrezikoi jetën e tij për të shpëtuar të tjerët?
- 8 Shkruani në fletore emrat e të gjitha personazheve që marrin pjesë ose që përmenden në këtë pjesë.

## Interpretojmë tekstin

- 9 Çfarë ndjesish përjetoni gjatë leximit të kësaj pjese? Shënoni me ✓ përgjigjen.

Frikë	
Dhimbje	
Ankth	

Vlerësim	
Trishtim	
Mërzi	

- 10 Çfarë arsyes e shtynë Robertin të kryente veprimin e përshkruar në tekst?

## Detyrë

- ▣ A keni lexuar ndonjë roman tjetër të shkrimtarit Zhyl Vern? Shkruani përmbajtjen e tij ose përmbajtjen e pjesës së mësipërme.

## Shkruajmë

## Rishikimi i një teksti

Rishikimi i një teksti kërkon shqyrtimin e punës me shkrim nga ana kuptimore, leksikore, gramatikore, drejtshkrimore dhe nga pikësimi.

Rishikimi i shkrimit nga ana kuptimore	<ul style="list-style-type: none"> <li>▣ Verifikoni që shkrimi ta shtjellojë temën e dhënë me ide që lidhen nga ana kuptimore me të.</li> <li>▣ Verifikoni nëse fjalitë e shkrimit lidhen nga ana logjike me njëra-tjetrën dhe formojnë paragrafë që kanë kuptim.</li> <li>▣ Verifikoni që shkrimi të jetë i organizuar sipas strukturës hyrje – zhvillim – mbyllje.</li> </ul>
Rishikimi i shkrimit nga ana leksikore	<ul style="list-style-type: none"> <li>▣ Verifikoni që fjalori i shkrimit të jetë i larmishëm dhe i zgjedhur me kujdes.</li> <li>▣ Gjeni fjalët e huaja që mund të keni përdorur dhe zëvendësojini ato me gjegjëse të shqipes.</li> </ul>
Rishikimi i shkrimit nga ana gramatikore	<ul style="list-style-type: none"> <li>▣ Verifikoni që kohët e foljeve të jenë shkruar si duhet.</li> <li>▣ Verifikoni përshtatjen gramatikore mes emrave, mbiemrave dhe foljeve.</li> <li>▣ Verifikoni ndërtimin e fjalive dhe renditjen e gjymtyrëve të tyre. A arrijnë ta përcjellin si duhet informacionin që doni të transmetoni?</li> </ul>
Rishikimi i shkrimit nga ana drejtshkrimore	<ul style="list-style-type: none"> <li>▣ Verifikoni saktësinë drejtshkrimore të fjalëve që përbëjnë shkrimin.</li> </ul>
Rishikimi i shenjave të pikësimit	<ul style="list-style-type: none"> <li>▣ Verifikoni që t'i keni vendosur si duhet shenjat e pikësimit, duke u bazuar në njohuritë e deritanishme.</li> </ul>

- ▣ Rishikoni, sipas rregullave të mësipërme, përmbajtjen që shkruat në rubrikën "Detyrë".



# Përleshja e kryetrimnit me kryepiratin

## Para leximit

Kjo pjesë është shkëputur nga romani "Shpella e piratëve". Një grup fëmijësh, të karakterizuar nga guximi, por edhe kurioziteti i moshës, hyjnë në atë që njihet si shpella e piratëve. Aty gjejnë një libër, në të cilin rrëfëhet historia e kryetrimnit Gjonbaba (që mbron interesat e banorëve vendas) dhe e kryepiratis Rusman El Namsuri, i cili kishte nëntë vjet që vriste e priste, plaçkiste dhe shkatërronte anijet që kalonin në det. Ndërmjet tyre zhvillohet një dyluftim i tmerrshëm për jetë a vdekje, që në libër rrëfëhet me nota të forta fantastike.

Arritëm në një shpellë të vogël. Në hyrje kishte shumë shtylla. Hymë brenda. Dyshemeja ishte me kalldrëm. Shpella dukej si një dhomë, se kishte *kamare*, *potone*, mindere guri dhe një shtrat. Fenerët që mbanim në duar ngriheshin e uleshin, siç ngrihej dhe ulej vala e kureshtjes sonë për ato që shikonim.

Gjonbaba u mundua shumë sa e çeli atë *kamare* të gjatë si qivur. Ishte një *kanavetë* e bërë me një trung të prerë e të gdhendur bukur. Geëëërrr! – bëri kapaku, kur u hap.

– Më ndihmoni! – u dëgjua zëri i Gjonbabës sonë.

Sa i rëndë që ishte kapaku! Si plumb. Tetë duar e mbanin! Kurse duart e Gjonbabës preknin gjëra të çuditshme: një shpatë, një mburojë, helmetë,... dhe një libër të madh me fletët prej papirusi të fortë...

Gjonbaba e mori këtë libër gjigant. Mezi e ngriti. Kur u largua pakëz, urdhëroi:

– Mbylleni!

Ne e mbyllëm *kanavetën*. Dhe iu afruam kapedanit tonë, që e kish shtrirë librin e madh mbi një *poton*.

Ai, gati sa s'fluturoi nga gëzimi. Çeli disa faqe dhe u kthye nga ne:

– Është historia e shpellës së *piratëve*!

## Fjalor

*kamare* – hapësirë si dollap i vogël në mur, zakonisht në anë të oxhakut, ku vihen enë a sende të tjera të vogla.

*potone* – vend i ngritur prej guri anash portave, për t'u ulur.

*kanavetë* – arkë e vogël ku mbahen sende me vlerë.

*pirat* – kusar deti.

**Petro Marko** ishte arsimtar, publicist, gazetar, shkrimtar. Lindi në vitin 1913, në Dhërmi të Himarës, të cilin e quante fshati më i bukur në botë. Mori pjesë në Luftën e Spanjës së bashku me një grup shqiptarësh patriotë, që dolën vullnetarë për të luftuar kundër fashizmit. Atje ai takoi Heminguejin, shkrimtarin e njohur, të cilin do ta vlerësonte gjithë jetën. Në vitin 1940, u burgos nga italianët, që asokohe kishin pushtuar Shqipërinë, dhe përfundoi në kampin e Ustikës, një ishull afër Palermos. Shumë nga këto eksperiencat ai i ka pasqyruar në veprat e tij. Petro Marko ka botuar një sërë romanesh, si: "Qyteti i fundit", "Stina e armëve", "Halimi", "Ultimatum", "Një emër në katër rrugë", "Nata e Ustikës", "Hasta la vista", "Shpella e Piratëve" etj.



– Me kujdes! – tha Fotua. – Mos na bëhet shkrumb!  
 – Mirë e ka! – pohoi Gjonbaba. – Se me të vërtetë, gati të bëhet hi është! Dhe kush e di ç’vlerë ka... Po, pa dale të shohim, se mos nxjerrim ndonjë fjalë...

I pari që zbuloi emrin e Rusman El Namsurit, ish Fotua.

– Afroi më shumë fenerët! E mos e prekni librin! – urdhëroi Gjonbaba ynë dhe e ktheu, duke u nisur nga faqja e parë. – Shkronjat janë pak a shumë si tonat, po më të përdredhura...

“U Gion Nipi, Biri i Gion birit et nipi i zullumadhit kapedan Gionbaba shkruaj historia e ksaj spelle, liruo ka fundi vitit 999 kontra saraçenëve... Im zot gysi Gionbaba dëbou et mundi kursarin kapedan pirat Rusman El Namsur”...

– Shumë mirë! Shumë mirë! – thirri i entuziazmuar Jani. – Qenka shkruar shqip... E kuptojmë mirë!

– Po – tha, gati për të fluturuar nga gëzimi, Fotua, – unë e kuptova. Megjithëse është shqipe e vjetër.

– Domethënë, im atë e paskish dëgjuar mirë që Gjonbaba kish mundur Rusman El Namsurin!

– Po ku e dinte ai? – pyeti Fotua.

– Nga gojëdhëna! – u përgjigj Gjonbaba ynë. – Që shekuj e shekuj me radhë. Po tani kini durim sa të nxjerrim këtë shkrim e këto fjalë të lashta...

– Domethënë këto i shkruan Gjonnipi!

– Këndoje me ngadalë. Ç’thotë ashtu? – pyeta unë, i kredhur në ato që lexonte Gjonbaba ynë.

– Aman, mos e ndërpritni! – ulëriti Fotua.

– “... El Rusman El Namsur ndezi beleg tek Perrua hores inë, kur si rrufe flakrua kapedan zullumadh Gionbaba et nië dit et dy net përlesje strou përdhe Rusman El Namsur, uku i deteve et ziarri i stereve... I preu *katinën* me zverk të rrumbullaktë sa të kaut et miekër të gjatë gjer te komba... Giaku rrodhi rrëke të përruo kië sot kiuhet Perruo Rusmanit...”

Kjo fletë nuk lexohet dot.

– Me ngadalë se mos grisët! Kur të dalim së këtejmi, do të përpiqemi ta lexojmë! – tha Fotua. [...]

[...] E kuptuat gjer këtu? – pyeti Gjonbaba ynë.

– Unë jo! – tha Lulja, që ish gjunjëzuar dhe mbante pranë librit fenerin e saj.

– Si s’e kuptove? – u hodha unë. – Shumë e qartë: Gjonbaba nxori nga shpella Rusman El Namsurin dhe e ndoqi dhe, pas një ditë e dy net lufte, e shtriu përdhe dhe i preu kokën aty ku sot quhet Përroi i Rusmanit.

– Se ç’domethënë beleg? Ç’domethënë hora? – pyeti Jani.



## Fjalor

*katinë* – kokë.

*fellukë* – varkë druri e vjetër.

*këllëç* – shpatë ose thikë me dy tehe, që mbahet në brez.

– Beleg, domethënë luftë! Hora, domethënë, qyteti.

– u përgjigj i sigurt Gjonbaba ynë, si një njeri që i di të gjitha. – Pa dale, se këtu nga njëra anë përshkruhet si ka qenë Gjonbaba dhe nga ana tjetër si paraqitej Rusman El Namsuri...

– Ai e lexoi e pastaj u ngrit më këmbë dhe përsëriti:

“Gjonbaba, – shkruan Gjonnipi, – ishte dy metra i gjatë. Peshonte sa një ka. *Fellukët* zhyteshin në ujë, kur hypte ai në to. Një sy e kishte humbur në betejë kundër piratëve. Në faqen e djathtë kishte shumë të çara thike. Syrin e humbur e mbante të lidhur me një pece të zezë. Mjekarën e kishte të dendur dhe të gjerë gjer te gjoksi i tij katror. Këmbët i kishte të shpejta. Mund të qëndronte edhe një javë pa ngrënë. Po kur

hante, s'i dilte një dem i pjekur në hell. Verën e pinte si ujë dhe kurrë nuk dehej. Ditën që do të luftonte me Rusman El Namsurin, provoi forcat duke ngritur në krahë një kalë të gjallë dhe duke shkukur një lis të moçëm... kur kollitej, sikur bubullinte. Kur qeshte, sikur shqyheshin çatitë e shtëpive. Nëntë vjet gjersa shkuli piratët nga kjo shpellë, që e kish kthyer në kala të pamposhtur, jetoi si i tërbuar; nëntë vjet gjaku kish skuqur detin. [...]

[...] Rusman El Namsurin, – tregonte pastaj Gjonbaba ynë, – ishte një ujk i detit. Thuhet se kishte lindur nga një magjistare këtej Maleve të Sinajës. Kishte trupin e një gjarpri, se me gjarpërinj ish rritur. Thonë se ushqehet me trutë e peshkut dhe mund të zinte të gjallë edhe peshkaqenin; thonë se kafshët i vinte në gjumë me një shikim dhe delfinët i shkonin si manarë; thonë se kur këndonte ai, flinin erërat e detit... thonë se ishte martuar me të Bukurën e Dheut që banonte në fund të detit... thonë se asnjë rrufe nuk e godiste ... thonë...

Rusman El Namsuri gajasej, hante, pinte, plaçkiste, vriste, digjte... Ndërsa Gjonbaba e ftonte të dilte në mejdan e të provonte forcën e tij... Kryepirati ishte dhelpër. E kish parë nga shpella Gjonbabën dhe kish kuptuar se po të ndeshet me të, do të humbiste, do të vritej...

Në kohën kur bota priste kiametin, se për pak ditë do të agonte viti 1000, gjë që e priste edhe vetë i biri i magjistares, gjarpri dhe ujku i detit, Rusman El Namsuri, ndodhi ajo që ndodhi: kryepirati duke u kapardisur doli me fellukë dhe sodiste malet tona... Gjonbaba, që për nëntë vjet, nëntë muaj, nëntë javë e nëntë ditë e ruante, dha urdhër që të bllokohej hyrja e shpellës dhe dalja në det të hapur. Dhe i doli përkundraill atij që i trembeshin dhe peshkaqenët e detit. Dhe bërtiti. Ku je, o pjell' e errësirës dhe ligësisë! Dil në fushë të mejdanit, o turp, o i lyer, i zhyer, i gërryer, o derr, o gjarpër, o hie...

[...] Përleshja zgjati nëntë orë! Luftonin bajlozi i zi me zotin e vendit! Dhe ku binin të dy të mbërthyer, rrokulliseshin shkëmbinjtë. E po të binin në trungjet e lisave apo të ullinjve, trungjet thyheshin sikur të ishin kashtë misri.



Piratët saraçenë ulërinin si çakej të tërbuar për t'i dhënë zemër kapidanit të tyre, që dukej si një bishë e trullësuar... Kur ish duke perënduar dielli, Gjonbaba e sulmoi me tërbim, e shtriu përdhe, nxori *këllëcin* dhe i preu kokën. Gjaku shkoi rrëke...dhe ai vend u bë përrua i gjerë... Ish gjaku i Rusman El Namsurit që e çeli atë përrua.... Saraçenët, të tmerruar, ua hipën fellukëve të tyre dhe u zhdukën në horizontin e detit, që po errësohej”...

Vendosëm ta ndërprisnim leximin. Gjonbaba ynë na hodhi një shikim, për të na parë se në ç'gjendje ishim.

## Studim teksti

### Kuptojmë tekstin

- 1 Përgjigjuni pyetjeve rreth tekstit:
  - ▣ Si ishte pjesa e brendshme e shpellës? Me çfarë ngjante?
  - ▣ Çfarë kishte brenda në kanavetë?
  - ▣ Për çfarë flitej në librin që gjetën fëmijët?
  - ▣ Në çfarë gjuhe ishte shkruar libri?
  - ▣ Kush e kishte shkruar librin?
  - ▣ A kishin dëgjuar ndonjëherë fëmijët për personazhet që përmenden në libër? Nga kush kishin dëgjuar?
  - ▣ Sa kohë zgjati lufta mes Gjonbabës dhe Rusman El Namsurit? Kush e fitoi dyluftimin?

### Analizojmë tekstin

- 2 Gjeni në tekst elemente që tregojnë respektin që kanë fëmijët për komandantin e zgjedhur prej tyre.
- 3 Paraqitni me anë të diagramit të Venit karakteristikat fizike dhe morale të Gjonbabës dhe Rusman El Namsurit.
- 4 Gjeni në tekst fjalitë që tregojnë qëndrimin e Gjonbabës ndaj piratit Rusman El Namsuri. Shpjegoni arsyet e një qëndrimi të tillë.

### Gjuha e tekstit

- 5 Gjeni në tekst fjalë që i përkasin gjuhës shqipe, por tregojnë se libri është shkruar shumë kohë më parë.
- 6 Gjonbaba përshkruhet me përmasa të hiperbolizuara. Gjeni në tekst hiperbolat që shprehin këtë gjë.

### Reflektojmë rreth tekstit

- 7 Duke u nisur edhe nga pjesa që lexuat, diskutoni rreth rolit që kishte deti për njerëzit që jetonin pranë tij apo për ata që udhëtonin me anije. Përshkruani vështirësitë me të cilat përballëshin ata, sidomos rreziqet që u kanoseshin nga piratët.

### Detyrë

- ▣ A keni lexuar libra të tjerë, në të cilët rrëfohen histori me piratë? Diskutoni në klasë rreth subjektit të tyre.

# Nëndhesja

## Para leximit

Njerëzit gjithmonë janë përpjekur të ndërtojnë pajisje, nëpërmjet të cilave plotësojnë disa nga dëshirat apo pasionet e tyre, p.sh. të udhëtojnë nën tokë, të zhyten në ujë, në thellësi të mëdha, të fluturojnë në hapësirë etj. Për ndërtimin e këtyre pajisjeve, shkencëtarët bëjnë studime të panumërta mbi natyrën, objektet, kafshët. Shpesh, ata shfrytëzojnë aftësitë e veçanta të kafshëve për t'i përdorur në shpikjet apo zbulimet e tyre shkencore. Në këtë tekst, flitet për një nëndhese, e cila është ndërtuar në bazë të mënyrës se si orientohet një lakuriq nate në errësirë.

Qartë, qartë, mendova unë, po përsëri... jo dhe aq qartë. Ja, fjala vjen, si vepron anija kur has në truallin e fortë të ndonjë shpelle, si në rastin kur u takua me ne?

Pas një ngurrimi, ia thashë këto paqartësi komandantit.

– Në ato raste, na vjen në ndihmë tanku...

– Tanku?! – hapëm sytë ne.

Megjithëse përmenda pak më parë zinxhirët, harrova t'ju sqaroj për ta. Në sipërfaqe, *nëndhesja* jonë është e pajisur për së gjati me katër palë zinxhirë si ato të tankut, por tepër të modifikuar. Këta shërbejnë për t'i dhënë shpejtësinë e duhur, pra për ta shtyrë atë përpara, ashtu si edhe timoni i saj. Kur anija has në truallin e ndonjë shpelle ose del në sipërfaqe të tokës, ecën vetëm me anë të zinxhirëve, si tanku.

– Bukur i paskish gjetur, – tha kësaj radhe i entuziazmuar. – Por përsëri...

– Hë, ke edhe ti ndonjë paqartësi tjetër?

– Po, e kam fjalën... Dua të them... si veproni kur s'ka as truall e as mjedis të fortë: shkëmb, mineral ose dhe, që i copëtoni e i thërrmoni? Pra, ta zëmë se gjatë udhës ju del përpara një humnerë. Si veproni në këtë rast? Mos fluturoni si aeroplani?

– Jo.

– Atëherë do të *gremiseshit* në *hon*.

Vërtet, mirë e kishte menduar shoku im. Nuk më pati shkuar mendja në një rast të tillë. Me siguri nëndhesja do të gremisej.



## Fjalor

*nëndhese* – pajisje që shërben për të udhëtuar nën tokë.

*gremis* – rrëzoj dikë nga një vend i lartë.

*hon* – gropë e thellë me anë të thepisura, greminë, humnerë.

**Astrit Bishqemi** lindi në Elbasan. Ka punuar arsimtar dhe ka qenë redaktor i gazetës lokale "Shkumbini". Që nga viti 1981, jep leksionet e lëndës së Letërsisë për fëmijë në Universitetin "Aleksandër Xhuvani", në Elbasan. Ka shkruar vjersha, tregime, romane, tekste mësimore dhe novela. Është shquar veçanërisht në lëvrimin e letërsisë fantastiko-shkencore. Ndër krijimet e këtij zhanri përmendim "Gëzofi i Tokës", "Përtej oborrit diellor", si dhe "Udhëtim i jashtëzakonshëm".





– Jo, – përsëriti komandant Ylli. – More... ju sikur më thatë se në shpellë ditën e parë kishit shkuar për të zënë një lakuriq nate, kështu?  
– Po, – thashë. – Partini dëmtoi lakuriqin e natës në shkollë dhe vendosëm ta zëvendësonim.

– Pa të shohim çfarë keni mësuar për lakuriqët e natës në zoologji! Partini, siç duket, iu kujtua ora kur qe ngritur në mësim dhe ia nisi si gjinkallë.

– Lakuriqi i natës. Lakuriqi i natës është më e çuditshmja nga të gjitha kafshët në botë. Megjithëse fluturon, nuk është shpend. Bën pjesë në klasën e gjitarëve dhe i ushqen të vegjlit me qumësht. Ka dy palë gjymtyrë. Kocka e krahut...

– Mirë, mirë, – e ndërpreu komandanti në mënyrë të tillë, saqë, ndoshta, Partinit do t'i jetë dukur sikur përsëri lakuriqi i ra nga duart dhe u shkërmoq në dysheme. – Të ndalemi në njërën nga çuditë e kësaj kafshe. Si shikon, si orientohet natën *xëc*?

Ej ç'punë! Kësaj pyetjeje do t'i druhesha sikur të më ngrinin në mësim. I kisha shumë qejf lakuriqët e natës si banorë të shpellave. Dhe do ta kisha dëgjuar me vëmendje shpjegimin e mësueses, po të më kishin lënë të qetë pleshtat e dhelprës.

Ai që më nxori përsëri nga sikleti ishte Partini.

– Megjithëse është një kafshë e natës, sytë e saj janë pak të zhvilluar, madje nuk i hyjnë fare në punë. Edhe kur shkencëtarët ia mbyllën me leukoplast, fluturoi për bukuri në dhomën e mbushur tërë pengesa, pa u përplasur asgjëkund. Veç nuk ndodhi kështu kur ia shtuposën veshët me dyllë. Doli pra, që lakuriqi i natës shikonte jo me sy, por... me veshë.

Nga këto që po dëgjoja, *çakërrita* sytë. Sa interesante! Lakuriqi na shikuaka me veshë! Mos nuk e kisha dëgjuar mirë? Hajde po deshe e mbaje mendjen te pleshtat kur shpjegon mësuesja e zoologjisë!



## Fjalor

*xëc* – errësirë e madhe, terr.  
*çakërrit* – hap shumë sytë sa më dalin e më shkojnë anash, zgurdulloj.  
*ultratinguj* – tinguj që nuk kapen dot nga veshi i njeriut.

– Ja edhe një eksperiment tjetër! – vazhdoi Partini. – I ngjeshën në kokë lakuriqit një kësulë letre dhe e lëshuan në pyllin e dendur, përfundimi qe tragjik: kafsha u përplas në një dru dhe ra pa frymë përtokë. Por, kur hapën në kësulë tri vrime, një te goja e dy te veshët, fluturoi si mos më mirë, pa u përplasur jo më në trungje, por as në degët e holla.

– E ç’del nga kjo?

– Del që në orientimin e lakuriqit lozin rol organet e zërit dhe të dëgjimit. Pra, gjatë fluturimit, lakuriqi lëshon me gojë disa tinguj të veçantë. Këta shkojnë përpara, përplasen në pengesa dhe kthehen me shpejtësi te veshi i kafshës. Ajo merr dijeni mbi largësinë e sendit dhe, po të jetë nevoja, ndryshon drejtimin që të mos përplasat me të.

– Të lumtë! – tha komandant Ylli, sikur të kishte vlerësuar si mësuesit e qëmotit “ulu në vend, dhjetë!” – Pikërisht këtë çudi shfrytëzon nëndhesja jonë për të mos u rrëzuar në hone.

Këtë herë u habita: Ja ç’na doli! Siç fluturuaka në natën xëc lakuriqi, ashtu “fluturuaka” edhe nëndhesja. Po ku i kishte ajo gojën, veshët? Ç’mrekulli të tjera do të dëgjoja?!

– Çudinë e tingujve të lakuriqit të natës i ka studiuar në mënyrë të përkryer bionika.

– Ëhë, e njohim këtë gruan shkencëtare, – bëri shaka Partini.

– Kemi mësuar në shkollë se bionika ndërton pajisje, aparate dhe mjete të nevojshme për njeriun, duke kopjuar nga natyra. Studion, fjala vjen, delfinin, për të ndërtuar nëndetëse. Shkurt, ia rrëmben “patentat e gjalla” natyrës.

– Po, bukur e the, ashtu është. Kjo shkencë e veçantë, që lindi para njëqind e tridhjetë vjetësh, na ka dhënë një ndihmesë të çmuar në teknikat e ndërtimit të automjeteve.

– M’u bë koka dhallë! – u ankova unë. – Sikur e kishim fjalën te tingujt e lakuriqit të natës.

– Po, ke të drejtë! – vazhdoi shpjegimin e lënë përgjysmë komandant Ylli. – Tingujt e veçantë që lëshon lakuriqi i natës, janë të pakapshëm nga ne, nuk mund t’i dëgjojë veshi i njeriut, ndaj i quajmë *ultratinguj*. Të tillë zëra të mprehtë lëshon edhe mushkonja, edhe balena, a ku ta di unë.

–Dhe ju i keni zbatuar në nëndhese këto?

– Po, Arbin. Sipas këshillave të bionikës, kemi ndërtuar një aparat valësh sizmike. I shkaktojmë ato në një drejtim të caktuar përpara. Valët vrapojnë nëpër dhe, derisa hasin në pengesë. Ose, kur anija udhëton nëpër një masiv shkëmbor, valët vrapojnë përpara, duke bërë 3500-6000 metra në sekondë, derisa ndeshin në kufirin e fundmë të shkëmbit, pas të cilit fillon ajri, humnera.

### Proza fantastiko-shkencore

Në prozën fantastiko-shkencore shkrimtarët gërshtojnë elementet realiste me ato fantastike e shkencore: personazhet, ngjarjet dhe vendet reale me ato të krijuara nga fantazia e autorit. Në këtë lloj letrar, autorët na sjellin pranë dhe na e bëjnë të besueshme një kohë të imagjinuar, të ardhmen e largët, shumë më të zhvilluar sesa koha e shkrimtarit. Në prozat fantastiko-shkencore, imagjinata gërshtohet me njohuritë shkencore. Në disa raste, proza të tilla kanë paralajmëruar zbulime shkencore, të cilat pas shumë kohësh janë bërë realitet. Për shembull, shumë nga ato çka imagjinoi përfaqësuesi më i mirë i romanit fantastiko-shkencor, Zhyl Verni, sot janë bërë realitet. Gjuha e këtyre romanëve është mjaft e pasur me fjalë nga fjalori i shkencës dhe i teknologjisë moderne.

Kur arrijmë në këtë kufi ndarës, ato kthehen mbrapsht, pasqyrohen. Rikthehen në nëndhese, ku kapen nga një aparat i dytë.

– Pa shiko! – u çudit Partini. – Aparati i parë bëka punën e gojës së lakuriqit të natës, ndërsa i dyti, atë të veshit të kafshëzës.

– Tamam ashtu. E kuptoni, pra? Edhe nëndhësja orientohet në errësirën e nëntokës, duke zgjedhur pa u gabuar udhën e saj, sikundër lakuriqi i natës midis degëve e drurëve të pyllit. Çdo gjë e bën vetë, në mënyrë automatike, me ndihmën e aparatit elektronik që ndodhet në pultin e komandimit.

## Studim teksti

### Kuptojmë tekstin

- 1 **Përgjigjuni pyetjeve rreth tekstit:**
  - Çfarë bën nëndhësja, kur has në truallin e ndonjë shpelle ose del në sipërfaqen e tokës?
  - Cili është emri i shkencës që përmendet në tekst? Çfarë kontributi ka dhënë kjo shkencë?
  - Çfarë janë ultratingujt?
  - Cila është karakteristika kryesore e ultratingujve?
  - Si veprohet kur përpara nëndhësës shfaqet një humnerë?
  - Si funksionon aparati me valë sizmike? Çfarë ndodh në këtë rast?

### Analizojmë tekstin

- 2 **Shënoni me  përgjigjen e saktë. Nëndhësja e përshkruar në tekst ka aftësinë:**
  - të ecë në tokë;
  - të ecë nëpër shkëmbinj;
  - të notojë në ujë;
  - të fluturojë;
  - të rrokulliset;
  - të ecë nën tokë.
- 3 **Si orientohet lakuriqi i natës në errësirë?**
- 4 **Në ndërtimin e nëndhësës, cilat tipare të lakuriqit marrin në konsideratë shkencëtarët?**
- 5 **A ka rrezik që nëndhësja të përplasat dhe të shkatërrohet?**

### Gjuha e tekstit

- 6 **Proza e mësipërme është fantastiko-shkencore. Cilat janë elementet që e bëjnë këtë prozë të konsiderohet e tillë?**
- 7 **Gjeni në tekst të gjithë termat shkencorë dhe shënojeni ata në fletore.**

### Detyrë

- Gjeni një prozë tjetër fantastiko-shkencore dhe diskutoni rreth saj në klasë.



# Një mik i paharruar

## Para leximit

Kjo pjesë është shkëputur nga novela e njohur "Princi i vogël". Rrëfimtari është një pilot. Një ditë, avioni i tij u përplas në shkretëtirën e Saharasë. Gjatë përpjekjeve për të riparuar motorin e avionit, pilotit iu shfaq një djalë i vogël, i cili i kërkoi t'i vizatonte një dele. Në këtë pjesë, ai na tregon se ky djalë ishte një 'princ i vogël', që vinte nga shumë larg, nga asteroidi B 612.

Unë mësova kështu një gjë tjetër shumë të rëndësishme: planeti nga vinte ai, ishte pak më i madh sesa një shtëpi!

Por nuk u habita shumë. E dija fare mirë se përveç planetëve të mëdhenj, si Toka, Jupiteri, Marsi dhe Venusi, të cilëve u kemi vënë emra, ka dhe qindra të tjerë që shpesh janë aq të veckël, sa mezi shihen edhe me teleskop. Kur një astronom zbulon njërin prej tyre, ai i vendos një numër në vend të emrit. Mund ta quajë, për shembull, "Asteroidi 325".

Jam i bindur, për shumë arsye të forta, se planeti nga vinte princi i vogël është asteroidi B 612. Ky asteroid është parë vetëm një herë me teleskop, më 1909, nga një astronom turk.

Ky astronom e shpalli zbulimin e tij me bujë të madhe përpara një kongresi ndërkombëtar të astronomisë. Por askush nuk e besoi, për shkak të rrobave turke që kishte veshur. Se kështu janë të rriturit.

Por, për fatin e mirë të asteroidit B 612, një diktator turk hartoi një ligj, i cili i dënonte njerëzit me vdekje, në qoftë se nuk visheshin në mënyrë evropiane. Astronomi e shpalli sërish zbulimin e tij më 1920, me një veshje shumë elegante. Dhe kësaj radhe e besuan të gjithë.

Tregova kaq shumë hollësi rreth asteroidit B 612, madje shënova edhe numrin e tij, pikërisht për shkak të të rriturve, që vdesin për shifra. Kur ne u flasim atyre për ndonjë shok të ri, ata nuk na pyesin kurrë: "Si e ka zërin? Cilat lodra i pëlqejnë më shumë? A koleksionon flutura?". Përkundrazi, ata na pyesin: "Sa vjeç është? A ka vëllezër e motra? Sa peshon? Sa para fiton babai i tij?". Pandehin se vetëm kështu mund ta njohin më mirë. Sikur ne t'u themi të rriturve: "Kam parë një shtëpi të bukur me tulla të kuqe, me lule kacavjerrëse në dritare dhe me pëllumba mbi çati", ata nuk e përfytyrojnë dot se si mund të jetë kjo shtëpi. Sepse, duhet t'u themi: "Pashë një shtëpi




## Fjalor

*franga* – njësia monetare bazë e Francës para vendosjes së euros.  
*boa* – gjarpër shumë i madh johelmues, që jeton në Amerikën Jugore e në Madagaskar dhe që e mbytyt gjahun duke i mbështjellë e duke e shtrënguar.

**Antoine de Saint-Exupéry (Antuan de Sent-Ekzyperi)** (1900-1944) është shkrimtar, gazetar dhe pilot. Ka fituar shumë çmime të rëndësishme letrare në Francë dhe në ShBA. Vepra e tij më e njohur është "Princi i vogël", novelë e lexuar nga fëmijët në mbarë botën.





që kushton njëqind mijë *franga!* Atëherë, ata zënë e thërrasin: “Uu, sa e bukur qenka!”

Prandaj, nëse ne u themi: “Prova që princi i vogël ka ekzistuar është se ai ishte i mrekullueshëm, se qeshte, se donte një dele. Kur dikush kërkon një dele, do të thotë se kjo është një provë që ai ekziston”, ata do të mbledhin supet dhe do të na trajtojnë si fëmijë të vegjël! Por, sikur t’u themi: “Planeti prej nga ai vinte është asteroidi B 612”, atëherë do të binden dhe nuk do të na bëjnë më pyetje.

Të mëdhenjtë kështu janë. Nuk duhet t’u mbajmë mëri. Fëmijët duhet të jenë mjaft zemërgjerë me të rriturit.

Por, pa dyshim, ne, që e dimë si është jeta, nuk na bëjnë përshtypje shifrat! Do të kisha dashur që këtë histori

ta kisha filluar siç fillojnë përrallat dhe të kisha shkruar:

“Na ishte njëherë një princ i vogël, i cili banonte në një planet pak më të madh se ai vetë dhe dëshironte të kishte një shok...”.

Për ata që e kuptojnë jetën, kjo do të tingëllonte shumë më e vërtetë.

Sepse mua nuk më pëlqen që librin tim ta lexojnë pa vëmendje. Sepse, teksa rrëfej këto kujtime, shpirti më mbushet me pikëllim. Kanë kaluar gjashtë vjet që kur miku im u largua, bashkë me delen. Prandaj dhe po e përshkruaj këtu, që të mos e harroj. Është shumë e trishtë të harrosh një mik. Jo të gjithë mund të kenë miq. Po e harrova, edhe unë mund të bëhem si të rriturit, të cilët e kanë mendjen vetëm te shifrat. Prandaj dhe bleva një kuti me bojëra e lapsa. Nuk është e lehtë të vizatoj tani, në këtë moshë, aq më tepër që nuk kam bërë prova të tjera që nga koha e *boas* nga përbrenda dhe boas nga jashtë, kur isha gjashtë vjeç! Do të përpiqem, kuptohet, që portretet të jenë sa më afër të vërtetës. Por nuk jam i sigurt nëse do të mund t’ia dal mbanë.

Një vizatim më del mirë, por tjetri nuk i ngjan më. Gaboj pak edhe me gjatësinë. Në njërin, princi i vogël duket shumë i gjatë, në një tjetër shumë i shkurtër. Vras mendjen edhe për ngjyrën e rrobave të tij. Dhe filloj e pikturoj me hamendje, herë mirë e herë keq. Gaboj edhe te disa hollësi më të rëndësishme. Por këto ia fal vetes. Se miku im nuk më shpjegonte kurrë asgjë. Ndoshta më pandehte si veten e tij. Por, për fat të keq, unë nuk di ta shoh një dele përmes arkës. Ndoshta unë jam paksa si të rriturit. Me sa duket, jam plakur.

## Studim teksti

### Kuptojmë tekstin

- 1 Lexoni tekstin dhe përgjigjuni pyetjeve.
  - a) Cila është rruga që ndiqet për të emërtuar një asteroid?
  - b) Në çfarë mënyre u bë i njohur asteroidi B 612?
  - c) Nga sa tregohet në këtë pjesë, sa i madh ishte planeti nga vinte princi i vogël?
  - ç) Kur e ka parë rrëfimtari për herë të fundit princin?
  - d) Përse po e shkruan rrëfimtari këtë libër? Çfarë nuk do që të harrojë ai?



# Borfor – provat e Askanos

## Para leximit

Historia e romanit "Borfor" lidhet me një planet që ndodhet shumë larg planetit dhe galaktikës sonë. Ky planet i largët, që ngjan shumë me Tokën, quhet Bordjogan. Ndryshe nga planeti ynë, aty dihen shumë gjëra për jetën në hapësirë. Kjo sepse Bordjogani ka fatin që rreth e përfaqë vetes të ketë planetë të populluar nga qenie të gjalla nga më të ndryshmet, në varësi të planetit. Krijesat më të evoluuara që jetojnë në Bordjogan, kanë ngjashmëri të madhe me tokësorët. Bordjogani ka një burim energjie shumë të veçantë, që prodhohet nga vetë trupi i disa prej banorëve të këtij planeti. Këta quhen ikeas! Në këtë tekst flitet për një djalë, i cili e ka ëndërr të bëhet ikeas.



## Fjalor

*koloseum* – amfiteatër në formë vezake.

*ikeas* – (sipas romanit) banorë të planetit Bordjogan, të cilët zotërojnë një burim energjie tepër të fuqishëm, që buron nga trupi i këtyre banorëve.

Djemtë ndenjën disa çaste në heshtje. Dardali po mendonte për vazhën me flokë të zinj, Arkneri për djalin që quhej Xhonatan, ndërsa Zafiri vriste mendjen edhe sa minuta mund të kishin ngelur para se të niseshin.

Mbasi kaluan edhe disa minuta, gjatë së cilave asnjë nga tre djemtë nuk hapi gojë, buçiti një zë i fortë burri nga një altoparlant, i cili thoshte:

– Fëmijët që do të nisen për te *koloseumi* i ikeasve, të bëhen gati për t'u nisur. Të afrohen te mjeti fluturues dhe të mbajnë radhë për t'u futur.

Dardalin dhe Arknerin i kapi një ndjesi e keqe kur dëgjuan zërin e burrit. Ishin hutuar aq shumë me mendime të kota, saqë pothuajse e kishin harruar se përse gjendeshin aty. Çasti i shumëpritur kishte ardhur. Kur iu erdhi radha për t'u futur brenda mjetit fluturues, që do t'i çonte te vendi i trajnimeve, Dardali, Arkneri dhe Zafiri ndaluan përpara një *ikeasi*, i cili kërkonte me saktësi dhe shpejtësi emrat e secilit prej djemve. Mbasi ata i treguan ikeasit emrat e tyre, ai i lejoi të futeshin brenda mjetit.

Sapo hodhën hapin e parë brenda mjetit fluturues, Dardali, Arkneri dhe Zafiri ngelën gojëhapur. Nuk kishin parë kurrë një mjet fluturues, i cili nga brenda të ishte aq i veçantë. Si fillim, djemve iu ra në sy se ai ishte jashtëzakonisht i madh. Me sa dukej, e parë nga jashtë, ai mjet dukej goxha më i vogël se ç'që në të vërtetë. Dardali u hutua duke parë muret, në të cilat gjendeshin fotografi të mëdha



**Joni Boçari** (1998). Shkrimtar i ri, nga Shqipëria, i cili ka lëvruar letërsinë fantastike për fëmijë. Vepra e tij "Borfor", është vlerësuar si më e mira në kategorinë e letërsisë për fëmijë, në kuadër të çmimeve kombëtare të letërsisë në vitin 2010.

të ikeasve më të njohur që kishin hyrë në histori. Dardali kërkoi aty që të gjente fotografinë e Askanos, pasi ishte shumë kureshtar ta shihte si ishte nga pamja e jashtme, por nuk e gjeti në asnjë vend. Mbasi e shkëputi vëmendjen nga fotografitë e mureve, Dardali i hodhi një sy vendit ku gjendej.


I gjithë mjeti fluturues ishte i ndarë në tri dhoma të veçanta, ku secila dhomë mund të nxinte afërsisht njëzet nxënës. Dardali, Arkneri dhe Zafiri u futën në dhomën që gjendej më pranë tyre, jo për ndonjë arsye të veçantë. Nga brenda, dhomat ishin të mbushura me karrige të zeza prej lëkure, të cilat kishin shumë rripa sigurimi. Tre djemtë u ulën në tri karrige të rehatshme të ngjitura me njëra-tjetrën, e megjithatë nuk gjenin dot rehat prej emocioneve të forta që kishin.

Mbas disa minutash, kur normalisht çdo fëmijë duhej të ishte ulur nëpër vende, zëri i burrit që i lajmëroi që të përgatiteshin për nisjen, kumboi sërish, duke thënë:

– Për pesë minuta do të nisemi, prandaj ju lutemi të lidhni rripat e sigurimit dhe ju paralajmërojmë se në çastet e para të nisjes do të kaloni një përvojë jo fort të këndshme. Për çdo nevojë, ju kemi vendosur një qese në çdo karrige. Dardali vriste mendjen se për se mund të shërbente qesja e vogël transparente, që gjendej poshtë karriges së tij. Papritur u hodh përprjetë, pasi karrigia e tij po lëshonte një tingull të fortë, meqë nuk kishte lidhur rripat e sigurimit. Duke u nxituar, meqë nuk duronte dot sinjalin, Dardali lidhi tre rripat e sigurimit. Në pritje që të niseshin, Arkneri hapi sytë që të shihte se mos ishte në të njëjtën dhomë me Xhonatanin dhe shokët e tij, por mbasi vështroi mirë vendin, nuk pa ndonjë nxënës që i spikati, përveç dy binjakëve të shëndoshë që i kishte parë përpara se të futej te mjeti fluturues. Pikërisht ato çaste, zëri i burrit që jepte lajmërimet buçiti sërish:

– Gjashtë sekonda para se të nisemi, ju lutemi të jeni gati. Pesë, katër, tre, dy, një. Sapo mbaroi numërimin, një shpërthim tmerrësisht i fortë u dëgjua dhe më pas, të gjithë fëmijët që gjendeshin brenda mjetit, ndjenë se po ngjiteshin sipër qiellit më shumë se ç'ishin. Dardali, i mrekulluar nga ajo eksperiencë që po kalonte, përpiquej të thoshte ndonjë gjë, por nuk nxirrte dot asnjë llaf nga goja.

Zafiri u përpoq të qeshte teksa shihte fytyrën e tmerruar të Dardalit, i cili nuk fliste dot, por edhe ai nuk mundi të bënte asnjë ndryshim në mimikën



e fytyrës. Fuqia e shpejtësisë së mjetit fluturues i kishte bllokuar fëmijët. Aty, në atë mjet fluturues, djemve iu dukej sikur gjendeshin në një dimension tjetër. Çastet e para të nisjes, ata ndien një trysni të fortë e të bezdisshme, por me kalimin e kohës, ajo filloj të zhdukej dhe kështu, Dardali, pak e nga pak, mund të fliste e të lëvizte. Pikërisht në ato çaste, ai e kuptoi se përse shërbenin qeset që gjendeshin në çdo karrige. Ai pa një nga binjakët e shëndoshë, që kishte marrë qesen e tij dhe po villote në të.

Orët e para të udhëtimit kaluan të qeta. Fatmirësisht, ndjesia e pakëndshme e fillimit të udhëtimit kaloi plotësisht, kështu Dardali mund të bisedonte i qetë me Arknerin dhe Zafirin. Të tre ishin në ankth të madh se ç'do të ndodhte kur të arrinin te vendi i trajnimeve. Orët kalonin ngadalë dhe Dardali, Arkneri dhe Zafiri, nuk kishin më se çfarë të bisedonin. Ato çaste, Dardali dalloj një fotografi të varur në mur, të cilën e kërkoi që çastin e parë që u fut te mjeti fluturues. Ishte fotografia e një ikeasi rreth moshës dyzetvjeçare, me flokë paksa të gjatë ngjyrë kafe, me një pamje autoritare që reflektonte forcë e guxim dhe i veshur me uniformën e komandantit të ushtrisë së ikeasve. Poshtë saj, me shkronja të arta qe shkruar: “Fortjonus Askano, themeluesi dhe komandanti i ushtrisë moderne të ikeasve”. Dardali kaloi shumë minuta *duke admiruar* fotografinë e Askanos. Kaluan afërsisht pesë orë dhe të gjithë fëmijët që gjendeshin te mjeti fluturues, ishin përgjumur.

Ndërkohë që orët kalonin, pak e nga pak edhe dielli filloi të perëndonte. Tashmë Dardali, Arkneri e Zafiri po habiteshin se sa larg gjendej vendi i trajnimeve. Shumica e fëmijëve të tjerë ishin duke dremitur. I gjithë vendi ishte në qetësi të plotë dhe vetëm zhurma e motorëve të mjetit fluturues dëgjohej.

Qetësia që qe vendosur u prish nga zëri i burrit që jepte lajmërimet: – Për pesë minuta, do të ulemi te koloseumi i ikeasve, por mos i hiqni rripat e sigurimit.

Dardali, që me sa dukej po dremiste, u zgjua i tmerruar duke lehur si qen. Zafiri ia nguli sytë plot kureshtje Dardalit, sikur të donte ta pyeste pse e bëri atë budallallëk.

– Po shihja në ëndërr sikur po më hante një qen, – u shfajësua Dardali. Pikërisht në ato çaste u dallua se mjeti fluturues po ngadalësohej.

Pranë vendit ku ishin ulur Dardali, Arkneri dhe Zafiri gjendej një dritare e vogël. Arkneri zgjati kokën që të shihte se ku po uleshin dhe dalloj *siluetën* e një ishulli, në një det të madh. Të gjithë filluan të pyesnin Arknerin se çfarë shihte. Arkneri kishte ngelur i habitur, kur pa se vendi i trajnimeve gjendej në një ishull. Fëmijët vazhdonin të pyesnin Arknerin se çfarë shihte, por sapo ai filloi t’iu tregonte për ishullin, një ndjesi akoma më e keqe se ajo e nisjes i pushtoi të gjithë.



## Fjalor

*duke admiruar* – duke vështruar dikë a diçka me ëndje e me kënaqësi të madhe.

*siluetë* – hija e errët e një njeriu apo e një objekti, që shfaqet në një fushë të bardhë ose të ndritur.



Fëmijëve iu duk sikur stomaku dhe trupi po iu tkurrej dhe sikur, dalëngadalë, trupi i tyre po shpërbëhej. Ajo ishte ndjesia më e pakëndshme që kishte provuar ndonjëherë Dardali. Fatmirësisht, ajo ndjesi nuk zgjati shumë dhe gradualisht filloi të zhdukej derisa mjete fluturues nuk lëvizi më. Zhurmat e motorit nuk dëgjoheshin më, dhe kjo bëri të kuptohej se mjete kishte ndaluar në tokë. Pikërisht atë çast, zëri i burrit lajmëroi se kishin mbërritur në destinacion dhe se mund të zbrisnin me radhë nga mjete fluturues.

Të gjithë fëmijët u pushtuan sërish nga emocionet, pasi çasti i shumëpritur kishte ardhur. Disa qindra metra larg aeroportit ku gjendeshin fëmijët, ishte një koloseum. Por jo një koloseum i thjeshtë si gjithë të tjerët. Ai ishte një koloseum me përmasa gjigante, që në brendësi duhej të mbante një qytet të tërë. Në pamje të parë, dukej sikur koloseumi ishte një lloj muri mbrojtës për atë që gjendej brenda. Me aq sa dallohej në atë errësi, dukej se koloseumi ishte i përbërë prej *mertefi*, por jo me ngjyrën e tij metalike të zakonshme, por me ngjyrë floriri. Fëmijët gjendeshin disa qindra metra larg koloseumit, por ai dallohej fare qartë prej madhësisë së tij. Gjithashtu, rrugës kishte disa pemë që pengonin paksa pamjen, për të parë se ku gjendej hyrja e koloseumit. Megjithatë, shumica e fëmijëve e kuptuan se brenda koloseumit duhej të gjendej ndonjë qytezë e vogël ku do të jetonin tetë vitet e ardhshme. Ajo ishte me të vërtetë diçka e mahnitshme!

Arkneri po mendohej se ç'duhet të bënin nxënësit në ato çaste, kur pa se drejt tyre po afroreshin katër ikeas.

Ishin dy burra e dy gra, të cilët ishin veshur me një uniformë ikease me ngjyrë të verdhë. Dardali kishte lexuar se atë uniformë e vishnin ikeasit e thjeshtë, ata të gradës më të ulët. Të gjithë fëmijët ua ngulën sytë katër ikeasve, të cilët po afroreshin gjithmonë e më shumë. Mbas disa çastesh, ikeasit mbërritën përpara fëmijëve dhe, duke buzëqeshur, njëri nga burrat tha:

– Mirë se erdhët në koloseumin e ikeasve! Ky do të jetë vendi ku do të jetoni dhe stërviteni tetë vitet e ardhshme për t'u bërë ikeas.

Dardalit i rrahu zemra fort kur dëgjoji fjalët e ikeasit. Në ato çaste iu kujtua plotësisht se për çfarë gjendej në atë vend. Pavarësisht se i dukej ende e pamundur, më në fund ishte duke realizuar ëndrrën e tij që të bëhej ikeas!



## Fjalor

*mertef* – (sipas romanit) metal shumë i fortë dhe i bukur, që gjendet në përbërjen e të gjitha ndërtesave të planetit dhe që është rezistent ndaj energjisë në rast lufte.

## Studim teksti

## Kuptojmë tekstin

- 1 Lexoni tekstin dhe përgjigjuni pyetjeve.
  - a) Cilat janë personazhet kryesore?
  - b) Si e kryejnë ata udhëtimin në hapësirë?
  - c) Si është mjete fluturues ku hipin fëmijët?
  - ç) Për çfarë ishin në ankth Dardali, Arkneri, Zafiri, ndërsa po udhëtonin në mjete fluturues?
  - d) Fotografinë e kujt pa të varur në mur Dardali?
  - dh) Ku ndodhej vendi i trajnimit?
  - e) Sa kohë zgjaste trajnimi për t'u bërë ikeas?

## Analizojmë tekstin

- 2 Nga se dallon koloseumi i ikeasve nga koloseumet e zakonshme?
- 3 Çfarë veprimi të sikletshëm bën Dardali në mjetin fluturues?
- 4 Kush është Askanosi dhe çfarë thuhet për të në tekst?
- 5 Cila është ëndrra më e madhe e Dardalit?
- 6 Si e interpreton Dardali uniformën e ikeasve që dalin për t'i pritur?
- 7 Çfarë ndjesish përjetojnë fëmijët? Shënoni me ✓.
 

<input type="checkbox"/> frikë	<input type="checkbox"/> kuriozitet
<input type="checkbox"/> ankth	<input type="checkbox"/> zemërim
<input type="checkbox"/> padurim	<input type="checkbox"/> kënaqësi
<input type="checkbox"/> gëzim	<input type="checkbox"/> inat
<input type="checkbox"/> habi	<input type="checkbox"/> pasiguri

## Reflektojmë rreth tekstit

- 8 Në këtë pjesë, personazhet kryesore janë fëmijë. A ka të rritur? Cilët janë ata? Po për të afërmit dhe prindërit e fëmijëve, a na tregohet gjë në këtë fragment? Si mendoni ju, ku gjenden ata?

Dardali, Arkneri, Zafiri, Vordraku dhe Xhonatani janë 5 nga emrat e 100 personazheve të "Borfor", që për nga numri krahasohen me romanin historik "Lufta dhe Paqja" të Tolstojt. I pyetur për emrat e personazheve që ka përdorur në veprën e tij, shkrimtari i ri ka treguar: "Emrat e personazheve i kam shpikur vetë, kam bërë kombinim germash. Doja emra të çuditshëm, meqë historia nuk ka lidhje me planetin tonë".

- 9 Bashkëbisedoni për zbulimet e planetëve të tjerë. Si mendoni, a ka jetë në ta?

## Detyrë

- 📄 Shkruani, sipas imagjinatës suaj, vijimin e ngjarjeve në prozën e mësipërme.



# Roboti që donte të flinte

## Para leximit

*Në vitin 2222, është e zakonshme që robotët të merren me punët e shtëpisë dhe të kujdesen për fëmijët. Një nga këta robotë, Katerino, i intriguar nga gjumi i qenieve njerëzore, gjë që robotët nuk e kanë, përpiqet me çdo mënyrë që ta përjetojë. Pas 3 muajsh përpjekje, arrin të flejë. Kjo gjë shqetëson shumë jo vetëm të zotët e shtëpisë, por edhe fqinjët e tyre. Dikush lajmëron policinë dhe Katerinon e burgosin dhe e dënojnë për 15 ditë. Gjykatësi kërkon që asnjë gazetë të mos e botojë lajmin, por robotët e tjerë e marrin vesh lajmin se Katerino kishte arritur të flinte. Të tërë robotët e Romës mësojnë si të flenë dhe, duke qenë se është e pamundur që të burgosen të gjithë, gjykata vendos që të bëjë një marrëveshje dhe t'u jepte të gjithë robotëve të drejtën për të fjetur. Lajmi i shpikjes së gjumit merr dhenë anembanë botës.*

Në vitin 2222, në gjithë sipërfaqen e planetit filluan të përdreshin robotë shtëpiakë. Katerinoja ishte ndër këta. Ai ishte robot i shkëlqyer, që bënte çdo punë në apartamentin e profesor Izidor Kortit, mësues historie në liceun e Romës, për të dhe për familjen e tij. Si të gjithë robotët shtëpiakë, Katerinoja dinte të bënte punë pa fund: të gatuar, të lante, të merrte pluhurat, të hekuroste e të tjera, e të tjera. Ai bënte pazarin, mbante llogaritë, hapte e mbyllte televizorin, i ndihmonte fëmijët të bënë detyrat, shtypte me makinë shkrimi letërkëmbimin e profesorit, priste me thikë fletët e librave të rinj, ngiste automobilin, e vinte në dijeni profesorin për thashethemet e fqinjëve. Ishte një makinë e përkryer.

Ishte makinë, pra, dhe si makinë që qe, nuk kishte nevojë për të fjetur. Natën, kur familja pushonte, Katerinoja, që të mos mërzhitej, hekuroste pantallonat e profesor Izidorit, punonte me trikon që po thurte zonja Luiza, sajonte lodra për fëmijët, u jepte një e dy duar bojë e llak mureve të kuzhinës, karrigeve. Kur s'i mbetej më asnjë punë për të bërë, shkonte e ulej në kolltuk të sallonit dhe zgjidhte fjalëkryqe. Se botohej një revistë posaçërisht për robotë, me fjalëkryqe tepër të vështira, që kishin fjalët më të ngatërruara të fjalorit. Dhe zgjidhja e tyre u hante shumë kohë robotëve.

Një natë, tek po kërkonte një fjalë prej 17 shkronjash, Katerinoja dëgjoi profesor Izidorin që gërhinte në dhomën e vet. Nuk e dëgjonte për herë të parë këtë zhurmë Katerinoja. I dukej e ëmbël, si një muzikë

**Gianni Rodari (Xhani Rodari)** (1935-1980). Shkrimtar i mirënjohur italian i letërsisë për fëmijë. Ka shkruar një sërë veprash mjaft të rëndësishme, si: "Aventurat e Çipolinos", "Xhipi në Tv dhe ndodhi të tjera në orbitë", "Libri i gabimeve", "Torta në qiell" etj. Rodari ka një stil të veçantë rrëfimi dhe në tregimet e novelat e tij bën bashkë elemente të përditshmërisë së fëmijëve, me shumë fantazi dhe situata komike.



që prishte këndshëm heshtjen e natës. Porse atë mbrëmje, bashkë me zhurmen, i shkrepri në krye edhe një mendim.

"Pse, vallë, flenë njerëzit? – pyeti me vete. – Ç'ndiejnë, vallë, në atë kohë?". U ngrit dhe, duke ecur në majtë të gishtave, shkoi në dhomën e fëmijëve. Rolandi dhe Luçila ishin aty e po flinin me derë hapur, që t'u dukej sikur qenë bashkë me prindërit, të cilët po flinin në dhomën përbri. Në komodinën midis dy shtretërve rrinte ndezur një llambë e vogël dritëkaltër. Katerinoja i vështroi një copë herë fytyrëzat e fëmijëve që flinin. Rolandi kishte një shprehje të çlodhur e të qetë, ndërsa fytyrën e trëndafilte të Luçilës e përshkonte një buzëqeshje e lehtë.

"Buzëqeshka, – mendoi Katerinoja i mrekulluar. – Mbase sheh në ëndërr ndonjë gjë të bukur. Po, a ke se ç'sheh me sy mbyllur?"


Katerinoja u kthye në sallon mendueshëm. U ul sërish në kolltuk, po s'kishte më pikë dëshire për të zgjidhur fjalëkryqet.

"Gjithsesi, dua të provoj edhe unë të fle njëherë", vendosi. Kishte afërsisht njëqind vjet që kishin dalë robotët, po gjer atëherë, asnjërit prej tyre nuk i kishte shkrepur një mendim kaq i guximshëm.

"E pse, pra, të mos e provoj që tani, ç'më pengon? – tha me vete Katerinoja. – Madje do ta provoj në çast. Natën e mirë, Katerino. Gjumë të ëmbël", tha pastaj, duke përsëritur fjalët që u thoshte çdo mbrëmje zonja Luiza fëmijëve, kur i vinte në shtrat.

Katerinoja kishte vënë re se të zotët, kur binin për të fjetur, para së gjithash mbyllnin sytë. U përpoq t'i shkërbente ata, por s'arriti dot: sytë e tij ishin ndërtuar për të ndenjtur hapur ditë e natë. Nuk kishin qepalla. Katerinoja u ngrit, vështroi të gjente ndopak karton, preu dy copa vezake, i vuri përmbi sy dhe u kthye përsëri në kolltuk. Mirëpo gjumi nuk po i vinte dhe Katerinoja u mërzit sa më s'ka ashtu me sy mbyllur. Gjë prej gjëje nuk shihte që ta bënte të buzëqeshte ashtu siç buzëqeshte Luçila. Shihte vetëm një terr të zbrazët, të thellë e acarues.

Nata kaloi me këto përpjekje të kota. Megjithatë, tek po shkante të zgjonte profesorin me filxhanin e zakonshëm të kafesë në dorë, vendosi të thellonte vëzhgimet e veta. Po atë ditë vërejti se pas buke, profesor Izidori shtrihej në divan për të lexuar gazetën; e shfletonte atë disa minuta, pastaj gazeta i binte mbi gjunjë, sytë i mbylleshin dhe prej hundës i dilte



ajo muzikë shumë e bukur dhe e çuditshme: “kënga e gjumit”? Mezi duroi sa të vinte nata dhe me të rënë tërë familja në shtrat, mori gazetën, u ul në kolltuk dhe filloi ta lexonte që nga kreu. E lexoi gjer në rreshtin e fundit, pastaj numëroi një e nga një të gjitha presjet e pikat, numëroi të gjitha fjalët që fillonin me **a**, të gjitha fjalët që fillonin me **b**, të gjitha fjalët që fillonin me **z**. Por agoi dita dhe atë e gjeti zgjuar.

Po prapë Katerinoja nuk hoqi dorë nga përpjekjet. Një herë, kur ishin në tryezë të bukës, ai kapi si në mjegull një fjalë të çuditshme të zonjës Luizë, që po i thoshte profesorit:

– Mbrëmë, që të më zinte gjumi, m’u desh të numëroja delet. Dhe a e di sa numërova? 1528. Më në fund hoqa dorë nga numërimi dhe mora një hapje për gjumë.

"Të numërosh delet? – bloi vetmevete Katerinoja. – Kushedi ç’deshi të thoshte. Dele në dhomë nuk ka, as më zuri veshi mbrëmë të kalonte ndonjë kope delesh poshtë dritareve të shtëpisë."

E vrau mendjen për këtë punë disa ditë me radhë e në fund e mblodhi të pyeste Rolandin. Kur i drejtoi pyetjen, Katerinoja provoi një ndjenjë të fortë turpi: iu duk sikur do të shpërdoronte besimin e fëmijës, sikur do t’i nxirrte një të fshehtë me zor. Por, më në fund, mori guximin dhe e pyeti:

– Si i numëroni delet kur doni të flini?

– S’ka gjë më të lehtë, – iu përgjigj Rolandi, pa i shkuar mendja se në atë çast po tradhtonte racën njerëzore: – Mbyll sytë dhe bën sikur sheh një dele. Pastaj bën sikur sheh një gardh. Pastaj bën sikur e shtyn delen të kapërcejë gardhin dhe numëron. Pastaj, fillon me një dele tjetër, e kështu me radhë. Është një gjë kaq e mërzitshme, sa do, s’do, pas pak të zë gjumi. Unë s’kam numëruar dot kurrë më shumë se tridhjetë dele. Luçila njëherë mundi të numëronte gjer në dyzet e dy, së paku kështu thotë, po unë nuk e besoj.

Me të shtënë në dorë këtë të fshehtë ngazëlluese, Katerinoja mezi duroi sa të vinte koha për t’u tkurrur sakaq në banjë që të provonte të numëronte delet. Më në fund, erdhi nata. Ai u shtri në divan, mbuloi sytë me gazetë dhe u përpoq të shihte një dele. Në fillim pa vetëm një re të vogël, përvijuar turbull e ngatërrueshëm, pastaj reja e vogël filloi të përmblidhej në një trajtë më të përcaktuar: u duk një si kokë dhe shpejt doli me të vërtetë koka e një deleje. Pastaj u bë me këmbë, me bisht: doli një dele. Përfytyrimi i gardhit që më i vështirë. Katerinoja nuk kishte qenë kurrë në katund dhe s’i përfytyronte veçse vagëllimthi gjerdhet. Mendoi të zëvendësonte gardhin me një karrige dhe si e përftoi përfytyrimin e një karrigeje të madhe kuzhine, lyer krejt me bojë vaji të bardhë, e detyroi delen të vihej në urdhrat e tij.

– Kapërceje, – e urdhëroi Katerinoja.

Delja e bindur kapërceu karrigen e u zhduk. Sakaq Katerinoja u përpoq të përfytyronte një dele tjetër, po në këtë kohë e sipër karrigia ishte zhdukur. Iu desh ta përsëriste veprimin duke filluar nga e para, mirëpo, kur përfytyroi karrigen, a dëgjonte delja ta kapërcente? Jo që jo. Katerinoja pa orën dhe vuri

re me tmerr se vetëm për të përfytyruar dy dele i qenë dashur katër orë. U tund vendit dhe shkoi në kuzhinë, që të bënte punët e zakonshme të natës. – Megjithatë, – murmurinte me vete, – një dele arrita ta bëj të kërcëjë. Katerino, ngulmo: ki besim te vetja. Nesër do të bëhen dy dele, pastaj tre, e do t'ia dalësh mbanë.

Nuk do të tregojmë këtu gjithë hollësitë e ushtrimeve që bëri Katerinoja për të arritur të përfytyronte një kope të tërë delesh. Mjafton të dini se afërsisht tre muaj pas deles së parë, një mbrëmje Katerinoja mundi të numëronte njëqind, po të njëqind e njëtën nuk mundi ta shihte, sepse e kishte zënë një gjumë i këndshëm. S'fjeti veçse pak minuta, po që kishte fjetur e bindi ora. Një të diel mbrëma, e zuri gjumi dhe për të parën herë pa ëndërr; pa ëndërr sikur profesor Izidori ia lustronte këpucët dhe i lidhte kravatën. Sa ëndërr e bukur!

Në krahun tjetër të rrugës, banonte profesor Tibola. Atë natë, pak përpara se të gdhinte, ai pati etje dhe shkoi në kuzhinë të pinte një gotë ujë. Para se të kthehej në shtrat, hodhi sytë jashtë nga dritarja e sallonit, që binte pikërisht përballë dritares së profesor Kortit. Dhe çfarë pa profesor Tibola, thoni ju, kur vështroi përtej xhamave në sallonin e fqinjit përballë, ku të gjitha dritat e llambadarët ishin shuar? Na pa robot Katerinon që po flinte për shtatë palë qejfe! Si e vëzhgoi mirë dhe si zgjati veshin, iu duk edhe sikur dëgjoi një gumëzhimë të lehtë. Mos po gërhinte Katerinoja?

Profesor Tibola hapi dritaren me kanatë; ashtu siç ishte në pizhame, pa pyetur fare se mos merrte ndonjë të ftohtë, thirri me sa i hante zëri:

– Alarm! Alarm! Alarm i madh!...

Brenda pak minutash, mes një përplasjeje të stuhishme dyersh e dritaresh, tërë rruga u zgjua. Dolën të trembur edhe profesori me zonjën Luizë dhe pyetën:

– Ç'ka ndodhur? Ka rënë tërmet?

– Ç'tërmet! – thirri profesor Tibola. – Tërmetin e keni mu brenda në shtëpinë tuaj!.. Ju flini mbi mina, profesor i nderuar.

– Unë merrem vetëm me historinë e lashtë, – u shfajësua profesor Izidori.

– Dhe të gjithë e dinë se dinamiti nuk ishte shpikur në kohët e lashta.

– Ne jemi njerëz të urtë, – shtoi zonja Luizë me druajtje.

– Shkoni më mirë hidhini një sy sallonit, – thirri ashpër profesor Tibola.

Zoti Izidor dhe zonja Luizë u panë sy më sy të habitur.

Gjatë gjithë kësaj kohe, Katerinoja vazhdonte të flinte. Në fytyrën metalike i endej një shprehje e çlodhur dhe e qeshur, që dukej sikur i jepte dritë gjer në bulonin e fundit. Katerinoja po flinte e po gërhinte me të madhe. Gërhinte me një fërshëllimë e me një zukatje muzikore, që i zinin vendin njëra-tjetrës si violina me pianon në një sonatë të bukur të Bethovenit. Fërshëllima pyeste, zukatja përgjigjej.

– Katerino! – klithi zonja Luizë me zë të përvajshëm.

– Katerino! ... – thirri një mijë herë më ashpër profesor Izidori.

## Studim teksti

## Kuptojmë tekstin

- 1 Lexoni tekstin dhe përgjigjuni pyetjeve.
  - a) Cilat ishin disa nga detyrat që duhej të kryente roboti Katerino?
  - b) Si e kalonte ai kohën e lirë?
  - c) Si e zinte gjumi profesor Izidorin gjatë ditës?
  - ç) Ç'është "kënga e gjumit"? Me çfarë krahasohet kënga e gjumit e robotit Katerino?
  - d) Çfarë ëndrre sheh Katerino teksa fle dhe përse kjo është një ëndërr e ëmbël për të?
  - dh) Si reagojnë profesor Izidori dhe zonja Luizë, kur kuptojnë se Katerinoja po flinte?

## Analizojmë tekstin

- 2 Cili veprim gjatë leximit të gazetës, na tregon se Katerinoja e lexon gazetën ndryshe nga mënyra se si e lexojnë njerëzit?
- 3 Përse fëmijët numërojnë më pak dele sesa të rriturit?
- 4 Pse thuhet se Rolandi, duke i treguar Katerinos si të binte në gjumë, po tradhtonte racën njerëzore?
- 5 Roboti Katerino është në gjendje të mendojë, megjithatë ai e ka të vështirë të imagjinojë. Nënvizoni në tekst pjesën ku shfaqet kjo gjë.

## Interpretojmë tekstin

- 6 Ndër punët që bënte Katerinoja, cila është ajo që nuk mund të kryhet në një kohë kur teknologjia ka përparuar aq shumë sa të ekzistojnë robotët?
- 7 Kur dëgjon zonjën Luizë të thotë se kishte numëruar delet, Katerinoja i bën të ditur se aty nuk ka dele dhe nuk kishte dëgjuar as ndonjë kope delesh që të kalonte aty pranë. Çfarë tregon kjo për mënyrën se si e interpreton gjuhën njerëzore Katerinoja?
- 8 Përse gjumi është i domosdoshëm për qeniet njerëzore? Çfarë ndodh me trupin e njeriut gjatë kohës së gjumit? Gjeni informacione të mëtejshme në internet.

## Gjuha e tekstit

- 9 Në thënien "... në fund e mblodhi të pyeste Rolandin", çfarë mblodhi Katerinoja?
  - a) pyetjen;
  - b) mendjen;
  - c) kopenë e deleve.
- 10 Teksa i shpjegon se si numërohen delet, Rolandi përsërit shumë herë të njëjtën fjalë. Cila është ajo dhe si lidhet përdorimi i kësaj fjale me mënyrën se si flasin fëmijët?

## Detyrë

- ▣ Shkruani një tregim të shkurtër imagjinar me titull: "Unë dhe roboti im Katerino" ose "Njerëzit dhe robotët në vitin 2222".

## Bashkëbisedojmë

Bashkëbisedoni rreth zhvillimeve të shkencës dhe teknologjisë që prej vitit 1967, kur është botuar tregimi "Roboti që donte të flinte".

# Busulla e artë

## Para leximit

Lira Belakua është rritur si një vajzë jetime, që u gëzohet lojërave të moshës dhe shëtit e lirë mes studiueseve në kolegjin "Xhordan" të Oksfordit, me shejtanin e saj gjithmonë përkrah. Qetësinë e Lirës e prish ardhja e xhaxhait të saj, Asrilit, nga Poli i Veriut. E fshehur, ajo dëgjon bisedat e fshehta mbi "Pluhurin", një lloj grimce e jashtëzakonshme, dhe sheh fotografitë e një qyteti që qëndron pezull në ajër. Në këtë mënyrë vërtetohet ekzistenca e universeve paralele, por lind pyetja se si mund të lidhen ato ndërmjet tyre. Para se të largohet nga "Xhordan", mjeshtri i jep asaj një busull të artë, e cila do ta ndihmojë për t'i treguar të vërtetën. Lira do të gjendet papritmas në mes të një beteje të tmerrshme, që e ka zanafillën te Hamësit dhe fëmijët e grabitur, klanet e shtrigave dhe arinjte me parzmore. Nëpërmjet fantazisë, autori ka krijuar personazhe njerëzore, por që bashkëshoqërohen në mënyrë të pandashme me nga një shejtan, që përjeton gjithçka, si ata. Shejtani i Lirës e ka emrin Pantalejmon. Ai e shoqëron kudo. Në fragmentin e mëposhtëm përshkruhet Lira, e cila bashkë me ciganët po udhëton drejt Polit të Veriut, për të zbuluar se kush i ka rëmbyer fëmijët. Mes fëmijëve të rëmbyer është edhe shoku i saj, Roxheri. Në këtë udhëtim ajo do të përballet me të vërteta të mëdha: që nga zbulimi i prindërve të saj, që ishin gjallë, deri te zbulimi i misterit të fëmijëve të zhdukur.

Në kërkim të Lirës janë vënë të gjithë, për shkak të busullës së artë, e cila ka aftësinë t'i përgjigjet çdo pyetjeje, por më parë duhet të dish kuptimin e simboleve të saj.



## Fjalor

**hamës** – emër që iu vendos atyre që rrëmbejnë fëmijët, meqenëse nuk dinin asgjë tjetër rreth tyre.

**tartar** – banor vendas i Tartarisë;

**këtu**: ushtar mercenar shumë i fortë.

**kabinë** – kthinë e vogël për udhëtarë në një anije, në një vagon treni etj.

**alithiometër** – (nga greq. alithia do të thotë, e vërtetë), këtu: lexues simbolesh, matës i së vërtetës.

**kridhej** – zhytej në ujë, në mendime.

**kreshtë** – kurriz shkëmbor i një mali.

Në të gjithë mbretërinë ishin vënë në ndjekje të një vajze të vogël flokëverdhe dhe jepej një shpërblim i majmë për atë që e zbulonte, si dhe një ndëshkim i rëndë për atë që e fshihte. Pastaj thuheshin edhe thashetheme të çuditshme: njerëzit thoshin se ajo ishte i vetmi fëmijë që arriti t'u shpëtonte **Hamësve** dhe se dinte sekrete të llahtarshme. Por kishte nga ata që thoshin se ajo nuk ishte fëmijë njeriu, por një palë shpirtrash në formën e një shejtani dhe një fëmije, që ishte dërguar në këtë botë nga fuqitë e skëterrës për të sjellë shkatërrim; ndërsa të tjerë thoshin që nuk ishte fëmijë, por një qenie njerëzore e rritur, që i kishin bërë magji dhe paguhej nga **Tartarët** për të spiunuar anglezët e mirë, duke përgatitur kështu terrenin për pushtimin e tyre.

Lira i dëgjoji gjithë këto përralla në fillim me gaz, pastaj me dëshpërim. Sa njerëz që e urrenin dhe i trembeshin! Ndërsa ajo mezi priste të dilte nga ajo **kabinë** e vogël. Sa do të donte që tani të ishte në veri, mes borës dhe agimit të shndritshëm. Ndonjëherë dëshironte të ishte prapë në kolegjin "Xhordan", duke u kacavarur në çati me Roxherin...



**Philip Pullman (Filip Pulman)** (lindi më 1946) është shkrimtar britanik. Ka punuar si mësues dhe është autor i disa prej librave më të vlerësuar, për fëmijë dhe të rinj. Ai është i njohur veçanërisht për trilogjinë fantastike të përkthyer edhe në shqip: "Materialet e tij të errëta: Busulla e artë, Thika e mprehtë, Tejqyra e qelibartë".

... E vetmja gjë që e qetësonte dhe ia hiqte mërzinë ishte *alithiometri*. Ajo merrej me të përditë, ndonjëherë vetëm dhe ndonjëherë me Farder Koramin, dhe vuri re se mund të *kridhej* gjithnjë e më shumë në gjendjen e qetë, në të cilën kuptimet e simboleve qartësoheshin vetë dhe *kreshtat* e atyre maleve të mëdha që i preknin rrezet e diellit ktheheshin në vizion.

Ajo u përpoq t'ia shpjegonte Farder Koramit se si ndihej.

– Është si të flasësh me dikë që nuk e dëgjon mirë, ndaj të duket vetja kot, pse është më i zgjuar se ti... Dhe sa shumë që di, Farder Koram! Madje duket sikur di gjithçka. Zonja Kulter ishte e zgjuar, edhe ajo dinte shumë, por ishte një lloj tjetër njohurie... Si të kuptuarit, mbase...

Ai i bënte pyetje specifike dhe ajo kërkonte për përgjigjet.

– Ç'po bën tani, zonja Kulter? – i tha, por duart e saj lëvizën sakaq. Dhe ai vazhdoi: – Më thuaj, çfarë po bën?

– Po ja, Madona është zonja Kulter dhe mendoj, mamaja ime... kjo është e thjeshtë, ky është kuptimi kryesor. Ndërsa ora e rërës ka kuptimin e kohës, dhe aty do të thotë tani, pra unë përqendrohem tek ajo.





– Dhe nga e di se ku janë këto kuptime?

– I shoh, në njëfarë mënyre, sikur zbres në një shkallë litari në errësirë; vendos këmbën dhe e di që aty është një këmbë shkalle tjetër. Pra, e shpie mendjen më poshtë dhe atje gjendet një kuptim tjetër, dhe e ndiej pak a shumë se ç’kuptim është. Pastaj i bashkoj të gjitha kuptimet. Është një lloj *marifeti*, si të ngulësh sytë diku.

– Atëherë, pa shih se çfarë thotë. Dhe Lira uli kokën mbi alithiometër.

... Akrepi u ndal te rrufeja, fëmija, gjarpri, elefanti dhe së fundmi qëndroi te një krijesë që Lira nuk dinte si ta quante: ishte një lloj hardhuce me sy të mëdhenj dhe një bisht të hollë, të përdredhur. Kjo u përsërit herë pas here, teksa Lira e vështronte.

– Ç’kuptim ka ajo hardhuca? – ndërhyri Farder Korami duke e shpërqendruar.

– Nuk ka kuptim... E shoh se ç’thotë, por kam frikë se mos e lexoj gabim. Rrufeja, mendoj se do të thotë zemërim, ndërsa fëmija... duhet të jem unë... Më erdhi ndër mend diçka për atë hardhucën, Farder Koram, por në atë çast ju më folët dhe e humba fillin. E sheh, tani po lëviz kot më kot.

– Po, e shoh. Më fal, Lira. Ndiresh e lodhur? E lëmë me kaq?

– Jo, nuk jam lodhur, – i tha, por ishte bërë prush në fytyrë dhe i shkëlqenin sytë. Dukej që ishte tepër e shqetësuar dhe gjendja e saj rëndohej nga qëndrimi për një kohë të gjatë brenda asaj kabine të vogël.

Lira u ngjit lart dhe Pantalejmoni u kthye sakaq në një pulëbardhë, duke hapur flatrat në ajër. Jashtë ishte ftohtë dhe, megjithëse ishte veshur mirë, Lira zuri të dridhej. Pantalejmoni, nga ana tjetër, u derdh në ajër me një *piskamë* të fortë *ngazëllimi* dhe zuri të rrotullohej sa para - mbrapa barkës. Lira, e ngazëllyer pothuajse sa ai, e nxiti me mendje që të ftonte në një garë shejtanin *karabullak* deti të timonierit. Por ajo nuk ia vuri veshin dhe u shtriq e përgjumur te timoni, pranë njeriut të saj.

Jashtë nuk dukej asgjë e gjallë dhe heshtjen e atyshme e prishnin vetëm gulçima e pandërprerë e motorit dhe pllaquritja e ujërave. Retë e rënda ishin ulur poshtë, por nuk binte shi; i gjithë vendi ishte kredhur në një tym të rëndë. E vetmja gjë e gëzueshme aty ishte Pantalejmoni.

## Fjalor

*marifet* – mënyrë e shkathët e dinake për të kryer një punë; dredhi, djallëzi, hile.

*piskamë* – thirrje me zë të lartë, britmë.

*ngazëllim* – gëzim i madh, i thellë.

*shejtan* – këtu: krijesa që pasqyrojnë genien e brendshme të çdo personi. Njerëzit dhe shtrigat kishin të gjithë nga një shejtan. Kur ishin fëmijë, ai mund të ndryshonte formën, ndërsa kur rritej, merrte formë përfundimtare.

*karabullak* – lloj shpendi që jeton në kënetë ose në bregdet.



## Studim teksti

## Kuptojmë tekstin

- 1 Përgjigjuni pyetjeve rreth tekstit.
  - ▣ Çfarë thuhej për Lirën? Si i priste Lira këto thashetheme?
  - ▣ Me çfarë e hiqte mërzinë Lira, ndërsa qëndronte e mbyllur? Si ishte gjendja shëndetësore dhe psikologjike e Lirës?
  - ▣ Kush e shoqëronte kudo dhe në çdo moment?
  - ▣ Kush e nxiste Lirën për të kuptuar alithiometrin? Ç'pyetje i bën alithiometrit Lira?
  - ▣ Si i përgjigjet ai? Kush ishte zonja Kulter?

## Analizojmë tekstin

- 2 Gjeni në tekst fragmentin ku Lira tregon se si vepron për të gjetur përgjigjet në alithiometër.
- 3 Pantalejmoni është një figurë imagjinare. Në çfarë forme u shndërrua Pantalejmoni në këtë pjesë? Si ishte gjendja emocionale e Pantalejmonit?

## Gjuha e tekstit

- 4 Lidhni me shigjetë çdo simbol me kuptimin përkatës.
 

a) Fëmija	zemërim
b) Madona	Lira
c) Ora e rërës	Zonja Kulter
ç) Rrufeja	koha
- 5 Gjeni fjalët kyçe në tekst që e përshkruajnë alithiometrin si objekt magjik.
- 6 Gjeni në tekst pjesët ku personazhet meditojnë, bisedojnë, rrëfejnë.

## Bashkëbisedojmë

- ▣ Cili është lloji i librit që ju pëlqen të lexoni? Plotësoni tabelën e mëposhtme sipas anketimeve në klasën tuaj. Diskutoni rreth tyre.

Emri i nxënësit/es	Titulli i librit	Libër me:					
		ngjarje reale	fabula, përralla, legjenda	fantazi dhe aventura	përmbajtje fantastiko-shkencore	poezi dhe poema	drama, tragjedi, komedi
Drilona Haxhiu	"Udhëtimet e Guliverit"						
Genti Azizi	"Ekspedita e kaltër"						
Valon Kurti	"Bagëti e bujqësi"						
Jehona Kupi	"Mrekullia"	✓					

## Kur nëna ime...

## Para leximit

Për njeriun, familja është gjithçka. Ajo që i bashkon anëtarët e një familjeje është dashuria dhe respekti për njëri-tjetrin. Për fëmijën, ndjenja më e çmuar është dashuria për nënën. Sa herë që ka nevojë, nëna është gjithmonë pranë tij. *Për këtë ndjenjë sublime, si edhe për marrëdhënien e ngushtë me motrat e vëllezërit flet edhe poezia e mëposhtme. Pranë familjes, vetmia dhe trishtimi largohen, sepse ndien dashurinë e gjithë anëtarëve të saj.*

Kur nëna ime  
Bëhet kitarë,  
Unë atëherë bëhem  
kënga e parë.

Kur babai im  
bëhet **ani**,  
unë atëherë bëhem  
veli i tij.

Kur motra ime  
bëhet me vaj,  
unë atëherë bëhem  
loti i saj.

Kur vëllathi im,  
kërkon kaltërsinë,  
unë atëherë bëhem  
qielli i tij.

Pilot unë bëhem.  
E tani ç'thua?  
Ime nënë shtrohet  
si rrjetë nën mua.



Dua të bëhem  
Verës ujvarë,  
Motra më bëhet  
Vala e parë.

Dua të shoh  
N'zemër ç'ka ngjet,  
Babi më hap  
Zemrën e vet.

Por i vetmuar  
Asgjë nuk dua;  
Vëllathi i vogël,  
Ja, vjen me mua!

*“Kur buzëqesh nëna ime”, 1984.*



Fjalor

ani – anije

**Agim Deva** (1948-2009) u diplomua për Gjuhë dhe Letërsi Shqipe në Universitetin e Prishtinës. Kreu studimet për doktoraturë në fushën e letërsisë për fëmijë. Punoi në Fakultetin e Filologjisë, si ligjërues në lëndën e “Letërsisë për fëmijë”. Organizoi disa simpoziume e sesione shkencore mbi çështjet e letërsisë për fëmijë e të rinj. Ndër librat që shkroi për fëmijë, përmendim: “Zonja e livadheve”, “Panushi” (roman për fëmijë), “Parada e luajve”, “Rrota e historisë” (vjersha për fëmijë), “Harta e zemrës”, “U këndojmë dëshmorëve”, “Dreri në mal” (vjersha të zgjedhura për fëmijë) etj.



## Studim teksti

## Kuptojmë poezinë

- 1 Përgjigjuni pyetjeve rreth poezisë.
  - a) Kujt i kushtohet kjo poezi?
  - b) Cilët janë individët që përmenden në këtë poezi?
  - c) Cili prej tyre është më i vogli?


## Interpretojmë poezinë

- 2 Cila është e vetmja gjë që ia largon vetminë poetit kur është i mërzhitur?
- 3 Interpretoni vargjet: *Dua të shoh/N'zemër ç'ka ngjet, /Babi më hap/Zemrën e vet. Çfarë mund të bëjë babai për djalin e tij?*


## Analizojmë poezinë

- 4 Realizoni në skemë ndërlidhjen mes anëtarëve të familjes.

- a) Çfarë është gati të bëjë poeti për secilin prej tyre?



- b) Po ata, çfarë janë gati të bëjnë për poetin?



- 5 Analizoni ndërlidhjen mes veprimit të poetit "pilot unë bëhem" dhe veprimit të nënës "shtrohet si rrjetë".

## Gjuha e poezisë

- 6 Gjeni dy mënyra në poezi, nëpërmjet së cilave poeti tregon se vëllai i tij është shumë më i vogël se ai.
- 7 Titulli i poezisë është "Kur nëna ime...", por në të vërtetë, aty flitet edhe për të tjerë. Shpjegoni funksionin e reticencës (tri pikave).

## Reflektojmë rreth poezisë

- 8 Gjeni shprehje popullore që tregojnë për sakrificat që bëjnë anëtarët e familjes për njëri-tjetrit.

## Detyrë

- Dashuria mes anëtarëve të familjes është më e madhja dhe më e vërteta. Diskutoni për ndihmën dhe përkujdesjen që i jepni njëri-tjetrit në familjen tuaj.

## Proza lirike

Veçoria kryesore e lirikës është shprehja lirish e ndjenjave, emocioneve dhe ndjesive të unit poetik.

Subjektiviteti: poezia lirike karakterizohet nga një ngarkesë e madhe emocionale intime, e brendshme, çka e dallon atë nga epika dhe dramatika.

Poezia lirike dallohet për dendurinë e madhe figurative dhe krijimin e imazheve, që shpeshherë nxitin refleksion te lexuesi/ja. Një tekst lirik, ndryshe nga ai epik apo dramatik, është zakonisht i shkurtër. Përmbajtja e tij është mjaft e sintetizuar ose lakonike. Kjo është arsyeja që ky lloj teksti u drejtohet metaforave, simboleve dhe figurave të tjera retorike për të shprehur me pak fjalë kuptime të shumëfishta apo të thella. Poezia lirike i trajton disa tema shumë më shpesh se të tjerat. Studiuësit, duke u nisur nga temat që ajo trajton, e ndajnë poezinë lirike në: lirika e dashurisë, lirika atdhetare, lirika e peizazhit, lirika shoqërore, lirika fetare, lirika filozofike etj.

# Shpell' e Dragobisë

(Elegji për Bajram Currin)

## Para leximit

Kjo poezi është një elegji epike dhe himnizuese kushtuar heroit legjendar, Bajram Curri. Njëpërmjet saj, Noli ka portretizuar një figurë të gjallë dhe heroike. Bajram Curri, trimi nga Kosova, ishte drejtues kryesor i kryengritjes kundër osmanëve që u finalizua me shpalljen e pavarësisë. Ai dha një kontribut të madh në mbrojtjen e tërësisë territoriale të atdheut.



Kur tufani e çthuri fenë,  
Kur tirani e krrusi atdhenë,  
Mi një brek të **Dragobisë**  
Priret Flamur' i lirisë.

Atje nisi, atje mbaroj,  
Atje krisi, atje pushoj,-  
Rrufe-shkab' e Malësisë,  
Në një shkëmb të Dragobisë.

Vendi dridhej, ay mbeti  
Se s'tronditej nga tërmeti.-  
**Dif** drangoj i Dragobisë,  
Trim **tribun** i Vegjëlisë.

O Bajram, bajrak i gjallë,  
More nam me gjak në ballë,  
Te një shpell' e Dragobisë, -  
Yll i rall' i burrërisë.

Thon' u-shtri e thon' u-vra,  
Po ti s'vdiqe, or Baba,  
As te shkëmb' i Dragobisë,  
As të zëmr' e Djalërisë.



## Fjalor

*Dragobi* – mal në Veri të Shqipërisë

*Dif* – qenie e trilluar me fuqi të jashtëzakonshme

*tribun* – udhëheqës që mbron të drejtat e popullit

*Ante* – vigan mitologjik, bir i Neptunit dhe i Tokës, i pathyeshëm

*dithiramb* – këngë që këndohej në

Greqinë e lashtë për nder të Dionisit;

*këtu* ka kuptimin e heroit

*katakomb* – këtu: shpellë e

nëndheshme, nga ku është e vështirë të dalësh

**Fan S. Noli** (1882-1965) është poet, publicist, përkthyes shumë i njohur. Lindi në Ibrik-Tepe të Adrianopojës, në një koloni shqiptare në Turqi. Ai njihet për kontributin e çmuar që i ka dhënë lëvizjes kombëtare me veprimtarinë e tij politike dhe letrare. Në vitin 1912 u diplomua për arte në Universitetin e Harvardit. Ka shkruar vëllimin me vjersha "Albumi" (1948), si dhe dramën me tri akte "Israilitë dhe Filistinë". Noli ka realizuar edhe studime, siç është ai për heroin tonë kombëtar, "Historia e Skënderbeut" (1921); studimin "Bethoveni dhe Revolucioni Francez" etj. Shqipëroi dhe shoqëroi me analiza vepra të Shekspirit, Servantesit, Ibsenit, Omar Khajamit etj.



As je vrar' e as po vritesh  
 Legjendar Ante po rritesh.  
 Dithiramb i Dragobisë,  
 Tmerr, panik i mizorisë.

Me Zjarr Shenjt u ndrit kjo shpellë,  
 Gjer në qjell u ngrit Kështjellë  
 Për çlirimn' e Shqipërisë  
 Katakomb i Dragobisë.

Shkëputur nga "Poezi të zgjedhura", 1966

## Studim teksti

### Kuptojmë poezinë

- 1 Përgjigjuni këtyre pyetjeve rreth poezisë:
  - a) Bajram Curri është hero i popullit shqiptar. Cila është origjina e tij?
  - b) Për çfarë luftoi Bajram Curri?
  - c) Cili është kontributi i tij për mbrojtjen e tërësisë territoriale?
  - d) Ku luftoi dhe ku "pushoi" Bajram Curri?

### Analizojmë poezinë

- 2 Si e përshkruan Noli figurën e Bajram Currit? Gjeni në tekst, fjalët që përdoren për të treguar trimërinë e madhe të kësaj figure.

### Interpretojmë poezinë

- 3 Duke u nisur nga shpjegimi i fjalës "katakomb", pas sulmeve të vazhdueshme, në çfarë u shndërrua shpella e Dragobisë? Analizoni vargjet: *Për çlirimn' e Shqipërisë/Katakomb i Dragobisë*.

### Gjuha e poezisë

- 4 Gjeni një hiperbolë në elegjinë epike që i kushtohet Bajram Currit.
- 5 Lexoni me vëmendje poezinë, gjeni tri metafora dhe shpjegoni mënyrën si janë ndërtuar.
- 6 Cila është figura tingullore e ndërtuar nga poeti në vargjet: *Dif drangoj i Dragobisë/ trim tribun i vegjëlisë?*
- 7 Gjeni dy anafora në poezinë e mësipërme.

### Reflektojmë rreth poezisë

- 8 Trimat dhe heronjtë që japin jetën për atdheun, mbeten të gjallë në kujtesën e popullit. Si ruhet figura e Bajram Currit në kujtesën e brezave?

### Detyrë

- 📄 Ka edhe poezi të tjera kushtuar Bajram Currit. Gjeni të paktën një të tjerë dhe lexojeni në klasë.

## Vrull

## Para leximit

Vjersha ("Rrutullupë") "Vrull", paraqet shqetësimin e madh me të cilin e vështron Serembja fatin e atdheut të tij. Larg vendlindjes, ai shfaqet herë i trishtuar e herë rebel për këtë gjendje. Në katër strofat e kësaj vjershe përshkruhet malli për atdheun e të parëve, dëshira për ta parë të lirë, urrejtja për pushtuesin, besimi në të ardhmen, por edhe droja apo frika se mund të harrohet. Përmes vargjeve ndihet një lloj vetmie, në të cilën është zhytur jo vetëm ai si individ, por edhe bashkëkombësit e tij përtej detit.

Zogj të bukur këndojnë me *hare*,  
Po zëmra do t'më plasë mua në gji.  
I helmuar e shkoj jetën te ky dhe,  
mërzitem në katund, në vetëmi.

Hapet përpara meje deti i shkëlqyer,  
Që zgjon në trutë e mi mendime shumë,  
E shqetësimi zemrën time çjerr,  
aq sa vetëm pushoj kur bie në gjumë.

Arbria matanë detit, na kujton,  
se ne të huaj jemi te ky dhe!  
Sa *mote* shkuan! E zëmra nuk harron,...  
Që nga turku mbetëm pa mëmëdhe...

Hakmarrja na jep shpresë e na ndriçon,  
Por fryn era dhe akulli më zë,  
Se ç'ka qenë Arbëreshi po harron:  
Dhe s'i vjen turp aspak, po rri e flë.



## Fjalor

*hare* – gëzim i madh.

*mote* – vite.



**Zef Serembe** lindi më 6 mars 1844, në fshatin arbëresh San Kozmo Albaneze të Kalabrisë ose Strigari, siç i thonë vendësit, ku zakonet dhe gjuha shqipe janë ruajtur deri më sot. Fshati ndodhet mbi një kodër të veshur me vreshta, me portokaj dhe limonë, me pamje nga deti Jon. Serembe shkroi poezi, drama dhe bëri një sërë përkthimesh. Sa që gjallë, ai arriti të botonte vetëm "Poezi italiane dhe këngë origjinale të përkthyer nga shqipja", si dhe një përmbledhje shumë të rrallë prej 42 sonetesh me një parathënie të imtësishme.

## Strofa

**Strofa** është një grup vargjesh të lidhura ndërmjet tyre përmes ritmit, rimës dhe intonacionit të përbashkët, që mund të qëndrojë edhe më vete. Numri i ndryshëm i vargjeve përcakton edhe llojin e strofave të ndryshme.

**Strofa dyshe** (distiku) është forma më e thjeshtë; përbëhet prej dy vargjeve që janë të lidhura me një mendim dhe me rimë të përputhur. Ka raste kur janë edhe pa rimë.

*E shkuara ka orë dhe çaste të hidhura, mos ma kujto,*

*Ka drojtje dhe heshtje kur lipsen të thirrura, mos ma kujto! (Mos ma kujto, Dritëro Agolli)*

**Strofa treshe** (tercina) përbëhet prej tri vargjeve të rimuara ose prej tri vargjeve pa rimë. Rima e saj mund të jetë e ndryshme AAA ose AAB, ose ABA etj.

*Kur të vdes, le të bahem bar*

*Në malet e mia në pranverë,*

*Në vjeshtë do të bëhem farë. (Vendit tem, Martin Camaj)*

**Strofa katërshe** (katrena) është ndër më të përhapurat, përbëhet prej katër vargjesh të lidhura ndërmjet tyre me rimë të përputhur (AABB), të kryqëzuar (ABAB) ose të përmbysur (ABBA).

*I dha erë trëndafilit,*

*I dha dritë bukurisë,*

*I dha këngët bilbilit,*

*I dha shije gjithësisë. (Fyelli, Naim Frashëri)*

Një lloji i veçantë i strofës me katër vargje është **strofa safike**, e cila u quajt kështu sipas poeteshës greke Safo, që e lëvroi atë. Kjo strofë përbëhet prej katër vargjesh, prej të cilave tri vargjet e para janë njëmbëdhjetërokëshe, kurse i fundit përbëhet prej pesë rrokjesh. Në letërsinë shqipe këtë strofë e kanë lëvruar: Ndre Mjedja, Fan Noli, Luigj Gurakuqi, Gjergj Fishta etj.

*Bylbyl, ky shekull orë e ças ndrrohet:*

*Bijnë poshtë të naltit, i vogli çohet;*

*Edhe natyra po do m'u ndrrue:*

*Fillo me gëzue. (Vaji i bylbylit, Ndre Mjedja)*

Ekzistojnë edhe strofat me pesë vargje, shtatë vargje, tetë vargje, dhjetë vargje, por këto përdoren më rrallë.

## Studim teksti

## Kuptojmë poezinë

- 1 Përgjigjuni pyetjeve rreth poezisë:
  - ▣ Si përshkruhet natyra në këtë poezi?
  - ▣ Si paraqitet gjendja emocionale e poetit?
  - ▣ Çfarë e shqetëson kaq shumë poetin?

## Analizojmë poezinë

- 2 Serembe është poet arbëresh. Gjeneri në poezi elementet që përshkruajnë rrethanat, në të cilat bashkëkombësit e poetit u detyruan të largohen nga atdheu.
- 3 Strofa e dytë fillon me vargun: *Hapet përpara meje deti i shkëlqyer*. Për çfarë shkëlqimi e ka fjalën poeti? Cili është burimi i këtij shkëlqimi?
- 4 Cili është motivi kryesor i kësaj poezie? Shpjegojeni me fjalët tuaja këtë motiv.
- 5 Interpretoni vargun: *Nga urrejtja, ngrihet shpresa dhe ndriçon*. Çfarë toni përdor poeti në këtë varg?
- 6 Në vargun: *I helmuar e shkoj jetën te ky dhe*, poeti i ngjan heroit lirik romantik, pothuajse krejt i pashpresë. Po në vargjet në vijim, a vazhdon të shfaqet i tillë poeti?

## Gjuha e poezisë

- 7 Përcaktoni llojin e strofës dhe llojin e vargut të kësaj poezie.
- 8 Gjeneri në tekst antitezat në bazë të së cilave është ndërtuar kjo poezi.

## Ora e Shalës

## Para leximit

Ky fragment është shkëputur nga kënga e gjashtëmbëdhjetë "Kulshedra" e poemës epike "Lahuta e Malcisë". Dragonjtë, pas një përleshjeje të fortë, kanë mundur Kulshedrën. Ata janë ulur të lodhur në Bigën e Gimajve e po kuvendojnë. Në një skenë të mrekullueshme, Fishta tregon që Orët e malit, pasi kanë parë përleshjen, janë kujtuar se Dragonjtë janë të pangrënë. Ata janë shumë larg shtëpisë e gratë e tyre s'mund të gatuajnë për ta. Fishta përshkruan gatishmërinë dhe shpejtësinë e Orëve, të cilat mbledhin ushqim, u shtrojnë darkën Dragonjve dhe bisedojnë me ta.

At herë Orët u kan sjellë bukën;  
U kan vû **ferlikët** përpara,  
E u kan prû mjelcat me kjumshtë:  
Kjumshtë me borë, dhâmin me t'pi:  
Edhë mjaltë, sà kush kà dashtë:  
Mâ e mirë darka s'ndreqet n'ashtë.



## Fjalor

*lahuta* - vegël muzikore popullore me një tel ose një qime kali, mbi të cilën luhet me një hark të përkulur. Është përdorur kryesisht në Shqipërinë e Veriut, në Kosovë dhe në Mal të Zi. Përbëhet nga një kupëz e drunjte në trajtë vezake, e mbuluar me lëkurë, që quhet shark, dhe ka një bisht jo shumë të gjatë, në të cilin janë të pikturuara figura të ndryshme.  
*ferlikët* - mish i pjekur në hell.



**Gjergj Fishta** (1871- 1940) lindi në Fishtë të Zadrimës. Ai është i njohur si poet, kritik, arsimtar, përkthyes; ka qenë edhe kryetar i komisionit për hartimin e alfabetit në Kongresin e Manastirit. Ai shkroi përmbledhje me poezi, drama, prozë etj. Ka shkruar "Lahuta e Malcisë", kryevepër e poezisë epike shqiptare, përmbledhjen satirike "Anzat e Parnasit", përmbledhjen lirike "Pika voëset", "Mrizi i Zanave" etj. Për gjysmë shekulli, ishte figura mbizotëruese e letërsisë shqipe, madje në kohën kur jetonte e quanin edhe "poet kombëtar". Pas vitit 1944, vepra e Fishtës u ndalua dhe qëndroi e tillë deri në vitet '90. Më pas, vepra e tij filloi të ribotohej dhe ai të vlerësohej si një ndër shkrimtarët më të mëdhenj të letërsisë shqipe.



Gurrën nget kishin për bri,  
 Gurrë si aklli e kjartë florî,  
 Sa kush dote aty me pi.  
 Mbasi bukë trimat kan ngrânë  
 Jânë çue prap e dalë m'njâ' n' ânë  
 E po rrin tue bisedue  
 Me njat t'bukurën Oré të Shalës,  
 Për kanû e pûnë urtije,  
 E për besë e për pûnë t'mikut,  
 E për lufta qi u bânë motit:  
 Për trimni të Gjergj Kastriotit:  
 Për Drangoj e për Kulshedra:  
 Për breshana e për gopedra  
 Edhë folën mbi liri,  
 Mbi liri e mbi Shqypni:  
 Si Shqypnija do t'dalë m' vedi,  
 Mos m'e urdhnuë mâ as Krajli as Mbreti.



## Fjalor

*gurrë* – burim i madh me shumë ujë në një vend malor.  
*breshan* – pushkë me strall e me tytë të gjatë.  
*gopedër* – top artilerie.

## Rima

**Rimë** quhet përputhja e tingujve në fund të dy a më shumë vargjeve. Vargjet që kanë rimë ndërmjet tyre quhen vargje të rimuara ose me rimë. Ajo krijon muzikalitetin në varg dhe thekson një numër të caktuar fjalësh, duke krijuar një lidhje të brendshme mes fjalëve që rimojnë. Sipas vendit, kemi disa lloje rimash:

**Rimë e përputhur**, kur vargjet me të njëjtën rimë vijnë njëri pas tjetrit: *Skema AABB.*

*Arratisur, syrgjynosur,  
 Rraskapitur dhe katosur  
 Po vajtonj pa funt, pa shpresë,  
 anës Elbës, anës Spresë. (Anës lumenjve, F. Noli)*

**Rimë e kryqëzuar**, kur me të njëjtën rimë janë vargu i parë me të tretin dhe i dyti me të katërtin: *Skema ABAB.*

*Mbreti plak u hoq mënjanë,  
 pa u ngrit një trim më këmbë,  
 shikoi një her' anëmbanë  
 hekurin e haj me dhëmbë! (Histori e Skënderbeut, N. Frashëri)*

**Rimë e përmbysur**, kur vargu i parë rimon me të katërtin dhe vargu i dytë me të tretin: *Skema ABBA.*

*Si tufa mëndafshi t'artë në të kaltërtën shami,  
 n'mes dy duersh t'bardha, dy kodra në borë-  
 flakron perëndimi... Retë mbi krye prorë  
 ngasin nëpër qiell dhe zhduken n'hapsi. (Mbramja, A. Pipa)*

**Rimë e brendshme**, kur rimojnë fjalët brenda një vargu.

*O i zhgrryer, i zhyer, i vyer për hu,  
 Turp-e-ndot-kundërmonjës të krusen mbi gju,  
 Dallkaukët, kopukët e turmat pa tru,  
 Zëmër-krund-e-gërdhu: Hosanna, Barabba! (Marshi i Barabbajt, F. Noli)*

## Studim teksti

## Kuptojmë poezinë

- 1 Ora e Shalës e ka kundruar nga larg përleshjen e Dragonjve me Kulshedrën. Çfarë bëjnë Orët, pas përleshjes, për trimat që luftuan?
- 2 Për çfarë bisedon Ora e Shalës me trimat luftëtarë?
- 3 Për çfarë luftojnë trimat e Fishtës?

## Analizojmë poezinë

- 4 Në eposin e kreshnikëve, Zanat ndihmojnë Mujin. Çfarë roli luajnë Orët në këtë fragment të "Lahutës së Malcisë"? A përputhet funksioni i tyre në këngën e Fishtës me funksionin e Zanave në epos?
- 5 Radhitni njëra pas tjetrës figurat mitologjike që përmenden në vepër.
  - a) \_\_\_\_\_
  - b) \_\_\_\_\_
  - c) \_\_\_\_\_
- 6 Gjeni vargjet në të cilat lartohen dhe përmenden virtytet e heronjve të së shkuarës. Gjeni emrin e heroit që përmendet në këto vargje.
- 7 Interpretoni këto vargje që janë edhe mesazhi i gjithë "Lahutës së Malcisë".  
*Si Shqypnija do t'dalë m'vedi,  
 Mos më urdhnuë më as Krajli as Mbreti*

## Reflektojmë rreth poezisë

- 8 Dragonjve që luftojnë në male, atje ku janë Orët, u shtrohet prej tyre një darkë mjaft e pasur, me qumësht të zier, mjaltë, mish e bukë të ngrohtë. Kjo skenë, çfarë zakonesh e traditash të lashta ju kujton? Diskutoni rreth tyre.
- 9 Orët janë figura të mitologjisë popullore shqiptare, që përfytyrohen më së shpeshti si gra, vajza që u sjellin fat ose ndihmojnë njerëzit. Përshkruani si i imagjinoni ju Zanat dhe Orët shqiptare.

## Gjuha e poezisë

- 10 Përcaktoni llojin e strofës, të vargjeve dhe rimën e kësaj pjese të shkëputur nga "Lahuta e Malcisë".

## Detyrë

- ▣ Gjeni figura të tjera mitologjike, të përmendura në këngë të tjera të poemës epike "Lahuta e Malcisë".

## Kosovës

## Para leximit

Në këtë poezi, e shkëputur nga vëllimi "Tufa", poeti shpërfaq të gjitha ndjesitë që e bëjnë të jetë i lidhur përjetësisht me vendin e tij. Ai këndon kur e sheh vendin e tij me *vulën e fitores*; këndon kur e sheh vendin e tij në *dritë të vërtetë*; këndon kur e sheh vendin e tij që del në *hapsirë* e fluturon.

Kosova kreshnike po zgjohet nga gjumi  
Me vulë të fitimit... Dhe na po gëzojmë!  
Po shkundet mali e prroi e lumi –  
Eni t'këndojmë!  
Kosovë kreshnike po vjen prap në jetë  
Me diell në dorë... Dhe na po shikojmë!  
Po del nga terri në dritë të vërtetë –  
Eni t'këndojmë!  
Po del para botës Kosova krenare  
Me ballin e hapët ... Dhe na po fitojmë!  
Me gjak e stolisun po del dëshmitare –  
Eni t'këndojmë!  
Po del para botës Kosova heroike  
Me zana e dragonj... O, na po gjallnojmë!  
Po del në hapsirë me krahët e një *sprije* –  
Eni t'këndojmë!



## Fjalor

eni – ejani

sprije – qenie fantastike e mitologjisë popullore

**Latif Berisha** lindi më 1931, në Vushtrri. Është diplomuar në degën e Albanologjisë, në Universitetin e Beogradit. Që student kontribuoi në formimin e shoqërisë letrare "Përpjekja" të të rinjve shqiptarë që studionin në këtë universitet. Më vonë, punoi si ligjërues në Degën e Albanologjisë, në Fakultetin Filozofik të Prishtinës. Ka shkruar vëllimin me poezi "Tufa" (1957) dhe studime, si: "Ali Asllani dhe krijimtaria e tij poetike"; "Skënderbeu në poemën", "Kënga e sprasme e Balës"; "Skënderbeu në disa krijime të letërsisë shqipe në Jugosllavi"; vepra "Lulet e Verës" dhe disa nga dimensionet e saj kuptimore etj. Në vitin 2004, Latif Berisha u dekorua me "Medaljen e Artë të Pavarësisë", për kontributin e dhënë për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës.



**Kreshnikët**

Kreshnikët janë heronj epikë të krijimeve popullore, të cilët paraqiten me trup të madh, me forcë të jashtëzakonshme, me shpirt të paepur e fisnik dhe kryejnë vepra heroike për mbrojtjen e vendit dhe të popullit. Kreshnikë janë Muji, Halili, Omeri etj.

**Zanat e malit**

Zanat e malit janë krijesa mitologjike shqiptare me tipare origjinale autoktone. Ato shfaqin dy anë të tyre: nga njëra anë i ndihmojnë dhe mbrojnë kreshnikët në beteja, nga ana tjetër janë idhnake dhe i shitojnë (ngurosin) ata që u prishin qetësinë apo futen në territorin e tyre.


**Dragonjtë**

Dragonjtë në përgjithësi përfytyrohen me trup gjarpri dhe krahë të fuqishëm për fluturim: diçka që lidhet me kultin e gjarprit dhe simbolin e shqiponjës. Në mitologjinë popullore shqiptare, dragoi është një njeri që lind me shenjë, për të mos e prerë shpata (ose plumbi). Ai ka fuqi të jashtëzakonshme.

**Studim teksti****Përgjigjuni pyetjeve**

- 1 Çfarë e gëzon poetin që e bën të thurë vargje e të këndojë?
- 2 Gjeni në tekst të gjitha epitetet që përdoren për të karakterizuar Kosovën?
- 3 Përsëritja e të njëjtit varg "*Eni t'këndojmë!*" në fund të çdo strofe, çfarë efekti ka në poezi?
- 4 Interpretoni vargun "*Po del para botës Kosova heroike*". Përçon idenë e një ballafaqimi me botën apo të paraqitjes si e barabartë me botën?
- 5 Duke u nisur nga kuptimi i fjalës **kreshnikë** në fjalor dhe njohuritë që keni rreth tyre, shkruani më poshtë çfarë vlere ka kjo fjalë kur përdoret për të karakterizuar Kosovën.  
Kosova kreshnike - Kosova heroike, \_\_\_\_\_
- 6 Sa vargëshe janë strofat e kësaj poezie? Si është e ndërtuar rima e saj?
- 7 Vargu i fundit i çdo strofe është përsëritur duke u shndërruar në refren. Çfarë efekti ka kjo përsëritje?
- 8 Poezia është ndërtuar si një paralelizëm figurativ mes asaj që ndodh në zemrën e poetit dhe asaj që ndodh në natyrë. Analizoni këtë paralelizëm.

**Detyrë**

-  Gjeni poezi të tjera kushtuar Kosovës dhe lexojini në klasë.

# Shkëndijë e diellit ndaj manushaqes

## Para leximit

*Poezia e mëposhtme i kushtohet atdheut, të cilin poeti në mënyrë simbolike e paraqet në formën e lules së manushaqes. Atdheu e ka humbur shkëlqimin e tij, pasi ndodhet nën sundimin osman. Pushtuesit dhe tradhtarët e vendit janë paraqitur gjithashtu në mënyrë simbolike nëpërmjet fjalëve shpendëra, hithra, ferra. Poezia përcjell besimin dhe shpresën në një të ardhme më të mirë të vendit.*

Manushaqe bukuroshe,  
pse s'ngre kryetë përpjetë,  
po rri e mpit' edhe e qetë.  
Pse s'zbukuroh'e 'shëndoshe?


Pa shiko lulet e tjera,  
q'u çel e u lulëzuan,  
shih, pa shih ç'u zbukuruan,  
i ngjalli përsëri vera.

O lulëz' e Perëndisë,  
që të mbolli vetë Zoti,  
Zgjohu tani q'u ngroh moti,  
Erdhi koh'e gjallërisë.

Hap syt' e qesh dhe gëzohu,  
se gaz të madh të kam prurë,  
mos më rri si e sëmurë,  
po çelu e zbukurohu.

Shpendëra, hithëra, ferra  
përsipër të kanë rënë,  
dritënë ta kanë zënë  
me fletë shumë të gjera.

Dimër' i madh me dëborë,  
me të ftoht' e me të ngritë  
e' me gjithë ligësitë,  
të la të mjer' e të gjorë.



**Naim Frashëri** (1846-1900) konsiderohet figura qendrore e letërsisë shqiptare të Rilindjes Kombëtare. Studimet e mesme i kreu në Janinë, në gjimnazin e njohur "Zosimea" dhe, pas mbarimit të tyre, shkoi për të punuar në Stamboll. Atje u bë një nga veprimtarët më aktivë të Shoqërisë së Shkronjave dhe të lëvizjes së atdhetarëve shqiptarë. Iu kushtua çështjes kombëtare: punoi për ngritjen e shkollës shqipe dhe hartoi libra për të, shkroi vjersha, përktheu e botoi vazhdimisht. Disa nga veprat e tij janë: "Bagëti e Bujqësia", "Vjersha për mësonjëtorët e para", "Lulet e verës", "Historia e Skënderbeut" etj.

Ah, ta zbriti bukurinë  
dhe gjëllimn' e gjithë ç'kishe.  
Vdiqe, u trete, u prishe,  
të thatë të shoh tanimë!

Po mos u tremb, bëhu trime  
edhe ki durim e shpresë,  
e po silli zotit besë  
dhe kësaj fjalësë sime.

### Simboli

Simboli është një figurë letrare, që paraqet në mënyrë të figurshme një send, një qenie a një dukuri nëpërmjet një sendi, një qenieje a një dukurie tjetër, sipas karakteristikave të përafërta. Për shembull, flamuri nënkupton kombin shqiptar. Simboli përdoret gjerësisht jo vetëm në letërsi, por edhe në jetën shoqërore. Kafshë të tilla, si: *dhelpra, ujku, luani*, janë kthyer përkatësisht në simbole të dinakërisë, egërsisë, forcës. Shumë personazhe të letërsisë artistike, të përsosura në tipin e tyre, janë bërë simbole të virtyteve ose veseve të ndryshme njerëzore. *Prometeu* është bërë simbol i dashurisë dhe i sakrificës njerëzore; *Gjergj Elez Alia*, simbol i luftëtarit që mbron nderin dhe lirinë.

## Studim teksti

### Kuptojmë poezinë

- 1 Kujt i drejtohet poeti me këtë poezi?
- 2 Në ç'gjendje është manushaqja?
- 3 Ku ndryshon ajo nga shoqet e tjera?
- 4 Çfarë simbolizon në këto vargje manushaqja, së cilës i drejtohet poeti?

### Analizojmë poezinë

- 5 Kjo poezi tingëllon si një bisedë e ngrohtë mes birit dhe nënës. Fjalët e zgjedhura janë fjalë dhembshurie dhe dashurie. Si e interpretoni këtë zgjedhje të poetit?
- 6 Interpretoni vargjet: *Dimër' i madh me dëborë, /me të ftoht' e me të ngritë /e' me gjithë ligësitë, /të la të mjer' e të gjorë, duke nënkuptuar vështirësi me fjalën "dimër".*
- 7 Si mendoni, a është përmbushur pritshmëria e poetit në lidhje me të ardhmen e atdheut? Diskutoni në grupe.

### Gjuha e poezisë

- 8 Në ç'dialekt është shkruar kjo poezi? Nga e kuptoni këtë?
- 9 Flisni për llojin e strofave, vargut dhe të rimës së poezisë. (Kujtoni: Llojet e vargjeve përcaktohen nga numri i rrokjeve.)

### Detyrë

- ▣ Shkruani një përshkrim ose rrëfim letrar, në qendër të të cilit të vendosni një objekt a frymor simbolik. Përpiquni që mes rreshtave të lini të kuptohet se kujt i referoheni me të. Lexoni punët me shkrim të njëri-tjetrit dhe diskutoni rreth tyre.

### Bashkëbisedojmë

Lexoni poezi të ndryshme kushtuar atdheut dhe diskutoni rreth tyre. Gjatë diskutimit mbani parasysh këto këshilla:

- ▣ Poezia ka më shumë se një kuptim.
- ▣ Poezia lexohet dhe komentohet në mënyrë të tillë që të ndikosh te të tjerët.
- ▣ Ndërhyni në diskutim, duke thënë "Unë mendoj se..." dhe dëgjoni me vëmendje edhe ata që kanë mendim të ndryshëm nga yti.

# Mëma

## Para leximit

Poezia e mëposhtme i kushtohet një prej njerëzve më të rëndësishëm dhe të pazëvendësueshëm në jetën e njeriut: nënës. Poezia përcjell cilësitë më karakterizuese të një nëne, si: dhembshuria, përkujdesja, dashuria dhe sakrifkimi për bijtë. Përmes metaforave dhe fjalëve të zgjedhura me kujdes na përcillet një ndjesi ngrohtësie dhe ndërgjegjësimi për të rritur vlerësimin ndaj të shtrenjtave tona.

Fjal' e bukur, fjal' e shenjtë  
thellë zemrës që tingëllon,  
s'ka në botë gjë m'e shtrenjtë,  
s'ka si mëmë kur kujton!

Mëmë, mëmë, frym' e lartë,  
rreze drite, yll qiellor,  
plot mëshirë e mall të zjarrtë  
engjëll roje madhështor.

Që nga gjinjtë e saj *të dliurë*  
*vilet jeta* pa shterim.  
Që nga zemra e saj ka mbirë,  
dashuri dhe mallëngjim.

Si në gaz dhe në vajtje,  
veç një mëmë të larton.  
Sa ka frym' e sa ka rrojtje,  
mendja kurrë s'të harron.



**Aleksandër Stavre Drenova** (1872-1947), i njohur në letërsinë shqipe me pseudonimin Asdreni, i mori mësimet e para në Korçë. Që në moshën trembëdhjetëvjeçare emigroi në Rumani, ku vazhdoi shkollën e mesme dhe më vonë fakultetin e shkencave politike. Atje u detyrua të bënte gjithfarë punësh të rënda dhe u lidh me atdhetarët shqiptarë që jetonin në Bukuresht, të cilët ishin organizuar në formën e një shoqate. Asdreni u bë një nga përfaqësuesit më të shquar të saj. Disa nga vëllimet e tij me poezi janë: "Rreze dielli", "Ëndërra dhe lotë", "Psallme murgu".



**Fjalor**

të dliirë – të dëlirë, të pastër.

vilet jeta – buron jeta.

nëmë – mallkim.

Çdo rreziku rri të ruan,  
bën detyrë si luftar.  
Si dëshmori heq e vuan  
për të zemrës saj thesar.

Kush s'di vlerën e një nëne,  
është pa ndenjë e shpirtmizor,  
bir skëterre e frymë *nëmë*,  
është' i vetes tradhëtor!

**Studim teksti****Kuptojmë poezinë**

- 1 Lexoni vargjet dhe përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme.
  - a) Kujt i kushtohet kjo poezi?
  - b) Poeti e lartëson figurën e nënës. Deri ku arrin ky lartësim?
  - c) Çfarë bën nëna për fëmijën e vet? Cilat nga veprimet e saj përcjell kjo poezi?



**Analizoni poezinë**

- 2 Shpjegoni kuptimin që përcjellin metaforat:  
*thellë zemrës që tingëllon, mall të zjarrtë, engjëll roje madhështor.*
- 3 Analizoni vargjet:  
*s'ka në botë gjë m' e shtrenjtë*  
*s'ka si mëmë kur kujton!*

**Gjuha e poezisë**

- 4 Gjeni mbiemrat e përdorur në këtë poezi. Çfarë cilësish shprehin ata?
- 5 Gjeni fjalët sinonime të përdorura në poezi dhe shkruani çiftet e tyre, p.sh.:  
heq – vuan.

**Detyrë**

-  Bëni një punë me shkrim, në të cilën të shprehni ndjenjat për nënën tuaj duke iu referuar vargjeve:  
*S'ka në botë gjë m'e shtrenjtë,*  
*s'ka si mëmë kur kujton!*
-  Shkruani një poezi kushtuar nënës, me dy strofa dhe me rimë.



# Shqiponja

## Para leximit

Në poezinë e mëposhtme, poeti i thur vargje shpendit që është konsideruar si mbreti i qiejve. Asnjë shpend nuk ia kalon shqiponjës për nga forca, mprehtësia dhe aftësia për t'u orientuar. Asnjë shpend nuk del kundër shqiponjës, duke treguar në këtë mënyrë fuqinë e saj të padiskutueshme. Shqiptarët janë shumë të lidhur me këtë shpend, me të cilin shpesh identifikohen.



Shqiponja e mprehtë – vetëtimë,  
Vetëtimën e ka marrë –  
Nga retë e qiellit.

Bebëzat e mbushura – shkëlqim,  
Shkëlqimin e ka marrë –  
Prej rrezeve të diellit.

Në qiellin e gjerë arbëror  
Valon si flamur – kurorë.  
Krahët – shkëmb i fortë,  
Fortësinë ia kanë rritur –  
Ndeshjet me stuhi.

Zemrën – flakadan i plotë,  
Zjarrin ia ka shtuar –  
Etja për liri!...

Në qiellin e gjerë arbëror  
Qëndron si roje – kurorë.

**Ymer Elshani** (1948-1999) lindi në Korroticë të Poshtme të Drenasit. Kreu Fakultetin për gjuhë dhe letërsi shqipe dhe një kohë të gjatë punoi në arsim. Botoi dhjetëra libra për fëmijë me poezi, tregime, romane dhe pjesë teatrale. Ka shkruar përmbledhjet me vjersha: "Anija e miqësisë", "Çka ëndërrojnë lulet", "Unaza magjike"; romanet "Ndodhitë e Hundëkarotës", "Aventurat mbi trotinetin e vjetër", përmbledhjet me tregime "Loti udhëtar", "Ishulli i lumturisë", "Guri i çmueshëm", "Plaku me violinë", "Përjetimet e bardhoshit" etj.



## Studim teksti

### Analizojmë poezinë

- 1 Përgjigjuni pyetjeve rreth poezisë:
  - a) Çfarë na vjen ndër mend kur përmendim shqiponjën? Çfarë simbolizon shqiponja?
  - b) Cilat karakteristika të shqiponjës e shtynë poetin të krijojë një poezi për të?
- 2 Në përshkrimin e shqiponjës, poeti ndalet veçanërisht në disa pjesë të trupit të saj. Analizoni çfarë funksioni kanë dhe ç'simbolizojnë secila prej tyre.
  - 📌 bebëzat e mbushura;
  - 📌 krahët;
  - 📌 zemra.
- 3 Në poezi përsëritet një strofë, në mënyrë pothuajse identike. Identifikojeni dhe analizoni nga ana kuptimore.
- 4 Sipas një hipoteze, shqiptarët mund ta kenë marrë emrin e tyre nga shqiponja. Çfarë tiparesh kanë vlerësuar ata te ky shpend, me të cilat identifikohen?

# Yjeve të pashuar

## Para leximit

Shqiptarëve u është dashur të luftojnë vazhdimisht për lirinë, vendin dhe integritetin e tyre. Rrugëtimi i popullit tonë është i përgjakshëm, sepse shpesh i është dashur të vetësakrifikohet për hir të çështjeve dhe idealeve më të rëndësishme. Vetëmohimi, sakrificat e të parëve dhe respekti për veprat e tyre janë motivi që gjallon edhe në poezinë e mëposhtme.

A ka njeri fisi që mund të mos dijë se pat  
Ndër gjyshërit tanë dhe stërgjyshërit –  
Burra, të cilët shtazërisht i munduan,  
Trima që i kalbën ndër pranga *ngujuar*,  
Nëpër *zindanet* e mallkuar  
Të *zaptuesve* të shumtë, që vinin e vanë  
E kurrë në paqe s'na lan?

Ka,  
Apo – nuk ka!

Atyre, pra – fjalën e krenarisë,  
Atyre – zjarrin e dashurisë!  
Burrave trima, ndër shekuj.

Atyre, që prore pësuan  
E vuajtën,  
U varën dhe u pushkatuan,  
Por s'u dorëzuan.  
Trimave që *u bënë fli*.  
Dëshmorëve që ranë për liri!

Atyre më të dhënë, të paepur  
që pa shpresë s'na lanë jo kurrë;  
atyre që luftuan duke derdhur gjak,  
që për popullin u sulën të marrin hak;  
atyre që ndër të parët – mjerimit i bënë ballë,  
që i nderojmë dhe përherë i kemi mall!



## Fjalor

*ngujuar* – mbyllur brenda.

*zindane* – dhoma të vogla e të errëta, qeli.

*zaptues* – pushtues.

*u bënë fli* – ranë dëshmorë, dhanë jetën.



**Esad Mekuli** (1916-1993) lindi në Plavë. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, gjimnazin në Pejë. Studimet i vazhdoi në Beograd, Zagreb e Itali. Për shumë vite me radhë drejtoi revistën "Jeta e Re". Ai ka dhënë një kontribut të rëndësishëm për zhvillimin e letërsisë shqipe. Ka botuar përmbledhjen me poezi "Për ty", "Dita e Re", "Avsha Ada", "Vjersha" etj. Është marrë edhe me përkthime të letërsisë artistike.

## Studim teksti

## Kuptojmë poezinë

- 1 Kujt i kushtohet poezia?
- 2 Cilat janë arsytet që poeti u kushton një poezi "atyre"?
- 3 Çfarë ndieni kur lexoni këtë poezi?
  - Dashuri.
  - Krenari.
  - Dhimbje.
  - Brengë.
  - Gëzim.
  - Trishtim, keqardhje.
  - Habi.

## Analizojmë poezinë

- 4 "Atyre" që u kushtohet poezia, poeti u drejtohet me disa emra. Gjejini dhe shkruajini në fletore.
- 5 Cili është mesazhi i kësaj poezie?
- 6 Si e interpretoni vargun e fundit: *i nderojmë dhe përherë i kemi mall?* Në ç'mënyrë i nderojmë ne poetët?

## Gjuha e poezisë

- 7 Strofa e parë ndonëse e përbërë nga shtatë vargje është e ndërtuar në një fjali të vetme. E tërë strofa është një pyetje retorike. Cili është funksioni emocional i kësaj pyetjeje?
- 8 Poezia krijon një ritëm të fortë të brendshëm nëpërmjet përsëritjes së fjalëve dhe rimës. Jepni shembuj për këto dy elemente.
- 9 Strofa e parë është një pyetje retorike që përfundon me pikëpyetje, ndërsa strofa e dytë është sërish një pyetje, por mbaron me pikëçuditje. Ç'kuptim transmetojnë në poezi këto shenja pikësimi?

## Reflektojmë rreth poezisë

- 10 Pyesni prindërit për sakrificat që kanë bërë shqiptarët ndër shekuj, për të mbrojtur lirinë dhe atdheun.
- 11 A mendoni se për lirinë ia vlen ç'dolloj sakrifice? Pse?

## Detyrë

-  Gjeni dhe lexoni poezi të tjera nga letërsia shqipe kushtuar të rënëve për liri.

# Të dua baltë shqiptare

## Para leximit

Në letërsinë shqipe ka shumë poezi kushtuar vendlindjes dhe atdheut. Kuteli ka arritur me mjeshtëri të thurë vargje mjaft emocionuese për baltën, e cila është ndër elementet identifikuese të identitetit etnik të poetit. Motivi i baltës është një motiv i hershëm, sipas të cilit, njeriu i parë është krijuar nga balta dhe pas vdekjes, ai mbetet përjetësisht pjesë e baltës. Poetë të ndryshëm e kanë quajtur simbolikisht njeriun si baltë vdekatore.



## Fjalor

*baltë* – 1. dhe i squllët; 2. lëndë, brumë për diçka; baltë e dobët (fig.) njeri jo i fortë. 3. tokë, truall, dhe; / poet. toka mëmë, atdheu.  
*gjer* – deri.  
*kam lerë* – kam lindur.  
*pelin* – 1. barishte shumë e hidhur, me lule të vogla të verdheme, që përdoret në mjekësi; për prodhimin e pijeve të ndryshme etj. 2. hidhërim i madh, helm.

Të dua baltë shqiptare,  
 Të dua egërsisht! Dëshpërimisht!  
 Si ujku pyllin,  
 si vala valën,  
 si *balta* baltën.  
 Se *gjer* mbi gju  
 jam brenda teje,  
 Se *lerë kam* këtu,  
 si baba, si gjyshi.  
 Të dua baltë shqiptare!  
 se gjer mbi bel,  
 e përmbi bel  
 jam brenda teje  
 s'dal dot  
 se s'dua!  
 Se ti më lidh  
 e më mban  
 me mjaltë  
 e me *pelin*.  
 Se këtu vdekur ka,  
 këtu,  
 nëna dhe baba e gjyshër-stërgjyshi.  
 Të dua baltë shqiptare  
 Magjistare  
 e ëmbël  
 si vetë vdekja,  
 se thellë jam këtu  
 brenda teje  
 gjer mbi gju,  
 gjer mbi bel  
 e gjer mbi krye.  
 Dhe dua fort të dehem  
 të prehem (ah që tani!) brenda teje.



## Studim teksti

## Kuptojmë poezinë

- 1 Lexoni vargjet dhe plotësoni tabelën e mëposhtme.
- Përse autori e krahason dashurinë e tij për baltën shqiptare me dashurinë e ujkut për pyllin, të valës për valën, të baltës për baltën? Si është kjo dashuri për të?
  - Cilët janë familjarët e poetit që prehen në baltën (tokën) shqiptare?
  - Cilat janë vargjet ku tregohet se autori është i lidhur edhe fizikisht me baltën shqiptare?

## Analizojmë poezinë

- 2 Cili është kuptimi i secilit prej vargjeve të mëposhtme? Qarkoni alternativat që ju duket se qëndrojnë dhe argumentoni zgjedhjen tuaj.

*Të dua egërsisht!/ Dëshpërimisht!/ Si ujku pyllin...*

- Për ujkun, mjedisi natyror është i pazëvendësueshëm. I tillë është edhe atdheu për poetin.
- Ujku në letërsi shfaqet kryesisht si një kafshë e egër dhe luftarake.
- Ashtu si ujku nuk jeton dot pa pyllin, ashtu edhe poeti nuk jeton dot pa atdheun e tij.

*Dhe dua fort të dehem/ të prehem/ (ah që tani!)/ brenda teje.*

- Poeti e sheh prehjen në baltën e vendit të vet si mundësi për të ritakuar veten dhe paraardhësit e tij.
- Poeti dëshiron të dehet nga pija dhe të llokoçitet për t'u zbavitur.
- Poeti dëshiron t'i turbullohet mendja, për të rënë në një gjendje shpirtërore të tillë, sa t'i duket sikur po prehet në tokën e tij.

*Të dua si balta baltën, si vala valën...*

- "Të dua si prindi fëmijën e vet".
- "Të dua si veten".
- "Të dua siç do njeriu të afërmin e vet".

## Gjuha e poezisë

- Përse autori përdor ndajfoljet *egërsisht* dhe *dëshpërimisht* për t'i thënë baltës *të dua*. Çfarë kuptimesh kanë këto ndajfolje dhe si mund të interpretohet vargu "Të dua egërsisht!/Dëshpërimisht!"?
- Përse balta konsiderohet si magjistare? Sinonim i fjalës *magjistare* është fjala çudibërëse. Komentoni këtë përzgjedhje të poetit.
- Flisni për llojin e strofave, vargut dhe rimës së poezisë. (Kujtoni: llojet e vargjeve përcaktohen nga numri i rrokjeve të tyre).
- Gjeni krahasimet që janë përdorur në këtë poezi. A i dëgjojmë shpesh këto krahasime në gjuhën e përditshme?

## Detyrë

- Shkruani një ese me temë "Të dua baltë shqiptare!"

# Leni lumejt...

## Para leximit

"Leni lumejt..." është një poezi lirike, në të cilën himnizohet spontaniteti dhe rrjedhshmëria e gjërave me qëllim gjetjen e ekuilibrit. Edhe nëpërmjet detajeve të konkretësisë, siç janë lumenjtë, detet, malet, edhe nëpërmjet ndjesive që përjetëson vajzat, edhe nëpërmjet ngjyrave të grunit, ullirit a faqeve të vashës, poeti i thur vargje natyrshmërisë, rrjedhës së spontanitetit. Natyra e Camajt nuk është përshkrim në një kohë të përcaktuar, koha në poezi nuk ikën me shpejtësi dhe as qëndron në vend. Çdo gjë do të rrjedhë dhe çdo gjë do të shkojë në vendin e vet.



Leni lumejt të derdhen të gjithë në Adrie  
dhe në detin Jon  
e rrezja të lodrojë me valë  
për kënaqje të zemrës e të mendës sonë.  
Vashat t'i lagun kambët n'ujë  
para syve tonë të qartë.

Ngjyra e grunit dhe e ullinit  
t'u shihet në faqe e në bebëzat e synit  
dhe kulmi i shpisë të jetë *bungu*  
e pragu guri.

Kur të ulen valët  
fryma jonë do të matet  
me gjansinë e detit: atëhere  
do të pushojmë  
te kambët e bjeshkve të bardha.



## Fjalor

*bungu* - lloj dushku i lartë e i trashë,  
me kurorë të gjerë.



**Martin Camaj** lindi më 21 korrik 1925. Ai mori edukim klasik në Kolegjin Saverian të Shkodrës, të drejtuar nga etërit jezuitë. Më vonë, për shkak të vendosjes së regjimit komunist në Shqipëri, Camaj arratiset dhe vendoset në ish-Jugosllavi, ku ia del të regjistrohet si student në Universitetin e Beogradit. Më pas shkon në Romë, ku studion sërish dhe, nën kujdesin e Koliqit, Camaj bëhet kryeredaktor i revistës "Shejzat" (1957-1975) dhe studion nga afër botën arbëreshe.

Më 1961 vendoset në Mynih të Gjermanisë, ku u bë profesor i gjuhës dhe i letërsisë shqipe në Universitetin e Mynihut. Ai është edhe një ndër albanologët më të shquar, duke spikatur me punimet e tij mbi gjuhën shqipe.

## Studim teksti

## Kuptojmë poezinë

- 1 Përgjigjuni pyetjeve rreth poezisë:
  - a) Camaj shpesh etiketohet si poet i malit. Në poezinë e mësipërme, a e justifikon një etiketim të tillë apo e thyen?
  - b) Camaj është poeti, i cili gjithmonë ruan në poezinë e vet elementet e vendit të tij. Cilat janë këto elemente?
  - c) Poeti beson në rendin e gjërave, që me kalimin e kohës krijojnë një ekuilibër. Në cilin prej vargjeve e shpreh Camaj besimin e tij se, në një moment, gjithçka do të jetë e qetë dhe do të pushojë?

## Analizojmë poezinë

- 2 Nëpërmjet vargjeve: *Ngjyra e grunit dhe e ullinit / t'u shihet në faqe e në bebëzat e synit*, autori synon të tregojë:
  - a) humbjen e identitetit të njeriut;
  - b) identifikimin e njeriut me natyrën.
- 3 Përcaktoni kohën për të cilën flet Camaj në këtë poezi.
  - a) e tashmja
  - b) e shkuara
  - c) përjetësia
- 4 Camaj kërkon që gjërat të ndryshojnë dhe të gjendet qetësia e humbur. Si mendoni se gjendet ajo:
  - a) koha të ecë me shpejtësi;
  - b) koha të rrjedhë me qetësinë e asaj që është e pashmangshme.
- 5 Gjeneroni kontrastet në poezinë e mësipërme.

## Detyrë

- 📖 Lexoni në klasë edhe poezi të tjera të Camajt dhe diskutoni për gjuhën që përdor në to.

## Bashkëbisedojmë

Zgjidhni dy nga nxënësit/et e klasës që recitojnë më bukur. Njëri/a prej tyre e lexon poezinë të plotë dhe gjithë të tjerët e dëgjojnë pa e ndërprerë.

Nxënësi/ja tjetër e lexon poezinë pjesë-pjesë, duke u ndalur në vargjet që atij i pëlqejnë më shumë.

Pas kësaj, diskutoni duke iu përgjigjur pyetjeve:

- 📖 Çfarë emocionesh ju zgjon kjo poezi?
- 📖 Cilat janë vargjet që ju bënë më shumë përshtypje? Pse?
- 📖 A do ta këshillonit për lexim këtë poezi?
- 📖 Kujt do t'ia këshillonit? Përse?
- 📖 Si mendoni, çfarë melodie mund të vendosej në sfond gjatë recitimit të kësaj poezie?

# Besëlidhja shqiptare

## Para leximit

Fragmenti i mëposhtëm është shkëputur nga drama historike "Besëlidhja shqiptare". Në këtë dramë trajtohet një nga periudhat më tragjike të popullit shqiptar. Perandoria turke, e cila kishte shekuj që i mbante të pushtuara trojet shqiptare, po shkatërrohej. Në një situatë të tillë, rreziku i copëtimit të trojeve shqiptare ndërmjet vendeve fqinje ishte shumë i madh. Të gjendur në këto kushte, shqiptarët bashkohen në mbrojtje të lirisë e të identitetit kombëtar, duke harruar çdo lloj ndasie dhe konfliktesh personale. Në kuvend flasin udhëheqësit shpirtërorë të popullit, të cilët nëpërmjet bashkimit synojnë ta shpëtojnë atë nga fati tragjik që po përgatitej në kurriz të tij.

**SYLA:** (pas një pauze) Çdo shtëpi ka një të parë, edhe trualli një pleqnar! Fol, Abdyl Frashëri!

**NGA SALLA:** Fol Abdyl Frashëri! Fol!

**ABDYLI:** Fjalën time e thashë! Dy-tri ditë na ndajnë nga Kongresi i Berlinit! Asgjë të mirë, të gjitha të këqijat priten nga vendimet e atij Kongresi! Të lidhemi me besa-besë! Të vdesim duke luftuar, të mos rrojmë duke u zvarritur!

**YMERI:** Të lumtë, Abdyl Frashëri!

**NGA SALLA:** Të lidhemi me besa-besë! Të lidhemi me besa-besë!

**ABDYLI:** (shkruesit) Gjon Thaçi!

**GJONI:** Urdhëroni, Abdyl Frashëri!

**ABDYLI:** Shkruaj! Njohja e kombit shqiptar si një dhe i pandarë!  
a) respektimi kundrejt tij i parimit të kombësisë në të gjitha drejtimet;  
b) ruajta e paprekshmërisë dhe e tërësisë së trojeve kombëtare shqiptare;  
c) bashkimi i tokave të Shqipërisë në vilajet të vetëm, siç ka qenë tërë jetën Shqipëria, me administratë shqiptare, me gjuhë shqipe e kryeqendrën e vet!

**PASHKO:** Të hapen shkollat shqipe në qytet dhe në fshatra!

**MICI:** (i ekzaltuar.) Ah, mor vëllezër, padishahu nuk njeh letra, nuk na jep me të mirë ato që kërkojmë! Fuqitë e Mëdha nuk duan të dëgjojnë fjalën tonë. Le të dëgjojnë krismën e armëve.



**Sulejman Krasniqi** ka lindur në Hoçë të Vogël, të Rahovecit. Mësimet e para dhe ato të mesme i kreu në vendlindje. Për shkak të atdhedashurisë dhe pikëpamjeve të tij përparimtare, regjimi serb e burgosi. Për këtë arsye ai u vendos në Shqipëri, ku kreu studimet në degën Gjuhë dhe letërsi shqipe, në Universitetin e Tiranës. Në vitin 1981, ai u vlerësua me "Çmimin e Republikës" për librin që i kushtoi heroit Bajram Curri. Veprat e tij më të njohura janë: "Tri motra, tri histori", "Në shpellën e banditëve", "Qielli i përflakur", "Mic Sokoli", "Oso Kuka", "Belbacakja", "Rrëfimet e majorit", "Rebeli i bajraqeve", "Besëlidhja shqiptare" etj.



**ABDYLI:** Puna është të krijojmë Besëlidhjen Shqiptare! Do t'i vijë koha edhe asaj që thua ti, Mic!

**SYLA:** Të hiqet nga fuqia ligji i Portës së Lartë, që ua ndalon shqiptarëve mbajtjen e armëve! Lidhja Shqiptare të ketë ushtrinë e vet!

**ZËRA:** Kërkesë me vend!

**HAXHIU:** Të pajtohen gjaqet!

**YMERI:** Sa herë *vatani* është gjendur në rrezik, kanuni i gjaqeve ka pushuar së vepruari! Të shuhet hasmëritë midis fiseve, krahinave, katundeve, familjeve! Ky ka qenë dhe do të mbetet zakoni ynë i vërtetë!

**HAXHIU:** Ç'thua, Xhemë Bungu? Burrërinë tënde duhet ta tregosh në këtë Kuvend!

**XHEMA:** (*Ngrihet i murrëtyer, flet kokulur.*) Po nipit tim të vrrarë nga Ngallicajt ende i kullojnë plagët, more trima! (*Të gjithë shikojnë nga Xhemë Bungu*)

**YMERI:** Xhemë Bungu, përpara tridhjetë e nëntë vjetësh ti e zbraze pushkën e parë kundër *Tanzimatit*! Shkrepe edhe sot!

**XHEMA:** Aih, burra! A bash tek unë qenka lidh nyja e gjaqeve, a?

**YMERI:** Zgjidhe ti këtë nyje, Xhemë Bungu!

**HAXHIU:** Falja, Xhemë Bungu!

**XHEMA:** (*Psherëtin*) E rëndë qenka, bre burra! Fort ngushtë më keni zënë!

**SYLA:** Bëje këtë për hir të vatanit, Xhemë Bungu!

**ABDYLI:** Për hir të Shqipërisë, Xhemë Bungu!

**XHEMA:** Ih, burra! Falë i qoftë gjaku i nipit tim!

**YMERI:** Paç faqen e bardhë, Xhemë Bungu!

(*Në sallë dëgjohen pëshpërima.*)

(*Cen Ngallicaj i afrohet Xhemës, qëndron kokulur.*)

**CENI:** Paç faqen e bardhë, Xhemë Bungu! Me punë të fisme e tregove se je më burrë se kushdo tjetër! (*i zgjat koburen*) Hë mbaje!

**XHEMA:** (*Refuzon duke shtyrë koburen me kurrizin e dorës.*) Jo, mbaje, Cen Ngallica! T'u bëftë top për vatanin!

**CENI:** Tetëdhjetë pushkët e fisit tim do të jenë luftëtarë të Besës shqiptare! Nusët dhe cucat e Ngallicajve le të jenë motrat e Bungëve. (*Përqafohen*)

**ABDYLI:** Trima, të lidhemi me besa-besë!



## Fjalor

*pleqnar* – Ai që ishte zgjedhur në kryer të punëve të fshatit etj.

*vatan* – atdhe.

*i murrëtyer* – i vrenjtur.

*Tanzimat* – emri i një reforme që ndërmori Perandoria Osmane dhe që pati pasoja negative mbi shqiptarët.

## Teksti dramatik

Gjinia dramatike përfshin brenda saj tragjedinë, komedinë dhe dramën. Drama është një lloj i veçantë letrar, më e afërt me tragjedinë sesa me komedinë, megjithatë, ajo nuk synon domosdo një stil të madhërishtëm, as përfundim tragjik, domethënë vdekjen e heroit, si zgjidhje të vetme (siç ndodh në tragjedi). Dramat karakterizohen nga tensioni, pa synuar të shkaktojnë përqesim maksimal të fatit tragjik, duke ruajtur gjithsesi seriozitetin e duhur të veprës. Heroi i dramës është një individ, i cili e ndien thellësisht vuajtjen dhe lufton me gjithë shpirt për të zgjidhur problemet e mëdha të jetës. Teksti dramatik është i përbërë nga: dialogu, monologu dhe didaskalitë.

## Studim teksti

## Kuptojmë tekstin

## 1 Përgjigjuni pyetjeve rreth tekstit.

- ▣ Në ç'kohë dhe në ç'vend zhvillohet ngjarja e përshkruar në këtë pjesë?
- ▣ Cilat janë personazhet që marrin pjesë?
- ▣ Përse janë mbledhur këta njerëz së bashku?
- ▣ Cilat janë qëllimet e Besëlidhjes, që i shpreh Abdyl Frashëri?
- ▣ Po Pashko, cilën kërkesë shton?
- ▣ Çfarë i kërkohet Xhemë Bungut?

## Analizojmë tekstin

- 2 Cilat janë ngjarjet historike që përmenden në tekst?
- 3 Kush janë personazhet historike? Po ato të krijuara?
- 4 Cilat janë tiparet që e karakterizojnë Abdyl Frashërin, duke u nisur nga ato që thotë në këtë skenë?
- 5 A mendoni se e ka të lehtë Xhema të bëjë atë që i kërkohet? Argumentoni përgjigjen.

## Didaskalitë

Në studimet teatrale, didaskali konsiderohet çdo gjë e shkruar brenda një vepre dramatike që nuk thuhet drejtpërdrejt nga personazhet e dramës. Kuptimi i fjalës *didaskali* vjen nga greqishtja e lashtë dhe do të thotë mësim, udhëzim. Zakonisht didaskalitë shkruhen mes kllapash, ndërsa në këtë pjesë, autori ka përdorur edhe shkrimin e pjerrët.

## Interpretojmë tekstin

- 6 Pjesëtarët e kuvendit kërkojnë që në një situatë të tillë, të falen gjaqet, shqiptarët të mos vriten me njëri-tjetrin. Çfarë synon kjo kërkesë?
- 7 Xhemë Bungu i refuzon koburen Cen Ngallicajt, të cilit i ka falur gjakun duke i thënë "Tu bëftë top për vatanin!". Si e shpjegoni këtë veprim dhe këto fjalë?
- 8 Çfarë dini rreth ngjarjes historike që përshkruhet në këtë skenë?

## Gjuha e tekstit

- 9 Dalloni në këtë pjesë didaskalitë nga fjalët e personazheve dhe shpjegoni rolin e tyre.
- 10 Rilexoni pjesën ku përmendet disa herë fjalia: "Të lidhemi me besa-besë!". Shpjegoni çfarë sjell kjo përsëritje.

## Detyrë

- ▣ Luani pjesën në role.

# I sëmuri për mend

## Para leximit

"I sëmuri për mend" është komedia e fundit e Molerit, të cilën e vuri në skenë më 1673. Ai vdiq mbas shfaqjes së katërt të kësaj komedie. Në qendër të kësaj komedie është Argani, një njeri i pasur që megjithëse me shëndet të mirë, jeton me frikën e sëmundjeve. Ai është i rrethuar nga mjekë sharlatanë, të paaftë, por edhe mashtrues e përfitues. Ata e kanë kuptuar maninë e Arganit për shëndetin dhe i japin atij mjekime pa fund, të shoqëruara me fatura të majme. Sëmundjet imagjinare e tjetërsojnë karakterin e Arganit, duke e shndërruar në një skllav të mjekëve dhe të farmacistëve. Duke vendosur sëmundjet në qendër të gjithçkaje, ai humb çdo lidhje me realitetin dhe u kundërvihet edhe vajzave të tij. Dashuria e vëllait të tij, Beraldit dhe e shërbëtores besnike Tuaneta, do ta ndihmojnë që të lirohet nga frika e tij, nga mjekët, dhe të kuptojë cilët janë njerëzit që e duan vërtet.

## SKENA VII

### ARGANI, BERALDI, TUANETA

**TUANETA** – (Arganit) Zotëri, ka ardhur një mjek dhe kërkon të takohet me ju.

**ARGANI** – Cili është ai mjek?

**TUANETA** – Një mjek i mjekësisë.

**ARGANI** – Cili është, të pyes?

**TUANETA** – Ku e njoh unë, po më ngjet aq shumë mua, sa sikur më ke prerë kokën e ia ke vënë atij.

**ARGANI** – Pa thuaji të vijë, moj, thuaji të vijë!

(Tuaneta del të vishet me një bluzë mjeku)

[...]

## SKENA XIII

### ARGANI, BERALDI, TUANETA si mjek ...

**TUANETA** – Më falni, zotëri, që u vonova pak!

**ARGANI** – (Me zë të ulët, Beraldit) Epo, një mrekulli është kjo!

**TUANETA** – Ju lutem të mos ma merrni për të keq, zotëri, kureshtjen që më shtyu të shoh një të sëmure kaq të dëgjuar, siç jeni ju dhe besoj se, meqë jeni i famshëm, do të më falni për guximin që mora.

**ARGANI** – Ju jam shumë mirënjohës, zotëri.

**Molier** (1622-1673) është pseudonimi letrar i Jean-Baptiste Poquelin. Për pesëmbëdhjetë vjet me radhë drejtoi një grup komedianësh shëtitës. Në vitin 1659 u vendos në Paris, ku i mbrojtur nga Luigji XIV, shkroi dhe shfaqti shumë komedi për të zbavitur oborrin mbretëror dhe publikun parisian. Disa nga veprat e tij kryesore janë: "Shkolla e grave", "Don Zhuani", "Mizantropi", "Koprraci", "Tartufi", "Borgjezi fisnik" etj. Molieri konsiderohet model në krijimin e komedive të karakterit dhe të zakoneve njerëzore.



### Komedia

Komedia është lloj i gjinisë dramatike, ku përqeshen, goditen dhe vihen në lojë veset e të metat njerëzore e shoqërore. Përmes ironisë dhe sarkazmit goditen dukuritë e shëmtuara: mendjemadhësia, lakmia, etja për pushtet, paturpësia, marrëzia etj. Ndryshe nga tragjedia, që përfundon me dhimbje, me vdekjen e personazhit, komedia zakonisht, mbaron në mënyrë të gëzueshme. Kur komedia kritikon dukuri ose karaktere duke i përqeshur keq dhe duke i dënuar rreptë, kemi satirë. Kur ndaj dobësive dhe të metave njerëzore flitet me mirëkuptim dhe pa dëshirë që t'i dënojë, kemi të bëjmë me humor. Në disa raste, komikja dhe satira ngrihen në një nivel të tillë, ku karakteret e caktuara jepen me një formë shumë të shtrembëruar, të shëmtuar, aq sa komikja ecën midis së qeshurës e seriozes. Në këtë rast kemi të bëjmë me groteskun.

**TUANETA** – E shoh se po më vështroni me vëmendje të madhe, zotëri, sa vjeç besoni të jem?

**ARGANI** – Besoj se mund të jeni shumë-shumë njëzet e gjashtë, njëzet e shtatë vjeç.

**TUANETA** – Ha! Ha! Ha! Ha! Jam plot nëntëdhjetë vjeç.

**ARGANI** – Nëntëdhjetë vjeç?!

**TUANETA** – Po, po, nëntëdhjetë vjeç. E shikoni se sa të freskët e të fuqishëm më kanë mbajtur të fshehtat e mjekësisë që i di vetëm unë?

**ARGANI** – Për besë, ja një plak i bukur nëntëdhjetë vjeç që duket fare i ri.

**TUANETA** – Unë jam një mjek shëtitës, që shkoj qytet më qytet, krahinë më krahinë, mbretëri më mbretëri, që të gjej punë të mëdha për zotësinë time, të sëmure që meritojnë të merrem me ta, te të cilët të mund të ushtroj të fshehtat e mëdha e të bukura që kam zbuluar në mjekësi. Unë as që pranoj të merrem me ato sëmundjet e zakonshme dhe pa rëndësi, siç janë reumatizmat dhe artritet, ethet dhe dhembjet e kokës e një tog gjërash të tilla të vogla. Unë dua të kem të bëj me sëmundje të rëndësishme, me ethe të forta e të paprera që shkaktojnë tronditje në tru, me ethe skarlatine, me murtajën, me hidropizi të rënda, me plevite të forta, me pneumoni; këto më pëlqejnë mua, në këto sëmundje e tregoj zotësinë time; dhe do të desha, zotëri, t'i kishit të gjitha këto sëmundje që përmenda, të ishit braktisur, nga të gjithë mjekët, pa shpresë shërimi, në agoni, që t'ju tregoja se sa i shkëlqyer është mjekimi im dhe sa më pëlqen t'ju mjekoj.

**ARGANI** – Ju falem nderit shumë, zotëri, që silleni kaq mirë me mua.

**TUANETA** – Më jepni dorën t'ju shoh pulsën. Hajde! Rri mirë, të thashë, se nuk shkojnë nazet tek unë! More, po ky puls paska luajtur mendsh! Duket që nuk më njeh akoma. Cili është mjeku juaj?

**ARGANI** – Zoti Pyrgon.

**TUANETA** – Ky njeri nuk është në listën e njerëzve të mëdhenj! Epo, ç' thotë ai, ç' sëmundje të ka gjetur?

**ARGANI** – Ai thotë se vuaj nga mëlçia e zezë, kurse të tjerët thonë nga shpretka.

**TUANETA** – Ata nuk marrin erë fare nga mjekësia, ju vuani nga mushkëritë.

**ARGANI** – Nga mushkëritë?

**TUANETA** – Pooo. Pa më thoni, çfarë ndieni?

**ARGANI** – Kohë më kohë, ndiej një dhembje në kokë.

**TUANETA** – Tamam, mushkëritë.

**ARGANI** – Nganjëherë, më duket sikur më kanë zënë perde sytë.

**TUANETA** – Mushkëritë.

**ARGANI** – Herë-herë, ndiej dhembje këtu, në zemër.

**TUANETA** – Mushkëritë.

**ARGANI** – Nganjëherë, sikur më këputen këmbë e duar.

**TUANETA** – Mushkëritë.

**ARGANI** – Ka raste që më dhemb aq shumë barku, sikur kam kolit.

**TUANETA** – Mushkëritë. Keni oreks, apo jo?

**ARGANI** – Po, zotëri.

**TUANETA** – Mushkëritë. Ju pëlqen të pini nga pak verë?

**ARGANI** – Po, zotëri!

**TUANETA** – Mushkëritë. A nuk dremitni nga pak, pasi hani bukë, dhe a nuk ju pëlqen të flini?

**ARGANI** – Po, zotëri.

**TUANETA** – Mushkëritë, mushkëritë ju thashë. Po mjeku ç'ju ka këshilluar të hani?

**ARGANI** – Më ka këshilluar të ha supë.

**TUANETA** – Injoranti!

**ARGANI** – Mish pule.

[...]

**ARGANI** – Vezë të freskëta.

**TUANETA** – Injoranti!

**ARGANI** – Dhe në mbrëmje, më ka thënë, të ha kumbulla të thata, që të lahen mirë zorrët.

**TUANETA** – Injoranti!

**ARGANI** – Po më ka këshilluar sidomos që verën ta pi gjysmë përgjysmë me ujë.

**TUANETA** – *Injorantus, injoranta, injorantum!* Verën ju duhet ta pini pa ujë fare dhe, që t'ju trashet pak gjaku, sepse e keni shumë të hollë, duhet të hani mish lope, mish derri të trashë, djathë Holande, bollgur, pilaf, gështenja, ëmbëlsira, që t'ju mpikset e t'ju trashet gjaku. Mjeku juaj është budalla. Do t'jua dërgoj unë mjekun që ju duhet juve. Le që, sa kohë që të jem unë në këtë qytet, do të vij t'ju shoh vetë herë pas here.

**ARGANI** – Nuk e di se si do të mund t'jua shpërblej.

**TUANETA** – Po këtë krah, ç'e doni që ma mbani?

**ARGANI** – Si?

**TUANETA** – Po të isha në vend tuaj, do ta kisha prerë menjëherë atë krah.

**ARGANI** – E pse?

**TUANETA** – Nuk e shikoni se si ai ia merr gjithë ushqimin krahut tjetër?

**ARGANI** – E shoh, e shoh, po mua më duhet krahu.

**TUANETA** – Po atë synë e djathtë, pse nuk e nxirrni? Unë, të isha si ju, do ta kisha nxjerrë me kohë.

**ARGANI** – Të nxjerr synë?

**TUANETA** – Nuk e dini se ai nuk e lë të shohë mirë këtë tjetrin dhe i rrëmben gjithë ushqimin? Besomëni mua, nxirrreni sa më parë, se do të shihni shumë më kthjellët me syrin e majtë.



**ARGANI** – Nuk na nxiton gjë për atë punë.

**TUANETA** – Tungjatjeta, më vjen keq që po ju lë, po duhet të shkoj në një konsultë të madhe mjekësh, që do të bëhet për një njeri që vdiq dje.

**ARGANI** – Për një njeri që vdiq dje?

**TUANETA** – Po, po, të shohim se ç'duhej t'i qe bërë që të shërohej. Tungjatjeta!

**ARGANI** – Më falni, zotëri, ju e dini se të sëmuret nuk janë në gjendje t'i përcjellin ata që vijnë i shohin.

## Studim teksti

### Kuptojmë tekstin

#### 1 Përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme.

- ▣ Në këtë skenë vjen një mjek i panjohur për Arganin. Kush e prezanton atë para tij?
- ▣ Ç'lojë ka përgatitur Tuaneta për zotërinë e saj?
- ▣ A vëren Argani ndonjë lidhje mes Tuanetës dhe mjekut të sapoardhur? Pse nuk është në gjendje të kuptojë që bëhet fjalë për të njëjtin person?
- ▣ Sipas mjekut të sapoardhur, cili organ i trupit të Arganit ishte i sëmurë?
- ▣ Çfarë këshillash "mjekësore" i jep Arganit ai? A i jep ndonjë ilaç?
- ▣ Zbuloni shkaqet pse Argani shfaqet aq i çuditur dhe i frikësuar pas largimit të mjekut të rremë.

### Analizojmë tekstin

- 2 Renditni emrat e personazheve në fragment. Cili prej personazheve ka vetëm një rol?
- 3 Analizoni sjelljen e Arganit dhe mënyrën se si është tjetërsuar prej fiksimit të tij nga sëmundjet.
- 4 Tuaneta, e maskuar si mjek, shqipton fjalët "*Injorantus, injoranta, injorantum!*". Pse hiqet ajo sikur po flet në latinishte?
- 5 Gjeni në tekst momentin kur Argani frikësohet, gjë që e bën t'i thërrasë mendjes, duke e bërë lexuesin/en sa të qeshë, aq edhe të trishtohet për të.
- 6 Tuaneta e maskuar si mjek e quan zotërinë e saj "të sëmurë kaq të dëgjuar" dhe "të famshëm". Cilat janë arsyet?
- 7 Pse Tuaneta krijoi një skenë të tillë? A filloi të dyshonte Argani për vërtetësinë e atyre që thonë mjekët?

### Gjuha e tekstit

- 8 Pasi ta keni lexuar disa herë tekstin me kujdes, gjeni situatat, batutat, veprimet, të cilat krijojnë humor dhe çtensionojnë situatën, që Argani e paraqet si dramatike.
- 9 Batutat që ata shkëmbejnë me njëri-tjetrin, janë të gjata apo të shkurtra? Çfarë tregon kjo në lidhje me ritmin e ngjarjeve?

### Detyrë

- ▣ Luajeni në klasë komedinë në role.

# Krijesat e pazakonta

## Para leximit

Eksploruesi dhe magjizoologu Njut Skamandër sapo ka mbërritur në Nju Jork, pas një udhëtimi rreth botës në kërkim të krijesave magjike më të rralla dhe të pazakonta. Por kur valixhja e tij magjike hapet gabimisht nga Xhejkob Kovalski, disa nga kafshët fantastike të Njutit arratisen nëpër qytet dhe telashet nisin për të gjithë. Xhejkobi është një veteran (dhe jomagj), i cili dëshiron të hapë një furrë buke dhe ëmbëltore. Një nga kafshët magjike e kafshon Xhejkobin në qafë. Tina Golldstin, një shtrigë e re, ish-punonjëse në ministrinë e magjisë të ShBA-së, përpiket që t'i vijë në ndihmë Njutit për të ndrequr rrëmujën e krijuar. Tina i merr në shtëpinë e saj Xhejkobin dhe Njutin, të cilët aty takojnë Kuini Golldstinin, motrën e bukur dhe të paturpshme të Tinës, e aftë të lexojë mendimet.

## SKENA 39

*Jashtë. Rrugë me ndërtesa ngjyrë tulle; pak çaste më pas – muzg.*

**TINA** dhe **NJUTI** ecin duke e mbajtur **XHEJKOBIN** nga të dyja anët, që të mos bjerë.

**TINA:**

Kthehu këtu në të djathtë...

**XHEJKOBI** lëshon herë pas here tinguj dhe zhurma sikur nga çasti në çast do t'i plasë e vjella. Duket qartë se kafshimi që mori në qafë po fillon t'i shfaqë efektet gjithnjë e më shumë.

Me të marrë kthesën, **TINA** i detyron të fshihen pas një kamioni të madh. Prej këndeje, ajo përgjon një nga shtëpitë në anën tjetër të rrugës.

**TINA:**

Përpara se të hyjmë, duhet ta dini se nuk më lejohet të fus meshkuj në shtëpi.

**NJUTI:**

Meqë qenka kështu, unë dhe zoti Kovalsi e kemi shumë të thjeshtë të kërkojmë një vend tjetër për të fjetur...

**J. K. Rowling** (1965), shkrimtare dhe skenariste. Është autorja e serisë së librave "Harry Potter", e dashur dhe e vlerësuar në të gjithë botën për librat e saj për fëmijë. Vepra "Kafshët fantastike dhe ku mund të gjenden" është një ndër veprat shoqëruese të serisë së Herri Poterit, që përshkruan krijesat magjike që gjenden në universin e Herri Poterit. Kjo vepër përmendet si një ndër tekstet e shkollës së magjisë të vetë Herrit. Skenari i kësaj vepre është bërë edhe film.





**TINA:**

Oh jo, jo, as që bëhet fjalë!

TINA e kap me shpejtësi XHEJKOBIN nga krahu dhe e tërheq matanë rrugës. NJUTI detyrohet ta ndjekë.

**TINA:**

Kini kujdes ku vini këmbën.

## SKENA 40

*Brenda. shkallët që të çojnë në apartamentin e Golldstinëve – muzg.*

NJUTI, TINA dhe XHEJKOBI ngjisin shkallët në majë të gishtave. Sapo mbërrijnë në sheshpushimin e katit të parë, dëgjojnë zërin e pronares së shtëpisë, zonjës ESPOSITO. Që të tre nuk lëvizin.

ZONJA ESPOSITO (J.S.):

TINA ti je?

**TINA:**

Po, zonja Esposito.

ZONJA ESPOSITO (J.S.):

Je vetëm?

**TINA:**

Unë gjithmonë vetëm jam, zonja Esposito.

Pauzë.

## SKENA 41

*Brenda. Apartamenti i Golldstinëve. Dhoma e ndenjjes – muzg.*

*Të tre hyjnë në apartamentin e GOLLDSTINËVE.*

*Edhe pse e varfër, banesa ka një ngrohtësi magjike. Në një qoshe,*



hekuri punon vetë, ndërsa pranë zjarrit një varëse rrobash lëkundet mbi këmbët e saj të drunjta, ku janë duke u tharë disa të brendshme. Përreth ka revista të shpërndara: “Miku i magjistares”, “Magjistarja moderne” dhe “Shndërrimi Sot”.

KUINI, një vajzë bionde, ndoshta vajza më e bukur shtrigë, e veshur me një këmishë nate prej mëndafshi, është duke parë se si po qepet vetvetiu një fustan i vendosur në një manekin rrobaqepësi. XHEJKOBI mbetet pa mend.

NJUTI as që i vë re të gjitha këto që po e mahnitin XHEJKOBIN. Ai pret me padurim sa të largohet. Kokën e mban vjedhurazi nga dritarja.

**KUINI:**

Tina... Hëm, ke filluar të sjellësh meshkuj në shtëpi?

**TINA:**

Zotërinj, kjo është motra ime.

Them se duhet të hedhësh diçka krahëve, si thua Kuin?

**KUINI:**

(aspak e shqetësuar)

Oh, sigurisht.

KUINI e kalon shkopin e saj magjik mbi manekin dhe fustani përnjëherë rrëshqet deri te trupi i saj. XHEJKOBIT i ikën truri.

TINA, e bezdisur fillon të rregullojë shtëpinë.

**KUINI:**

Kush janë këta pra?

**TINA:**

Ky është z. Skamandër. Ka bërë një shkelle të rëndë të Statutit Kombëtar të Fshehtësisë.

**KUINI:**

(i bën shumë përshtypje)

Uaa, domethënë qenka një kriminel?

**TINA:**

Ëhë. Dhe tjetri është zoti Kovalski.

Ai është një *jomagj*.

**KUINI:**

(papritur e shqetësuar)

Një jomagj? Tin, çfarë je duke *kurdisur* kështu?

**TINA:**

Është sëmure. Histori e gjatë. Zotit Skamandër i ka humbur diçka dhe unë po e ndihmoj që ta gjejë.



XHEJKOBIT *i merren këmbët. Është i mbytur në djersë dhe me një çehre të keqe. KUINI nxiton drejt tij, po ashtu edhe TINA. Të dyja të shqetësuara mundohen ta ndihmojnë.*

**KUINI:**

*(ndërkohë që XHEJKOBI lëshohet prapa një divani)*

Duhet të ulesh, zemër.

*(duke i lexuar mendimet)*

S'ka vënë gjë në gojë gjithë ditën.

Dhe...

*(duke i lexuar mendimet)*

Oh! Ç'gjë e shëmtuar!

*(duke i lexuar mendimet)*

Nuk i dhanë para për të hapur pastičerinë e tij. Jeni një pastičier?

Mua më pëlqen shumë të gatuj.

NJUTI vështron KUININ *që prej vendit ku po qëndron pranë dritares.*

*Duke dëgjuar bisedën, i zgjohet kureshtja shkencore.*

**NJUTI:**

Qenke një *Leximagje*?

**KUINI:**

Mh-hm, po... Por kam pasur gjithmonë probleme me ju... britanikët, për shkak të theksit.

**XHEJKOBI:**

*(duke filluar të kuptojë, i tronditur)*

Ju mund ta lexoni... mendjen?

**KUINI:**

Oh... mos u shqetëso, i dashur. Shumica e meshkujve kështu mendojnë, kur më shohin për herë të parë.

KUINI *lëviz me shaka shkopin drejt XHEJKOBIT.*

**KUINI:**

Por tani ju duhet të hani.

NJUTI *sheh jashtë dritares dhe dallon Billiugin. NJUTI është i shqetësuar dhe i paduruar për të gjetur kafshët e tij.*

TINA dhe KUINI *nisin të gatujnë në kuzhinë. Përbërësit fluturojnë jashtë rafteve dhe KUINI me magji i shndërron në ushqim – karotat e mollët qërohen vetë, petët hapen vetvetiu dhe tigani vihet vetë në zjarr.*

**KUINI:**

(TINËS):

Prapë *hotdog* do të hash?



## Fjalor

*jomagj* – njeri që nuk bën ose nuk merret me magji; jomagjistar.

*hotdog* – salsiçe e skuqur, e vendosur brenda një panineje.

*kurdis* – bëj që të fillojë një punë a një veprim; thur kundër dikujt intriga, një komplot etj.

*leximagje* – magjistare që lexon mendjet e të tjerëve.

**TINA:**

Mos ma lexo mendjen.

**KUINI:**

Nuk është ushqim shumë i shëndetshëm.

TINA drejton shkopin nga raftet e kuzhinës. Pjatat, *takëmet* e ndryshme dhe gotat dalin fluturimthi dhe me një goditje të shkopit magjik, vendosen mbi tavolinë. XHEJKOBI, edhe i mahnitur edhe i frikësuar, afrohet në tavolinë duke u lëkundur.

PAMJE e NJUTIT, i cili e ka vendosur dorën mbi dorezën e derës.

**KUINI:**

(me çiltërsi)

Ej, Zoti Skamandër, preferon tortë apo *strudel*?

Të gjithë shohin NJUTIN i cili, i zënë ngushtë, heq dorën nga doreza e derës.

**NJUTI:**

Çfarë të duash.

TINA shikon ngultas NJUTIN. Ajo duket agresive, por edhe e zhgënjyer dhe e fryer njëkohësisht.

XHEJKOBI është rehatuar në tavolinë dhe po fut pecetën në jakën e këmishës.

**KUINI:**

(duke i lexuar mendimet XHEJKOBIT)

Ju besoj se dëshironi strudel, apo jo i dashur? Pra për ju, strudel!

XHEJKOBI pohon me kokë, i entuziazmuar, KUINI, e lumtur, ia kthen me buzëqeshje.

Me një goditje të shkopit KUINI nxjerr fluturimthi në ajër rrushin e thatë, mollët dhe petët. Përbërësit *pleksen* me kujdes në formën e një cilindri dhe nisin të piqen vetë aty ku janë, madje me forma zbukuruese, dhe më në fund spërkatën me sheqer pluhur. XHEJKOBI merr frymë thellë, i kënaqur. Ndodhet në parajsë!

TINA ndez qirinjtë mbi tavolinë. Darka është gati!

PAMJE E NGUSHTË, brenda në xhepin e NJUTIT. Dëgjohet një *angullimë* e lehtë dhe më pas shfaqet koka kureshtare e PIKITIT.

**TINA:**

Epo, zoti Skamandër ejani uluni, ju lutem. Nuk do t'ju helmojmë.

NJUTIT, ende pranë derës së jashtme, sikur po i pëlqen ambienti i krijuar brenda. XHEJKOBI e sheh shtrembër dhe i bën shenjë me lezet që të ulet në tavolinë bashkë me të tjerët.

**Fjalor**

*agresive* – sulmuese dhe armiqësore.

*angullimë* – kuisja e qenit apo e ujkut; ulërimë e përvajshme.

*pleks* – përziej.

*strudel* – pastë me peta me mbushje të ëmbël.

*takëm* – tërësia e sendeve, e pajisjeve etj., që shërbejnë për të njëjtën gjë.

## Studim teksti

## Kuptojmë tekstin

- 1 Lexoni tekstin dhe përgjigjuni pyetjeve.
  - a) Në çfarë kohe të ditës zhvillohen ngjarjet?
  - b) Çfarë shqetësimi ka Xhejkobi?
  - c) Ku e dërgojnë atë Njuti dhe Tina?
  - ç) Kush flet e para, kur hyjnë për në apartamentin e Golldstinëve?
  - d) Me kë jeton Tina në apartamentin e saj? A është ajo një jomagje?
  - dh) Si është banesa e Tinës dhe Kuinit?
  - e) Cilët janë përbërësit që duhen për të gatuar strudelin?
  - ë) Me çfarë mjeti i bëjnë magjitë Tina dhe Kuini?

## Analizojmë tekstin

- 2 Gjeni në tekst fragmentet ku tregohet se është e pazakontë që në shtëpinë e Tinës dhe Kuinit të vijnë burra.
- 3 Si e kupton Kuini që Xhejkobi është i uritur?
- 4 Cilat janë disa nga objektet magjike që gjenden në apartamentin e Tinës dhe Kuinit?
- 5 Përmendni disa veprime të pazakonta që ndodhin në apartamentin e motrave magjistare.

## Interpretojmë tekstin

- 6 A mund ta lexojë me lehtësi Kuini mendjen e një britaniku si Njuti?
- 7 Çfarë kanë të përbashkët Kuini dhe Xhejkobi?
- 8 Si shtrohet tryeza dhe si gatuhet ushqimi me anë të magjisë?
- 9 Cila është ajo pjesë në tekst që tregon se veprimtaria dhe bota e magjisë rregullohet me ligj dhe rregullore?
- 10 Çfarë mendoni se është krijesa që angullin? Kafshë shtëpiake, shpend apo kafshë magjike?

## Gjuha e tekstit

- 11 Gjeni në tekst dy shprehje që tregojnë habinë e madhe të Xhejkobit me atë që sheh në apartamentin e motrave magjistare.
- 12 Vështroni didaskalitë që përmban teksti. A do të ishte i plotë kuptimi i dialogëve, nëse nuk do të jepeshin didaskalitë?

## Detyrë

- ▣ Lexoni ose luani me role pjesën e mësipërme, duke përdorur kostumet dhe skenografinë e nevojshme.


# Prometeu i mbërthyer

## Para leximit

*Prometeu, duke parë gjendjen e mjeruar në të cilën jetonin njerëzit, vodhi nga Olimpi zjarrin dhe jeta e tyre ndryshoi shumë. Ai u mësoi njerëzve edhe shumë njohuri shkencore, përmes të cilave ata e njohën më mirë natyrën dhe u përshtatën me të. Zeusi u zemërua që Prometeu kishte bërë diçka fshehurazi atij, por ai ishte më tepër i zemëruar nga që Prometeu, i cili kishte dhuntinë të shihnte të ardhmen, nuk i tregonte një të fshehtë të madhe: kush do të ishte ai që do ta rrezonte nga fronti? Ai urdhëroi që ta mbërthenin Prometeun në një shkëmb në malet e Skithisë.*

Dhe hesht, veç hesht! Nevojë ju nuk keni që t'ju tregoj. Çdo gjë e dini vetë. Tani do t'ju rrëfej veç për mjerimet e njerëzve të shkretë. Si çiliminj dikur nga mendja qenë dhe i bëra të mençur. Nuk po flas për t'i poshtëruar të mjerët njerëz, jo, por që ta dini ç'dhuratë të vyer atyre u kam bërë. Më parë njerëzit kishin sy dhe s'shihnin, i kishin veshët dhe asgjë s'dëgjonin, si hije ëndrrash krejt të mjegulluara, të turbullta, të mjera zvarriteshin nga njëri brez, në tjetrin. S'linin gjë pa ngatërruar. Nuk dinin as shtëpi qerpiçi të ndërtonin, se punimin e drurit nuk e njihnin. Nëpër shpella, nën dhë, ku s'futej dielli kurrë dergjeshin si milingonat. Nuk i njihnin shenjat që stinët i dallojnë në mes tyre: as dimrin e acartë, as pranverën plot lule, as edhe verën frutaplotë. Kështu **dikonin** djersën kot më kot,

**Eskili** lindi në Eleuzinë, një fshat afër Athinës, rreth vitit 525 p.e.s. Ai është konsideruar si babai i tragjedisë antike, si dhe është quajtur poet i së drejtës. Eskili ka shkruar rreth 80 apo 90 tragjedi. Janë ruajtur të plota: "Lutëset", "Persët", "Të shtatë kundër Tebës" dhe "Agamemnoni", "Koeforet", "Eumenidet" që janë pjesë përbërëse të trilogjisë "Orestia". Tragjedia "Prometeu i mbërthyer" është vepër madhështore me temë nga mitologjia greke. Është pjesë përbërëse e një trilogjie, dy pjesët e së cilës "Prometeu zjarrsjellës" dhe "Prometeu i çliruar" nuk janë ruajtur.





gjersa i pari u tregova lindjen  
dhe perëndimin e yjeve, numrat,  
që janë shkenc' e shkencave, i shpika  
për ta. U dhashë shkronjat, të renditura  
pas radhës, duke u forcuar kujtesën,  
që është mëma e të gjitha **muzave!**  
I pari unë vura kafshët e egra  
në zgjedhë, i mësova si ngarkesa  
të mbajnë dhe si t'u shërbejnë njerëzve,  
nga punët e rënda duke i shpëtuar.  
Dhe kuajt i zbuta e nën frë i vura  
për të tërhequr karrot që luks janë  
për pasunarët. Jo, askush veç meje  
nuk i ka shpikur lundrat krahëlira  
që çajnë detin me vërtik. Medet!  
Sa shpikje të dobishme bëra unë  
për njerëzit, ndërsa për vete s'gjej mjet  
për të shpëtuar nga ky kob i madh!



## Fjalor

*dikoj* – derdh, buron.

*lëngatë* – vuajtje të mëdha.

*muzat* – ishin vajzat e Zeusit. Ato  
ishin nëntë dhe mbronin degë të  
ndryshme të artit dhe të diturisë.

*Moirat* – tri hyjnesha, që kishin në  
dorë fatin e njerëzve dhe të vetë  
perëndive. Në dritën e një llambe  
ato endnin në heshtje fillin e fatit  
të njeriut.

*Erinitë* – hyjnesha të hakmarrjes.

## KORI

Mjerim i madh të paska rën' në kokë  
dhe s'di të gjesh aspak shpëtim për veten.  
Si mjeku që kur vet' e zë sëmundja,  
nuk di ç'ilaç i bën atij më mirë.

## PROMETEU

Dëgjo më tej dhe fort do të çuditësh  
sa mjete dhe mjeshtri të tjera shpika.  
Më e madhja është kjo: kur nga sëmundjet  
të shkretët njerëz vuanin, kur as barna,  
as lëngje për të pirë, as përzierje  
për t'u fërkuar nuk kishin që të hiqnin  
sëmundjet dhe lëngonin dhe vdisnin  
krejt pa mjekim, atyre u tregova  
mënyrat, lëngjet se si t'i përziejnë  
dhe t'i përdorin kundër çdo **lëngate**.  
U kam shpjeguar si të parashikojnë  
atë që vjen dhe cilat ëndrra dalin  
e cilat s'dalin, fjalët që të yshtin;

kuptimin e shenjave që shikon një udhëtar kur ecën rrugës dhe si dallojnë fluturimin e mbarë nga ai i prapt i zogjve sqepmëdhenj me kthetra. U shpjegova tërë huqet e zogjve, si ushqehen, armiqësohen dhe duhen; si vallëzojnë tufa-tufa. (...) Të gjith' oguret, që tregojnë flaka, e zjarri dhe që fare s'i kuptonin më parë, ua shpjegova un' atyre. Po arin, bakrin, hekurin, argjendin dhe gjithë zejet e dobishme kush veç meje mund të thotë se i nxori nga gjiri i nëntokës për dobi të njerëzve? Askush nuk mund të thotë, po nuk desh të mburret krejt pa turp. T'i bie më shkurt, të gjitha artet dhe mjeshtëritë njerëzit e vdekshëm i mësuan nga Prometeu.

### KORI

Sa shumë njerëzit i ke ndihmuar!  
Tani nga gjëma veten e shpëto!  
Kam shpres' se kur nga prangat të çlirohesh,  
me Zeusin vet' do matesh në fuqi.

### PROMETEU

Oh, fat' plotfuqishëm s'ka caktuar  
nga prangat e mallkuara të çlirohem  
më parë se ky trup e shpirt nga mija  
mundime e tortura të robtohet.  
Se mendja kurrë s'matet dot me fatin.

### KORI

Po fatin, cila forcë e drejton?

### PROMETEU

Tri **Moirat** dhe **Eriniet** që s'harrojnë.

### KORI

M'i dobët është Zeusi se ato?

### PROMETEU

As Zeusi s'i shpëton dot fatit të tij.



### Kalimi nga një tekst dramatik në vënien e tij në skenë

Pasi keni zgjedhur dramën që do të vini në skenë, vendosni nëse do të vini gjithë tekstin apo vetëm një pjesë të tij.

Duke u nisur edhe nga talenti i tyre, nxënësit/et do të ndahen në grupe:

- grupi i aktorëve;
- grupi i regjisë. Një ose dy nxënës që do të kujdesen për provat, për koordinimin e veprimeve mes aktorëve etj.;
- grupi i skenografisë (duhet të krijohet një ambient i përshtatshëm për subjektin);
- grupi i kostumografisë (aktorët duhet të vishen si personazhet e tyre);
- ata që do të kujdeset për ndriçimin (herë është natë e herë është ditë, herë është diell e herë është furtunë). Duhet të krijohet atmosferë e përshtatshme;
- ata që do të kujdesen për muzikën (shpesh ka nevojë për muzikë në sfond);
- ata që do të kujdesen për koreografinë (mund të ndodhë që të ketë pjesë me kërcim të ndërthurura).

*Çdo element është njësoj i rëndësishëm për të realizuar një teatër të bukur. Provat përfundimtare janë momenti ku të gjitha këto elemente, si: loja e aktorëve, skena, muzika, ndriçimi, kërcimi, bashkohen në një.*

**KORI**

Më thuaj, për Zeusin fati ç'ka caktuar,  
përveç sundimit që s'do sosë kurrë?

**PROMETEU**

Nuk e them dot, prandaj mos pyesni kot.

**KORI**

E shoh se një të fshehtë të madhe ke.

**PROMETEU**

S'ka ardhur ende koha që ta them.

**Studim teksti****Kuptojmë tekstin**

- 1 Në mitologjinë greke, miti i Prometeut është shumë i njohur. Çfarë keni dëgjuar rreth Prometeut?
- 2 Çfarë e dallon Prometeun nga të gjitha perënditë e tjera?

**Analizojmë tekstin**

- 3 Në antikitet, grekët e lashtë, besonin se fati ishte fuqia që qëndronte mbi gjithçka, mbi vetë hyjnitë. Gjeni në tekst vargjet ku flitet për fatin dhe forcën e tij.
- 4 Cilat janë karakteristikat që e bëjnë Prometeun një hero me përmasa madhështore?
- 5 Interpretoni Fjalët e Prometeut: *"Dhe hesht, veç hesht!"*. Si e interpretoni heshtjen e Prometeut: si përlulje, si kokëfortësi apo si siguri se do të vijë dita e shpagimit për vuajtjet e tij?
- 6 Prometeu dhe Zeusi janë të dy perëndi, por shumë të ndryshme. Çfarë simbolizon Zeusi, parë në dritën e veprimeve të tij; ai po dënon një perëndi dhe një ish-mikun e tij?

**Gjuha e tekstit**

- 7 Gjeni krahasimin e zgjatur (similitudën) në strofën e mëposhtme dhe shpjegoni ndërtimin e tij.

*Mjerim i madh të paska rën' në kokë  
dhe s'di të gjesh aspak shpëtim për veten.  
Si mjeku që kur vet' e zë sëmundja,  
nuk di ç'ilaç i bën atij më mirë.*

- 8 Fjalët e korit janë me nuanca asnjane. Ndërgjegjja e kujt fshihet pas fjalëve të tij?

**Detyrë**

- ▣ Mitologjia greke është e mbushur me heronj me fate të paracaktuara. A mund të përmendni edhe raste të tjera të figurave mitologjike që vuajnë pasojat e fatit të pashmangshëm?



# TEKSTI JOLETRAR

Tekstet joletrare kanë përmbajtje reale, pra nuk janë të trilluara, ashtu siç ndodh në të shumtën e rasteve me tekstet letrare. Në to tregohen fakte dhe përshkruhen rrethana apo objekte për qëllime funksionale, që lidhen me fushën e dijës për të cilën bën fjalë teksti.

<i>Teksti joletrar</i>		
<i>Tipi i tekstit</i>	<i>Karakteristika</i>	<i>Lloji</i>
tekst rrëfyes	Tregon ngjarje reale me personazhe reale.	kronikë, shënime udhëtimi, biografi, intervistë, ditar etj.
tekst informues-paraqitës	Paraqet të dhëna, informacione; shpjegon koncepte.	njoftime, zëra nga enciklopeditë, raporte, relacione, fjalorë etj.
tekst udhëzues	Udhëzon, këshillon, urdhëron për të mbajtur qëndrime të caktuara.	udhëzime, urdhra, receta, ligje, rregullore etj.
tekst argumentues	Argumenton duke mbështetur ose kundërshtuar ide, opinione, fakte; vlerëson punime.	ese, artikuj, fjalime me karakter nga jeta sociale, ekonomike, politike etj.
tekst përshkrues	Përshkruan njerëz, vende, kafshë, objekte.	guida turistike, enciklopedi, tekste shkencore etj.

## Nanë e dashtun!

## Para leximit

Kjo është një letër që atdhetari, poeti, e veprimtari Jusuf Gërvalla, i shkruan nënës së tij, Ajshes. Letra është shkruar në shtator të vitit 1980, kohë kur autori gjendej larg atdheut, në Gjermani.



## Nanë e dashtun!

Rruga e jetës na pruni deri këtu. Zor sa të duesh. Po kollaj, s'ka qysh bahet ma kollaj. Ti vetë sa e sa herë, në prag të gjumit, kur ishim fëmijë e kur kishim dalë prej lojname të fëminisë, na ke kallxue përralla që kanë të njëjtin përfundim: rruga e nderës asht ma e zorshmja, po ma e mira dhe e vetmja rrugë e vërtetë për njeriun. Dhe, kush u mundue për nder, nder ka gjetë! Sot, në vjeshtën e kësaj rruge, kur s'po kemi qysh me i dhanë *gjevap bereqetit* kaq të pasun, farën e të cilit e kemi mbjellë vetë, kush lodhet i pari mundet me thonë: a *vyen* me luftue për nder, tuj i ngarkue vetit kaq të liga në shpindë?!

Unë, besoj, nanë, se ti nuk je ajo që thotë kështu. Ti gjithmonë u ke përballue burrisht rrebesheve të mëdha. Unë besoj se ti nuk je lodhë. Rruga jonë, mendja e shpirti ynë kanë pasur strofull fjalën tande, dashuninë e kujdesin tand të pashoq. Kur i kujtoj këto, më del se ti, në vend se të mërzitesh, duhet të gëzohesh e të përtërihesh. Ma në fund, veç tuj mos u dorëzue në këtë kohë të vështirë, ti nanë, do ta qitësh edhe hapin tand të fundit burrnor, që të bon si të gjitha ato nana trimnesha e fisnike shqiptare, të cilat, kur e ka lypë puna e *vatanit*, s'e kanë kursye e s'e kanë kajtë me lot jetën e djemve të tyne dhe kanë këndue kur kanë *kukatë* qyqet.

Jam shumë i lumtun që për këtë pikë, pra, për mërzinë tande, shpirtin e kam të fjetun. Ti je një lis, që nuk don me ditë për *fërflazat* e forta. *Bile*, një lis, madhështia e të cilit del në pah *bash* kur merr mot me fërflazë. As bora, as ngricat e mëdha nuk të kanë ba kurrë shejë.

Pse, pra, dridhesh aq fort prej lagshte e prej bryme?

Në përfytyrimet e mia të gjalla, këtu në *tretdhë*, të shoh tuj ecë me atë *krejninë* tande të pashoqe, sa herë që nisesh me e pa djalin tand në burg, e rrugës të bjen *me u shpërndrue* me anmiq të mëdhenj e të

## Fjalor

*gjevap* – përgjigje.

*bereqet* – fryt, dobi; vlerë.

*vyen* – vlen.

*vatan* – atdhe.

*kukat* – nxjerr një zë vajtues (për qyqen).

*fërflazë* – reshje shiu a bore, të shoqëruara me erëra të forta.

*bile* – madje.

*bash* – pikërisht.

*tretdhe* – vend shumë i largët, humbëtitë.


*krejni* – krenari.

*me u shpërndrue* – me u këmbye, me has.



Jusuf Gërvalla (1943-1982), veprimtar, shkrimtar dhe muzikant shqiptar. Shkollën e lartë e kreu në Prishtinë e Lubjanë dhe më pas punoi si gazetar në Shkup e Prishtinë. Shquhet për veprimtarinë e tij atdhetare dhe për veprat e spikatura letrare e poetike. U nda nga jeta si pasojë e një atentati të organizuar nga shërbimi sekret jugosllav gjatë kohës kur ishte në Gjermani, pasi kishte fituar azil politik.

vegjël të pjellës sate. Le të pëlcasej anmiku, gjithë ai që e ka ba synin qorr e veshin shurdh kur e do puna me luftue për nderën, për ato që ti jau ke kushtue jetën e shëndetën. Dhe dije se krejnia jote përballë fërflazës së sotme, asht helmi ma i fortë për anmikun.



### Letra

Letra përmban një mesazh të shkruar për të përcjellë informacion në distancë. Letrat ndahen në dy lloje: letra formale dhe letra joformale. Letrat formale janë letra zyrtare që i drejtohen një personi apo një institucioni për qëllime të ndryshme. Letrat joformale (jozyrtare) janë letra që i drejtohen një mikui, një të afërmi ose një të njohuri.

Letrat formale duhen shkruar duke respektuar jo vetëm strukturën, por edhe formulat e duhura për t'iu drejtuar marrësit dhe për të mbyllur letrën. Gjuha duhet të jetë sa më e qartë, pa dykuptimësi dhe pa shkurtime. Si rregull, letrat formale duhen shkruar në shqipen standarde.

Nga ana tjetër, letra joformale është intime dhe ka një gjuhë të figurshme, që ngjan me gjuhën e ligjërimit bisedor. Letra joformale mund të mos ndjekë rregullat e shqipes standarde.

## Studim teksti

### Kuptojmë tekstin

- 1 Lexoni tekstin dhe përgjigjuni pyetjeve.
  - a) Cila është rruga më e drejtë për t'iu ndjekur në jetë?
  - b) Çfarë paralelizmi ka mes përrallave të nënës dhe asaj çka autori ka zgjedhur të bëjë në jetë?
  - c) Cila është pyetja që bëjnë ata që lodhen duke vepruar apo luftuar për nder?
  - ç) Si është sjellë nëna përballë vështirësive të mëdha?
  - d) Përse duhet të gëzohet e të përtërihet ajo?
  - dh) Ku gjendet djali, të cilin shkon ta vizitojë nëna?
  - e) Cila është arma më e mirë kundër armikut?

### Analizojmë tekstin

- 2 A ka teksti strukturën e zakonshme të një letre? Çfarë mungon në fillim dhe në fund të letrës?
- 3 Çfarë i ka frymëzuar e nxitur djemtë në jetë? Ku e ka burimin rruga që ata kanë ndjekur, mënyra se si ata i mendojnë dhe i ndiejnë gjërat?
- 4 Çfarë i kërkon djali nënës së tij në këtë kohë të vështirë?
- 5 Cila është e përbashkëta mes nënës së autorit dhe nënave shqiptare?
- 6 Cilat janë karakteristikat gjuhësore të letrës që tregojnë se ajo është joformale?

## Studim teksti

- 7 Ju si mendoni, “a vyen me luftue për nder”? Bashkëbisedoni duke ndarë histori personale ose familjare të njerëzve që kanë luftuar për nderin dhe lirinë e tyre.

## Detyrë

- ▣ Shkruani një ese me titull “Kush u mundue për nder, nder ka gjetël”.
- ▣ Shkruani një letër për një njeri të shtrenjtë të familjes.

## Bashkëbisedojmë

Komunikimi është një marrëdhënie (dhënie dhe marrje) informacionesh, idesh, ndjenjash, mendimesh. Ai realizohet mes njerëzve përmes shenjave, simboleve, fjalëve dhe kodeve të ndryshme.

## Komunikimi me shenja

Është komunikimi përmes shenjave, si: lëvizjet e dorës, dhënia e sinjaleve, tundja e kokës në shenjë mohimi apo pranimiti etj.

- ▣ Përcaktoni mesazhin që përcjellin shenjat e mëposhtme.



## Komunikimi përmes simboleve

Simbolet janë figura të ndryshme që japin informacion. Për shembull, shenja e lugëve apo e pirunëve tregon se diku afër është një restorant; figura e një shtrati tregon se diku afër është një hotel; figura e një aeroplani tregon se një aeroport është afër etj.

- ▣ Shpjegoni informacionin që transmetojnë simbolet e mëposhtme.



## Komunikimi përmes gjuhës

Për të komunikuar, njerëzit kanë një mjet shumë të fuqishëm: **gjuhën**. Njerëzit edhe flasin, edhe shkruajnë. Pra, përdorin edhe gjuhë të folur, edhe gjuhë të shkruar. Shenjat gjuhësore më të rëndësishme për të komunikuar janë: fjala, veshja e saj tingullore, paraqitja grafike me shkronja të bashkuara brenda strukturës së vet dhe më pas në fjali. Komunikimi, me gojë ose me shkrim, kalon përmes një procesi të caktuar.

**Komunikimi gjuhësor** realizohet përmes gjuhës së folur dhe asaj të shkruar. Kur shkruajmë, komunikimi gjuhësor ruhet gjatë, rikujtohet, përdoret në situata dhe në kohë të ndryshme.

**Komunikimi jogjuhësor** realizohet edhe me mjete jogjuhësore, siç janë: gjestet, mimika, pantomimika, sinjalet, simbolet, shenja të tjera, si: figura, zëra, ngjyra etj.

- ▣ Përcaktoni llojin e komunikimit dhe shpjegojeni atë.

- Vajza që luajnë me shenja, me lëvizje gishtash.
- Shenja të qarkullimit rrugor.
- Fëmijë duke lexuar.
- Të rritur duke punuar në kompjuter.

Gjuhësor

Jogjuhësor

# Idriz Ajeti, babai i albanologjisë në Kosovë

## Para leximit

Teksti i mëposhtëm, shkruar nga Sabri Hamiti, është një tekst i shkurtër përkujtimor e biografik për vlerat e personalitetit të gjuhësisë shqiptare, albanologut Idriz Ajeti, i cili u nda nga jeta në moshën 102-vjeçare, më 13 shkurt të vitit 2019.



## Fjalor

*ligjëroj* – këtu: jap mësim në universitet.

*katedër* – grup pedagogësh të një lënde a të lëndëve të afërta në një universitet; zyra a dhoma e këtyre pedagogëve; departament.

U nda sot nga jeta Idriz Ajeti, babai i albanologjisë në Kosovë. Nderimi dhe kujtimi për të do të jenë të përhershëm sa të jetë shqipja.

*Atta* (rrënjë e moçme indoevropiane) bashkon kuptimisht të dyja gjinitë, për të treguar amësinë dhe atësinë. Idriz Ajeti e kishte amë shqipen e atë atdheun. Vetë u bë babai i albanologjisë në Kosovë. Shëmbëlltyrë e studiuesit të historisë së shqipes dhe protagonist i shkëlqyeshëm i botës kombëtare në Kosovën moderne.

Një nga studiuesit më të mëdhenj të historisë së gjuhës shqipe, që studimet e veta i botoi në një seri monografish shkencore, të paraqitura edhe në nivel të librave universitarë e shkollorë, për t'i përhapur si ide e si rezultate për brezat e rinj.

Me statusin e fituar të Kreut të studimeve shqiptare te ne, ai doli përherë në krye. *Ligjëroi* në *katedrën* e albanologjisë në Beograd, themeloi katedrën e albanologjisë në Prishtinë, ku ligjëroi dhe u bë kreu i saj. U bë dekan i Fakultetit të Filozofisë në Prishtinë, rektor i Universitetit të Prishtinës, punonjës shkencor dhe drejtor i Institutit Albanologjik, themelues dhe drejtor i Seminarit për Gjuhë, Letërsi e

Kulturë Shqiptare. Anëtar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës dhe kryetar i kësaj Akademie.

Punonjës i palodhur për standardizimin e shqipes. Drejtoi Konsultën Gjuhësore në Prishtinë dhe ishte njëri nga protagonistët e Kongresit të Drejtshkrimit në Tiranë. *Mentoroi* studentë e studiues të shqipes, shqiptarë dhe të huaj. Të gjithë brezat e studentëve dhe të studiuesve të shqipes në Prishtinë janë nxënës të drejtpërdrejtë apo të *ndërmjemë* të tij.

Idriz Ajeti ishte në ballë të veprimtarëve për të drejtat kombëtare të shqiptarëve në Kosovë. Si bashkëpunëtor i afërm i Ibrahim Rugovës, ai u bë një protagonist i lëvizjes pavarësiste të Kosovës. Ishte një nga autoritetet e mëdha të kësaj lëvizjeje dhe u zgjodh kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës (1998).

Idriz Ajeti ka njohur thellë ligjërimin letrar dhe ligjërimin shkencor shqip. Ka pasur stil në ligjërimin e vet shkencor si dhe në reagimet e tij publike. Këtë e dëshmon gjuha e tij karakteristike, me fjalor dhe me sintaksë.

Ka qenë e admirueshme sjellja e tij me moshatarët e vet dhe me brezat më të rinj, me *finesë* e fisnikëri, por edhe me dashuri për të vërtetën. Idriz Ajeti e ka adhuruar Eqrem Çabejn si personalitet dhe si studiues të albanologjisë. Ai vetë ka qenë i çmuar dhe i nderuar lart nga Çabej për veprimtarinë e tij shkencore e kombëtare. Ka qenë i admiruar nga studentët e tij, të cilëve u ka mësuar shkrimin e bukur të shqipes. E kanë lexuar ata, por i ka lexuar edhe ai me vëmendje të jashtëzakonshme.

*mentor* – t'i japësh mësimë dikujt ose të udhëzosh dikë që ka më pak përvojë ose është më i ri.

*ndërmjemë* – që ndodhet në mes të dy gjërave a dy njerëzve; i mesëm.

*finesë* – delikatesë mbresëlënëse.

*konciz* – i thukët, i mbledhur, i ngjeshur në argumentim.

*i pakompromis* – ai që nuk bën marrëveshje që bëjnë palët kundërshtarë duke i bërë lëshime njëra-tjetrës.

*lajthitje* – gabim pa dashje, gabim i vogël; ngatërrim pa dashje.

*diletantizëm* – punë a veprimtari prej amatori në fushën e shkencës, të artit, të teknikës etj.; punë e cekët, e përciptë.

*emblematic* – që shërben si simbol i një cilësie ose koncepti të veçantë.

*qerthull* – vorbull, rrjedhë ngjarjesh.

*tribunë* – vend i ngritur në krye të një salle, në një shesh etj., ku rrinë drejtuesit, udhëheqësit, të ftuarit etj., gjatë një veprimtarie.



Ka qenë një reagues i rreptë, *konciz* dhe *i pakompromis* kundër *lajthitjeve* dhe *diletantizmit* në fushën e studimeve shqiptare. Ka mbrojtur me përkushtim origjinën antike të shqipes në konferenca shkencore dhe në ballafaqime politike e nacionale. Është *emblematic* kjo mbrojtje e shqiptuar fuqishëm edhe në Beograd, në *qerthullin* e nacionalizmit agresiv serb kundër shqiptarëve. Reagim i bërë ky madje në *tribunën* e tyre politike. Idriz Ajeti do të vlerësohet dhe kujtohet sa herë të përmenden shqipja dhe shqiptarët.

## Studim teksti

## Kuptojmë tekstin

- 1 Lexoni tekstin dhe përgjigjuni pyetjeve.
- Si e cilëson që në titull autori Idriz Ajetin?
  - Ku ka punuar studiuesi Idriz Ajeti?
  - Cilin personalitet të rëndësishëm të gjuhësisë shqiptare admironte ai?
  - Me çfarë veprimtarish është marrë Idriz Ajeti gjatë jetës së tij?
  - Çfarë e ka lidhur *babain e albanologjisë në Kosovë* me shkollën? Po me universitetin?
  - Si sillej Ajeti me kolegët e tij dhe me të rinjtë?
  - Çfarë nuk toleronte ai dhe përse cilësohet si reagues i rreptë?

## Analizojmë tekstin

- 2 Si e kuptoni këtë fragment: "Atta (rrënjë e moçme indoevropiane) bashkon kuptimisht të dy gjinitë për të treguar amësinë dhe atësinë. Idriz Ajeti e kishte amë shqipen e atë atdheun".

Shënoni me ✓.

- Studiuesi e donte shumë atdheun dhe gjuhën indoevropiane.
- Studiuesi kishte edhe nënë, edhe baba.
- Studiuesi, gjatë jetës së tij, i kishte pasur shumë të vyera edhe çështjet e gjuhës shqipe, edhe çështjet atdhetare.

- 3 Për çfarë shquhej gjuha dhe ligjërimi vetjak i Idriz Ajetit?

- 4 Sipas tekstit, me cilat fusha studimi është marrë ai?

Shënoni me ✓.

- Histori e gjuhës shqipe
- Drejtshkrimi i gjuhës shqipe
- Gjuhësi teorike
- Histori e letërsisë
- Letërsi e vjetër shqipe



- 5 Çfarë mendimi kishte Idriz Ajeti për prejardhjen e gjuhës shqipe dhe ku e pati shprehur ai këtë mendim?

## Gjuha e tekstit

- 6 Gjeni dhe shkruani të gjithë ata mbiemra që përdoren në tekst për të paraqitur cilësitë e studiuesit. Çfarë tregojnë për vlerësimin që ka autori i tekstit për figurën e Idriz Ajetit?

- 7 Në cilën kohë përdoren foljet në këtë tekst biografik?

## Detyrë

-  Kërkoni dhe gjeni më tepër informacion rreth jetës, veprës shkencore dhe veprimtarisë patriotike të Idriz Ajetit. Të dhënat që do të mblidhni, shkruajini në formën e një biografie për gjuhëtarin.
-  Gjeni informacione rreth Konsultës së Prishtinës dhe Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës shqipe.

# Erza, shqiptarja me famë botërore, nga muzika drejt kinematografisë

## Para leximit

*Duket si një vajzë nga përrallat. Me sy bojëqielli, me flokë të verdhë e të gjatë deri në bel, këngëtarja e vogël shqiptare Erza Muqolli edhe jetën e ka mu si në përralla. Prindërit e saj u larguan nga Kosova në Francë, për një jetë më të mirë, kur Erza ishte e vogël, ndërsa tani familja po shijon suksesin e saj.*

*Vetëm 12 vjeçe, ajo konsiderohet si një yll francez, e cila bashkë me anëtarët e grupit të saj "Kids United", themeluar në vitin 2015, po korrin sukses anëmbanë Francës; bashkëmoshatarët e tyre bëjnë të pamundurën që të sigurojnë bileta për të parë nga afër koncertet e Erza Muqollit. Në mbyllje të vitit 2017, ajo, bashkë me fëmijët e grupit "Kids United", u ftua në Elize nga presidenti i Francës, Emanuel Makroni, dhe nga bashkëshortja e tij. Aty dhanë edhe një koncert. Më pas, zonja e parë e Francës, Brigit Makroni, priti në një takim Erza Muqollin, e cila bashkë me grupin e saj dhuroi 1,5 milionë euro për UNICEF-in. Erza Muqolli (e cila bashkë me grupin e saj tashmë kanë shitur mbi 1,7 milionë kopje të albumit) ka dhënë një intervistë për "KultPlus", duke shprehur dëshirën që një ditë të këndojë edhe në Kosovë.*

## **Kur e zbulove talentin tënd për të kënduar?**

Kam filluar të këndoje që në moshën 2-vjeçare, ose pak më herët (siç më kanë thënë prindërit). Nga ai moment gjithmonë kam kënduar këngë në gjuhën frënge e shqipe.

## **Ti je ndër vogëlushet shqiptare që po shkëlqen në botë, duke bërë krenarë të gjithë shqiptarët kudo ndodhen. Çfarë të frymëzon ty, Erza, që të guxosh kaq shumë, edhe pse e vogël në moshë?**

Ju faleminderit shumë për komplimentin. Jam shumë e gëzuar kur i bëj shqiptarët të krenohen me mua. Unë e dua shumë muzikën dhe kjo më bën të guxoj çdo ditë e më shumë.

## **Ti je cilësuar nga kritikët e muzikës ndërkombëtare (kryesisht në Francë) si "Selin Dioni" i dytë. Si e ke pritur këtë koment për ty? Pse zgjodhe një këngë tradicionale parisiane për finalen e madhe të konkursit?**

Po, e vërtetë, kështu më kanë cilësuar kritikët e muzikës. Unë e adhuroj Selin Dionin, dhe të të krahasojnë me të, nuk është pak. Në finalen e supertalentit në Francë, zgjodha këtë këngë tradicionale franceze të këngëtares, ose legjendës së muzikës franceze Édith Piaf, sepse më ka pëlqyer gjithmonë. Më është propozuar edhe nga produktioni i emisionit, sigurisht.

## **Sa të mbështet familja në rrugën e karrierës që ke nisur? Si është një ditë e zakonshme jotja?**





Familja është mbështetja më e fortë që kam. Mbështetja e prindërve, motrave e vëllait. Unë shkoj në shkollë gjatë gjithë javës, ndërsa fundjavave jam në *turneun* e koncerteve që kam deri në dhjetor të këtij viti. Ndërkohë kam edhe incizime të emisioneve të ndryshme televizive, të cilat i realizoj gjatë javës.

**Ti zure vendin e tretë në konkursin e “Got Talent” në Francë. Më thuaj pak, si u ndjeve për rezultatin? Cilat janë projektet e tua të ardhshme?**

Po, jam renditur në vendin e tretë në finalen e “*Got Talent*” dhe jam e lumtur që kam qenë pjesë e finales. Projektet e mia të ardhshme janë si në muzikë, po ashtu edhe në aktrim. Sa i përket muzikës, për dy albumet që kemi bërë në vitin 2016, jemi grupi që kemi arritur më shumë sukses dhe jemi në *top-listën* e 5 albumeve më të shitura dhe më të dëgjua në Francë. Në historinë e muzikës franceze nuk ka ndodhur që dy albumet e një grupi të jenë në *top-listën* e pesë albumeve më të shitura. Tani kemi përgatitur edhe albumin e tretë dhe del në shitje nga mesi i muajit gusht. Albumi i tretë do të jetë pak më ndryshe nga dy të parët, sepse do të ketë *duo* me disa këngëtarë të njohur francezë e ndërkombëtarë. Secili nga ne do të ketë një këngë *solo*, ndërsa në fushën e kinematografisë jam zgjedhur të jem pjesë e një filmi me metrazh të gjatë, në rolin e parë feminist, ku pjesë e filmit do të jenë edhe 4 aktorë të njohur francezë.



## Fjalor

*top-list* – (angl.) lista e më të mirëve.

*turne* – udhëtim i gjatë në disa vende sipas një ecurie të vendosur që më parë; udhëtimi në disa vende i një trupe teatrore ose këngëtarë për të dhënë shfaqje.

*duo* – bashkë me një tjetër, me dy zëra.

*solo* – pjesë muzikore a valle që luhet ose që kërcëhet nga një artist i vetëm.

*klip* – pjesë e shkurtër e një filmi ose programi televiziv; (këtu) videoja shoqëruese e një kënge.

*iniciativë* – nismë.

*eveniment* – ngjarje e rëndësishme kulturore, muzikore.



**Të kemi parë që je e pasionuar pas këndimit të këngëve në shqip. Pse zgjedh të këndosh në shqip herë pas here, edhe pse jeton në Francë?**

Unë këndoj gjithmonë në gjuhën shqipe, sepse jam rritur me to. Këngët shqiptare më emocionojnë shumë. Këndoj kudo, në shtëpi apo gjatë udhëtimeve të ndryshme. Edhe pse jetoj në Francë, unë jam krenare që kam dy prindër shqiptarë dhe prezantohem gjithmonë si shqiptare.

**Ti je përzgjedhur për klipin e “Kids United” dhe je pjesë e njërit prej fëmijëve të përzgjedhur. Ky është një hap i madh për karrierën tënde. Më trego ndonjë moment që të ka mbetur në mendje gjatë realizimit të klipit.**

Jam pjesë e grupit “Kids United”. Ky grup u krijua me *iniciativën* e produksionit muzikor *Play On* (Warner), kanalit televiziv M6 në bashkëpunim me UNICEF, Francë. Gjatë këtyre viteve kemi realizuar disa klipe. Gjatë regjistrimeve kemi pasur momente të bukura. Për shembull, për klipin “Tout le bonheur du monde” ishim në Marok, në qytetin Marakesh, ku ishin të pranishëm më shumë se 120 fëmijë për të qenë pjesë e klipit. Fëmijët ishin jetimë dhe ishte shumë i veçantë fakti që ata ishin pjesë në klip, si një mesazh i madh për botën. Kemi 1 milion e gjysmë albume të shitura dhe këto para kanë shkuar në ndihmë të fëmijëve në vështirësi në mbarë botën.

**Përveçse e talentuar, ti je edhe bukuroshe dhe flokët e tu janë të veçantë. Pse i mban flokët të gjatë?**

Flokët e gjatë i kam merak dhe i dua shumë. Janë identifikues të stilit tim.

#### Intervista

Intervista është bisedë në formë dialogu mes një gazetari dhe një personi, e cila realizohet përmes pyetjeve dhe përgjigjeve. Intervista botohet në shtyp ose transmetohet në radio a në televizion. Teksti i intervistës konsiderohet tekst rrëfyes, ku i intervistuari rrëfen rreth përvojave dhe qëndrimeve të tij personale.

**Nga yjet botërore të muzikës, cilin ke takuar dhe cili takim të ka mbetur në mendje? A ka ndonjë prej tyre që ke marrëdhënie shumë të mirë, qoftë për të marrë këshilla profesionale, apo fanse e jotja?**

Nga yjet botërore kam takuar Selin Dionin, po ashtu gati të gjithë këngëtarët e njohur francezë. Kam kontakte me të gjithë, më japin shumë këshilla për muzikën. Kam pasur rastin të takohem edhe me Dejvid Bekamin, gjatë një ceremonie për 70-vjetorin e krijimit të UNICEF-it. Në këtë *eveniment* pata mundësinë t'i përshëndesja të gjithë të pranishmit në gjuhën shqipe.

**A ke menduar të zhvillosh turne koncertesh në Shqipëri apo Kosovë?**

Po, shpesh kam biseduar që të bëjmë ndonjë koncert në Kosovë dhe Shqipëri, në mënyrë që të ardhurat të shkojnë në ndihmë të fëmijëve të braktisur. Kjo është një ëndërr imja dhe besoj që në një të ardhme të afërt do të realizohet. Jemi në kontakt për të përgatitur koncert në Kosovë e Shqipëri. Jemi në pritje të një përgjigjeje.

**Cila është ëndrra jote më e madhe?**

Ëndrra ime është që të vazhdoj shkollimin dhe të diplomohem për mjekësi. Në të njëjtën kohë të merrem me muzikë dhe të përgatis albumin tim. Të ndihmoj njerëzit në vështirësi dhe të prezantoj më së miri popullin shqiptar në arenën ndërkombëtare.

**Cili është mesazhi yt për fëmijët që vuajnë në botë? Po për fëmijët e talentuar?**

Dua që fëmijët që vuajnë në botë, të mos humbasin asnjëherë shpresat për një ditë më të mirë. Të gjithë së bashku duhet të punojmë për një botë më të mirë e më të paqtë. Fëmijët e talentuar duhet të ndjekin gjithmonë ëndrrat e tyre. Mos u dorëzoni kurrë!

*(Kultplus 2018)*

## Studim teksti

### Kuptojmë tekstin

- 1 Lexoni tekstin dhe përgjigjuni pyetjeve.
  - a) Si quhet vajza e intervistuar?
  - b) A është Erza një fëmijë i zakonshëm? Çfarë e bën të veçantë atë?
  - c) Me cilën këngëtare të famshme e kanë krahasuar Erzën?
  - ç) Si është dukja fizike e këngëtares së vogël?
  - d) Si e imagjinon veten në të ardhmen Erza?
  - dh) Çfarë e lidh Erzën me këngët dhe muzikën shqiptare në tërësi?
  - e) Në cilën fushë do të përfshihet Erza, veç muzikës?

## Studim teksti

## Analizojmë tekstin

- 2 Për çfarë shërbejnë paratë që mblidhen nga aktiviteti muzikor i Erzës dhe i grupit ku ajo bën pjesë?
- 3 Çfarë thuhet në tekst për futbollistin anglez, Dejvid Bekam?
- 4 Cilat ngjarje të rëndësishme të karrierës së saj përmend Erza në intervistë?
- 5 Çfarë thuhet në intervistë për 200 fëmijë?

## Interpretojmë tekstin

- 6 Përveçse është një vajzë tepër e talentuar, në intervistë tregohet se Erza është edhe mjaft e dashur me të tjerët dhe bën bamirësi. Gjeni ku shfaqet kjo gjë në tekst.
- 7 Çfarë toni ka rrëfimi i Erzës për sukseset dhe arritjet e saj në këtë intervistë? Shënoni me ✓.
  - ton melankolik
  - ton triumfues
  - ton të përzishëm
  - ton të gëzueshëm
  - ton inkurajues
  - ton atdhetar-patriotik



## Gjuha e tekstit

- 8 Shikoni me vëmendje foljet e tekstit të intervistës. Cilat kohë gramatikore të foljes janë më të përdorurat?
- 9 Pyetjeve të intervistës, zakonisht, intervistuesi u paraprin me disa komente ose sqarime. Gjejini ato dhe thoni ç'funktion kryejnë. Qarkoni alternativën e saktë.
  - a) Komentet/sqarimet shërbejnë për ta bërë të intervistuarën të ndihet mirë.
  - b) Komentet/sqarimet shërbejnë për të komplimentuar vajzën.
  - c) Komentet/sqarimet shërbejnë për t'i dhënë lexuesit/es informacione që ai mund të mos i ketë.
  - ç) Komentet/sqarimet shërbejnë që pyetjet mos të duken shumë të shkurtra.
- 10 Gjeni në tekst fjalët që i përkasin fushës leksikore të muzikës.

## Reflektojmë rreth tekstit

- 11 Gjeni në internet këngë të Erzës, ku ajo këndon shqip dhe frëngjisht. Cila prej këtyre këngëve është më e bukura, sipas jush?
- 12 A do të ishte e plotë intervista, nëse nuk do të kishte pjesën hyrëse (*para leximit*)? Çfarë funksioni luan kjo pjesë për lexuesin/en?

## Detyrë

-  Zhvilloni një intervistë me shokun ose shoqen e klasës, duke luajtur rolin e gazetarit dhe të një personazhi të famshëm.
-  Intervistoni prindërit rreth kujtimeve të tyre shkollore. Pyetjet dhe përgjigjet shkruajini në fletore.

# Gjirokastra

## nga udhëpërshkrimi i Evlija Çelebiut

### Para leximit


Në nëntor të vitit 1670, udhëtari turk, Evlija Çelebiu, pas një udhëtimi nëpër Kosovë në dhjetor të vitit 1660, dhe një udhëtimi në Shqipërinë e Veriut dhe në Malin e Zi në shkurt të vitit 1662, filloi udhëtimin e tij të tretë dhe më të gjatë në trevat shqiptare. Kësaj radhe ai hyri në Shqipëri nga jugu. Pas një qëndrimi të shkurtër në Delvinë, Zhulat dhe Kardhiq, ai shkoi në qytetin e Gjirokastrës (turqisht Ergiri), ku u habit shumë nga zakonet e gjirokastritëve. Ja dhe përshkrimi i vizitës së tij në atë qytet para më shumë se treqind vjetësh...

### Kalaja madhështore e me emër e Gjirokastrës

Në greqisht ka kuptimin Kalaja. Ai që e themeloi i pari ka qenë biri i Filipit, njëri nga mbretërit grekë. Më pas, ra në duar sundimtarësh të ndryshëm dhe në fund, u mor prej kryengritësve shqiptarë nga vetë Sulltan Bajazidi II i Shenjti. Shumë *ngrehina* në Gjirokastrë duket se kanë qenë ndërtuar prej venedikasve, sepse në to mund të shihen portretet e Shën Markut, i cili është simbol i Venedikut.

Kalaja është një ndërtim i hershëm prej guri, e ngritur përgjatë një kreshte shkëmbi të lartë. Ka një perimetër prej 1400 hapash dhe shtrihet nga lindja në perëndim, në një gjatësi prej 600 hapash të gjerë dhe në një gjerësi prej 100 hapash. Bedenet e gjata e të ngjeshura i japin pamjen e një anijeje *galerë*. Brenda në kala ka vetëm një rrugë kryesore, e cila shkon nga lindja në perëndim. Në të dyja anët e rrugës, janë në rresht 200 shtëpi dykatëshe prej guri, me çati krejt me rrasa. Meqë kalaja ngrihet në majë të një shkëmbi të lartë, uji mblidhet në një *sternë* të madhe rrëzë minares. Të gjitha shtëpitë brenda mureve, ujin e marrin nga ky burim, d.m.th. nga uji i shiut, që zbret dhe mbush këtë sternë-det. Po edhe çdo shtëpi ka sternën e vet.

Kalaja ka dy porta me tri pjesë të forta e të rënda hekuri secila. Te porta lindore hyhet nëpërmjet shkallësh prej guri dhe, për këtë arsye, kalorësit e kanë të vështirë të hyjnë e të dalin nga kjo portë. Në hyrjen e tretë, e cila shkon edhe më në brendësi se të tjerat, ka një si





## Fjalor

*ngrehinë* – ndërtesë.

*galerë* – anije e vjetër lufte me vela e me rrema.

*sternë* – depo e gërmuar në tokë për të mbledhur dhe për të ruajtur ujërat e shiut.

*namazgjah* – vend i hapur, shesh lutjeje.

*bezistan* – pjesë e pazarit të tipit lindor, e rrethuar dhe pjesërisht e mbuluar.

*çesme* – çezmë.

*hamam* – banjë allaturka.

qoshk, nga mund të shihet e gjithë bota. Pikërisht këtu, e gjithë paria dhe njerëzit e shquar të qytetit mbledhen për të kënaqur syrin, duke soditur vreshtat dhe kopshtijet e fushës poshtë. Nga ana perëndimore është porta e *namazgjahut*, ku falen besimtarët. Edhe ajo ka tri dyer prej hekuri. Në këtë anë, ndërmjet sheshit të namazgjahut dhe kalasë gjendet një hendek i cekët, 100 hapa i gjatë dhe 20 hapa i gjerë. Në tri anët e tjera nuk ka hendeqe, sepse shkëmbi është tepër i thikët. Brenda në kala, ndërtuar mbi bedena, janë 200 shtëpi me çati me rrasa. [...]

## Qyteti i madh i vjetër

Qyteti jashtë kalasë është i ngritur mbi tetë kodrina e lugina përfaqë kalasë, me shtëpi shumëkatëshe prej guri, të gjitha me çati me rrasa dhe me vreshta e kopshtije. Secila nga këto shtëpi të ndërtuara për bukuri ka kullë. Avllitë e oborreve të këtyre shtëpive janë me një lloj gur graniti të bardhë, të latuar prej mjeshtëurve gurgdhendës, si të ishin tulla Ankaraje nga një brumë i vetëm. Avlli të tilla kanë si shtëpitë e të pasurve, ashtu edhe ato të të varfërve. Gurë të tillë të prerë me kënde të drejta nuk gjen gjëtu mbi dhë, përveçse në qytetet Tire e Manisa të Anadollit. *Emrat e mëhallave* të Gjirokastrës. Janë 8 mëhalla, ndër to Palortoja; Vutoshi; Manalati; Haxhi Beu, mëhalla më e madhe; Dunavati (Dundari); si dhe, lart mbi shpat, Memi Beu (Teqe/Partizani). Të gjitha të begata.

## Tregjet dhe pazaret

Janë 200 dyqane të hijshme gjithsej. Përveç tyre, pazari i ri ka 80 dyqane të kohës, dykatëshe. Është pazar tërheqës, me porta të forta në të dy cepet e hyrjedaljes, si porta *bezistani*.

*Çesmet*. Janë 5 çesme me ujë jashtëzakonisht të lehtë.

*Bujtinat* për tregtarët. Janë 5 hane. Më në zë e më i sigurt është hani i Memi Pashës.

*Klima e shëndetshme*. Qyteti ka klimë shumë të mirë dhe, për këtë arsye, banorët bien në sy për trup të shëndetshëm. Djemtë e vashat janë në zë për nur e bukuri. Por furnizimi me ujë nuk i përmbush të gjitha nevojat e qytetit. Banorët zbresin deri te lumi i Dropullit, rrjedha e të cilit kalon mes për mes vreshtave poshtë në fushë, dhe atje vazhdimisht ngarkojnë enët me ujë në kuaj e gomarë. Me pak fjalë, pesë *çesme* janë tepër pak për këtë qytet.

*Hamamet*. Ka vetëm një hamam, i cili punon vetëm gjatë dimrit dhe në korrik mbyllet. Ka edhe një tjetër hamam publik, por ai është lënë shkretë; veçse, në numër të madh janë *hamamet* e banorëve në



shtëpitë e tyre, të cilat nganjëherë përdoren edhe në raste ritesh e ceremonish.

Ka edhe shumë njerëz të ditur, sidomos janë një numër vjershëtorësh, prej të cilëve Bykajiu, Figaniu, Nalishi, Sykuniu dhe Fezaiu vazhdojnë të banojnë në këtë qytet e të shquhen në forma vjershërie të ndryshme. Nalishi, për shembull, nuk e ka shoqin as në *gazele* e as në *kaside*.

Këta njerëz janë të dhënë pas qejfeve, pijes e të ngrënave. Nuk e kanë për gjë të pijnë verë dhe pije të tjera dehëse e dalldisëse, sikundër është ajo që i thonë rejhanie.

*Një tjetër zakon i keq i gjirokastritëve.* Në raste dasmash, në ditë të kremtesh si ato të Shën Gjergjit, Nevruzit, Shën Mitrit, dhe Shën Kollit, si dhe në dy festat e Bajramit, ata vishen me rrobat më të mira dhe pinë pije alkoolike të ndryshme. Dashnorët shkojnë dorë për dorë me djemtë e tyre të bukur dhe përqafohen e kërcejnë së bashku në mënyra si të krishterët.

*Veshjet e burrave.* Pleqtë mbështjellin një *çallmë* rreth kokës dhe vishen me të gjitha ngjyrat, përveç mavisë. Ata dalin të veshur me tirq me kopsa dhe ecin burrërishte. Të rinjtë veshin këmishë me mëngë të shkurtra dhe një rrobë të brendshme shumë të shkurtër me *kinda*, prej mëndafshi të kuq dhe atlasi. Krahët dhe kofshët i lënë zbuluar. Vetëm një këmishë mëndafshi me buzë të bardha i mbulon deri poshtë te kryqet. Me pak fjalë, të rinjtë kanë *takëme* shumë të çuditshme, por ata janë edhe shumë *të përkorë*. Burrat janë soj luftëtarësh dhe nuk kanë marrëdhënie të fshehta as me djemtë e as me femrat. Sa për gratë e tyre, kur burrat ua merr vdekja, ato dalin nga dera dhe ia marrin lutjes “Ku ka burrë si ai, shoqin nuk e ka.” Përndryshe, ato nuk dalin kurrë nga shtëpia, qysh nga dita kur lindin deri në ditën e vdekjes, nuk po marr parasysh zinë dhe vajtimet e së dielës. Ato madje nuk *venë* as te shtëpia e prindërve, aq të dëlira e të virtutshme janë, tamam si zonja shenjtore Rabie Adavija.



## Fjalor

*gazele* – lirika të dashurisë dhe të kënaqësisë tokësore ose për çështje të fesë e të filozofisë.

*kaside* – vjersha të gjata (ode) me përmbajtje të ndryshme, që u kushton lavde personaliteteve.

*çallmë* – rrip i gjatë pëlhere, i mbështjellë rreth festes a rreth kësulës së klerikëve myslimanë.

*kinda* – palë e fustanit, e fustanellës.

*takëm* – tërësia e sendeve, e pajisjeve etj., që shërbejnë për të njëjtën gjë.

*e përkorë* – që ka masë në të ngrënë a në të pirë; fig. i matur, i përmbajtur.

*venë* – shkojnë.

*rejhani* – lëng rrushi i zier, me shije pak të thartë.

*pogaçe* – kulaç i grunjtë.

*qerpiç* – tullë balte e tharë në diell; plithar.

*suva* – shtresa prej llaçi përsipër murit e tavanit.

*i pafe* – këtu: jomysliman.

*Haja dhe mjeshtëritë e ndërtimit.* Ushqimet dhe pijet më të njohura janë vera, *rejhania*, araku polak, simitja e bardhë shqiptare, *pogaçja* e pjekur në prush dhe rrushi me erë i quajtur sarali. Mënyra si janë ndërtuar avllitë e të gjitha shtëpive nuk e ka shoqen në mbarë botën. Ato të gjitha janë 20 kut (15 metra) të larta, me blloqe guri ranor të kuq, thjesht të vënë gur mbi gur, pa *qerpiç*, pa llaç e pa *suva*. Avllitë dhe shtëpitë janë të gjitha shekullore, që nga koha e *të pafeve*. Avllitë janë aq të larta e të ngjeshura, sa as edhe harabeli nuk gjen dot vend ku të kapet. Në kullotat malore të larta, klima nuk lejon të bëhen limonët, portokajtë, shegët dhe ullinjët.

(R. Elsie, tekst i shkurtuar)

## Studim teksti

### Kuptojmë tekstin

- 1 Lexoni tekstin dhe përgjigjuni pyetjeve.
  - a) Ku është ndërtuar Kalaja e Gjirokastrës dhe kush mendohet se e ka ndërtuar atë?
  - b) Me çfarë materiali janë ndërtuar shtëpitë dhe çatitë e tyre?
  - c) Cilat aspekte të Gjirokastrës paraqet teksti?
  - ç) Sa lagje ka qyteti i Gjirokastrës?
  - d) Si është klima e këtij qyteti?
  - dh) Cilat janë disa nga ushqimet që përmenden në këtë tekst?

### Analizojmë tekstin

- 2 Nënvizoni në tekst ato fjali që japin qëndrimin e autorit ndaj dukurive që ai përshkruan.
- 3 Cilat janë ato objekte dhe tipare të qytetit që përshkruhen në tekst dhe tregojnë se ai është shkruar në një epokë kulturore dhe historike të shkuar.
- 4 Çfarë thuhet për njerëzit e qytetit të gurtë? Çfarë qëndrimi mban autori për ta: qëndrim objektiv apo subjektiv?

### Gjuha e tekstit

- 5 A ka detaje të shumta përshkrimi i karakteristikave të kalasë së Gjirokastrës? Përse përdoren ato?

### Reflektojmë rreth tekstit

- 6 Gjeni të dhënat në tekst që tregojnë për origjinën e tekst-shkruesit. A ndikon ky fakt në mënyrën sesi autori e sheh dhe e përshkruan qytetin e Gjirokastrës?

### Detyrë

- 📄 Gjeni informacion për monumentet e kulturës në Gjirokastrë, që përbëjnë vlerë për trashëgiminë kulturore shqiptare. Cilat objekte përmenden edhe në udhëpërshkrimin e Evlija Çelebiut, duke i rezistuar kështu peshës së shekujve?



## Kulti i disa gjallesave të natyrës

### Para leximit

Veprat studimore përbëhen zakonisht nga tekste informuese-paraqitëse. Teksti i mëposhtëm është shkëputur nga një vepër studimore për mitologjinë ndër shqiptarë. Mitologjia ka të bëjë me mitet, që janë rrëfenja a tregime për qenie të mbinatyrshe ose për ngjarje të çuditshme. Në këtë tekst përmenden disa kafshë, për të cilat, në mite apo legjenda të hershme, shqiptarët shfaqin adhurim a nderim të madh. Të tilla janë: dhia e egër, kaprolli, shqiponja dhe bleta.

Në mitologjinë shqiptare ndeshim disa kafshë, shpendë a insekte me *atribute* kulti, por këtu do të marrim në shqyrtim disa prej tyre, nga ato që jetojnë në natyrë.

### Dhia e egër

Vetë shkathtësia e saj, tiparet interesante që e dallojnë atë nga kafshët e tjera, me sa duket, kanë bërë që tek ajo të ruhen *tribute kulti*. Kulti i dhive të egra është ruajtur në Malësinë e Shqipërisë së Veriut, në zonat rreth malit të Tomorit, në malësitë e Labërisë dhe në disa vende të tjera. Gjahtarët, shpeshherë jo me qejf të madh, i vrisnin dhitë e egra, vetëm sepse një traditë e lashtë i mbante këto për kafshë “të shenjta”.

Zbukurimi më karakteristik në bishtin e lahutës shqiptare janë kryet e dhisë së egër me gjithë brirë, ose koka e sorkadhes. Kjo ndeshet thuajse në të gjithë Shqipërinë e Veriut, në Kosovë e ndër shqiptarë të Malit të Zi e të Maqedonisë. Edhe në malësitë e Jugut, sidomos në Labëri, koka e dhisë së egër gjendet aty-këtu e gdhendur në objekte të jetës së përditshme të banorëve të këtyre viseve ose në mure.

Dhia e egër shfaqet kështu me *tribute* të *hyjnisë* së pyllit. Kjo gjë dëshmohet më së miri në disa variante të Ciklit të Kreshnikëve, ku flitet se Zanat, forcën e tyre e kanë te tri Dhitë e Egra. Në përmbajtjen e tyre, Zanat shfaqen me tipare të hyjnive të pyllit e të gjuetisë. Ato e marrin forcën nga tri dhi të egra, të cilat kanë brirë me tipare të veçanta, “të arta”. Në qoftë se këto dhi do të lëndoheshin, atëherë, sipas këtij miti, Zanat nuk do të kishin më fuqi.

Zanat i thanë nuses së Mujit:

“Se na i kem sall tri dhi t’egëra

E i kanë brinat prej dukati,

E tanë forcën pre ‘atyne e kemi”.

(Q. Haxhihasani, “Epika legjendare”, Tiranë, 1966).



### Fjalor

*atribut* – veti thelbësore, e domosdoshme dhe e përhershme e një sendi a e një dukurie.  
*kult* – adhurim a nderim i tepruar ndaj dikujt apo diçkaje.  
*hyjni* – perëndi, zot.





## Kaprolli

Është një kafshë e egër kulti, e njohur si e tillë thajse në të gjitha viset malore të vendit tonë, sidomos që nga Karaburuni, në gjithë viset e Labërisë, në zonat e Tomorit, në Përmet, shfaqet pastaj në Alpet e Shqipërisë Veriore e deri në viset e Kosovës dhe të Maqedonisë Perëndimore; po kështu, në viset shqiptare në Mal të Zi. Shumë nga gjahtarët, këtë kafshë, edhe kur u dilte përpara, nuk e vrisnin, sepse një veprim të tillë e quanin mëkat. Në tregimet popullore thuhet se sorkadhja, kur vritet, derdh lot si njeri. Ajo, para se të ngordhë, kthehet me krye nga lind dielli e andej, sipas besimeve popullore, lutet.

Në mitet popullore thuhet se sorkadhja dikur ka qenë njeri, prandaj qan me lot e bën gjeste si të njeriut.

### Fjalor

*bereqet* – drithë; të lashtat, fryt, dobi, punë.



## Shqiponja

Është e njohur ndër shqiptarë si shpend kulti. Në disa vise të vendit tonë është i pranishëm besimi se ajo s'duhet vrarë, sepse një veprim i tillë është mëkat. Mbi nderimin e veçantë që kanë shqiptarët për këtë shpend, na tregon edhe Edit Durham në veprën e saj kushtuar zakoneve dhe originës së fiseve të Ballkanit.

## Bleta

Në të kaluarën, shqiptarët tregonin një nderim të veçantë për bletën. Sipas disa legjendave, ky insekt ka qenë dikur njeri. Për bletën nuk thonë *ngordhi*, por *vdiaq*, sepse mendohet që ajo ka më shumë cilësi njerëzore sesa insektesh.

Ishte rreptësisht e ndaluar që ajo të mallkohej, se një veprim të tillë e quanin mëkat dhe me pasoja të padëshirueshme në *bereqet*. Kur i

marrin mjaltin bletës, lahen në mënyrë të veçantë, duke u nisur nga besimi se po të mos lahen, bletët nuk prodhojnë më mjaltë dhe rrezikojnë të “vdesin”. Ky kult mund të shpjegohet me tradita të hershme vendase. Tradita e rritjes së bletëve është e njohur ndër ilirë, ndër arbër të mesjetës e përgjithësisht në Ballkanin e vjetër. Ilirët bënë verë prej mjaltit të bletëve.

Mark Tirta



## Studim teksti

### Kuptojmë tekstin

- 1 Lexoni tekstin dhe përgjigjuni pyetjeve.
  - a) Hyjnia e cilit mjedis ishte dhia e egër?
  - b) Përse gjahtarët nuk e kishin me qejf që t'i vrisnin dhinë e egra?
  - c) Në cilat vise shfaqet kaprolli si kafshë kulti?
  - ç) A lejohej dikur që gjahtarët të vritnin kaprollin?
  - d) Për çfarë adhurohej shqiponja? Po bleta?
  - dh) Ku e ka origjinën kulti i bletës?
  - e) Në cilin instrument muzikor shfaqet dhia e egër?

### Analizojmë tekstin

- 2 Qarkoni alternativën e saktë. Teksti paraqet informacione që janë më së shumti me natyrë:
 

a) biologjike;	b) gjeografike;
c) gjuhësore;	ç) kulturore;
d) letrare;	dh) historike.
- 3 Çfarë tregojnë vargjet e shkëputura nga Eposi i Kreshnikëve për kultin e dhive të egra?
- 4 Çfarë tipari të përbashkët mendohej se kishte kaprolli me njerëzit?
- 5 Cila është e përbashkëta që kanë nga pikëpamja e kultit, bleta dhe sorkadhja?

### Reflektojmë rreth tekstit

- 6 A ka nevojë për informacione shtesë secila pjesë e tekstit? Përse në këtë tekst mungojnë figurat letrare? Si duhet të jetë një tekst informues-paraqitës joletrar?

### Detyrë

- ▣ Shkruani në fletore një tekst informues-paraqitës për karakteristikat e bletës si insekt, pa u ndalur kësaj radhe te vendi që zë ajo në besimet popullore.

### Bashkëbisedojmë

- ▣ Bashkëbisedoni rreth kulteve të këtij teksti. A vlerësohen sot këto lloje kafshësh, shpendësh ose insektesh ashtu si dikur? Kërkoni ndihmën e prindërve ose të mësuesit/es për t'u përgatitur për këtë temë.

# Zogjtë

## Akrobatë, prijës dhe anëtarë të thjeshtë: ja rregullat e një tufe



Një tufë zogjsh në fluturim kryen akrobaci pa pasur nevojë për urdhrat e një prijësi, duke ndërruar drejtim papritur e papandehur, duke u ndarë në dysh pa e humbur orientimin, apo duke u ulur në tokë pak sekonda për t'i shpëtuar një grabitqari. Se si është e mundur që një sistem shumë i ndërlikuar i mijëra individëve vetëm pak centimetra larg njëri-tjetrit arrin të veprojë si një njeri i vetëm, duke ndryshuar drejtim, dendësi dhe lartësi brenda pak çastesh, është një mister që ngjall kureshtjen jo vetëm të *etologëve*, por edhe të fizikanëve. Ja përse një grup studiuesish të universitetit të Budapestit ka nisur

të hetojë *dinamikat* e një tufe pëllumbash në fluturim, duke iu lidhur në shpinë një GPS të vogël, 16 gramë, dhe duke mbajtur shënim ndryshimet e kursit të fluturimit plot 5 herë në sekondë.

Studimi hungarez botohet sot nga revista shkencore *Nature*. Rregulla e sjelljes së përgjithshme të një tufe është se pjesëtari i tufës që ndodhet pas, ndjek atë që ka përpara. Sistemi duket tej mase hierarkik. “E megjithatë, *hierarkitë* janë të ndryshueshme dhe roli i çdo zogu të veçantë mund të ndryshojë pareshtur”, – shpjegon Dora Biro, studiuese në Universitetin e Oksfordit, që ka marrë pjesë në studim. “Ky sistem i ndërkëmbyeshëm prijësish dhe vartësish, në të cilin edhe hierarkitë më të ulëta kanë peshën e tyre dhe mund të japin ndihmesë, përbën një sistem shumë efikas për të marrë vendime.”

Të joshur nga shfaqja e tufave të zogjve që përvijojnë figura të çuditshme në qiellin e Romës, edhe fizikanët e universitetit *La Sapienza* iu përkushtuan studimit të zogjve. “Çdo mbrëmje, plot tre dimra rresht, u ngjitëm në çatinë e muzeut të *Pallatit Massimo* dhe fotografuam *formacionet* e tufave të zogjve”, – shpjegon Andrea Kavanja, fizikan i Institutit të Sistemeve Komplekse të Këshillit Kombëtar të Studimeve dhe anëtar i projektit evropian *Superflag*, që ka marrë financime nga Bashkimi Evropian dhe ka përfshirë punën e shtatë instituteve evropiane të fizikës. Pasi u shkrepën mijëra fotografi të zogjve në fluturim, studiuesit ndërtuan me shumë durim, në tre përmasa, ndryshimin e formës, drejtimin dhe dendësisë së tufave. Studimi i tyre rreth formës *kaleidoskopike* të fluturimit të zogjve romanë është botuar në vitin 2008, në gazetën zyrtare të Akademisë Kombëtare të Shkencave të ShBA-së.

### Fjalor

*etolog* – studiues që merret me studimin e sjelljeve të kafshëve.

*dinamikë* – lëvizjet e trupave.

*hierarki* – këtu: rendi i

përgjegjësive, nga më të ulëtat deri në më të lartat.

*formacion* – këtu: mënyra e vendosjes.

“Në tufat shumë të mëdha, që grupojnë deri në dhjetë mijë individë, prishet çdo lloj sistemi udhëheqjeje”, – shpjegon Kavanja. Edhe rregulla e ndjekjes së atij që ke përpara nuk bën punë. E megjithatë, grupet e zogjve arrijnë të vizatojnë në qiell forma që ndryshojnë sekondë pas sekonde pa e humbur kompaktësinë, pa ndryshuar pozicionin ndaj shokëve dhe për më tepër pa u përplasur me njëri-tjetrin. “Çdo tufë, – shpjegon fizikani roman, – merr si referim një grup të vogël individësh të tjerë, përgjithësisht gjashtë ose shtatë, jo domosdoshmërisht pranë tij. I mjafton të lëvizë në *unison* me ta për t’u bërë pjesë e një grupi unik. Krijohet kështu një sistem kontrolli i shpërndarë, ku mjafton të ndjekësh rregulla të thjeshta për të arritur një lëvizje kolektive shumë komplekse”.

Të heqësh një paralele midis shoqërisë së njerëzve dhe tufave të zogjve është një objektivi që shkon përtej synimeve të kërkuesve. “Po merremi me studimin se si mund të udhëheqim një grup mikrorobotësh. Duke marrë shkas nga sjellja e vetorganizuar e zogjve, në vend të një kontrolli të *centralizuar*, mund të gjendet zgjidhja më frytdhënëse për të ruajtur koordinimin e lëvizjeve të një grupi robotësh të vegjël fluturues”. Një grup tjetër fizikanësh në Romë, i kryesuar nga Irene Xhardina, ka marrë një financim nga Instituti Italian i Teknologjisë në Gjenovë. “Por këtë herë s’do të merremi me zogjtë, do të ndjekim mizat e vogla”, shpjegon Kavanja, që ka filluar të endet me biçikletë fshatrave përreth kryeqytetit në kërkim të vendeve të lagështa plot me *luzma* mizash të vogla.



## Fjalor

*kaleidoskopike* – këtu: që të befason me pamjen.

*unison* – në mënyrë të njëjtë.

*të centralizuar* – të përqendruar.

*luzma* – tufa.

**Titulli** i një shkrimi, artikulli apo reportazhi është tepër i rëndësishëm, pasi është elementi i parë me të cilin përballet lexuesi/ja.

Ndaj, zakonisht autorët zgjedhin një titull që tërheq vëmendjen, që përshkruan përmbajtjen e tekstit ose që zgjon kërshërinë e lexuesve/eve për ta lexuar tekstin më tej. Një mënyrë për ta bërë titullin tërheqës është edhe përdorimi i fjalëve të pazakonta. Shpesh titulli shoqërohet edhe me nëntitull.

**Nëntitulli** është një rresht i dytë i vendosur poshtë titullit, që zgjeron e çon më tej atë çka thotë titulli ose informon më tepër rreth shkrimit. Si rregull, dallimi mes titullit e nëntitullit bëhet me anë të madhësisë së shkronjave ose llojit të shkrimit të përdorur.

## Studim teksti

### Analizojmë tekstin

- 1 Në secilin prej paragrafëve të këtij teksti dalloni nga një fakt:

Paragrafi 1	
Paragrafi 2	
Paragrafi 3	
Paragrafi 4	

- 2 Si e kuptoni frazën: “Të heqësh një paralele midis shoqërisë së njerëzve dhe tufave të zogjve është një objektivi që shkon përtej synimeve të kërkuesve.”?

### Gjuha e tekstit

- 3 Fjala e nënvizuar në fjalinë “Të joshur nga shfaqja e tufave të zogjve që përvijojnë figura të çuditshme në qiellin e Romës”, mund të zëvendësohet me fjalën:

krijojnë;  formojnë;  vizatojnë;  vijëzojnë.

- 4 Nënvizoni të gjitha fjalët apo frazat e gjuhës formale në shkrimin e mësipërm:

P.sh.: *merr si referim...*, *duke marrë shkas nga...*

# Gjashtë këshilla për të rritur pasionin për të lexuar

## Para leximit

Këshillat janë udhëzime që i jepen dikujt për ta ndihmuar ose për ta mësuar si duhet të sillet a si duhet të veprojë, për ta ndihmuar që të korrigjojë të metat, të ndreqë gabimet etj.

Këshillat e mëposhtme na ndihmojnë që të orientohemi mes botimeve të shumta dhe të zgjedhim ato që përputhen me interesat tanë. Qëllimi i tyre është që të bëjmë pjesë të pandarë të jetës leximin dhe të marrim kënaqësi prej tij.

1. Zgjidh gjithnjë libra që përshtaten me moshën dhe aftësitë e tua.
2. Provo të lexosh libra me tema të ndryshme dhe të llojeve të ndryshme, në mënyrë që të përcaktosh cilët mund të të japin më shumë kënaqësi.
3. Angazhohu seriozisht dhe me këmbëngulje në leximin e njëzet-tridhjetë faqeve të para të një libri, në mënyrë që "të kapësh thelbin e librit". Ka libra që të bëjnë për vete që në faqen e parë, ndërsa të tjerë kërkojnë më shumë kohë për të të tërhequr.



4. Pasi arrin "ta kapësh thelbin e librit", mos ki ndrojtje të kapërcesh rreshta apo edhe fragmente të tëra që nuk të interesojnë. Kur lëmë pa lexuar pjesë të caktuara të një libri, ne arrijmë të krijojmë një vizion tonin për librin dhe kjo na bën të ndihemi aktivë. Gjithsesi, nuk duhet abuzuar me këtë praktikë, sepse, po të veprojmë vazhdimisht kështu, mund të na krijohet një lloj zhgënjimi si ai që provojmë kur shëtitim nga njëri kanal në tjetrin me telekomandën e televizorit për të kërkuar një program që na intereson.
5. Mbjaj shënim titullin e një libri për të cilin dëgjon fjalë të mira (nga një shok, në televizor etj.) dhe blije në rastin më të parë. Nuk duhet shtyrë për më vonë blerja e një libri, edhe pse aty për aty nuk kemi kohë për të lexuar, sepse herët a vonë, do të paraqitet rasti për t'i kushtuar kohë leximit dhe atëherë do të kënaqemi pa masë që kemi mundësi të lexojmë një libër që i përshtatet shijes sonë.

6. Në fund të leximit, vlerëso cilat aspekte të librit të kanë pëlqyer më shumë dhe cilat të kanë lënë në mëdyshje. Me fjalë të tjera, shikoje me sy kritik librin që ke lexuar. Ky vlerësim do të të japë mundësi të diskutosh për librin në bisedat me miqtë, duke të dhënë argumente të vlefshme për t'ua këshilluar ose jo të tjerëve, dhe do të të kujtojë ato pjesë të librit që ndoshta do të doje t'i lexoje sërish pas disa vitesh.

M. T. Serafini



## Studim teksti

### Kuptojmë tekstin

- 1 Lexoni tekstin dhe përgjigjuni pyetjeve.
  - a) Sa këshilla përmban teksti i mësipërm?
  - b) Për çfarë shërbejnë ato?
  - c) A e kupton një libër, nëse kapërcen rreshta dhe fragmente që nuk të interesojnë?
  - ç) Çfarë duhet të bësh kur dëgjon fjalë të mira për një libër?
  - d) A duhet të blesh libra kur nuk ke kohë për të lexuar?
  - dh) Çfarë duhet të bësh kur përfundon së lexuari një libër?

### Analizojmë tekstin

- 2 A mund të lexojmë çdo lloj libri që na bie në dorë? Pse?
- 3 Përse janë të rëndësishme njëzet-tridhjetë faqet e para të një libri?
- 4 Pse është i rëndësishëm vlerësimi i librit që kemi lexuar?

### Gjuha e tekstit

- 5 Gjeni në tekst folje të mënyrës urdhërore. Përse përdoren ato?
- 6 Në tekst përdoren edhe folje në mënyrën dëftore, koha e tashme, veta e parë shumës, të tilla si: *lëmë, arrijmë, veprojmë, provojmë* etj. Si mendoni, çfarë funksioni kanë këto folje? Shënoni me ✓.
  - Duket sikur autori i tekstit na shoqëron kur zgjedhim një libër.
  - Këto folje përdoren, pasi veprimet do t'i kryejmë ne, lexuesit/et.
  - Autori krijon efektin e bashkëpunimit me lexuesin/en e këshillave.

### Detyrë

- Shkruani pesë këshilla për të rritur përqendrimin gjatë një ore mësimore. Kujdesuni që t'i shkruani qartë këshillat, në mënyrë që të jenë sa më të kuptueshme. Shkruani sipas një ecurie logjike, duke i shpjeguar veprimet hap pas hapi. Përdorni vetën e dytë, sepse ju ndihmon për të orientuar lexuesit/et.

## Shkruajmë një plan për një projekt

- Një plan pune është përcaktimi i objektivave dhe i proceseve, përmes së cilave, një grup ose një person synon të përmbushë qëllimet e tij në një projekt të caktuar, për një periudhë kohore të dhënë. Planet e punës janë kusht i domosdoshëm i organizmit dhe realizimit të një projekti. Nëpërmjet tyre, tërë procesi i planifikuar copëzohet në detyra të vogla dhe të arritshme.
- Mësoni si të shkruani një plan pune, në mënyrë që të jeni të përgatitur për projektet e ardhshme.

1

### Identifikoni qëllimin e planit të punës.

Planet e punës shkruhen për arsye të ndryshme. Përcaktoni qartë qëllimin e më pas filloni përgatitjen e planit. Kini parasysh që shumica e planeve të punës hartohen për një periudhë të caktuar kohe (p.sh.: 6 muaj, 1 vit, 3 vjet etj.).



2

### Përcaktoni objektivat tuaj.

Qëllimet dhe objektivat janë të lidhur, pasi tregojnë se çfarë shpresoni të përmbushni përmes planit tuaj të punës. Megjithatë, kini parasysh edhe dallimet: qëllimet janë të përgjithshme, kurse objektivat janë më të përcaktuara. Qëllimet kanë një fushëpamje të gjerë, që përqendrohet në rezultatin e dëshiruar përfundimtar të planit tuaj të punës. Objektivat janë specifike dhe të matshme.



3

### Përcaktoni saktësisht veprimtarinë që do të kryhet për të arritur objektivat tuaj.

Për këtë përgjigjuni pyetjeve: Saktësisht, çfarë do të bëjmë? Për këtë?



4

### Përcaktoni kohën kur do të kryhet veprimtaria.



5

**Renditni burimet tuaja.** Përfshini çdo gjë që do të jetë e nevojshme për të arritur qëllimet dhe objektivat tuaj. Burimet do të ndryshojnë, varësisht nga qëllimi i planit të punës. Në projektet shkollore, burimet mund të përfshijnë biblioteka të ndryshme; materiale kërkimore si libra, gazeta dhe revista; kompjuterin dhe kërkimet në Internet; si dhe profesorë ose individë të tjerë që mund t'ju ndihmojnë nëse keni pyetje.



6

**Identifikoni çdo kufizim.** Pengesat që mund të dalin në rrugën e arritjes së qëllimeve dhe objektivave tuaj duhet të identifikohen dhe të mendohet me prakticitet për të gjetur zgjidhjet e duhura. Për shembull, koha e shkurtër në dispozicion, mund të kërkojë shkurtimin e disa aktiviteteve, në funksion të realizimit të planit.



7

### Kush është përgjegjës?

Mund të ketë një grup njerëzish që punojnë në një detyrë, por një person duhet të jetë përgjegjës për kryerjen e detyrave në afatet kohore të përcaktuara. Llogaridhënia është thelbësore për një plan të mirë.



- Ndahuni në grupe dhe caktoni detyrat për të hartuar planin vjetor të punës së Senatit të shkollës, sipas skemës së dhënë.

Qëllimi i planit të punës:					
Objektivi 1:	Veprimtaria	Afati	Personat përgjegjës	Burimet	Komente
Objektivi 2:					
Objektivi 3:					
Objektivi 4:					
Objektivi 5:					

## Përparësitë dhe të metat e shpyllëzimit

### Para leximit

Në një tekst argumentues, autori ose autorja argumenton për një çështje të caktuar dhe përpiqet të bindë lexuesin/en duke dhënë argumente në mbështetje të idesë që ai/ajo ka. Shpeshherë, tekste argumentuese japin edhe argumentet, edhe kundërargumentet, për çështjen që diskutohet. I tillë është edhe teksti “Përparësitë dhe mangësitë e shpyllëzimit”, që jep të mirat dhe të këqijat e shpyllëzimit. Shpyllëzimi përbën një nga çështjet më të mprehta mjedisore dhe për të diskutohet gjerësisht në shumë vende të botës.

Shpyllëzimi është procesi i shkatërrimit të një pylli dhe zëvendësimi i tij me diçka tjetër. Sot, termi përdoret për t’iu referuar shkatërrimit të pyjeve nga njerëzit me qëllim përdorimin e tokave për sisteme bujqësore apo për ndërtimin e banesave. Për t’i kuptuar më mirë efektet e shpyllëzimit, duhet të njohim disa nga përparësitë dhe mangësitë e këtij procesi.

### Përparësitë e shpyllëzimit

#### 1. Sigurohen lëndë drusore dhe qymyr druri.

Me anë të kësaj metode, njerëzit mund të nxjerrin burime natyrore, të tilla si lëndë drusore dhe qymyr druri, të cilat mund të përdoren nga industritë dhe bizneset për rritje tregtare dhe ekonomike.

#### 2. Rriten mundësitë e punësimit.

Lënda e drurit që vjen si rezultat i shpyllëzimit, rrit kërkesën nga industritë e lëndëve të drurit, të prodhimit, transportit dhe ndërtimit për më shumë forca pune, të cilat bëjnë të mundur punën që lidhet me këto procese. Në këtë mënyrë, rriten mundësitë e punësimit dhe shtohen vendet e punës.

#### 3. Priten pemët e thara ose të sëmura.

Në disa raste, pemët priten për shkak të tharjes apo sëmundjes së tyre. Përmes shpyllëzimit, ato zëvendësohen me mbjelljen e fidanëve më të shëndetshëm.

#### 4. Zgjerohen sipërfaqet e banueshme.

Ndodh shpesh që tokat e shpyllëzuara të përdoren për të ndërtuar shtëpi. Kështu, çmimet e banesave do të jenë më të leverdishme dhe këto të fundit do të ndërtohen në një terren më të qëndrueshëm.



## 5. Hapen më shumë toka bujqësore.

Përmes spastrimit të një sektori pyjor, njerëzit kanë hapësirë të mjaftueshme të tokës për qëllime bujqësore. Në këtë mënyrë, prodhimi bujqësor rritet, çka sjell përmirësimin e jetesës për banorët e zonës.

## Të metat e shpyllëzimit

### 1. Dëmton kafshët e egra dhe shkatërron mjedisin e tyre të banimit.

Pemët shërbejnë si shtëpi, si burim ushqimi dhe mbrojtjeje për kafshët e inktet. Ato janë element kryesor në një ekosistem, dhe pa to, i gjithë rajoni do të ndikohej, me shumë mundësi, duke çuar në zhdukjen masive të kafshëve.

### 2. Lë gjurmë në mjedis.

Shpyllëzimi mund ta shndërrojë një zonë me pemë të bukura të gjelbëruara e të shëndetshme, në një djerrinë të pistë. Gjatë kohës së shpyllëzimit, mund të rritet edhe ndotja akustike, për shkak të pajisjeve që përdoren për të prerë pemët.

### 3. Ndikon negativisht në kushtet e klimës.

Gjasat janë që shpyllëzimi të ndikojë ndjeshëm tek efekti serrë, sepse me prerjen e pemëve nuk do të jetë e mundur që niveli i dioksidit të karbonit të ulet në atmosferë. Të gjithë e dimë se bimët e përdorin këtë gaz për të kryer proceset jetësore.

### 4. Shkakton erozion të tokës.

Sipas Fjalorit të Trashëgimisë Shkencore Amerikane, pemët parandalojnë procesin e shkretimit dhe erozionit. Shpyllëzimi mund ta transformojë tokën, që ishte e përshtatshme njëherë e një kohë për bujqësi, në një shkretëtirë.

### 5. Ndikon në ciklin e ujit.

Pemët dhe bimët janë thelbësore për procesin e qarkullimit të ujit në natyrë, kështu që nëse priten, uji nuk do të kthehet më në atmosferë nëpërmjet avullimit. Për pasojë, klima do të bëhet më e thatë.


Në përgjithësi, shpyllëzimi cilësohet si një proces mjaft negativ. Përfitimet ekonomike që mund të vijnë janë afatshkurtra dhe nuk i tejkalojnë aspektet pozitive të pemëve në mjedis. Përveç kësaj, kritikët thonë se shumë nga përfitimet ekonomike që vijnë nga shpyllëzimi janë të paqëndrueshme dhe se këto të ardhura mund të sigurohen me mënyra të tjera, përmes ruajtjes së pyjeve dhe pemëve që janë mbjellë tashmë.

## Studim teksti

### Kuptojmë tekstin

- 1 Lexoni tekstin dhe përgjigjuni pyetjeve.
  - a) Çfarë është shpyllëzimi?
  - b) A është e mundur që të ndërtohen banesa në zonat e shpyllëzuara?
  - c) Si ndikon shpyllëzimi në rritjen e prodhimit bujqësor?
  - ç) Çfarë mund të ndodhë me kafshët në një zonë që shpyllëzohet?
  - d) Si ndikon në klimë shpyllëzimi i zonave të caktuara?
  - dh) Çfarë ndodh me tokën e shpyllëzuar?
  - e) A është i bukur një mjedis i shpyllëzuar? Argumentoni përgjigjen.

### Analizojmë tekstin

- 2 Në një plan afatgjatë, a duhet zgjedhur shpyllëzimi si mënyrë për të rritur ekonominë?
- 3 Në tekstin e mësipërm, autori ka paraqitur si përparësitë, ashtu edhe të metat e shpyllëzimit. Si mendoni, çfarë qëndrimi mban ai vetë ndaj shpyllëzimit? Është pro apo kundër këtij procesi? Argumentoni përgjigjen.
- 4 Teksti mbyllet me një pyetje për lexuesin/en. Interpretoni çfarë funksioni ka ajo. Shënoni me .
  - Është ftesë për të reflektuar rreth përparësive të shpyllëzimit.
  - Do të ndërgjegjësojë lexuesin/en për pasojat e shpyllëzimit.
  - Është pyetje retorike.
  - Fton lexuesin/en të mbajë qëndrim rreth përparësive dhe të metave të shpyllëzimit.

### Reflektojmë rreth tekstit

- 5 Çfarë çështjesh mjedisore janë shqetësuese në vendbanimin tuaj? Diskutoni rreth mënyrave të zgjidhjes së këtyre problemeve.

### Detyrë

-  Gjeni informacione rreth efektit serrë dhe shkruani se si lidhet shpyllëzimi me këtë efekt.

# A duhet të lejohen celularët në shkollë?

## Para leximit

*Debati për lejimin ose jo të celularëve në shkollë ka kohë që zhvillohet në vende të ndryshme të botës. Një studim në Britani zbuloi se shkollat që ndaluan celularët, kanë rezultate më të mira akademike. Sipas këtij studimi, kur nxënësit nuk shkojnë në shkollë me celularë me vete, rezultatet e tyre në mësim rriten në të njëjtën mënyrë sikur nxënësit të kishin bërë një javë më shumë mësim. Sakaq, ka ende shumë të tjerë që mendojnë se celulari duhet të merret në shkollë, për shkak të funksioneve pozitive që mund të ketë.*

Ja një pyetje që i mban disa prindër zgjuar gjatë natës: A duhet të lejohen fëmijët të mbajnë celularë në shkollë? Ka shumë nga ata që mendojnë se jo, teksa të tjerë mendojnë se fëmijët, për arsye të ndryshme, duhet t'i kenë me vete celularët në shkollë. Sipas një studimi të zhvilluar nga Qendra për Performancë Ekonomike, në Shkollën londineze të Ekonomikut, efekti i ndalimit të celularëve nga shkolla llogaritet sa thuhet një javë mësim shtesë. Studimi i quajtur "Ndikimi i celularëve në mbarëvajtjen e procesit mësimor", zbuloi se, pasi disa shkolla ndaluan celularët, rezultatet e testeve të nxënësve të moshës 16 vjeç u përmirësuan me 6,4 për qind. Ndalimi i celularëve solli përmirësime në rezultatet mësimore të nxënësve me arritje të dobëta, të cilët përfituan dyfish më shumë krahasuar me nxënësit mesatarë. Sipas studimit, ndalimi i përdorimit të celularëve në shkollë nuk pati efekt te rezultatet e nxënësve të shkëlqyer. Pra, për prindërit që duan të zhvillojnë perspektivat akademike të fëmijëve, përgjigjja ndaj pyetjes "A duhet të lejohen fëmijët të mbajnë celularë në shkollë?" është "jo".

Zbulimet e këtij studimi i shtohen debatit rreth qasjes së fëmijëve ndaj celularëve. Në Britaninë e Madhe, më shumë se 90 për qind e adoleshentëve zotërojnë një celular, në ShBA, rreth një ndër katër fëmijë ka një të tillë. Por mbizotërimi i pajisjeve teknologjike është një problem për mësuesit, të cilët tanimë përballen me këtë dukuri kaq të përhapur.

Sipas një sondazhi të kryer në vitin 2001, asnjë shkollë nuk i kishte ndaluar celularët. Deri në vitin 2007, 50 për qind e shkollave e kishin ndaluar përdorimin e celularëve në shkollë, ndërsa në vitin 2012, rreth 98 për qind të shkollave nuk i lejonin celularët në ambientet e tyre ose kërkonin që ata të dorëzoheshin në fillim të ditës. Po ashtu, ka nga ato shkolla ku ka filluar të lejohet përdorimi i kufizuar i telefonave celularë.

Përparimet teknologjike shihen shpesh si nxitëse të produktivitetit.



Teknologjia moderne përdoret në klasa për të ndihmuar më shumë nxënësit në ilustrimin e shembujve. Megjithatë, ajo mund të çojë në shpërqendrim.

Nga ana tjetër, personat që mbështesin lejimin e celularëve në shkollë japin një sërë argumentesh. Celularët mund të shërbejnë për të gjurmuar aktivitetin e fëmijëve, me anë të programeve të caktuara që u lejojnë atyre të dinë se çfarë bën fëmija në celular dhe ku ndodhet ai.

Gjithashtu, celularët shërbejnë si mjet emergjence. Ndalimi i celularëve në shkolla mund t'i nxisë shumë fëmijë të mos i marrin fare me vete. Por celularët përdoren edhe si mjet komunikimi për situata tepër të vështira, kur fëmija ka nevojë për ndihmën prindërore. Një tjetër argument që jepet, ka të bëjë me funksionimin e celularit si “bllok shënimesh” dhe po ashtu, me lehtësinë për të hyrë në internet përmes tij për të gjetur informacionin e nevojshëm menjëherë.

Krahas këtyre argumenteve, thuhet edhe se celularët mund të përdoren si mjet masiv komunikimi. Duke krijuar rrjete të tilla komunikimi ose duke shfrytëzuar ato që kanë, mësuesit mund ta përdorin celularin për të shpërndarë informacion më shpejt. Ata mund të qëndrojnë në kontakt edhe me prindërit e fëmijëve.

## Studim teksti

### Kuptojmë tekstin

- 1 Lexoni tekstin dhe përgjigjuni pyetjeve.
  - a) Çfarë i shqetëson prindërit e nxënësve?
  - b) Si quhet studimi i kryer për efektet e ndalimit të celularit në shkollë?
  - c) Në cilin vit lejohej përdorimi i celularëve në shumicën e shkollave?
  - ç) Cilët nxënës kanë përfituar më shumë (sipas studimit) gjatë kohës që telefoni celular nuk u lejua në shkollë?
  - d) Për çfarë përdoret teknologjia moderne në klasa?

### Analizojmë tekstin

- 2 Si nis teksti? Përse shërben një nisje e tillë?
- 3 Ku është kryer studimi që përmendet në tekst dhe çfarë argumentesh jep në lidhje me lejimin e celularëve në shkollë?
- 4 Plotësoni tabelën me argumente nga teksti.

Argumente pro lejimit të celularëve në shkollë	Argumente kundër lejimit të celularëve në shkollë

### Gjuha e tekstit

- 5 Gjeni në tekst të dhënat që jepen me shifra.
  - ▣ Përse përdoren ato?
  - ▣ A janë njësoj të besueshme dhe bindëse argumentet që nuk shoqërohen me shifra?

## Studim teksti

- 6 Gjeni fjalë e shprehje që lidhen me fushën e studimit (hulumtimit) dhe me fushën e teknologjisë.
- 7 A përdoret gjuha e figurshme në këtë tekst? Argumentoni përgjigjen.

## Detyrë

- ▣ Diskutoni të ndarë në grupe nëse duhet që ju dhe bashkëmoshatarët tuaj të përdorni telefonat celularë brenda dhe jashtë mjedisit të shkollës.

## Shkruajmë

## Si të shkruajmë një ese argumentuese

Eseja argumentuese është një shkrim, i cili synon të bindë lexuesin/en për vërtetësinë e një çështjeje nëpërmjet argumenteve dhe shembujve të shumta, të cilat janë në përputhje me qëndrimin e shkruesit.

## Hapi i parë

Shkruani hyrjen e esesë, duke shpjeguar shkurtimisht temën që ju është dhënë.

## Hapi i dytë

Formuloni tezën tuaj. Teza është një pohim i qartë, që përmbledh pikëpamjen tuaj për çështjen që do të argumentoni. Teza shfaqet zakonisht në fund të paragrafit hyrës.

**Shembull:** Konsumi i përditshëm i mishit të kuq, ndikon negativisht në shëndetin e njeriut. (Kjo tezë lidhet me një temë të debatueshme dhe interesante për t'u argumentuar.)

## Hapi i tretë

Shkruani zhvillimin e esesë. Formuloni dhe strukturoni argumentet tuaja. Mbështetini ato me fakte, shembuj dhe prova.


**Shembull:** Renata Miça, profesore në sektorin e Shëndetit Publik në Harvard, deklaron se për të ulur rrezikun e prekjes nga sëmundjet e zemrës dhe diabetit, duhet shmangur konsumi i mishit të përpunuar, p.sh.: sallamra, proshuta etj., transmeton Lajmi.net.

Përdorni fraza që i përshtaten natyrës së tij. Ato krijojnë mundësinë për të shprehur opinionet, për të mbrojtur qëndrimin tuaj, për të renditur faktet, shembujt etj. Disa prej tyre janë: *Unë besoj se...; Ka shumë arsye për të mbështetur tezën time, të cilat përfshijnë...; Arsyeja e parë është...; Në radhë të parë...; Për më tepër...; Mund edhe të thuhet...; Në vijim të...; Për të përmbledhur argumentet...; Si përfundim... etj.*

## Hapi i katërt

Shkruani mbylljen e esesë. Ju mund të zgjidhni forma të ndryshme mbylljeje, por në thelb të saj qëndron përfundimi i nxjerrë nga argumentet e dhëna, në formë të përmbledhur. Pra, është një rimarrje e tezës, që tashmë është vërtetuar, dhe shprehet me fjalë të tjera.

- ▣ Shkruani një tekst argumentues rreth dobisë së gjelbërimit në ambientin ku jetojmë.



## Përshkruajmë në mënyra të ndryshme

### Para leximit

Dy tekstet e mëposhtme janë përshkruese. Në to përshkruhen dy kafshë: ariu i zi amerikan dhe hardhuca. Tekstet ndryshojnë nga njëri-tjetri, jo vetëm për shkak të kafshës që përshkruajnë, por edhe për shkak të mënyrës se si e realizojnë përshkrimin: në mënyrë objektive dhe në mënyrë subjektive.



### Ariu i zi

Ariu i zi amerikan është një mishngrënës trupmadh që, kur ngrihet mbi gjymtyrët e pasme, arrin edhe më shumë se dy metra lartësi. Ka qime të dendura e të kreshpëruara me ngjyra që shkojnë nga e zeza te kafja, e verdha dhe e bardha. Turirin e ka ngjyrë kafe dhe përgjithësisht më të çelur se pjesën tjetër të trupit; bishtin e ka të shkurtër dhe thujt të fshehur.

Ariu ecën duke u mbështetur në katër putra me pesë gishta, të pajisur me kthetra të mëdha. Ai arrin të zhvendoset edhe duke u mbështetur vetëm mbi këmbët e pasme. Pavarësisht shtatit të bëshëm, është kacavjerrës i zoti dhe vrapues i shpejtë: arrin të vrapojë deri pesëdhjetë kilometra në orë.

M. de Jong

### Hardhuca


Atë ditë, kishte një dritë të bukur dhe hardhuca që kisha përpara, rrinte krejt pa lëvizur me trupin e lakuar, kthetrat e zgjatura dhe turirin e kthyer nga ne.

Dukej si e ngurtësuar nga ndonjë magji.

Po e soditja atë krijesë si të mos kisha parë kurrë një të tillë: ata dy sy me bebëza të zeza si qymyri në një iridë të verdhë; ato katër kthetra aq të shkathëta; atë bisht të gjatë që aq herë ishte këputur në gishtat e mi, kur isha djalë dhe shkoja për gjueti hardhucash në muret që rrethonin pellgun e ujit.

Lëkura e veshur me luspa ishte një kryevepër ngjyrash që ndryshonin në varësi të pasqyrimin të dritës. Tërë trupi përpiqej t'i jepte hare vështrimin të saj.

M. Roland



### Përshkrimi objektiv

Kur përshkruajmë nëpërmjet një morie të dhënash objektive për të informuar lexuesin/en rreth pamjes së objektit/frymorit që përshkruajmë, cilësive, karakteristikave, pa shprehur kurrësi përshtypje, emocione, ndjesi, vlerësime, kemi realizuar një përshkrim objektiv. Përdoren dëndur terma specifike apo mbiemra.



## Studim teksti

## Kuptojmë tekstin

- 1 Lexoni tekstin dhe përgjigjuni pyetjeve.
  - a) Cilat kafshë përshkruhen në tekstet e mësipërme?
  - b) Çfarë të veçante kanë ato?
  - c) Si përshkruhet ariu i zi? Po hardhuca?
  - ç) Sa është shpejtësia maksimale që mund të arrijë ariu i zi?
  - d) Ku qëndron hardhuca teksta e përshkruan autori?

## Analizojmë tekstin

- 2 Plotësoni tabelën e mëposhtme për ariun e zi dhe hardhucën. A mund t'i plotësoni të gjithë rreshtat e saj për secilën nga kafshët?

Lloji i kafshës		
Karakteristikat fizike		
Aftësitë		
Veçantitë		
Përshtypja e autorit për të		

- 3 Ç'lloj përshkrimi është ai i ariut të zi: objektiv apo subjektiv? Argumentoni përgjigjen.
- 4 Po përshkrimi i hardhucës, çfarë lloji është: objektiv apo subjektiv? Argumentoni përgjigjen.

## Interpretojmë tekstin

- 5 Si duhet ta ketë marrëdhënien me natyrën autori i tekstit të hardhucës?
- 6 Gjeni dhe interpretoni frazat që shprehin qëndrim subjektiv dhe përshtypje personale.

## Gjuha e tekstit

- 7 Plotësoni tabelën e mëposhtme.

Mbiemra dhe terma specifike që përdoren për të përshkruar ariun e zi.	Krahasime dhe similituda që përdoren për të përshkruar hardhucën.

## Detyrë

- 📌 Përshkruani në mënyrë objektive dhe subjektive një nga kafshët që ju pëlqen më shumë.

## Përshkrimi subjektiv

Kur përshkruajmë në mënyrë personale, nëpërmjet mbresave, përshtypjeve dhe opinionëve kemi të bëjmë me përshkrim subjektiv... Autori e përshkruan objektin/ frymorin nga këndvështrimi i tij, ashtu siç i duket atij në atë çast të veçantë, duke shprehur tërë emocionet.

Subjektiviteti shfaqet sidomos nëpërmjet gjuhës së pasur me krahasime për të shprehur gjykimet dhe opinionet e shpeshta të autorit.

# Vendi me më shumë libra sesa banorë

## Para leximit

Teksti i mëposhtëm përshkruan karakteristikat e një qyteti që është disi i pazakontë, sepse atje, kudo të sheh syri libra. Hollësitë e shumta e bëjnë më të gjallë dhe më të prekshëm përshkrimin. Tekstet që përshkruajnë vende, përfshijnë përshkrime të hollësishme rreth emrit dhe pozicionit gjeografik të vendit që përshkruhet; rreth klimës, natyrës, njerëzve dhe mënyrës së jetesës. Teksti që do të lexoni, megjithatë, përqendrohet te përshkrimi i asaj që e bën të veçantë këtë qytet, krahasuar me të tjerët.



## Fjalor

*fjord* – gji deti i thellë dhe i ngushtë, me brigje të larta e të thepisura: fjordet e Norvegjisë.  
*letargji* – gjumë dimëror.  
*surreal* – i pavërtetë, i pazakonshëm, si në imagjinatë.

Mirë se vini në Mundal, i njohur edhe si qyteza norvegjeze e librave! Kjo qytezë ndodhet në Norvegjinë Perëndimore dhe numëron rreth 280 banorë, thuhet të gjithë fermerë, por më shumë se 150 mijë libra. Syri të zë shtëpi të bukura prej druri që gjenden fare pranë *fjordit*, ndërsa në mes të qytetit, një kishë, e cila daton në vitin 1860. Qyteti piktoresk, me natyrë të mrekullueshme dhe ngjyra të këndshme, është disi i izoluar dhe deri në mes të viteve 1990 atje mund të shkohej vetëm me varkë. Në vitin 1996, qyteza iu bashkua projektit “Qytet librash”, duke u bërë kështu një qytet letrar.

Në Mundal vijnë turistë nga e gjithë bota, të cilët i bashkon një pasion i vetëm: dashuria për librat. Aty, librat dhe libraritë ndodhen kudo: në stalla të vjetra, në dyqane të dorës së dytë, në lokale, në galeri arti, në raftet përgjatë bregdetit, madje edhe në kabinat e vjetra telefonike. Po ashtu, ndërtesat publike dhe libraritë kanë një tematikë të caktuar, për shembull: histori, art, udhëtime, letërsi etj. Rruga kryesore e qytetit është e mbushur me raftet, me libra të vjetër apo të përdorur. Një libër kushton rreth 1 euro. Për t'i blerë, mjafton t'i fusni paratë në arkë. Askush nuk rri që të ruajë librat që shiten.

Në arkën e parave shkruhet fjala “nder”, pra çdokush supozohet të jetë i ndershem që të paguajë për librin që merr. Nga ana tjetër, në Mundal mirëprehen librat që çdokush mund të ketë për të dhuruar.

Në qytezën norvegjeze të librave, libraritë janë të hapura nga mesi i majit deri në shtator. Nga tetori e më pas, qyteza hyn thuhet në *letargji*, për t'u rizgjuar nga fundi i prillit. Sidoqoftë, Mundali është gjallëruar falë librave, aktiviteteve e festivaleve letrare.

Ky vend është i mrekullueshem, gati *surreal*. Në Mundal, turistë nga pothuaj të gjitha vendet vijnë për gjueti librash. Sot në botë ekzistojnë rreth 20 “Booktown”. Librat dhe libraritë janë arsyeja pse



ekzistojnë këto qytete letrare, parajsa për ata njerëz që lexojnë. Megjithatë, Mundali nuk është i vetmi vend që numëron më shumë libra se banorë. *Hay-on-Wye* në Uells, numëron 1400 banorë, më shumë se 40 librari e biblioteka dhe rreth 2 milionë vëllime librash. Qyteti anglez i librave është krijuar në vitin 1961 nga Riçard Both. Ndërsa sot *platforma* lidh të gjitha “qytetet letrare” të planetit, nga Evropa në Malajzi, e deri në Australi. Mjafton t’i vizitoni këto qytete dhe të zhyteni në magjinë e librave të tyre, të prekni nga afër faqet e vjetruara, por plot aromë karakteristike, të romaneve që mezi presin t’iu *shpërfaqin* veten lexuesve.



## Fjalor

*platformë* – politika ose qëndrimi i deklaruar i një grupi të caktuar.  
*shpërfaq* – nxjerr në dukje.

## Studim teksti

### Kuptojmë tekstin

- 1 Lexoni tekstin dhe përgjigjuni pyetjeve.
  - a) Ku ndodhet qyteti i Mundalit?
  - b) Çfarë të veçante ka ky qytet krahasuar me qytetet e tjera?
  - c) Si shiten dhe blihen librat në Mundal?
  - ç) A është i vizitueshëm gjatë gjithë vitit qyteti i Mundalit?
  - d) Ku tjetër mund të gjenden librat në Mundal, përveçse në librari?
  - dh) Çfarë janë qytetet letrare?

### Analizojmë tekstin

- 2 Teksti që lexuat më sipër është tekst përshkrues objekti, vendi apo mjedisi?
- 3 Çfarë e bën Mundalin, parajsën e atyre që i duan librat?
- 4 A shkohet me lehtësi në Mundal?
- 5 A ka shumë figura letrare ky tekst? Ku ndryshon ai nga tekstet përshkruese letrare?

### Reflektojmë rreth tekstit

- 6 Përse në Mundal nuk ruhen librat që janë në shitje?
- 7 Në tekst jepen shumë hollësi në lidhje me vendin që zënë librat në qytezë. Çfarë roli kanë këto hollësi për përshkrimin?

## Shkruajmë

### Për të shkruar një ese përshkruese ndiqni këta hapa:

- ❑ Planifikoni punimin, duke bërë një skemë me pikat kryesore.
- ❑ Shkruani esenë. Respektoni strukturën hyrje-zhvillim-mbyllje. Përpiquni të përdornir sa më shumë mbiemra dhe ndajfolje.
- ❑ Rilexoni atë që shkruat, duke shtuar dhe hequr fjalë, në mënyrë që rendi i përshkrimit të jetë sa më i qartë (nga lart-poshtë, nga jashtë-brenda etj.).
- ❑ Rishikoni esenë. Vëreni nëse i jeni përshtatur plotësisht temës së dhënë. Rregulloni fjalët dhe fjalitë, nga kuptimi dhe nga ana gramatikore. Kujdesuni për drejtshkrimin dhe pikësimin.
- ❑ Ndajeni me të tjerët (dorëzoheni, lexojeni para të gjithëve, afshojeni në stenda apo në gazetën e shkollës etj.).


# Si të krijojmë një revistë

Krijimi i një reviste është, në vetvete, një projekt. Për ta realizuar atë, shkruani planin e punës sipas udhëzimeve që morët në mësimin "Shkruajmë një plan për një projekt".



## Gjatë shkrimit të planit të punës, mbani parasysh se duhet:

- të përcaktoni qëllimin për të cilin po krijoni një revistë;
- të përcaktoni strukturën dhe formatin e revistës;
- të zgjidhni bashkëpunëtorët dhe të ndani detyrat sipas aftësive (kryeredaktori, gazetarët e rubrikave, redaktorët, korrektorët letrarë, dizenjuesit etj.);
- të përcaktoni titullin që do të ketë revista (të jetë tërheqës, të ketë një kuptim që përputhet me qëllimin e krijimit të revistës);
- të caktoni detyra sipas pjesëve përbërëse të revistës: *kopertinë dhe faqe të brendshme*; të përcaktoni nëse revista do të botohet një herë në javë, një herë në muaj, një herë në tre muaj etj.;
- të caktoni afate për realizimin e detyrave;
- të përcaktoni burimet kryesore të informacionit:
  - burime audio, video dhe digjitale (interneti, videoteka);
  - tekste shkollore, studimore;
  - revista, albume, katalogë, guida, manualë;
  - dokumentarë, filma etj.;
  - ngjarje sociale, kulturore që lidhen me tematikën e revistës.



## Prezantimi i materialeve të realizuara

Pas shkrimit të planit të punës dhe ndarjes së detyrave, vijohet me prezantimin e materialeve të grupeve të punës. Secili nga këto grupe paraqet produktin që ka realizuar, i cili përmban informacion mediatik, përshkrues dhe analizues për një tematikë a fushë të caktuar. Në të dëshmohet puna në grup dhe aftësitë krijuese individuale, sidomos përmes paraqitjes vizuale.

Arritja e një produkti cilësor është rezultat i një pune të koordinuar mirë përmes bashkëpunimit dhe shkëmbimit të ideve. Takimet e grupit ndihmojnë në konsolidimin e ideve dhe dakordësimin e zgjedhjeve të bëra.

Kryeredaktori mban përgjegjësi për koordinimet dhe cilësinë e produktit final. Për këtë arsye, ai lexon dhe shqyrton materialet që paraqesin grupet e ndryshme të punës dhe bën vërejtjet e tij, duke i argumentuar ato.



## Finalizimi i revistës

Grupet e punës takohen me kryeredaktorin me qëllim që:

- ▣ të diskutojnë dhe të bien dakord për ndryshimet e mundshme;
- ▣ të përzgjedhin variantet më të mira;
- ▣ të organizojnë materialet dhe të përcaktojnë vendin që do të zënë në revistë.



Në fund të këtij procesi, të gjitha materialet përbërëse të revistës redaktohen dhe korrektohen.

Vetëm pas verifikimit të qartësisë gjuhësore, revista dorëzohet në shtyp për t'u shtypur (si dhe në grupin e punës që do ta hedhë *online*, në rast se është parashikuar në planin e punës një i tillë).

Shumë shpejt, ju do të mbani në duar kopjet e shtypura të krijimit tuaj, të cilat do të shpërndahen në publikun e synuar, prej të cilit do të prisni vlerësime.

Urime!

### Këshillë:

Tregoni kujdes me mbledhjen e vlerësimeve, sidomos të vërejtjeve. Më pas mund t'i rishikoni ato dhe t'i reflektoni në punët e ardhshme.



# Njohuri për gjuhën



# Histori gjuhe

## HISTORI GJUHE

Studion zhvillimin historik të një gjuhe në mënyrë që të shpjegojë gjuhën që përdoret sot.

Gjuha e folur

Gjuha e shkruar

Format e para  
të shkrimit  
njerëzor

Dokumentet  
e para të shkrimit  
shqip

Formula e Pagëzimit  
Fjalori i Arnold Fon Harfit  
Perikopeja e Ungjillit të Pashkëve

# Historik i shkurtër i gjuhës shqipe të shkruar



Çdo gjuhë ka historinë e saj, që është e lidhur ngushtë me historinë e popullit që e ka folur atë gjuhë në të kaluarën dhe që e flet tani. Historia e gjuhës shqipe është historia e një gjuhe të lashtë.

Por ndonëse është njëra nga gjuhët më të vjetra të Ballkanit, historia e zhvillimit të gjuhës shqipe dëshmohet relativisht vonë. Me këtë mbahet parasysh fakti se vepra e parë e shkruar shqip është "Meshari" i Gjon Buzukut, që mban datën 1555.


## Dokumentet e para të shkruara

Gjithsesi, duhet theksuar se edhe para veprës së Buzukut, gjuha shqipe është shkruar, çka dëshmohet nga dokumentet e para të shkruara në gjuhën shqipe, si:


- "Formula e pagëzimit" (1462),
- "Fjalori i Arnold von Harfit" (1497),
- "Perikopeja e Ungjillit të Pashkëve" (shek. XVI).

boicke	bukë
vene	verë
oie	ujë
mische	mish
jat	djathë
foeije	vezë
krup	kripë

Kujtojmë që dokumenti i parë i shkrimit në gjuhën shqipe, është "Formula e Pagëzimit". Ajo u shkrua nga Pal Engjëlli, një prift katolik, për të lejuar që pagëzimin e fëmijëve ta bënin vetë prindërit e tyre, kur nuk ishte e mundur që kjo ceremoni të zhvillohej nga një klerik. Ata mund të përdornin formulën në gjuhën shqipe, të cilën e shkruan kështu:







Ky dokument u shkrua në dialektin e veriut (gegërisht) dhe me alfabetin latin. "Vnte' paghesont premenit Atit et Birit et Spertit Senit" (Unë të pagëzoz në emër të Atit e të Birit e të Shpirtit Shenjtë).

Sa i përket udhëtarit gjerman Arnold von Harf, kujtojmë që gjatë vitit 1497, ai kaloi në bregdetin shqiptar (Ulqin, Durrës dhe Sazan). Në këtë periudhë, ai shënoi edhe disa fjalë të gjuhës shqipe, duke krijuar kështu dokumentin e njohur gjerësisht si "Fjalori i Arnold von Harfit". Ky fjalor përmban gjithsej njëzet e gjashtë fjalë, tetë shprehje, numrat nga një deri në dhjetë, numrat njëqind, një mijë, të cilët i shoqëroi me përkthimin në gjermanisht. Fjalët dhe shprehjet i përkasin përdorimit të përditshëm. Disa prej tyre paraqiten në tabelë (djathtas – lista e sjellë nga Arnold von Harfi, majtas – rishkrimi i fjalëve sipas normës së sotme letrare).

Një tjetër dokument me rëndësi për historinë e shqipes së shkruar, është "Perikopeja e Ungjillit të Pashkëve". Bëhet fjalë për një fletë të shkruar në gjuhën shqipe, e cila është gjetur brenda një kodiku greqisht, që i përket shekullit XIV. Gjithsesi, nisur nga analiza gjuhësore e tekstit në fjalë, studiuesi Lloshi gjykon se ky shkrim nuk mund të datojë para shekullit XVI.

Në njërën anë të fletës së gjetur, është shkruar një pjesë nga Ungjilli i Mateut, ndërsa në anën tjetër të saj, një këngë pashkësh. Në këtë fletë, shqipja është shkruar me alfabetin grek dhe në dialektin e jugut.

Dokumentimi i shqipes së shkruar vijoi me libra e shkrime të mëvonshme, nga shekulli XVI e deri në ditët tona.



## USHTRIME

- 1** Cilat janë dokumentet e para të shkruara në gjuhën shqipe? Shënoni me ✓.
  - Meshari,
  - Formula e Pagëzimit,
  - Fjalori i Arnold von Harfit,
  - Doktrina e krishtenë,
  - Perikopeja e Ungjillit të Pashkëve,
  - Çeta e profetëve.
- 2** Në cilin dialekt janë shkruar dokumentet e para në gjuhën shqipe? Shënoni me ✓.
  - Në dialektin e veriut.
  - Në dialektin e jugut.
  - Në dialektin e veriut dhe në dialektin e jugut.
- 3** Cili ishte qëllimi i hartimit të "Formulës së pagëzimit"?
- 4** Hulumtoni rreth veprimtarisë së Pal Engjëllit dhe hartoni një shkrim të shkurtër për të, nëpërmjet të cilit të nxirrni në pah cilësitë e vizionarit largpamës dhe humanitar.

# Fonetikë

## FONETIKA

Fonetika studion veçoritë e shqiptimit të tingujve të gjuhës, si dhe rrokjen, theksin, intonacionin etj.

### Fjalët përbëhen nga:

#### Zanoret:

a, e, ë, i, o, u, y

#### Bashkëtingëlloret:

b, c, ç, d, dh, f, g, gj, h, j,  
k, l, ll, m, n, nj, p, q, r, rr,  
s, sh, t, th, v, x, xh, z, zh

#### Rrokjet:

Fjalët ndahen në rrokje.  
Rrokjet janë të hapura  
dhe të mbyllura.

#### Theksi i fjalës:

Tregon rrokjen e fjalës  
që shqiptohet më fort.  
Theksin e fjalës zakonisht  
nuk e shkruajmë, por e  
shqiptojmë.

# Ndërrimet historike të fonemave në gjuhën shqipe

Kujtojmë se disa ndryshime fonemore shpjegohen me rregulla fonetike që veprojnë aktualisht në gjuhë, çka na ndihmon të shohim konkretisht ndikimin e tingujve mbi njëri-tjetrin, si pasojë e pozicionit apo e kombinimit të tyre. Kështu, për shembull, për fjalën **numër**, vihet re se folësit, jo rrallëherë, përdorin trajtën **numur**.

Ndryshe nga ato raste ku sot mund të shohim se si një tingull ndikon mbi një tjetër, ka disa ndryshime fonemore, të cilat mund të shpjegohen vetëm me anë të rregullave fonetike, që kanë vepruar kohë më parë në gjuhë, por që në ditët e sotme nuk veprojnë më si dikur. Këto ndryshime fonemore quhen **ndërrime historike**, pra, tashmë i përkasin historisë së gjuhës dhe mund të shpjegohen vetëm në kuadrin e saj.

Një pjesë e mirë e ndërrimeve historike shfaqen kryesisht në **format e ndryshme të së njëjtës fjalë**, për shembull, për ndërtimin e shumësit të emrave, si: *dash - desh*. Siç e dëshmon shembulli, për formimin e trajtës së shumësit të fjalës **dash** shërben ndërrimi i fonemës –a në –e.

Shumë ndërrime fonemore vihen re edhe në **formimin e kohëve të ndryshme të foljeve**, si për shembull: *dal - dola; pres - prita; marr - mora* etj. Pra, siç shihet nga këta shembuj, disa ndërrime shërbejnë për të kryer funksione gramatikore, pasi falë tyre bëhet dallimi i kuptimeve gramatikore, si numri, rasa, koha, veta etj.

Disa ndërrime dalin në **fjalë të ndryshme që kanë të njëjtën rrënjë**, si për shembull te çifti i fjalëve: *shok - shoqëri*, ku vihet re ndërrimi k-q.

**Ndërrime të tilla nuk kanë funksione gramatikore, pra nuk shërbejnë për të dhënë kuptime të ndryshme gramatikore.**

Për të shpjeguar si dhe pse kanë ndodhur këto ndërrime, përgjigjen duhet ta kërkojmë në proceset historike të gjuhës. Disa nga këto dukuri të shqipes janë shumë të hershme, kurse disa të tjera janë më të vona, por që të gjitha ato janë shfaqur qysh para dokumentimit shkrimor të kësaj gjuhe, pra para shekullit XVI.

## Disa lloje ndërrimesh fonemore

Ndërrimet fonemore i hasim më shpesh gjatë eptimit të foljeve dhe të emrave. **Me eptim kuptojmë trajtat e ndryshme që merr fjala sipas kategorive gramatikore të saj.** Ndërrimet mund të prekin sistemin e zanoreve ose të bashkëtingëlloreve.

### 1. Ndërrime zanoresh

Në gjuhën shqipe, ndër ndërrimet e zanoreve hasen më dendur dy dukuri që quhen **metafonia** dhe **apofonia**, por ka dhe raste të tjera.

Ndërrime zanoresh		
Llojet	Përshkrimi	Shembuj
Metafonia	Metafoni kemi atëherë kur zanoret më të hapura bëhen më të mbyllura, ose kur zanoret e prapme bëhen më të përparme.	djalë-djem shoh-sheh
Apofonia	Apofoni kemi në rastet kur zanoret më të mbyllura bëhen më të hapura, ose kur zanoret e përparme bëhen më të prapme.	dal-dola sjell-solla
Përzjerja	Përzjerja (krasis) ndodh në ato raste kur zanoret –ë, –e bashkohen për të dhënë zanoren –a: bashkimi të+e dha trajtën përemërore të bashkuar –ta.	të+e: ta më+e: ma
Kontraksioni	Quhet kontraksion mbledhja ose reduktimi i dy zanoreve në kontakt me njëra-tjetrën në një diftong ose në një zanore të gjatë.	voe: ve (vezë) ngae: nge

## 2. Ndërrime bashkëtingëlloresh

Në gjuhën shqipe, ndër ndërrimet e bashkëtingëlloreve hasen më dendur këto raste:

Ndërrime bashkëtingëlloresh	
Raste ndërrimesh	Shembuj
k-q	mik-miq; park-parqe
g-gj	zog-zogj; breg-brigje
s-t	shes-shet; flas-flet
ll-j	kungull-kunguj; yll-yje
r-j	lepur-lepuj; flamur-flamuj
r-rr	bjerr-bora; nxjerr-nxora

### USHTRIME

- 1** Dalloni nëse te çiftet e fjalëve të dhëna ka ndryshime pozicionale, kombinatorë apo ndërrime historike. Plotësoni tabelën e dhënë.

Numër - numur; erdhi - herdhi; dash - desh; dal - dola; bukëpjekës - bukpjekës; kinema - kino; bujk - bujq; mbrekulli - mbrekulli; diell - diej; bregore - bregole; bir - bij; kullë - k<sup>o</sup>ull; vend - vent; çjerr - çora; ekzistoj - egzistoj; shteg - shtek

Ndryshime pozicionale	Ndryshime kombinatorë	Ndërrime historike

- 2** Formoni shumësin e këtyre emrave. Nënvizoni ndërrimet fonemore.


breg, shteg, shëlg, treg, plak, djalë, kalë, lepur

## Ndryshimet pozicionale dhe kombinatorë të fonemave në gjuhën shqipe

Me ndryshime fonemore apo të fonemave kuptojmë ndryshimin e tingujve në një gjuhë të caktuar. Fjala “fonemë” vjen nga greqishtja e vjetër: *phone* - tingull, zë. Ndryshimi i tingujve vjen si pasojë e ndikimit të tyre mbi njëri-tjetrin. Kështu, për shembull, fonema *n* ndryshe shqiptohet kur ndiqet nga një zanore, si në rastin e fjalës *nesër*, ku ndiqet nga zanorja –e dhe ndryshe kur ndiqet nga një bashkëtingëllore e tillë si ajo –g, si në fjalën *kongres*.

Nëse folësi do ta shqiptonte të veçuar një fonemë, si p.sh. –n, –a, etj., do t'i kushtonte vëmendje artikulimit të këtij tingulli, domethënë, mënyrës se si e përdor aparatit të folurit (gjuhën, buzët, qiellzën, dhëmbët etj.) për prodhimin e një tingulli të caktuar. Në rrjedhën e të folurit, gjatë komunikimit, kuptohet që folësi nuk i kushton vëmendje të posaçme mënyrës se si i nyjton tingujt, pasi e përqendron vëmendjen te përmbajtja e thënies dhe fjalët i shqipton si një njësi e vetme, e gatshme, dhe jo si një tërësi tingujsh. Pra, vënia e aparatit të të folurit në lëvizje, për nyjetimin e tingujve të ndryshëm (si: hapja apo mbyllja e gojës, takimi i gjuhës me qiellzën, i buzës së poshtme me dhëmbët e sipërm etj.) realizohet në mënyrë mekanike dhe të pavetëdijshme për proceset fonetike që zhvillohen gjatë të folurit.

Pikërisht gjatë fazës nyjetimore, ndodh që tingujt ndikojnë te njëri-tjetri për arsye nga më të ndryshmet. Për shembull, fonema –s, tek fjala **asgjë**, shqiptohet –z (*azgjë*), për shkak se fonema –gj, ndikon mbi fonemën –s, duke shkaktuar ndryshim fonemor.



Disa ndryshime shpjegohen me rregulla fonetike që veprojnë aktualisht në gjuhë, çka na ndihmon të shohim konkretisht ndikimin e tingujve mbi njëritjetrin, si pasojë e pozicionit apo e kombinimit të tyre. Për këtë arsye, janë quajtur **ndryshime pozicionale** dhe **kombinatorë**.

## 1. Ndryshimet kombinatorë

Me ndryshime kombinatorë kuptojmë atë **ndryshim fonemor që vjen si rezultat i ndikimit të një tingulli mbi një tjetër**, si rezultat i kombinimit, i fqinjësisë mes tyre. Siç e thamë më lart, nyjetimi i një tingulli ndikohet nga një tingull që i prin apo e ndjek atë, duke bërë që ky të mos shqiptohet gjithnjë njësoj. Në ndryshimet kombinatorë bëjnë pjesë: **akomodimet (përshtatja), asimilimi, disimilimi, metateza, shtesat, rëniet e tingujve**. Në tabelën e mëposhtme jepen shkurtimisht përkufizimi dhe shembuj për secilin rast.

Ndryshime kombinatorë		
Llojet	Përkufizimi	Shembuj
Akomodimi (përshtatja)	Quhet ai ndryshim kombinator si rrjedhim i të cilit ndodh ndryshimi i bashkëtingëlloreve nën ndikimin e zanoreve dhe anasjelltas, ndryshimi i zanoreve nën ndikimin e bashkëtingëlloreve.	lepur: l'epur molla: m <sup>o</sup> olla
Asimilimi (përngjasimi)	Quhet ai ndryshim kombinator si rrjedhim i të cilit një tingull bëhet plotësisht i njëjtë ose i ngjashëm me një tingull tjetër të fjalës.	fëtyrë: fytyrë ekzistoj: egzistoj
Disimilimi (e kundërta e asimilimit)	Quhet ai ndryshim kombinator si rrjedhim i të cilit dy tinguj të njëjtë ose të ngjashëm bëhen të ndryshëm ose më pak të ngjashëm.	birbil: bilbil gjarpër: gjalpër
Metateza (ndërrim vendi)	Quhet ai ndryshim kombinator si rrjedhim i të cilit dy tinguj ose dy rrokje të fjalës ndërrojnë vendin mes tyre.	kërpudhë: këpurdhë vëlon: lëvon
Shtesat e tingujve	Quhet ai ndryshim kombinator si rrjedhim i të cilit shtohen tinguj në fillim, në mes apo në fund të fjalës.	bletë: mbletë zemra: zembra
Rëniet e tingujve	Quhet ai ndryshim kombinator si rrjedhim i të cilit një tingull apo një rrokje e fjalës nuk shqiptohet, bie.	shtëpi: shpi kinema: kino
Elizioni	Quhet ai ndryshim kombinator si rrjedhim i të cilit bie zanorja fundore e patheksuar.	vajzë e re: vajz'e re

## 2. Ndryshimet pozicionale

Ndryshimet pozicionale janë ato ndryshime fonemore, si rrjedhojë e të cilave fonema të ndryshme mund të zhduken ose disa tipare të tyre mund të dobësohen.

Ndryshime pozicionale		
Llojet	Përkufizimi	Shembuj
Reduktimi i zanoreve	Quhet ai ndryshim pozicional si rrjedhim i të cilit ndodh reduktimi i zanoreve në rrokje të patheksuara.	nxënësit: nxënsit
Shurdhimi i bashkëtingëlloreve	Quhet ai ndryshim pozicional si rrjedhim i të cilit ndodh shurdhimi i bashkëtingëlloreve për shkak të pozicionit të tyre në fund të fjalës.	shteg: shtek brez: bres

### USHTRIME

- Në të folmen e gjyshërve, prindërve dhe tuajën, përpikuni të gjeni nga një apo më shumë shembuj për secilin lloj të ndryshimeve pozicionale dhe kombinatorë. Paraqitini, sipas modelit të tabelës së dhënë në këtë temë mësimore.
- Përcaktoni llojin e ndryshimeve fonemore të fjalët në vijim:  
asgjë: azgjë; eci: heci; punëtor: puntor; bodrum: budrum; mrekuulli: mbrekuulli; po: p<sup>o</sup>; kilogram: kilo; kullë: k<sup>o</sup>ull; vend: vent.
- Sillni nga dy shembuj ndryshimesh kombinatorë të fonemave sipas rasteve të dhëna në tabelën e mëposhtme.

Shembuj me ndryshime kombinatorë të fonemave						
akomodimi	asimilimi	disimilimi	metateza	shtesat e tingujve	rëniet e tingujve	elizioni

- Sillni nga dy shembuj ndryshimesh pozicionale të fonemave sipas rasteve të dhëna në tabelën e mëposhtme.

Shembuj me ndryshime apozicionale të fonemave	
reduktimi i zanoreve	shurdhimi i bashkëtingëlloreve




# Drejtshkrim

## DREJTSHKRIMI

Tërësia e rregullave që na tregojnë se si duhet t'i përdorim shenjat e pikësimit.

Tërësia e rregullave që na tregojnë se si t'i shkruajmë drejt fjalët e gjuhës standarde.





# Përdorimi i pikës dhe i pikëçuditjes

## Pika (·)

Pika shënon mbarimin e një fjalie që nuk shqiptohet as me intonacion pyetës, as me intonacion thirrormor. Në ligjërimin e folur, asaj i përgjigjet një pushim relativisht i gjatë midis fjalive.

### Vihet pikë:

- a. Në fund të një fjalie dëftore: *Ja, kështu po ngrihej Shqipëria e re, e pavarur, demokratike.*
- b. Pas një fjale a togu fjalësh ose pas një pjesëze me vlerën e një fjalie, kur nuk shqiptohen me intonacion pyetës a thirrormor: *Buzëqeshje. Shpërthime të qeshurash. Duartrokitje.*
- c. Në fund të një fjalie nxitëse jothirrmore, që shpreh këshillë, porosi, propozim, lejim ose pranim: *Dëgjomëni mua. T'i doni prindërit. Le t'i diskutojmë propozimet tuaja.*
- ç. Në fund të një fjalie të përbërë: *Ai vetë s'e kuptoi dot ç'e ngriti në këmbë. Pyete kur do të vijë.*



## Pikëçuditja (!)

Pikëçuditja shënon përfundimin e një fjalie që shqiptohet me intonacion thirrormor.

### Pikëçuditja vihet:

- a. Në fund të një fjalie dëftore-thirrmore: *Eh, kushedi ku e ka mendjen!*
- b. Në fund të një fjalie dëshirore-thirrmore e nxitëse-thirrmore: *Mbeçi mirë me shëndet! Mirupafshim! Asnjë të mos më afrohet! – foli nëna. – Jam me grip.*
- c. Në fund të një fjalie me nënrenditje që ka si fjali kryesore një fjali me karakter thirrormor, qoftë ajo dëftore, dëshirore ose nxitëse: *Sa ma bëtë qejfin që erdhët! Të lumshin këmbët që erdhe!*
- ç. Pas një thirrori ose një pasthirrme në krye të një fjalie për t'u vënë në dukje më shumë, për t'u theksuar më shumë: *– Tina! Tina! Tina! – thirrën njëzëri.*
- d. Pas një onomatopeje që përdoret më vete: *Pam! Pam! Pam! – u dëgjua një krismë. Ha-ha-ha! – u dëgjuan të qeshura nga jashtë.*
- dh. Pikëçuditja mund të përdoret e përsëritur edhe në kllapa për të shfaqur mosmiratim, ironi etj.

## USHTRIME

**1** Përcaktoni rregullën e përdorimit të pikës në fjalitë e tekstit të mëposhtëm (me shkronja nga **a** në **d**).

Zuri të ecte. ( ) Disi i hallakatur, disi i menduar. ( ) Këmbët i kishte të rënda. ( ) Plumb të rënda. ( ) Drini u tregua me të përzemërt. ( ) Bile më i perzemërt se zakonisht. ( ) Dhe sigurisht ky takim do t'i sillte diçka të re. ( ) Të paktën një lajm, një shpresë ose një udhëzim. ( ) Diçka përfundimtare. ( )

**2** Shpjegoni rastet e përdorimit të pikës në fragmentin e mëposhtëm.

Nuk do të ndodhë asgjë. (Kjo vlejti si përgjigje për dyshimet e Arbenit.) Fundja, unë kërkoj nga ju të më ndihmoni. Sidoqoftë, plaku doli nga spitali dhe ai mbeti sërish vetëm. (Por të mos harrojmë se plaku tetëdhjetëvjeçar kishte lënë pas hijen e trupit të tij të gjatë, me energjinë dhe dëshirën për t'u kthyer medoemos pranë bletëve.)

**3** Vendosni pikën dhe shkronjën e madhe në fjalitë e mëposhtme.

qyteti shtrihej në tërë gjatësinë e fushës dhe syri s'të zinte veçse shtëpi jam lodhur e dua të fle të gjithë së bashku, njerëzit toka dhe qielli, akuzonin ishte larg, shumë larg puna që bëja nga ëndrrat që thurja kjo nuk është e udhës

**4** Shpjegoni rastet e përdorimit të pikëçuditjes. Përcaktoni rregullën (me shkronja nga **a** në **f**).

- Po sa kujtime të ëmbla e të bukura ia pushtuan mendjen e zemrën atë çast Zanës! \_\_\_\_
- Më paske zgjidhur një problem të madh! \_\_\_\_ – foli ai i kënaqur. – Ehu, kushedi ku e ka mendjen! \_\_\_\_
- Qofshi me shëndet e mirupafshim! \_\_\_\_
- Ah, kur s'erdhe një gjysmë ore më parë! \_\_\_\_
- Nisuni, djem, shpejt! \_\_\_\_ – thirri me sa zë kishte.
- Shko dhe merr makinën! \_\_\_\_ – i tha Teuta Altinit.

**5** Vendosni pikëçuditjet atje ku mungojnë (edhe kur shoqërohen me pikëpyetje).

- E ku mund ta mbajë ajo gjithë atë çantë \_\_\_\_ – tha ai.
- Po ku humbët kështu, more djem \_\_\_\_ – i qortoi gjyshja.
- Vallë, asnjëra s'kishte dalë për ta parë \_\_\_\_ As e ëma \_\_\_\_ As e motra \_\_\_\_
- Edhe ti je zemëruar me mua \_\_\_\_ – e pyeti ai me çudi, duke vënë buzën në gaz.

**6** Vendosni shenjat e pikësimit që mungojnë.

- Uaaa \_\_\_\_ – buçiti salla.
- Pam \_\_\_\_ Pam \_\_\_\_ Pam \_\_\_\_ – ushtoi arma e tij \_\_\_\_
- Ha \_\_\_\_ ha \_\_\_\_ ha \_\_\_\_ – qeshi ai me të madhe \_\_\_\_
- Era ulërinte: – Vuu \_\_\_\_ Vuuu \_\_\_\_

**7** Shkruani një dialog duke përdorur jo më pak se pesë herë pikën dhe pikëçuditjen.**8** Në tekstet e mësimi "Krijime nga e kaluara", gjeni fjalitë ku është përdorur pikëçuditja dhe shpjegoni pse.

# Përdorimi i drejtë i dy pikave, thonjzave, pikëpresjes dhe kllapave

Mbani mend ▶

## Dy pikat

**Dy pikat** shënojnë grafikisht një pushim, që zgjat më pak se pika dhe më shumë se presja. Ky pushim është pothuajse i njëjtë me atë që bëjmë kur përdorim pikëpresjen, por më i theksuar.

P.sh.: *Ishte si i mpirë, nuk lëvizte dot asgjë: as duart, as këmbët.*

**Dy pikat** paralajmërojnë fjalët që riprodhohen në ligjëratën e drejtë, sqarimin a shpjegimin e diçkaje të thënë në pjesën e parë të fjalisë, numërimin e një vargu shembujsh etj.

**Naim Frashëri ka shkruar: "Punë, punë nat' e ditë, / që të shohim pakëz dritë".**

**Dy janë tragjeditë: të mos kesh ç'të do zemra në jetë dhe t'i kesh të gjitha.**

**Disa pemë, si: portokajtë, limonët, mandarinat, i pjekin frutat në dimër.**

**Dy pikat vihen në rastet e mëposhtme.**

- ✿ Përdoren para onomatopeve, kur vijnë pas fjalësh që i paralajmërojnë: *Në degët e një portokalli ia thoshte përvajshëm një kumri: gu-gu-gu!*
- ✿ Përdoren para një vargu gjymtyrësh homogjene: *Mbeten dy rrugë: të nisemi që sot ose të presim trenin nesër.*
- ✿ Përdoren para fjalëve **p.sh., si., siç janë**, kur paralajmërojnë një numërim dhe ndiqen nga një varg gjymtyrësh homogjene: *Në folklor pasqyrohen cilësitë më të mira të popullit tonë, si: ndjenja liridashëse, patriotizmi, besa, nderi, mikpritja, mençuria etj.*
- ✿ Përdoren në fund të një formulimi ose rregulle, pas së cilës renditen një ose më shumë shembuj për ilustrim: *E ruajnë "të-në" në shkrim: do të shkoj, do të kem shkuar.*
- ✿ Përdoren midis numrave që tregojnë orët, minutat dhe sekondat: *Kaloi në orën 13:30:05.*

Me dy pika mund të ndahen edhe dy fjali të bashkuara pa lidhëza: *lu kujtua menjëherë: duhej të këshillohej me shokun. Mësuesi pa orën: pas njëzet minutash, do të fillonte mësimi. Këtë bëmë edhe ne këtu: rrahëm mendimet tona.*

Mbani mend ▶

## Kujdes


Emërtime të tilla, si: *Rruga e Dibrës, Hoteli i Gjuetarëve* etj., nuk vihen në thonjëza: *Kaluam nga Rruga e Dibrës.*

## Thonjëzat

**Thonjëzat** tregojnë që fjalët e përfshira në to nuk janë të një natyre me pjesën tjetër të tekstit ose që fjalët brenda tyre nuk janë përdorur me kuptimin e tyre të zakonshëm.

**Thonjëzat vihen në rastet e mëposhtme.**


- ✿ Përdoren në ligjëratën e drejtë dhe në citime për të veçuar e për të dalluar fjalët që riprodhohen nga fjalët e autorit: *I panjohuri u kthye dhe thirri: "Bëhuni gardh, zihuni për krahu, që të mos na çajnë!"*

- 
- ✿ Përdoren për të mbyllur fjalë me ngarkesë emocionale apo me kuptim të veçantë: *Fjala "nënë" është fjala më e dashur në botë.*
  - ✿ Përdoren për të veçuar citatin ose për të riprodhuar fjalët e dikujt tjetër: *Te krijimi i pavdekshëm i De Radës, mali është gjithkund, madje dhe kënga e fundit e "Milosaos" ka vargun "Fryu er' e maleve, rrëzoi hijen e lisit". Nëpër dhëmbë, përshpëriti: "Po vëllai im si është?"*
  - ✿ Përdoren për të veçuar emrat e përveçëm a grupet e fjalëve që emërtojnë:
    - **libra, gazeta, revista, vepra muzikore:** *Në tavolinë mbante pesë numra të gazetës "Shqip". Ai mbante në dorë librin "Gjuha shqipe 8".*
    - **rrugë, shkolla, bulevarde, sheshe, lagje, hotele, stadiume** etj.: *bulevardi "Dëshmorët e kombit", shkolla "Avni Rustemi" etj.*
    - **tituj, urdhra,** kur vijnë pas këtyre fjalëve: *Presidenti e nderoi me urdhrin "Nderi i kombit".*

### Pikëpresja

**Pikëpresja** shënon grafikisht një pushim më të gjatë se presja, por më të shkurtër se pika. Në përgjithësi, ajo ndan në mënyrë më të prerë se presja, por më pak të theksuar se dy pikat.


#### Pikëpresja përdoret në rastet e mëposhtme.

- 
- ✿ Përdoret në fjalitë e bashkërenditura ose në fjalitë e bashkuara pa lidhëza, kur ato janë mjaft të zgjeruara: *Ky me katër veta u vendos kundrejt kryeportës së kështjellës; të tjerët kundrejt livadhishtave nga ana e Tiranës.*
  - ✿ Përdoret për të shënuar ndarje më të theksuara se ato me presje: *Retë u dyndën në veri dhe rënduan mbi kurrizin e majës së Rrungajës; kurse në jug, sikur të kish dalë nga drurët e pyllit, rrëshqiti vjedhurazi një hënë e madhe.*
  - ✿ Përdoret në shënimet bibliografike: *Xhuvani Aleksandër: Fjalë dhe shprehje të shqipes, "Studime filologjike": 1971, nr. 4, f. 193; 1972, nr. 1, f. 161-173; nr. 2, f. 134; nr. 4, f. 157-164.*

### Kllapat

**Kllapat** shënojnë një pushim të shkurtër, si presja, dhe shërbejnë për të dalluar, për të shquar dhe për të veçuar fjalë apo fjali që shprehin një sqarim ose një mendim të ndërkallur.

#### Kllapat e rrumbullakëta ( ) vihen në rastet e mëposhtme.

- 
- ✿ Përdoren për të mbyllur fjalë a fjali të ndërkallura, që shprehin sqarime plotësuese: *Te fusha e kuqe (ajo quhej kështu, se në mes të saj ishte një shkëmb i kuq), Albin e prisnin shokët.*
  - ✿ Përdoren për të veçuar treguesit skenikë në veprat teatrale: *Jonuzi – (Thërret) Mira!*
  - ✿ Përdoren për të mbyllur fjalët që zërthejnë një emërtim të shkurtuar, ose për pseudonimet, për nëntitujt dhe emërtimet e dyta: *Ata u nisën për në OKB (Organizata e Kombeve të Bashkuara). Millosh Gjergj Nikolla (Migjeni); "Dasmë pa nuse" (Komedi).*
  - ✿ Përdoren për të mbyllur datën e lindjes dhe të vdekjes së një autori: *Naim Frashëri (1845–1900).*
  - ✿ Përdoren për të mbyllur një pikëpyetje ose pikëçuditje, ose të dyja, në rastet kur fjalia shpreh mosbesim, falsitet etj.: *I ishte mbushur mendja se e kapërceu rrezikun (!!).*

Kllapat katrore [ ] vihen në rastet e mëposhtme.

- ✿ Përdoren për të mbyllur fjalë të shtuara nga redaktori: *Valiu të dërgohet në Stamboll te ministori [ministri] [i] brendshëm.*
- ✿ Përdoren për të mbyllur emrin e një vendi a qyteti që njihet e përdoret sot: *Ne të nënshkruarit e Urkupit [Prokupije] u bëjmë të ditur...*
- ✿ Përdoren për të mbyllur tri pikat, kur hiqen fjalë nga dokumenti: *Kongresi zgjodhi një komision [...] për të vajtur në Korçë.*
- ✿ Përdoren për të veçuar një fjalë a një togfjalësh brenda një teksti të mbyllur me kllapa të rrumbullakëta: *(Kudo ku fliten disa gjuhë [shqip, anglisht, italisht], mund të ketë ndikime të ndërsjella).*

## USHTRIME

### 1 Shpjegoni përdorimin e dy pikave dhe të pikëpresjes.

- ▣ *Kapedanët më të dëgjuar që morën pjesë, ishin këta: Gjergj Arianiti i Kaninës; Andrea Topia, stërnip i Karl Topisë, kryezot i Skurisë, krahinës midis Krujës e Durrësit, me të dy bijtë dhe me të nipin Tanush Topinë; Teodor Korona, kryezot i Beratit, me disa krerë të tjerë të Myzeqesë; Gjergj Stres Balsha...*
- ▣ *Pjesën më të madhe, pothuaj tërë punën, e mbaruat: Kruja dhe tërë krahina e saj u fitua; Dibra dhe Malësia u bashkuan me ne; armikut s'i mbeti as emri, as shenja në fushat tona; qëndrojnë vetëm fortesat.*
- ▣ *Rruga dukej e magjishme; gjithçka në të: pemët, kanalet anësore, gurët kilometrikë, ishin të bukur, miqësorë.*

### 2 Çfarë ndan pikëpresja dhe çfarë paralajmërojnë dy pikat në fjalitë e mëposhtme?

- ▣ *Atë mbrëmje, e mbuluar nën jorgan, ajo mendoi për të gjitha. Kujtoi jetën e saj: fëmijërinë, kur këmbëzbathur bridhte udhëve të fshatit; nënën plakë e të dobët gjithnjë të heshtur; babanë punëtor, të ndershëm, po përherë të mbyllur në vetvete; vëllanë e dashur, po të largët.*
- ▣ *Kallëzuesi mund të shprehet me një folje të vetme: Shtatorja e Nënë Terezës qëndron madhështore në hyrje të aeroportit.*

### 3 Vendosni thonjëzat atje ku duhet. Shpjegoni përdorimin e tyre.

- ▣ *Kur kaloi pranë meje, më rrahu krahët e më tha: Ki mendjen, Artan. Trimëria s'ka kuptim pa zgjuarsinë.*
- ▣ *Lidhja Shqiptare u krijua për të përballuar rrezikun e copëtimit, kur shqiptarët, siç thotë kënga popullore, lidhën besën si e kemi zakon, të vdesim ose të rrojmë.*

### 4 Shpjegoni përdorimin e kllapave.

- ▣ *Petríti* – Lamtumirë, kapedan! Të falem nderit! (*U afrohet t'i përqafojë, po prapë e mban veten dhe largohet*).
- ▣ *Një ditë (dita s'mbahet mend, as muaji) një fshatar shiti demin për të blerë një maliher.*
- ▣ *Përdorimi i kompjuterave (portativë), vitet e fundit është përhapur në mënyrë marramendëse.*

### 5 Formoni nga dy fjali për secilin rast, në të cilat të përdorni:

- ▣ dy pikat;
- ▣ pikëpresjen;
- ▣ thonjëzat;
- ▣ kllapat.

# Përdorimi i trepikëshit (...)

Trepikëshi tregon që thënia, për arsye të ndryshme, ndërpritet e nuk jepet e plotë.

**Trepikëshi përdoret:**

▶ Ndërprerja mund të bëhet në fjali dhe në fjalë të veçanta.

**a.** Për të shprehur ndërprerjen e një thënieje në mënyrë që t'lihet lexuesit ta marrë me mend çfarë ka dashur të thotë tjetri:

*Ja, sa të më rritet djali, pa...*

*Sa të korrim grurin, sa të mbledhim duajt e fundit, pastaj...*

**b.** Në shkurtimet e fjalëve ose të datave që nuk duam t'i japim të plota, ose që s'na kujtohen: *Nga rrethi i K...*

*Aty nga fillimi i majit të vitit 200...*

**c.** Për të shprehur mungesën ose vonesën e përgjigjes në dialog:

*- Eja, eja më pranë. - Po priste të fliste ajo...*

**ç.** Pas një numërimi që nuk jepet deri në fund:

*Ja caktojmë Dianën një, dy, tre...*

**d.** Në citime për të treguar që fjalia nuk jepet e plotë në fillim, në mes a në fund të saj:

*"...shkolla jonë do të pësojë ndryshime në formë, ... në strukturë, në përmbajtje..."*

**dh.** Përdoret në vend të një shkronje, fjale, numri a shenje aritmetike që nxënësi duhet ta gjejë:

*Përdorni trajtat e shkurtra në vendet bosh:*

*Anijet e mëdha mezi ... bëjnë ballë dallgëve të fuqishme.*



## USHTRIME

**1** Shënoni se me cilën rregull të përdorimit të trepikëshit lidhen shembujt e mëposhtëm (*nga a në dh*).

*E di ç'bëj unë me ato kronikat tuaja të mykura? ... \_\_\_\_\_ Nga rrethi i K...\_\_\_\_\_*

*Aty nga fillimi i majit të vitit 197...\_\_\_\_\_ - ... Eja, afrohu...\_\_\_\_\_ - ... E sheh këtë libërth? \_\_\_\_\_*

*Sidoqoftë, dihet... Por unë kështu them... Paçka... \_\_\_\_\_*

**2** Shkruani një dialog të shkurtër, ku të përdorni deri në katër raste të përdorimit të trepikëshit.

---



---



---

**3** Në pjesën e leximit me titull "Ciklopi", gjeni dhe shpjegoni raste të përdorimit të trepikëshit.

**4** Shkruani një shkrim të shkurtër me temë "Unë pas dhjetë vjetësh", ku të përdorni deri në katër raste të përdorimit të trepikëshit.

# Leksikologji

## Leksikologjia

Studion tërësinë e fjalëve (leksikun) që ka një gjuhë, një dialekt ose një e folme.

### Kuptimi i fjalës

- ▶ Kuptimi i drejtpërdrejtë i fjalës
- ▶ Kuptimi i figurshëm i fjalës
- ▶ Fjalët me shumë kuptime

### Dialektet e shqipes

- ▶ Gegërishte
- ▶ Toskërishte

### Gjuha standarde



# Fjalët me ngjyrim emocional



✿ Lexoni tekstin dhe parafrazoni fjalët me shkronja të zeza.

Pikërisht në këtë kohë ajo dëgjoji për ilaçin e ri, "Shërimtari". Porositi menjëherë një **arkë të madhe**. E provoi vetë dhe **iu kënaq zemra**. Ishte një lëng që **të ndizte flakë, një zjarr i gjallë**. Banjat dhe kurat e tjera u ndaluan në çast. Që tani e tutje ajo e **lidhi fatin** me "Shërimtarin". I dha Tomit një lugë kafeje dhe priti në ankth efektin. Dhe ja ku më në fund morën fund meraqet e saj, ja ku **i ra shpirti në paqe**, ja ku **u thye indiferenca** e djalit. Edhe flakën t'i kishte vënë atij nën vete, nuk do të gjallërohej e nuk do të shkundej më tepër.

sipas Mark Tuen, "Aventurat e Tom Sojerit"

Fjalët dhe grupet e fjalëve të theksuara në pjesën e mësipërme janë më së shumti emra, mbiemra dhe njësi frazeologjike. Këto lloj fjalësh ose grupe fjalësh kanë ngjyrim emocional.

## Mbani mend

Ngjyrimi emocional i fjalëve është tregues i qëndrimit të folësit ndaj asaj që ai komunikon.

**Fjalët me ngjyrim emocional** shprehin gëzim dhe hidhërim, lavdërim ose qesëndisje, përgëzim ose përbuzje, dashuri ose urrejtje, përkëdhelje ose shpërfillje etj. Fjalët që kanë ngjyrim emocional janë kryesisht:

- ✿ **emra:** shërimtari, grykë, shtojzovalle, kungull, kastravec, fyell, karafil etj.;
- ✿ **mbiemra:** të madhe, i gjallë, të pamata, e lehtë, e vockël etj.;
- ✿ **pasthirrma:** olele, uf, obobo, ah;
- ✿ **shprehje frazeologjike:** iu kënaq zemra, i ra shpirti në paqe, u thye indiferenca etj.

Fjalët ose grupet e fjalëve që kanë ngjyrim emocional ose e marrin lehtë atë, janë:

- ✿ **fjalët që tregojnë cilësi:** hutaq, i mrekullueshëm, bukurosh etj.;
- ✿ **fjalët që emërtojnë shpendë dhe kafshë:** buallicë, derr, kalë, korb, sorrë, viç, pëllumb etj.;
- ✿ **fjalët që emërtojnë lule, drurë dhe bimë:** karafil, kastravec, lis, mollë, pjeshkë, zambak, kungull, luleborë etj.;

- ✿ **fjalët e huazuara nga turqishtja:** kalama, serrat, teveqel, pazarllëk, maskara etj.;
- ✿ **emrat e sendeve që kanë cilësi të dallueshme:** çelik, fyell, hënë, rrotë, shkëmb, yll etj.;
- ✿ **njësitë frazeologjike:** e solli kokën, i kreh bishtin, i fut hundët, me lugë në brez etj.

## USHTRIME

**1** Gjeni se cilit kuptim i përgjigjet fjala **derë** në shembujt e mëposhtëm.

- 📌 Ai nuk po gjente dot derën e dhomës.
- 📌 Atij iu hap dera e madhe e jetës.
- 📌 Ai ishte njeri pa derë familjare.
- 📌 Nga cila derë e keni marrë këtë nuse?

**2** Gjeni fjalët që kanë më shumë se një kuptim. Kërkoni në fjalor kuptime të tjera të pesë prej fjalëve të fragmentit të mëposhtëm.

Mjerimi punon, punon ditë e natë, tu i vluce djersa në gjoks edhe në ballë, tue u zhigatun deri në gjunjë në baltë, e prap zorrët nga uja i bëhen palë-palë. Shpërblim qesharak!... Mjerimi është një plagë e pashlyeshme në ballë të njerzmit, që kalon nëpër shekuj....

**3** Zbërtheni kuptimin e shprehjeve frazeologjike. Zëvendësojini me një fjalë të vetme. Shpjegoni kuptimin emocional që mbartin ato.

si kali pa fre  
daulle e shpuar  
vë dorë  
mori dhenë  
shkel e shko  
fut hundët  
si cjapi te kasapi  
si macja me miun

si pulë e lagur  
i rrahur me vaj e uthull  
i kreh bishtin  
u bë erë  
vesh më vesh  
derë më derë  
si peshku pa ujë  
sa frëngu pulën

kockë e lëkurë  
s'ia ha qeni shkopin  
i mbylli derën  
t'i rrjep lëkurën  
majë më majë  
hap pas hapi  
me mish e me shpirt  
për dhjamë qeni

**4** Ndërtoni nga dy fjali me secilën nga fjalët: **ballë, gjunjë, baltë**. Përdorini një herë me kuptim të mirëfilltë dhe një herë me ngjyrim emocional.

---

---

---

---

---

---

---

---



---

---









# Kuptimet e drejtpërdrejta dhe të figurshme të fjalëve

## Mbani mend

Shumica e fjalëve të gjuhës shqipe kanë më shumë se një kuptim. Këto kuptime mund të jenë:

-  të drejtpërdrejta;
-  të figurshme.

Le të analizojmë disa nga kuptimet që mbart fjala *gjyshe*.



<p><b>Kuptimi 1</b> Nëna e prindërve kundrejt mbesës apo nipit.</p>	<p><b>Kuptimi 2</b> Grua në moshë të thyer kundrejt një fëmije.</p>
<p><b>Përbërësit e kuptimit 1</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li> njeri i seksit femër;</li> <li> njeri në moshë të thyer;</li> <li> njeri me lidhje farefisnore me fëmijën: <ul style="list-style-type: none"> <li><input type="radio"/> nga ana e babait ose nënës;</li> </ul> </li> <li> kundrejt nipit ose mbesës.</li> </ul>	<p><b>Përbërësit e kuptimit 2</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li> njeri i seksit femër;</li> <li> njeri në moshë të thyer;</li> <li>_____</li> <li>_____</li> <li> kundrejt një fëmije çfarëdo.</li> </ul>
<p><b>Shembull</b></p> <p><input checked="" type="checkbox"/> <i>Pushimet e verës do t'i kaloj te <b>gjyshja</b>, në fshat.</i></p>	<p><b>Shembull</b></p> <p> <i>Pse po mundohesh kaq shumë, moj <b>gjyshe</b>? Po të ndihmoj pak unë. Të kam si <b>gjyshen</b> time.</i></p>

Nga përbërësit e kuptimit 2 të fjalës *gjyshe*, kuptojmë se kjo fjalë nuk është përdorur në kuptimin e drejtpërdrejtë të fjalës (kuptimit 1), por në një kuptim të figurshëm.

Në këtë kuptim (kuptimi 2), fjala *gjyshe* përdoret edhe për një person që ngjan me të vërtetë me të.

## Mënyrat e krijimit të kuptimeve të figurshme të fjalëve

Kuptimet e figurshme të fjalëve mund të krijohen nëpërmjet mënyrave të ndryshme, që janë renditur më poshtë.

-  Nëpërmjet **metaforës gjuhësore**. Në këtë rast, emërtimin e një fjale e përdorim për diçka tjetër, mbi bazën e një tipari të përbashkët: *Është një **dhelpër** ajo, që **sé ka shoqen**.*
-  Nëpërmjet përdorimit të **prapashtesave me nuanca përkëdhelëse dhe keqësuese**.

➤ Lexoni tabelën e mëposhtme dhe plotësoni kolonat e fundit.

Prapashtesa	Shembull	Prapashtesa të tjera	Shembull për çdo rast
-zë	zogëzë		
-th	birth		
-aq	ngordhal <b>aq</b>		
-ash	bal <b>ash</b>		
-ac	përt <b>ac</b>		
-ec	grindav <b>ec</b>		
-osh	bukuro <b>sh</b>		

🌸 Nëpërmjet përdorimit të **intonacionit të veçantë** me nuanca: përbuzjeje, talljeje, shakaje, ironie: *Vërtet! Ashtu?! Posi?! Me gjithë mend?!*

## USHTRIME

- Zbërtheni kuptimin e drejtpërdrejtë (kuptimi 1) dhe kuptimin e figurshëm (kuptimi 2) të fjalëve në tabelat e mëposhtme. Argumentoni nëpërmjet shembujve se pse kuptimi 2 është kuptimi i figurshëm i kësaj fjale.

Fjala <i>bir</i>		Fjala <i>bijë</i>	
Kuptimi 1	Kuptimi 2	Kuptimi 1	Kuptimi 2
Përbërësit e kuptimit 1	Përbërësit e kuptimit 2	Përbërësit e kuptimit 1	Përbërësit e kuptimit 2
_____	_____	_____	_____
_____	_____	_____	_____
_____	_____	_____	_____
Shembull	Shembull	Shembull	Shembull
_____	_____	_____	_____
_____	_____	_____	_____

- Gjeni në internet dhe lexoni poezinë “Rent or maratonomak” të Fan Nolit. Dalloni rastet e krijimit të kuptimeve të figurshme të fjalëve.
- Formoni fjali me tri nga fjalët që Noli i ka përdorur në kuptim të figurshëm. Lexojini ato, duke përdorur një intonacion të veçantë, në përputhje me kontekstin e fjalisë.

# Dialektet e gjuhës shqipe

## Kujtojmë

Dialekti është një variant i gjuhës, që përdoret nga folës të një treve të kufizuar ose nga folës të një shtrese shoqërore të veçantë.

Gjuha shqipe ka dy dialekte kryesore: *gegërishten* dhe *toskërishten*.

Dialektet e shqipes, përveç të përbashkëtave të shumta, kanë edhe dallime. Disa prej tyre janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Karakteristika	Gegërishte	Toskërishte
Kanë togun	<b>ue:</b> <i>mue, punue, grue</i> etj.	<b>ua:</b> <i>mua, punuar, grua</i> etj.
Kanë zanoren	<b>a hundore:</b> <i>kambë, nanë, hana</i> etj.	<b>ë:</b> <i>këmbë, nënë, hëna</i> etj.
Kanë <b>-n-</b> ose <b>-r-</b> ndërzanore.	Ruan <b>-n-</b> në ndërzanore hundore: <i>zani, bana</i> etj.	<b>-N-</b> në ndërzanore të gegërishtes e kthen në <b>-r-</b> : <i>zëri, bëra</i> etj.

## USHTRIME

### 1 Shkruani në gjuhën standarde fjalët e mëposhtme.

lark	me punue	ndryshoj	rabeckë
bani	ish	kaposh	kam me shkue
tash	i math	lepitka	foshnjisht

### 2 Shkruani në gjuhën standarde tekstet e mëposhtme.

E ninte nadje herët pigrin e amël të zogut kangtar e ia kishte kana me nej shtri edhe ma deri sa dilli t'kalote mi çati t'fqiut. U nrit e u ba gadi me shpejti e u nis drejt e ke veni ku e kish lan me Zefin për m'u pjekë. Zefi e kish nji pushk ke shpia e i pat dhan fjalën me e nifmu kur ta lypte nevoja e kur kish m'i ardh dita ene aj do ja shpërblete. Se kshu e dote kanuni e zakoni i katunit e i asaj nahije.

Shkoni në shtëpitë tuaja pa përdënuar djelli e bëhi gati për nesarë, herëtë, që me natë e, kur të zënë e këndojnë gjelat, dilni ndë kodrë të kuqe mbi të mugullarët, që të gjendemi ndë rrëzët të malit të Tomorrit, pa zbardhurë dita e të qerthullojmë pyllin.

### 3 Shkruani pesë fjalë të urta në dialektin e zonës suaj. Rishkruajini ato në gjuhën standarde.

# Gjuha standarde dhe dialektet



A ndryshon gjuha e librave të shkollës nga gjuha që flisni në shtëpi me prindërit ose në rrugë me shokët?

Gjuha që përdorim në shkollë, që flitet në radio apo televizion, është **gjuha standarde**.

Gjuha që përdorim në jetën e përditshme, në shtëpi ose me shokët në rrugë, është e ndryshme nga gjuha standarde, sepse në shtëpi ose në rrugë shpesh herë flasim në **dialekt**.

Gjuha shqipe ka dy dialekte: gegërishten në veri dhe toskërishten në jug.

Si kufi ndërmjet territoreve ku flitet gegërisht dhe atyre ku flitet toskërisht, merret lumi Shkumbin.

🌸 **Lexoni tekstet vijuese dhe përgjigjuni pyetjeve poshtë tyre.**

## Gështenjëpkësi

1. E shihja çdo mëngjes, kur shkoja në shkollë. Gjithmonë në të njëjtën skutë, e njëjta fytyrë zeshkane, e mbuluar me lesh të gjatë, lëshonte ngandonjëherë vezullime të argjendta.

Vuajtjet, më tepër se koha, kishin lënë në faqet e tij të vrazhda gjurmë të thella, të shumta... Në verë shiste pemë... Në dimër gështenja të pjekura...

## Gështejëpkësi

2. E shifje çdo mëngjes, kur shkojshe në shkollë. Gjithmonë në të njëjtën skutë, e njëjta fytyrë zeshkane, e mbulueme me lesh të gjatë, lëshonte ngandonjëherë vezullime të argjendta. Vuajtjet, ma tepër se koha, kishin lanë në faqet e tij të vrazhda gjurmë të thella, të shumta... në verë shiste pemë. Në dimër gështejta të pjekme....

🌸 Çfarë ndryshimesh vini re ndërmjet dy varianteve të këtij teksti? Cili prej tyre ju duket më i afërt me gjuhën e përdorur në libra dhe në shtypin e përditshëm?

*Varianti 1 është shkruar në gjuhën standarde, ndërsa varianti 2 në gegërisht.*

## Mbani mend

- 🌱 Ajo gjuhë që kuptohet e përdoret nga të gjithë pjesëtarët e një kombi, quhet gjuhë standarde.
- 🌱 Gjuha standarde dallohet për zbatim të përpiktë të rregullave në të folur e në të shkruar.
- 🌱 Gjuha standarde është gjuha e përdorur në shkollë, libra, gazeta, revista etj.

## USHTRIME

- 1 Shkruani fjalët që përdoren në vendbanimin tuaj për të emërtuar sendet dhe kafshët e paraqitura në figurë.



- 2 Shkruani në cilin dialekt përdoret secili nga këto grupe fjalësh.

▣ tam(b)ël, rrej, katun(d), tinëz, fërgoj \_\_\_\_\_

▣ qumësht, gënjej, fshat, fshehurazi, skuq \_\_\_\_\_

Cilat nga këto fjalë përdoren në gjuhën standarde?

- 3 Shkruani në gjuhën standarde fjalët e mëposhtme.

asht tue mësue, amël, kangë, syni, asht tue lexue, pruni, bani, ashtu tue këndue, kam zgjidh, kam lanë, kam pre

- 4 Shkruani në gjuhën standarde fragmentin e mëposhtëm.

*Fjala misër përmban në vete legjenda të linduna nga dëshira për jetë. Dëshira për jetë asht e madhe dhe e mahnitshme, sa edhe malet tona që hapin gjitë për me varrosë njerzit e unshëm. E në lartësinë e maleve vigane, legjendë asht dhe lindja, legjendë asht dhe jeta, legjendë asht dhe vdekja. Dhe kjo legjendë e idhtë, dhe plot vuejtje historike, në shekullin e njëzetë asht e thekshme, zemërbrese dhe të ban të qajsh.*

“Legjenda e misrit”, Migjeni

- 5 Ndiqni lajmet në një stacion televiziv dhe dalloni rastet e përdorimit të pasaktë të gjuhës standarde.

- 6 Diskutoni në klasë rreth problemeve të përdorimit nga ana juaj të gjuhës standarde.

# Fjalët shqipe dhe fjalët e huaja


Gjuha shqipe është një nga gjuhët më të vjetra të Ballkanit. Ajo ka një fond të pasur fjalësh, i cili quhet leksik.

Leksiku i gjuhës shqipe përfshin:

- shtresën vetjake;
- shtresën e huazuar.

## a) Shtresa vetjake përbëhet nga:

- ✿ fjalët e hershme të leksikut të shqipes: *çel, dal, darkë, atë, bir, djalë, derr, drekë, ëndërr, djathë, hudhër, kohë, lopë, mal, mjekër, mot, motër, natë, punë* etj.;
- ✿ fjalët e shqipes të prejardhura dhe të përbëra të formuara brenda shqipes: *dimërak, dimëror, punëtor, punishte, shtegtar, zemërmirë, përmirësoj* etj.;
- ✿ fjalët e shqipes të formuara nga pasthirmat dhe onomatopetë: *çuçurit, mërmërit, gurgullon, shushurin, taketuke, tringëllin, zukat, belbëzoj, bubullon* etj.



## b) Shtresa e huazuar e fjalëve të shqipes përbëhet nga:

- ✿ fjalët e huaja, të cilat kanë zënë vend në leksik për arsye të ndryshme *historike, gjeografike, sociale, kulturore dhe gjuhësore*. Në gjuhën shqipe, si në gjithë gjuhët e tjera, kanë zënë vend huazime, si:
  - ✿ termat ndërkombëtarë: *epilepsi, tuberkuloz* etj.;
  - ✿ fjalët që kanë sjellë nuanca të reja kuptimore: *bejtexhi (vjershëtor, jo poet)* etj.;
  - ✿ fjalët që i ka pranuar një stil i caktuar shkencor, social, mediatik: *absolutisht, agrikulturë, eksperiment, realizoj, situatë, urgjencë* etj.;
  - ✿ fjalët që janë përdorur në fusha të ndryshme profesionale si terminologji e fushës përkatëse: *kompjuter, informatikë, internet, e-mail* etj.;
  - ✿ fjalët që kanë ardhur së bashku me mjetin dhe konceptin e ri: *lavastovilje, televizor, tablet, celular* etj.





Fjalët e huaja e prishin gjuhën. Nuk duhet të merren e të përdoren fjalë të huaja, kur kemi fjalët tona. Prandaj, duhet bërë kujdes që të përdorim fjalën shqipe në vend të fjalës së huaj, si:

## Shembuj

<i>i përkryer</i>	në vend të	<i>perfekt</i>	<i>pajtim</i>	në vend të	abonim
<i>i përshtatshëm</i>	në vend të	<i>adapt</i>	<i>të lutem</i>	në vend të	aman
<i>zotim</i>	në vend të	<i>angazhim</i>	<i>thirrje</i>	në vend të	apel
<i>miratoj</i>	në vend të	<i>aprovuj</i>	<i>zbatoj</i>	në vend të	aplikoj
<i>i vrazhdë</i>	në vend të	<i>brutal</i>	<i>vendimtar</i>	në vend të	deciziv
<i>teproj</i>	në vend të	<i>ekzagjeroj</i>	<i>ngjarje</i>	në vend të	eveniment
<i>ndjek</i>	në vend të	<i>frekuentoj</i>	<i>zemërim</i>	në vend të	indinjatë
<i>shmang</i>	në vend të	<i>evituj</i>	<i>ndikoj</i>	në vend të	influencoj
<i>ngul këmbë</i>	në vend të	<i>insistoj</i>	<i>padituri</i>	në vend të	injorancë
<i>përfundim</i>	në vend të	<i>konkluzion</i>	<i>kureshtar</i>	në vend të	kurioz
<i>epërsi</i>	në vend të	<i>superioritet</i>			

## USHTRIME

- 1 Në fjalët dyshe të mëposhtme (fjalë e huaj/fjalë shqipe), gjeni fjalë të tjera sinonime të shqipes me anën e të cilave ato mund të zëvendësohen.

novitet (risi) \_\_\_\_\_, sensibilitet (ndjeshmëri) \_\_\_\_\_, aparençë (dukje, pamje e jashtme) \_\_\_\_\_, monitoroj (vëzhgoj) \_\_\_\_\_, monitorim (vëzhgim) \_\_\_\_\_, interlokutor (bashkëbisedues) \_\_\_\_\_, evokoj (sjell në mend) \_\_\_\_\_, neutral-e (asnjanës-e) \_\_\_\_\_, kontestoj (kundërshtoj) \_\_\_\_\_, konfrontoj (ballafaqoj) \_\_\_\_\_, bilateral-e (dypalësh-e) \_\_\_\_\_, absorboj (thith) \_\_\_\_\_, reflektohet (pasqyrohet) \_\_\_\_\_, replikë (përgjigje) \_\_\_\_\_, konstatoj (vërej) \_\_\_\_\_, rinovoj (përtërij) \_\_\_\_\_, gratis (falas) \_\_\_\_\_, esencial (thelbësor) \_\_\_\_\_, liçencë (leje) \_\_\_\_\_, sensacional (i bujshëm) \_\_\_\_\_, integroj (përfshij) \_\_\_\_\_, tendencë (prirje) \_\_\_\_\_ etj.

- 2 Lexoni një faqe gazete dhe nënvizoni fjalët e huazuara të nevojshme, por edhe ato të panevojshme.
- 3 Shkruani një ese me titull "Qyteti i gabimeve të mëdha", në të cilën të dalë i qartë keqpërdorimi i fjalës së huaj në vend të fjalës shqipe.
- 4 Merrni një faqe gazete dhe zëvendësoni fjalët e huaja të panevojshme me fjalët përkatëse shqipe.
- 5 Bëni një projekt, ku të nxirrni në pah fjalë të shkruara gabim në emërtimin e dyqaneve, në titujt e emisioneve televizive, në gazeta dhe kudo që shikoni përdorim të fjalës së huaj në vend të fjalës shqipe.

# Fjalë dhe forma gjuhësore që përdoren gjatë të folurit dhe që dëmtojnë gjuhën

## Bashkëbisedojmë

### 1 Komentoni thëniet dhe vlerësimet e mëposhtme për gjuhën shqipe.

*"Fjala e huaj në gjuhë, është si dhia ndër dhen."*

Naim Frashëri

*"Kurrë nuk kemi të drejtë të quhemi komb i qytetëruar, sado të mësojmë gjuhë të huaja, sepse kombi nuk qytetërohet me mësimin e gjuhëve të huaja, por me mësimin e gjuhës së vet."*

Filip Shiroka

*"Gjuha është pasqyra më e qartë e një kombi dhe e kulturës së tij."*

Eqrem Çabej

*"Gjuha shqipe është një pasuri fjalësh dhe është e ardhshme e plot gjallëri e jetë, sa mund të përkthehen me të klasikët e çdo kombi e çdo kohe."*

Gjergj Fishta

*"Gjuha ruhet, atje ku shkruhet."*

Populli

### 2 Diskutoni rreth temës: "Gjuha shqipe "e pushtuar" nga format e strukturat e huaja gjuhësore". Gjatë diskutimit referojuni medias së shkruar dhe asaj vizive, po edhe mjedisit në të cilin jetoni dhe mësoni se si përdoret gjuha shqipe. Argumentoni dhe konkretizoni.

### 3 Teknologjitë e reja kanë sjellë përdorimin gjithnjë e më të madh të fjalëve dhe të shprehjeve të shkurtuara ose të huazuara. Diskutoni rreth këtij realiteti gjuhësor, duke sjellë shembuj dhe raste të ndryshme.

### 4 A duhet të pajtohemi me huazimet? Si duhet:


- gugloje apo kërkoje?
- sendoje apo nise?
- dominonte apo mbizotëronte?
- sejvoje apo ruaje?
- suportoje apo mbështete?
- selektoj apo përzgjedh?

### 🌸 Gjeni shembuj të tjerë dhe nxirri përfundime.

### 5 Bëni një listë me fjalë dhe shprehje të sotme që dëmtojnë gjuhën. Vendosini në tabelë.

Fjalë të huaja	Shprehje të huaja	Shkurtime pa vend

# Morfologji



# Përemri pronor

*Eltoni leu shtëpinë e tij.*  
*Eltoni leu shtëpinë e vet.*



Përemri që tregon përkatësi ndaj një vete të caktuar, quhet **përemër pronor**. Kemi **përemra pronorë vetorë: im, yt, i tij** etj., si dhe **përemra pronorë vetvetorë: i vet/e vet**. Këta të fundit përdoren në ato raste kur sendi a frymori i dhënë i përket sendit a frymorit të shprehur nga kryefjala.

Në fjalinë e dytë, ku është përdorur përemri pronor vetvetor **e vet**, nuk ka vend për dykuptimësi, sepse vetvetori i referohet vetëm kryefjalës së kësaj fjalie, *Eltoni*. Në fjalinë e parë, lind nevoja t'i referohemi një konteksti të caktuar, për të kuptuar se kujt i referohet përemri **i tij**. Ky problem nuk shtrohet për vetën e parë dhe të dytë, njëjës dhe shumës.

## Lakimi i përemrave pronorë

🌸 **Vëreni përdorimet e përemrave pronorë. Në cilën rasë janë përdorur?**

*Ky është libri im.*  
*Këtë e kam librin tim.*  
*Këta janë librat e mi.*

Përemri pronor përdoret i shoqëruar me emër.

*Ky libër është imi.*  
*Këtë librin e kam timin.*  
*Këta libra janë të mitë.*

Përemri pronor përdoret më vete.



Përemrat pronorë, krahas kategorisë së vetës, të gjinisë dhe të numrit, kanë edhe kategorinë e rasës.

Përemrat pronorë mund të përdoren të shoqëruar me emrat ose në vend të këtyre emrave.

Në të dyja përdorimet, këta përemra lakohen të gjithë.

Përemrat **tanë/tona** dhe **tuaj/tuaja** lakohen vetëm kur përdoren më vete.

🌸 Kur përemrat pronorë vendosen pas emrit, atëherë ky emër përdoret në trajtë të shquar.

🌸 Kur përemrat pronorë vendosen para emrit, atëherë emri është gjithmonë në trajtë të pashquar.

Lakimi i përemrit  
pronorLakimi i përemrit pronor  
(i shoqëruar me emra në trajtë të shquar)

Veta e parë (njëjës)				
Rasa				
emërore	shoku im	shoqja ime	shokët e mi	shoqet e mia
gjinore	i/e shokut tim	i/e shoqes sime	i/e shokëve të mi	i/e shoqeve të mia
dhanore	shokut tim	shoqes sime	shokëve të mi	shoqeve të mia
kallëzore	shokun tim	shoqen time	shokët e mi	shoqet e mia
rrjedhore	prej shokut tim	prej shoqes sime	prej shokëve të mi	prej shoqeve të mia
Veta e dytë				
Rasa				
emërore	shoku yt	shoqja jote	shokët e tu	shoqet e tua
gjinore	i/e shokut tënd	i/e shoqes sate	i/e shokëve të tu	i/e shoqeve të tua
dhanore	shokut tënd	shoqes sate	shokëve të tu	shoqeve të tua
kallëzore	shokun tënd	shoqen tënde	shokët e tu	shoqet e tua
rrjedhore	prej shokut tënd	prej shoqes sate	prej shokëve të tu	prej shoqeve të tua
Veta e tretë				
Rasa				
emërore	shoku i tij	shoqja e tij	shokët e tij	shoqet e tij
gjinore	i/e shokut të tij	i/e shoqes së tij	i/e shokëve të tij	i/e shoqeve të tij
dhanore	shokut të tij	shoqes së tij	shokëve të tij	shoqeve të tij
kallëzore	shokun e tij	shoqen e tij	shokët e tij	shoqet e tij
rrjedhore	prej shokut të tij	prej shoqes së tij	prej shokëve të tij	prej shoqeve të tij
Rasa				
emërore	shoku i saj	shoqja e saj	shokët e saj	shoqet e saj
gjinore	i/e shokut të saj	i/e shoqes së saj	i/e shokëve të saj	i/e shoqeve të saj
dhanore	shokut të saj	shoqes së saj	shokëve të saj	shoqeve të saj
kallëzore	shokun e saj	shoqen e saj	shokët e saj	shoqet e saj
rrjedhore	prej shokut të saj	prej shoqes së saj	prej shokëve të saj	prej shoqeve të saj
Veta e parë (shumës)				
Rasa				
emërore	shoku ynë	shoqja jonë	shokët tanë	shoqet tona
gjinore	i/e shokut tonë	i/e shoqes sonë	i/e shokëve tanë	i/e shoqeve tona
dhanore	shokut tonë	shoqes sonë	shokëve tanë	shoqeve tona
kallëzore	shokun tonë	shoqen tonë	shokët tanë	shoqet tona
rrjedhore	prej shokut tonë	prej shoqes sonë	prej shokëve tanë	prej shoqeve tona

Veta e dytë				
Rasa				
emërore	shoku juaj	shoqja juaj	shokët tuaj	shoqet tuaja
gjinore	i/e shokut tuaj	i/e shoqes suaj	i/e shokëve tuaj	i/e shoqeve tuaja
dhanore	shokut tuaj	shoqes suaj	shokëve tuaj	shoqeve tuaja
kallëzore	shokun tuaj	shoqen tuaj	shokët tuaj	shoqet tuaja
prej rrjedhore	prej shokut tuaj	prej shoqes suaj	prej shokëve tuaj	prej shoqeve tuaja

## Mbani mend

- ✿ Përemrat pronorë të vetës së parë dhe të vetës së dytë shumës **e mi, e mia, e tu, e tua** lakohen njësoj si mbiemrat e nyjshëm.
- ✿ Pronorët e vetës së parë shumës **tanë, tona, tuaj, tuaja** lakohen ashtu si mbiemrat e panyjshëm.
- ✿ Përemrat pronorë të vetës së tretë **i (e) tij, i (e) saj, i (e) tyre, i (e) vet, e veta** lakohen njësoj si mbiemrat e nyjshëm.

Veta e tretë				
Rasa				
emërore	shoku i tyre	shoqja e tyre	shokët e tyre	shoqet e tyre
gjinore	i/e shokut të tyre	i/e shoqes së tyre	i/e shokëve të tyre	i/e shoqeve të tyre
dhanore	shokut të tyre	shoqes së tyre	shokëve të tyre	shoqeve të tyre
kallëzore	shokun e tyre	shoqen e tyre	shokët e tyre	shoqet e tyre
rrjedhore	prej shokut të tyre	prej shoqes së tyre	prej shokëve të tyre	prej shoqeve të tyre

- ✿ Vetëm përemrat pronorë të vetës së parë dhe të dytë njëjës që shoqërohen me emra të farefnisës, si: **atë, ëmë, vëlla, motër, nip, mbesë** etj., mund të qëndrojnë edhe pas, edhe para emrit: **vëllai im – im vëlla, motra ime – ime motër.**
- ✿ Kurse me emrat **shoq** (burri), **shoqe** (gruaja), përemri mund të vendoset vetëm përpara: **im shoq, ime shoqe.**

## Përemrat e emëruar

Të gjithë përemrat pronorë mund të emëzohen dhe të lakohen si emra mashkullorë ose femërorë.

njëjës		shumës	
Mashkullor	Femëror	Mashkullor	Femëror
I <i>imi</i>	<i>imja</i>	<i>të mitë</i>	<i>të miat</i>
II <i>yti</i>	<i>jotja</i>	<i>të tutë</i>	<i>të tuat</i>
III <i>i tiji/i saji</i>	<i>e tija/e saja</i>	<i>të tijtë/të sajtë</i>	<i>të tijat/të sajat</i>
I <i>yni</i>	<i>jona</i>	<i>të tanët</i>	<i>tonat</i>
II <i>juaji</i>	<i>juaja</i>	<i>të tuajt</i>	<i>tuajat</i>
III <i>i tyri</i>	<i>e tyre</i>	<i>të tyret</i>	<i>të tyret</i>

- ✿ Kur janë të panyshëm, këta përemra lakohen si emra mashkullorë ose femërorë, në varësi të mbaresës shquese që marrin.
- ✿ Përemrat me nyjë të përparme lakohen si emra me nyjë të përparme (p.sh.: *e bija*).

E.		yti		jotja		të tutë		të tuat	II
Gj.	i/e	tëndit	i/e	sates	i/e	të tuve	i/e	të tuave	
Dh./Rr.		tëndit		sates		të tuve		të tuave	
K.		tëndin		tënden		të tutë		të tuat	

E.		i tiji		e tija		të tijtë		të tijat	III
Gj.	i/e	të tijit	i/e	së tijës	i/e	të tijve	i/e	të tijave	
Dh./Rr.		të tijit		së tijës		të tijve		të tijave	
K.		të tijin		të tijën		të tijtë		të tijat	
E.		i saji		e saja		të sajtë		të sajat	III
Gj.	i/e	të sajit	i/e	së sajës	i/e	të sajave	i/e	të sajave	
Dh./Rr.		të sajit		së sajës		të sajave		të sajave	
K.		të sajin		të sajën		të sajtë		të sajat	

E.		yni		jona		tanët		tonat	I
Gj.	i/e	tonit	i/e	sonës	i/e	tanëve	i/e	tonave	
Dh./Rr.		tonit		sonës		tanëve		tonave	
K.		tonin		tonën		tanët		tonat	

E.		juaji		juaja		tuajt		tuajat	II
Gj.	i/e	tuajit	i/e	suajës	i/e	tuajve	i/e	tuajave	
Dh./Rr.		tuajit		suajës		tuajt		tuajave	
K.		tuajin		tuajën		tuajve		tuajat	

E.				të tyret				të tyret	III
Gj.			i/e	të tyreve			i/e	të tyreve	
Dh./Rr.				të tyreve				të tyreve	
K.				të tyret				të tyret	

## USHTRIME

### 1 Plotësoni vendet bosh me nga një përemër pronor.

Secili të shohë punën \_\_\_\_\_. Ajo e takoi gjyshin në shtëpinë \_\_\_\_\_. I moshuari foli, por askush nuk ua vuri veshin fjalëve \_\_\_\_\_. Librat e mi janë në çantë, \_\_\_\_\_ janë mbi tavolinë. Ne e kryem detyrën \_\_\_\_\_. Shoqja ime del gjithnjë e shoqëruar me mamanë \_\_\_\_\_. Djali e la biçikletën \_\_\_\_\_ në oborrin e shkollës.

## USHTRIME

**2** Rishkruani si duhet ato fjali ku përemri pronor krijon paqartësi kuptimore.

- ▣ Ajo e ftoi shoqen në shtëpinë e saj. \_\_\_\_\_
- ▣ Ato punuan gjithë ditën në zyrën e tyre. \_\_\_\_\_
- ▣ Blerta i dha llirit librin e vet. \_\_\_\_\_
- ▣ Secili të shohë punën e tij. \_\_\_\_\_
- ▣ Ai kërkonte të vetat, ajo të vetët. \_\_\_\_\_

**3** Lakoni grupet emërore: *libri yt, shkolla ime, klasa jonë, lapsi i saj.*

**4** Dalloni përemrat pronorë dhe përcaktoni vetën, rasën dhe numrin në të cilin janë përdorur.

- ▣ Edhe bisedat tona të mëvonshme u ngjanin bisedave telefonike.
- ▣ Në largimin e tij shprehej mosbesim, ndaj nuk e ngacmuam më.
- ▣ Në bebëzat e zmadhuara të syve të tij kishte vetëtitër habia.
- ▣ E vërteta, ky është i vetmi ilaç dhe e vetmja ndihmë që më ka mbetur t'i jap popullit tim.
- ▣ Dielli po ngrihej mbi malet e tyre përtej dhe rrezet e tij po zbardhnin luginën.
- ▣ Kur të vijë im nip për t'u regjistruar në kursin tuaj?

**5** Plotësoni tabelën.

	Njëjës		Shumës	
emërore	imi	imja	të mitë	të miat
gjinore	i/e timit			
dhanore		simes		të miave
kallëzore				
rrjedhore			të mive	

**6** Vendosni në formën e duhur përemrat pronorë.

- ▣ Ajo u përpoq të kapte sadopak vështrimin \_\_\_\_\_ (i saj) të rrëshqitshëm.
- ▣ Por edhe ajo këtë herë nuk i hoqi sytë e zinj. Në bebëzat \_\_\_\_\_ (i tyre), që shkëlqenin nga një dritë e lehtë, u shfaq diçka e ngrohtë dhe e çiltër.
- ▣ Heshtja ishte e padurueshme për të dy. Këtë mund të vije re nga fytyrat \_\_\_\_\_ (i tyre) që papritur u bënë të ngurosura.
- ▣ - Kështu të dua, - tha duke u rënë me shuplakë supeve \_\_\_\_\_ (i saj). - Të jesh e sjellshme dhe e mirë.
- ▣ Ëndrrat e bukura kishin mbetur në skutat e errëta të vetëdijes \_\_\_\_\_ (i tij) së bashku me shpresat e vagëlluara.

**7** Lakoni përemrat pronorë të vetës së parë *yni, jona, tanë, tonat* njëjës dhe shumës.

	Njëjës		Shumës	
emërore	yni	jona	tanët	tonat
gjinore				
dhanore				
kallëzore				
rrjedhore				

**8** Formoni fjali me përemrat pronorë *imi, imja, yti, jona, juaja* duke i përdorur në rasat gjinore dhe kallëzore.



# Përemri vetvetor dhe përemri pyetës

## Përemri vetvetor

Përemri vetvetor është përemri që tregon vetën, e cila **përfaqëson** njëkohësisht edhe atë mbi të cilin ushtrohet një veprim, edhe atë që e kryen këtë veprim.

*M'u dhimbs **vetja**.*

Përemrat vetvetorë janë: **vetja** dhe **vetvetja**.

*Më dukej **vetja** sikur fluturoja. Nuk e dija se kisha aq besim në **vetvete**.*

Përemrat vetvetorë lakohen si emrat e gjinisë femërore në trajtën e shquar të numrit njëjës. Ata përdoren njësoj në të dyja gjinitë.

*Lakimi i përemrit vetvetor*

Emërore	vetja	vetvetja
Gjinore	vetes	vetvetes
Dhanore	vetes	vetvetes
Kallëzore	veten	vetveten
Rrjedhore	vetes	vetvetes

Përemri vetvetor përgjithësisht **përdoret si përcaktor i kryefjalës dhe i gjymtyrëve të tjera të fjalisë**: *Vetë Erjoni i kishte këshilluar për një gjë të tillë. Ata vetë e kishin marrë me vete.*

## Përemri pyetës

Përemri pyetës përdoret për të pyetur për frymorë e sende ose për tipare të tyre.

Përemrat pyetës janë: *kush, cili, çfarë, sa, i sati, se.*



**Kemi:**

- ▣ Përemra pyetës që kanë kategorinë gramatikore të gjinisë, numrit, rasës: *cili, i sati.*
- ▣ Përemra pyetës që kanë vetëm kategorinë gramatikore të rasës: *kush, sa.*
- ▣ Përemra pyetës që nuk kanë kategori gramatikore: *ç', çfarë, se.*

## Roli i përemrave pyetës

Përemri pyetës **kush** përdoret për të pyetur për njerëz ose për qenie të personifikuara vetëm në numrin njëjës dhe nuk mund të shoqërohet me emra: **Kush ishte autori i librit?**

**Kush** vrapon më shumë se unë? - tha Ermali.

Përemri pyetës **cili** mund të përdoret për të pyetur për njerëz, për kafshë dhe për sende.

Përemri pyetës **ç** shkruhet gjithmonë me apostrof: **Ç'bën aty, more djalë?**

Lakimi i përemrave pyetës **kush, cili, cila, cilët, cilat**

	kush	cili	cila	cilët	cilat
Emërore	kush	cili	cila	cilët	cilat
Gjinore	i (e) kujt	i (e) cilit	i (e) cilës	i (e) cilëve	i (e) cilave
Dhanore	kujt	cilit	cilës	cilëve	cilave
Kallëzore	kë	cilin	cilën	cilët	cilat
Rrjedhore	prej kujt	prej cilit	prej cilës	prej cilëve	prej cilave

## USHTRIME

### 1 Vendosni në vendet bosh përemra vetvetorë.

Unë për \_\_\_\_\_ time nuk e di se duhet të rri këtu për dy orë. E kam fajin \_\_\_\_\_.  
E kam inatin me \_\_\_\_\_ time. Ky është \_\_\_\_\_.

### 2 Shkruani fjali me përemrat vetvetorë për çdo rasë.

Vetja:	Vetvetja:
I, e vetes:	I, e vetvetes:
Vetes:	Vetvetes:
Veten:	Vetveten:
Prej vetes:	Prej vetvetes:

### 3 Plotësoni fjalën që mungon në vendet bosh.

\_\_\_\_\_ ju duhet për ta kryer këtë punë? \_\_\_\_\_ ju ka thënë se do të marrin pjesë vetëm vajzat në këtë garë? \_\_\_\_\_ nga ju do të jetë vullnetari i radhës? \_\_\_\_\_ mendon se do të dalësh?

### 4 Nënvizoni aty, përemrat dëftorë dhe qarkoni përemrat vetorë.

Të gjithë e kritikuan atë. Juliana ka një shoqe. Ajo nuk flet shumë. Ne duhet të flasim me mësuesit tanë. Unë kam menduar shumë para se të marr këtë vendim. Këto fjalë nuk më pëlqyen fare. E tillë është situata, duhet ta kapërcejmë.

### 5 Shkruani fjali me përemrat pyetës:

Kush \_\_\_\_\_? Cili \_\_\_\_\_?  
Cili \_\_\_\_\_? Çfarë \_\_\_\_\_?  
Sa \_\_\_\_\_? I sati \_\_\_\_\_?

### 6 Formoni fjali me nga tre përemra vetvetorë dhe pyetës.

# Përemri i pacaktuar

- 🌸 Dalloni përemrat e pacaktuar.
- 🌸 Cili prej tyre ndryshon gjatë përdorimit?
- 🌸 Cili përdoret i shoqëruar apo jo me emër?

*Dikush po vjen. Sekush trokiti. Le të shkojë kushdo të shohë. Gjithkush vendos vetë.*

*Ata kujdeseshin për njëri-tjetrin, megjithëse jetonin larg. E ndihmonin shoku-shokun.*

*Askush nuk e pa. Asnjëri nuk e pa. Ke parë njeri këtu? Secili prej nesh do të flasë. Në secilin grup ka disa nxënës të mirë e shumë të mirë. Çdo klasë është e veçantë.*

Përemri **dikush** përdoret për të treguar ndonjë njeri që nuk dihet se kush është apo që s'duam t'i përmendim emrin.

Përemrat **kushdo**, **gjithkush** tregojnë tërësinë e njerëzve nga e cila s'përfshihet asnjë.

Përemri **sekush** tregon një frymor (njeri të panjohur).

Përemrat **askush**, **asnjëri**, **njeri** mohojnë një frymor të pacaktuar.

Përemrat **cilido**, **secili**, **gjithsecili** tregojnë elemente të një grupi të marrë veç e veç.

Përemri **çdo** ka kuptim të përgjithshëm dhe përdoret vetëm i shoqëruar me emra.

Përemri **disa** tregon sasi të pacaktuar, por të kufizuar njerëzish a sendesh.

## Përemri i pacaktuar

Përemri i pacaktuar është përemri që tregon frymorë a sende në mënyrë të pacaktuar.

Përemrat e pacaktuar janë të shumëllojshëm për nga kuptimi, forma dhe përdorimi.

🌸 Sipas kuptimit, përemrat e pacaktuar përdoren:

Për të treguar njerëz:

*dikush, ndokush, sekush, gjithkush, kushdo, tjetërkush, askush, njeri, asnjëri, njëri-tjetri etj.*

Për të treguar njerëz e sende:

*një/njëri, ndonjë, njëfarë, asnjë, cilido, gjithsecili, secili etj.*

Për të treguar sende:

*gjë, gjithçka, diçka etj.*

🌸 Sipas mundësisë për t'u përdorur me emrin, dallohen:

🌸 Përemra që nuk shoqërohen me emra: *kush, kushdo, dikush, diçka, hiçgjë, kurrëgjë, njëri, gjë, gjësend, asgjë, kurrëgjë, njëri-tjetri, shoku-shokun* etj.

Ka ndodhur **diçka**. Të kërkon **njëri**.

Pe **gjë**? **Dikush** do të përgjigjet.

🌸 Përemra që shoqërohen me emra: *cilido, secili, gjithsecili, çfarë, çfarëdo, gjithë, gjithfarë, gjithfarëlloj, kurrfarë, mbarë, një, shumë, ca, disa, lloj-lloj, të gjithë, të tërë* etj.

Të pret **një** djalë.

**Gjithë** klasa kishte dalë për të parë ç'kishte ndodhur.

**Shumë** vetë e besojnë këtë mrekulli.

Kishte **lloj-lloj** librash.

🌸 Sipas formës, përemrat e pacaktuar ndahen:

🌸 të ndryshueshëm: *kush, dikush, ndokush, kushdo, askush, cilido, disa, të gjithë, të tërë* etj.

🌸 të pandryshueshëm: *një, ndonjë, çdo, asnjë, gjithë, gjë, diçka, kurrëgjë, asgjë* etj.

## Përemrat e pacaktuar të ndryshueshëm

Disa përemra ndryshojnë në rasë, disa në rasë dhe gjini e përemra të tjerë në gjini, rasë dhe numër. Përemrat që shoqërohen me emra, kur dalin bashkë me emrin, nuk lakohen.

Tabelat e lakimit të disa përemrave të pacaktuar të ndryshueshëm

Rasa						
E.	dikush	ndokush	kushdo	disa	cilido	cilado
Gj.	i/e dikujt	i/e ndokujt	i/e kujtdo	i/e disave	i/e cilitdo	i cilësdo
Dh.	dikujt	ndokujt	kujtdo	disave	clitdo	cilësdo
K.	dikë	ndokënd	këdo	disa	cilindo	cilëndo
Rr.	dikujt	ndokujt	kujtdo	disave	clitdo	cilësdo

Rasa						
E.	njëri	njëra	tjetër	tjetër	të tjerë	të tjera
Gj.	i njërit	i/e njëres	i/e një tjetri	i/e një tjetre	i/e të tjerëve	i/e të tjerave
Dh.	njërit	njëres	një tjetri	një tjetre	të tjerëve	të tjerave
K.	njërin	njëren	një tjetër	një tjetër	të tjerë	të tjera
Rr.	njërit	njëres	një tjetri	një tjetre	të tjerëve	të tjerave

Rasa						
E.	të gjithë	të gjitha	të tërë	të tëra	secili	secila
Gj.	i/e të gjithëve	i/e të gjithave	i/e të tërëve	i të tërave	i/e secilit	i/e secilës
Dh.	të gjithëve	të gjithave	të tërëve	të tërave	secilit	secilës
K.	të gjithë	të gjitha	të tërë	të tëra	secilin	secilën
Rr.	të gjithëve	të gjithave	të tërëve	të tërave	secilit	secilës

**Vini re:** Numri i përemrave të pacaktuar që nuk ndryshojnë në gjini, numër e rasë, nuk është i madh. Përemra të tillë që kanë vetëm një formë janë: *gjë, asgjë, kurrëgjë, një, ndonjë, njëfarë, asnjë, çdo, çfarëdo, diçka, seç, gjithë, gjithfarë, kurrfarë, mbarë, pak, shumë* etj.

## USHTRIME

## 1 Dalloni përemrat dhe tregoni llojin e tyre.

Dhe ai uli atë kokën e vet të madhe e të qethur, duke më buzëqeshur fshehurazi. Filluam të loznim. Unë i nxora të gjitha lodrat e mia. Prekosi sikur u magjeps nga treni i vogël që ecën vetë: nuk kishte parë kurrë diçka të tillë. I përpinte me sy vagonët e kuq e të verdhë. Unë i dhashë çelësin që të luante. Ai u ul në gjunjë që të luante me veten dhe s'e ngriti më kokën.

Kurrë nuk e kisha parë aq të gëzuar. Tërë kohën thoshte: "Më fal, më fal", duke na bërë shenjë me dorë që të mos e ndalnim trenin. Ne të gjithë rrinim në këmbë dhe vështronim. Vështronim atë qafë të hollë, ata veshë të mjerë, që dikur i kisha parë të pikonin gjak; atë xhaketë të gjatë me mëngë të përveshura nga dilnin dy krahe të hollë si prej të sëmuri që ishin ngritur aq herë për të mbrojtur fytyrën nga të rrahurat...

(E. de Amiçis, "Zemra")

## 2 Dalloni cilët nga përemrat e mëposhtëm janë pyetës dhe cilët të pacaktuar.

- ▣ Kishte mjaft kushërinj në atë qytet.
- ▣ Kush ka ngrënë mjaltin, ka mizën pas veshit.
- ▣ A e dini se çfarë u tha ajo?
- ▣ Pse, çfarë do të bësh?
- ▣ Kush më shumë e kush më pak të gjithë u kënaqën.
- ▣ S'ka ç'i bën gomarit, i bie samarit.
- ▣ Çfarë këngësh të pëlqejnë?
- ▣ Nuk e kisha parë prej vitesh dhe ndieja njëfarë emocioni.
- ▣ Nuk e di se kush e ka marrë.
- ▣ Sa ditë kanë kaluar që atëherë?
- ▣ Ç'ka barku, i nxjerr bardhaku.
- ▣ Sa ftova, më erdhën.
- ▣ Eja me kë të dëshirosh.

3 Lakoni grupet emërore: *ca libra, klasa tjetër, secili nxënës, çdo grup*.4 Ndërtoni gjashtë fjali me fjalën **kush** të përdorur si përemër pyetës, si përemër lidhor dhe si përemër të pacaktuar.5 Dalloni se në cilat raste fjalët **shumë, ca, tepër, pak** janë përemra të pacaktuar.

- ▣ Shumë njerëz po dukeshin nga lart. Shumë prej tyre po vraponin, të tjerët po ecnin ngadalë e disa po ecnin me hap të shpejtë.
- ▣ Trimi i mirë me shokë shumë.
- ▣ Ngjyrat dukeshin shumë të ndezura.
- ▣ Ju vijnë shumë të ftuar? Vijnë shumë, por pak qëndrojnë.
- ▣ Ka ca ngjarje të vërteta që, kur tregohen shumë herë, duken si të sajuara për të bërë humor.
- ▣ Mos jemi shumë larg prej këtej?
- ▣ Ai shpenzoi shumë.
- ▣ Mos po fantazojmë si tepër, Pablo?
- ▣ Njeriu i gjorë bën shumë gabime në jetë.

## 6 Shkruani një tekst të shkurtër argumentues, për përparësitë dhe rreziqet e përdorimit të internetit, duke përdorur përemra pronorë e të pacaktuar.

# Folja në mënyrat kushtore dhe habitore

Nëse do t'i zgjidhte të gjitha ushtrimet, Erdi do të merrte notë të mirë.



## Mënyra kushtore e foljes

*Të paskështa vrapn' e veriut, të kisha krahë pëllumbi,  
Nxitimn' e lumit me valë, q'ikën me vërtik si plumbi,  
E të vija në gjit tuaj, nj' ujë të ftohtë të pinja,  
Edhe nëpër ato hije një copë herë të rrinja.*

🌸 **Dalloni mënyrën dhe kohën e foljeve. Analizoni rolin e tyre për shprehjen e kuptimit të fjalisë.**

Folja e përdorur në mënyrën kushtore, tregon një veprim që mund të kryhej, po të vërtetohej një kusht i caktuar.

📌 *Pa mbështetjen tënde, nuk do t'ia dilja mbanë.*

Mënyra kushtore ka dy kohë: **të tashmen** dhe **të kryerën**.

Zgjedhimi i foljes  
në mënyrën  
kushtore

	Koha e tashme	Koha e kryer
unë	do të shkoja	do të kisha shkuar
ti	do të shkoje	do të kishë shkuar
ai/ajo	do të shkonte	do të kishte shkuar
ne	do të shkonim	do të kishim shkuar
ju	do të shkonit	do të kishit shkuar
ata/ato	do të shkonin	do të kishin shkuar

## Mënyra habitore e foljes

Folja e përdorur në mënyrën habitore, shpreh ndjenjën e habitës së folësit për kryerjen ose moskryerjen e një veprimi të caktuar.

▣ *Sa paska ndryshuar ky vend!*

▣ *S'paska njeri këtu!*

Me anë të mënyrës habitore, folësi mund të shprehë dyshimin ose mospajtimin, madje edhe ironi.

▣ *Domethënë, të tjerët ta paskan fajn? Ja, kështu i dashka mushka drutë.*

Mënyra habitore ka katër kohë: **të tashmen, të pakryerën, të kryerën** dhe **më se të kryerën**.

### Zgjedhimi i foljes në mënyrën habitore

Mënyra habitore

	E tashme	E pakryer	E kryer	Më se e kryer
unë	afruakam	afruakështa	paskam afruar	paskështa afruar
ti	afruake	afruakështe	paske afruar	paskështe afruar
ai/ajo	afruaka	afruakësh	paska afruar	pakësh afruar
ne	afruakemi	afruakëshim	paskemi afruar	pakëshim afruar
ju	afruakeni	afruakëshit	paskeni afruar	pakëshit afruar
ata/ato	afruakan	afruakëshin	paskan afruar	pakëshin afruar

## USHTRIME

- 1 Zgjedhoni foljet *kam, vizitoj, hap, fle* në të dyja kohët e mënyrës kushtore, sipas shembullit të dhënë.

	Koha e tashme	Koha e kryer
unë	do të kisha	do të kisha pasur
ti		
ai/ajo		
ne		
ju		
ata/ato		

- 2 Ndërtoni fjali duke i kthyer foljet në mënyrën kushtore sipas shembullit të dhënë.

a. Nuk kemi bileta. Nuk do ta shohim filmin në kinema.

▣ *Po të kishim bileta, do ta shihnim filmin në kinema.*

b. Po bie shi. Duhet të marrim çadra.

c. Nuk ka trafik. Unë arrij në orar në punë.

d. Të gjithë punojnë si duhet. Punët shkojnë mirë.


e. Ikën macja. Lozin minjtë.

## USHTRIME

### 3 Klasifikoni pohimet sipas skemës së dhënë.

Në fjalitë me folje në mënyrën kushtore:

- Mënyra kushtore e foljes shpreh habi.
- Kryerja e veprimit varet nga realizimi i kushtit.
- Kushti duhet të jetë medoemos i realizueshëm.
- Kushti shprehet vetëm me anë të një fjalie.
- Mënyra kushtore ka dy kohë.



### 4 Plotësoni tabelën e mëposhtme me foljet: *jam, mendoj, pres, ha*.


Mënyra habitore

	Koha e tashme	Koha e shkuar		
		E pakryer	E kryer	Më se e kryer
unë	qenkam	qenkështa	paskam <i>qenë</i>	paskështa <i>qenë</i>
ti				
ai/ajo				
ne				
ju				
ata/ato				

### 5 Plotësoni pohimet sipas skemës së dhënë.

Në fjalitë me folje në mënyrën habitore:

- Mënyra habitore e foljes shpreh edhe dyshimin e folësit.
- Folja në mënyrën habitore nuk shoqërohet me pjesëza mohuese.
- Folësi mund ta shprehë habinë vetëm nëpërmjet mënyrës habitore të foljeve.
- Format kohore të habitores përdoren në fjali të thjeshta dhe të përbëra.
- Mënyra habitore ka dy kohë.



### 6 Ktheni foljet e dhëna në kohën **më se të kryer** të mënyrës habitore dhe formoni fjali me to.

- mendoj* \_\_\_\_\_
- shkruan* \_\_\_\_\_
- flet* \_\_\_\_\_
- kërcejmë* \_\_\_\_\_
- udhëtoni* \_\_\_\_\_
- kthejnë* \_\_\_\_\_

### 7 Pëcaktoni mënyrën, kohën, vetën, zgjedhimin e foljeve të fjalive të mëposhtme.

- Në qenka puna kështu, unë heq dorë.* \_\_\_\_\_
- Gjoja, qenkësh i ditur ai.* \_\_\_\_\_
- Sa të vështira paskëshin qenë këto punë!* \_\_\_\_\_
- Në paskësh qenë atje edhe të premtën, unë s'flas më.* \_\_\_\_\_
- Kujt ia merrte mendja, ç'paskësh bërë ai.* \_\_\_\_\_

### 8 Shkruani një tregim të shkurtër deri në tetë fjali në të cilin të përdorni nga katër folje të mënyrës habitore dhe kushtore.



# Folja në mënyrat dëshirore dhe urdhërore

## Mënyra dëshirore e foljes



*Pra, mallkue njai bir Shqyptari,  
qi këtë gjuhë të Perëndis',  
trashigim, që na la i Pari,  
trashigim s'ia len ai fmis;  
edhe atij **iu thaftë**, po, goja,  
që përbuzë këtë gjuhë hyjnore;  
qi n'gjuhë t'huej, kur s'asht nevoja,  
flet e t'veten e lën mbas dore.*

🌸 Dalloni foljet në mënyrën dëshirore. Çfarë shprehin ato?

Me anë të mënyrës dëshirore, shprehet një dëshirë në formë urimi ose mallkimi: *Ardhtë shëndoshë e mirë! Gëzuar qofshi!*

Mënyra dëshirore ka dy kohë: të tashmen dhe të kryerën.

	Koha e tashme	Koha e kryer
unë	gëzofsha	paça gëzuar
ti	gëzofsh	paç gëzuar
ai/ajo	gëzofhtë	pastë gëzuar
ne	gëzofshim	paçim gëzuar
ju	gëzofshi	paçi gëzuar
ata/ato	gëzofshin	paçin gëzuar

## Mënyra urdhërore e foljes

*Shqipërin' e mori turku, i vu zjarr!  
Shqipëtar, mos rri, po duku, shqipëtar!  
Mjaft punove për të tjerë, o fatkeq!  
Kujto vendin tek ke lerë dhe tek heq.*

🌸 Dalloni foljet në mënyrën urdhërore. Vini re dallimin nga trajtat e tjera foljore.

Me anë të mënyrës urdhërore shprehet një dëshirë në formë urdhri, kërkese, këshille, porosie, lutjeje etj.

Folja në mënyrën urdhërore del vetëm në vetën e dytë njëjës dhe shumës: *Nisu menjëherë! Nisuni menjëherë!*

## USHTRIME

1 Zgjedhoni foljet: **jam, kërkoj, kap, lë** në të dyja kohët e mënyrës dëshirore.

	Koha e tashme	Koha e kryer
unë	qofsha	paça qenë
ti		
ai/ajo		
ne		
ju		
ata/ato		


2 Ndërtoni fjali me kuptim dëshiror, duke i kthyer foljet në mënyrën dëshirore sipas shembullit të dhënë.

- Dëshiroj të shkosh e të kthehesh shëndoshë e mirë. *Shkofsh e u kthefsh shëndoshë e mirë!*
- Le të kemi shëndetin, pa të tjerat shkojnë e vijnë. \_\_\_\_\_
- Të të këndoje zemra e të kesh njëmijë të mira! \_\_\_\_\_
- Le ta thyejë qafën andej nga ka ardhur. \_\_\_\_\_

3 Klasifikoni pohimet sipas skemës së dhënë.

Në fjalitë me folje në mënyrën dëshirore:

- Mënyra dëshirore e foljes shpreh vetëm urim.
- Mënyra dëshirore e foljes mund të përdoret në fjali kushtore.
- Mënyra dëshirore përdoret vetëm për veprime të së ardhmes.
- Urimet dhe mallkimet shprehen vetëm me mënyrën dëshirore të foljes.
- Mënyra dëshirore ka vetëm kohën e ardhme.



4 Përcaktoni llojin e fjalive të mëposhtme dhe rolin e foljes **jam**.

- Në *qoftë* duke fjetur, mos e zgjo! \_\_\_\_\_
- Në *qoftë* se nuk mëson, do ta kesh më të vështirë. \_\_\_\_\_
- Qoftë* me jetë të gjatë ky djalë! \_\_\_\_\_
- Duhet ta respektosh tjetrin, kushdo *qoftë*. \_\_\_\_\_

5 Ktheni foljet e dhëna në kohën **e tashme** të mënyrës dëshirore dhe formoni fjali me to.

*bëj* \_\_\_\_\_  
*merr* \_\_\_\_\_  
*del* \_\_\_\_\_  
*vëmë* \_\_\_\_\_  
*lini* \_\_\_\_\_

6 Klasifikoni pohimet sipas skemës së dhënë.

Në fjalitë me folje në mënyrën urdhërore:

- Folja në mënyrën urdhërore del vetëm në formën mohore.
- Njëpërmjet mënyrës urdhërore shprehet vullneti i dëgjuesit.
- Folësi mund ta shprehë urdhrin vetëm njëpërmjet mënyrës urdhërore të foljeve.
- Mënyra urdhërore realizohet me vetën e dytë njëjës dhe shumës.



7 Dalloni mënyrën dhe kohën e foljeve.

Më thuaj të vërtetën! Po të jepja tani një urdhër që vetëm mbreti ka të drejtë ta japë, a do të zbatohet? Do të kundërshtonte e të thoshte njeri "jo"? Jo, madhëri, askush nuk do të guxonte. Për sa kohë je mbret, vullneti yt është ligj. Atëherë Tomi tha: - Ngrihuni në këmbë dhe shpejt drejt kështjellës!

# Zgjedhimi jovepror në mënyrat: dëftore, habitore, lidhore, kushtore, dëshirore dhe urdhërore

## Mbani mend

Zgjedhimi jovepror ndërtohet me tri mjete gjuhësore të ndryshme:

- ✿ me anë mbaresash;
- ✿ me anë të pjesëzës *u*;
- ✿ me anë të foljes ndihmëse *jam*.

### I. Format foljore të zgjedhimit jovepror të ndërtuara me anë mbaresash

Në zgjedhimin jovepror, ndërtohen me anë të mbaresave format e kohës së tashme dhe të pakryer të mënyrës dëftore e lidhore, si dhe ato të kohës së ardhme. Po ashtu edhe disa kohë të mënyrës kushtore.

	e tashme	e pakryer	e ardhme
Mënyra dëftore	la- <b>hem</b>	la- <b>hesha</b>	do të la- <b>hem</b>
Mënyra lidhore	të la- <b>hem</b>	të la- <b>hesha</b>	
Mënyra kushtore	do të la- <b>hesha</b>		

### II. Format foljore të zgjedhimit jovepror të ndërtuara me pjesëzën *u*

Në zgjedhimin jovepror, ndërtohen me pjesëzën *u*, format foljore të së kryerës së thjeshtë të mënyrës dëftore, të kohës së tashme dhe të së pakryerës të mënyrës habitore, të kohës së tashme të mënyrës dëshirore dhe urdhërore.

	e tashme	e pakryer	e kryer e thjeshtë
Mënyra dëftore			u la-va
Mënyra habitore	u la-kam	u lakështa	
Mënyra dëshirore	u lafsha		
Mënyra urdhërore	la-h-u mos u laj		

## Vini re:

Edhe format foljore të pashtjelluara (përveç pjesores) e ndërtojnë formën joveprorë me anë të pjesëzës *u*, e cila vendoset menjëherë para temës foljore.

- Mohore: pa **u** larë  
 Përcjellore: duke **u** larë  
 Paskajore: për t'**u** larë  
 Të tjera: me t'**u** larë/ një t'**u** larë

### III. Format foljore të zgjedhimit jovepror të ndërtuara me anë të foljes ndihmëse *jam*

Në zgjedhimin jovepror, me anë të foljes ndihmëse *jam* ndërtohen të gjitha format foljore të përbëra të së shkuarës. Në zgjedhimin vepror këto forma foljore ndërtohen me anë të foljes ndihmëse *kam*. Ashtu si në zgjedhimin vepror, edhe në atë jovepror, zgjedhohet folja ndihmëse, pra folja *jam*, kurse pjesorja e vendosur pas saj mbetet e pandryshuar.

## Vini re:

Format foljore të pashtjelluara mohore dhe përcjellore e formojnë kohën e kryer të formës joveprorë me anë të foljes ndihmëse jam.

	e kryer	më se e kryer	e kryer e tejshkuar	e ardhme e përparme
Mënyra dëftore	jam larë	isha larë	qeshë larë	do të jem larë
Mënyra lidhore	të jem larë	të isha larë		
Mënyra habitore	qenkam larë	qenkështa larë		
Mënyra kushtore	do të isha larë			
Mënyra dëshirore	qofsha larë			

Mohore: pa qenë larë  
Përcjellore: duke qenë larë

## USHTRIME

1 Plotësoni tabelën e mëposhtme me format joveprorë të foljeve: *mendoj, mat, zë*.

	e tashme	e pakryer	e ardhme
Mënyra dëftore			
Mënyra lidhore			
Mënyra kushtore			

2 Bëni dallimin mes përdorimit të foljes *jam* si folje me kuptim të plotë dhe si folje ndihmëse.

- ▣ Ku je?
- ▣ Jam duke ardhur.
- ▣ Ku keni qenë kaç kohë?
- ▣ Qenke veshur e stolisur si rrallëherë.
- ▣ Qofsha gabim, por zor se kthehet më.
- ▣ Mund të ishim nisur që dje.
- ▣ Që të gjithë duhej të ishim atje.

folje e plotë	folje ndihmëse

3 Bëni dallimin mes pjesëzës *u* të formës joveprorë dhe të trajtës së shkurtër përemërore.

- ▣ U bëfsh njëqind vjeç!
- ▣ U thashë të prisnin pak.
- ▣ Merruni edhe me sport.
- ▣ Mos u anko kot!
- ▣ Kush u foli atyre?
- ▣ Jepuani të drejtën e fjalës!
- ▣ U shqetësova më shumë se ç'duhet.

pjesëz e foljes	trajtë përemërore

4 Rishkruani fjalitë, duke i kthyer foljet nga mënyra dëftore në atë lidhore.

- ▣ Ti zgjohesh shumë herët në mëngjes.
- ▣ Më parë mendohej gjatë para se të merrte një vendim.
- ▣ Do të takohemi me shokët pas dreke.
- ▣ Nuk e di se nga fshihet kohët e fundit.

5 Shkruani një tekst të shkurtër, ku të përdorni të tria mënyrat e formimit të zgjedhimit jovepror të foljeve.

# Pasthirrma

## Lexoni fragmentin. Emërtoni fjalët.

- Kërce, o Andrea...!
- Bum! – u dëgjua një zhurmë.
- Ua, e kapërceu! – thotë Arbi.

Vëreni me kujdes fjalët e nënvizuara në tekst. Çfarë shprehin ato?  
Të gjitha këto fjalëza janë pasthirrma.



*Pasthirrma është pjesë e pandryshueshme e ligjëratës, që shërben për të shprehur ndjenjën a vullnetin e folësit ose për të tërhequr vëmendjen e dëgjuesit.*

Pasthirrma mund të jetë një tingull ose një grup tingujsh, një fjalë a një grup fjalësh.

– Ua! Ti paske ndryshuar fare!

Pasthirrma **ua** shpreh çudinë, habinë e folësit ndaj ndryshimit që ka pësuar bashkëbiseduesi.

– **Foorcaaa!** Jepi, ia arrite!

Në këtë rast, pasthirrma **forca** shpreh nxitje për të kryer një veprim.

Pasthirrmat nuk janë fjalë emërtuese. Ato shërbejnë për shprehjen e ndjenjave.

Nisur nga kuptimi, pasthirrmat ndahen në tri grupe kryesore: emocionale, nxitëse, tingullimitime.

**Klasifikimi i pasthirrmave sipas kuptimit**

Shpreh	Pasthirrma emocionale	Shembuj
gëzim, admirim, kënaqësi	<i>ëhëhë, o, oho, ohoho, të lumtë, urra</i> etj.	<i>O hoho, sa ngrohtë qenka! Të lumtë, na nderove!</i>
habi	<i>au, eu, oj, ou, pa, u, ua, uh</i> etj.	<i>Ua, sa paske ndryshuar! Eu, ç'asht kanga, more!?</i>
frikë, dëshpërim, hidhërim	<i>bobo, bubu, korba, kuku, obobo, qyqja, ububu, e zeza</i> etj.	<i>Qyqja, më iku djali! Bobo, sa shumë njerëz që paska!</i>

mosbesim, mospërfillje, përbuzje	<i>aha, bah, ehe, ahu, i, ohu, ptu, ye</i> etj.	<i>Ahu, përsëri ti me këto! Ptu, sa turp!</i>
pakënaqësi, keqardhje, mërzi, dhimbje	<i>a, ah, eh, of, oi, uf</i> etj.	<i>Uf, s'durohet ky!</i>

b. **Pasthirrat nxitëse** shprehin dëshirën ose vullnetin e folësit. Ato ndahen në tri nëngrupe:

<i>Shpreh</i>	<i>Pasthirra nxitëse</i>	<i>shembuj</i>
thirrje	<i>ej (hej), o, ore (or, mor, more), moj (ori, mori), pëst</i> etj.	<b>Moj, do pushosh ti, apo?</b>
nxitje, urdhër ose lutje	<i>oburra, forca, hë, na sus, shët, të keqen</i> etj.	<b>Hë, se dhe pak arritëm!</b>
përsëndetje, mirënjohje, mallkime, sharje, ngushëllime	<i>faleminderit, lamtumirë, mirëmëngjes, mirupafshim, mirë se erdhe, natën e mirë, tungjatjeta, udha e mbarë</i> etj.	<i>Mirë se na erdhët, ju po ju prisnim.</i>

## Tingullimitimet

c. **Tingullimitimet (ose onomatopetë)** janë pasthirra që imitojnë tinguj e zhurma të frymorëve, të sendeve dhe të dukurive të natyrës.

Në të vërtetë, këto fjalëza as nuk shprehin ndjenja, as nuk nxitin për të vepruar, por vetëm imitojnë tingujt e natyrës: *mjau-mjau, be-be, ha-ha, ty-ty-ty, hi-hi-hi, ciuciu, plluq, pik-pik* etj.

🌸 Dëgjohej zëri i një kumrie: *gu-gu-gu!* *Mjau-mjau*, - bëri macja dhe trembi fëmijët.

### Vendi dhe funksioni i pasthirmave në fjali

Pasthirrat zakonisht vendosen në fillim të fjalisë, por edhe në mes apo në fund të saj.

Kur shqiptohen me fuqi të veçantë, pas tyre vendoset pikëçuditje ose edhe pikëpyetje.

- **Ua!**? *Ju na thatë vetë, - tha Bardha me zë të lartë.*

Pasthirrat mund të përdoren si një fjali e vetme ose si një fjalë brenda një fjalie të palidhura nga ana sintaksore me fjalët e tjera. - **Tungjatjeta!** - *i foli Arbri.*



## USHTRIME

- 1 Lexoni fjalitë duke i shqiptuar pasthirrat me intonacionin e duhur dhe thoni se çfarë shprehin ato.

*Oh! Sa të bukura janë fushat që gjelbërojnë! Ah, ku jeni o ditët e bukura të verës! O hoho, sa mirë bërë që erdhe! Lamtumirë, o mori Shkodër,/ Lamtumirë dhe ti Cukal!/ Zhduket Buna nën një kodër./ Zhduket Drini nën një mal.*

*- Eh, mor bir! - psherëtiu babai. - M'u rrite dhe ti.*

- 2 Dalloni pasthirrat që shprehin ndjenjat e folësit, pasthirrat nxitëse dhe tingullimitimet.

*- Prite, o Nikollë, se po të vjen një derr i madh!*

*- Ha-ha-ha! Ha-ha-ha! – ndërsej në qentë.*

*- Prite ti, o Arbër, atë dhelpër, se po të shkon pranë!*

*- Ah! Në të lënça të gjallë unë ty! - thotë Arbëri dhe qëllon me pushkë, taf! Dhe e godet në krye. - Të lumtë, o Arbër, se na zbardhe faqen!*

- 3 Vendosni në tabelë pasthirrat:

*bobo, shëët, mirëdita, taf-taf, uh, more, iii, lamtumirë, hi-hi, ah, oburra, mirë se erdhe, ku-ku-ku, ububu, tungjatjeta, sh-sh-sh, sus, pupupu, faleminderit.*

emocionale	nxitëse	tingullimitime

- 4 Shkruani një përshkrim të shkurtër në të cilin të përdorni pasthirra të grupeve të ndryshme.
- 5 Shkruani disa pasthirra që imitojnë tinguj të ndryshëm frymorësh apo sendesh dhe krijoni fjali me to.
- 6 Përshkruani figurën e mëposhtme me 5-6 fjali, ku të përdorni sa më shumë pasthirra.



# Pjesëza

## Lexoni fragmentin dhe emërtoni të gjitha fjalët me ngjyrë të theksuar.




*Ja dhe Berti, shoku im më i mirë. E kam njohur qysh në fëmijëri, kur jetonim të dy në të njëjtin fshat. **Madje** i kam mësuar si bëhen fyejt, por tani është bërë edhe më i zoti. Mbase do të bëhet më i shquar, ose **nuk** do që t'i flasë kush, **pale** babai mburret dhe e përmend çdo orë për zotësinë e tij.*

Fjalëza **nuk**, e vendosur para foljes **dua**, mohon kryerjen e veprimit të shprehur nga kjo folje.

Ndërsa fjalëza **pale** tregon se përforcon qëndrimin rreth informacionit që jepet më pas. Këto fjalë quhen pjesëza.





Pjesëza është pjesë e pandryshueshme e ligjëratës dhe shërben për të shprehur ngjyime kuptimore, emocionale ose plotësuese të një fjale, togfjalëshi apo fjalie.

Sipas kuptimit, pjesëzat grupohen në:

-  pjesëza që shprehin ngjyime kuptimore të përgjithshme;
-  modale;
-  emocionuese-shprehëse.

## I. Pjesëzat që shprehin ngjyime kuptimore të përgjithshme

Këto pjesëza shërbejnë për të shprehur ngjyime kuptimore plotësuese të një fjale, të një grupi fjalësh a të një fjalie të tërë. Ato grupohen në:

-  **Dëftuese**, ku përfshihet vetëm pjesëza **ja**, e cila shërben për të treguar dikë, diçka: *Ja dhe kroi i fshatit tonë.*
-  **Përcaktuese-saktësuese** (*deri (gjer), mu, pikërisht, plot, qysh, rrumbullak, sa, sapo etj.*), të cilat përcaktojnë ose saktësojnë më mirë kuptimin e një fjale, grupi fjalësh apo fjalie: *Pikërisht, të tilla fjalë të bënin të mendoje thellë.*
-  **Përforcuese** (*bile, dhe, edhe, madje, sidomos, veç, veçse, veçanërisht, vetëm, sa (për) etj.*), të cilat shërbejnë për të përforcuar më shumë kuptimin e një fjale, togfjalëshi a fjalie: *Madje e kishte ndihmuar edhe herë të tjera.*
-  **Përafruese** (*afërsisht (afër), aty-aty, nja, si nja, gati, rreth, thuajse (pothuajse), desh, mend*), të cilat përdoren para një fjale, grupi emëror a fjalie për ta paraqitur të përafërt kuptimin e tyre: *Ata na dëgjonin gati me vuajtje.*

## II. Pjesëzat modale

Këto pjesëza shërbejnë për të shprehur qëndrimin e folësit ndaj një a më shumë mendimeve, vërtetësisë së një ngjarjeje a dukurie. Në këtë grup, përfshihen pjesëzat:



- ✿ **Pohuese** (*po, posi, po që po, po se po, si urdhëron, e, ëhë* etj.), të cilat shërbejnë për të pohuar a për të miratuar një mendim, për të lejuar një veprim: *E lexove? Po, si urdhëron.*
- ✿ **Mohuese** (*jo, mos, nuk, s', jo që jo, jo se jo, as që* etj.), të cilat shërbejnë për t'i dhënë përgjigje mohuese mendimit a mendimeve të shprehura nga një tjetër ose nga vetë folësi, për të mohuar veprimin a gjendjen e shprehur nga folja: *Mos nuk e ndieni veten mirë?*
- ✿ **Pyetëse** (*a, ë, e*), të cilat shërbejnë për të pyetur. *A je i sigurt?*
- ✿ **Dyshuese** (*gjë, kushedi, mbase, ndoshta, sikur, vallë* etj.), të cilat shërbejnë për të dhënë ngjyrim dyshimi, mosbesimi, pasigurie: *Mbase dhe ka dalë.*
- ✿ **Zbutëse** (*pa, as, le, para, dot* etj.), të cilat shërbejnë për ta zbutur kuptimin e fjalës së cilës i përkasin: *Ja, këtë punë nuk e bëja dot.*

### III. Pjesëzat emocionuese-shprehëse

Këto pjesëza shërbejnë për të theksuar anën emocionuese të të folurit dhe për të rritur fuqinë e tij shprehëse. Këtu përfshihen pjesëzat: **ç', de, pale, pra, se, seç**: *Seç më hahet një ëmbëlsirë! Pale, po na hiqet dhe si shok!*

Sipas ndërtimit, pjesëzat janë:

- ✿ **të thjeshta**: *bile, ja, jo, nuk, po, s', vallë* etj.
- ✿ **të përngjitura**: *pale, posi, siç, thuajse (pothuajse)* etj.
- ✿ **shprehje**: *as që, ja që, jo që jo, po se po, se mos, vetëm e vetëm* etj.

## USHTRIME

- 1 Në tekstin e mëposhtëm, gjeni pjesëzat dhe përcaktoni llojin e tyre sipas kuptimit dhe sipas ndërtimit.  
*Ushtria gati po rrokullisej si një trup që ka humbur kontrollin. Ne thuajse nuk nxirrnim asnjë fjalë, por ecnim shpejt, gati pa marrë frymë. Armiku mund të na zbulonte edhe nga zhurma më e vogël, madje edhe nga frymëmarrja e rënduar e ndonjë të plagosuri. Vetëm komandanti seç bënte me dorë nga kalaja majë kodrës. Mbase na ftonte të uleshim e të maskoheshim më mirë. Vallë, a do të dilnim dot më prej atij vendi të lig?*
- 2 Zëvendësoni pjesëzat e tekstit të dhënë dhe shpjegoni ndryshimin që ndodh në të.
- 3 Ndërtoni pesë fjali me pjesëza që shprehin ngjyrim kuptimor të përgjithshme dhe me pjesëza emocionuese-shprehëse.
- 4 Shkruani një tregim të shkurtër, rreth 50 fjalë, ku të përdorni sa më shumë pjesëza që shprehin emocion.
- 6 Shkruani nga një fjalë ku të përdorni **e**-në herë si pjesëz, herë si lidhëz dhe herë si pasthirmë.

# Sintaksë

## FJALIA

- ▶ **Sintaksa** studion mënyrat si lidhen fjalët në grupe fjalësh, fjali dhe vetë fjalitë në mes tyre.

### Gjymtyrët kryesore

#### kryefjala

- ▶ me emër
- ▶ me grup emëror
- ▶ me numëror
- ▶ me përemër

#### kallëzuesi

- ▶ emëror
- ▶ foljor
  - ▶ i thjeshtë
  - ▶ i përbërë

#### përcaktori

- ▶ me përshtatje
- ▶ me drejtim
- ▶ me bashkim
- ▶ me ndajshtim

### Gjymtyrët e dyta

#### kundrinori

- ▶ i drejtë
- ▶ i zhdrejtë
  - ▶ me parafjalë
  - ▶ pa parafjalë

#### rrethanori

- ▶ kohe
- ▶ vendi
- ▶ mënyre
- ▶ sasi
- ▶ shkaku
- ▶ qëllimi

# Ndërtimi i fjalisë dhe analiza gramatikore e saj

🌸 **Lexoni shembujt e mëposhtëm dhe dalloni ndërtimet e pasakta. Argumentoni përgjigjen tuaj.**

- Dimër.
- Gjatë dimrit, ne.
- Dimri mbajti e ftohtë.
- Dimri merrte ilaçe për ftohje të rëndë.
- Dimër nga mbulohen bora në malet.
- Dimri është koha e duhur që njerëzit që e duan të ftohtët dhe borën që mbulon malet që shtrihen në lindje të qytetit që është i rënduar nga smogu që shkaktohet nga makinat e shumta që tejmbushin rrugët tona që janë si qorrsoke që nuk u gjendet filli, të gjejnë prehje në pistat e skive.



## Ç'është fjalia?

Fjalia është njësia sintaksore themelore e kumtimit ligjërimor, që shprehet me një a më shumë fjalë të lidhura gramatikisht e të shqiptuara me intonacion mbarimi. Pra, që fjalia të jetë e saktë, duhen përmbushur dy kriteret e rëndësishme: ana gramatikore dhe ajo kuptimore.

Siç dëshmohet në shembujt e mësipërm, një grup fjalësh mund të lidhen sipas rregullave gramatikore të gjuhës shqipe, por nëse nuk respektohet ana kuptimore, fjalia është e papranueshme: *Dimri merrte ilaçe për ftohje të rëndë*.

Në këtë lidhje fjalësh, janë respektuar të gjitha rregullat sintaksore dhe morfologjike të gjuhës shqipe. Kështu, kallëzuesi 'merrte' është një folje në vetën e tretë njëjës dhe kryefjala 'dimri' është një emër në rasën emërore, numri njëjës; kundrinori 'ilaçe' është një emër në rasën kallëzore, siç e kërkon folja kallëzues, e cila është një folje kalimtare, e kështu me radhë. Megjithatë, fjalia, jashtë kontekstit metaforik, është e papranueshme për shkak të mangësisë së kuptimit.

Nga ana tjetër, fjalia mund të përcjellë një kuptim të caktuar, por nuk respektohen rregullat gramatikore. Kështu në shembullin: "Dimri mbajti e ftohtë", gjymtyra emërore e shprehur me mbiemrin 'e ftohtë' nuk realizon përshtatjen me kryefjalën, e cila duke u shprehur me një emër në gjininë mashkullore, nuk mund të pranojë një mbiemër në gjininë femërore.

## Rregulla gramatikore dhe rregulla drejtshkrimore

**Vini re!** Duhet bërë mirë dallimi mes lidhjes së fjalëve që nuk respektojnë rregullat morfo-sintaksore të shqipes dhe gabimeve drejtshkrimore. Folësit e gjuhës

amtare zotërojnë një njohje të mirë e të pavetëdijshme të të parave, ndërkohë që duhet të mësojnë t'i përdorin mirë të dytat. Thënë ndryshe, një folës i gjuhës amtare, edhe nëse nuk i njeh rregullat e gramatikës, nuk ndërton fjali të pasakta nga ana gramatikore, si:

*Mua nuk pëlqen morfologjia.*

Por mund të ndërtojë një fjali me gabime drejtshkrimore dhe madje të mos jetë në gjendje t'i dallojë ato: *Mu s'm pëlqen morfologjia.* Në gjykimin e folësit amtar, shembulli i parë është i papranueshëm dhe korrigjohet lehtësisht, ndoshta pa ditur të japë shpjegimin përkatës, ndërkohë që shembullin e dytë mund të dijë ose jo ta korrigjojë si duhet. Kjo varet nga shkalla e njohjes së rregullave të drejtshkrimit.

Krahas rregullave dhe mjeteve gramatikore, edhe mjetet prozodike, ndër të cilat intonacioni luajnë një rol të rëndësishëm për fjalinë si njësi e kumtimit. I njëjti grup fjalësh, apo një fjalë e vetme e shqiptuar me një intonacion të caktuar mund ta kthejë fjalinë nga dëftore në pyetëse apo habitore:

U krye.

U krye?

U krye!

U krye...

U kreftë!

Te kjo e fundit, e cila shpreh dëshirë, krahas intonacionit, shërbejnë edhe trajtat e mënyrës dëshirore të foljes, ashtu si për të shprehur habinë mund të përdoren trajtat e mënyrës habitore: *U kryeka!*, apo ato të urdhërores për të dhënë një urdhër: *Kryej!*

## Grupet e fjalëve në fjali dhe rendi i tyre

Fjalialia nuk është një shumë e dosidoshme fjalësh. Këto të fundit, duhet të lidhen së pari në grupe sipas rregullave dhe ligjeve të gjuhës e më pas grupet bashkohen në një fjali. Shembulli i sjellë që në krye: **“Dimër nga mbulohen bora në malet”; dëshmon** që nuk mund të kemi fjali, kur fjalët ndjekin njëra-tjetrën pa një rend të caktuar. Kështu parafjala lidhet me një emër a përemër dhe duhet t'u paraprijë atyre dhe jo një foljeje 'nga mbulohen'. Po ashtu, parafjala i përket një rase të caktuar dhe nuk mund të marrë një emër që nuk ka po ato tregues rase 'në malet'. Folja nuk mund të mbajë dy emra në rasën emërore, ndaj njëri prej tyre duhet të shoqërohet me parafjalë 'mbulohen bora'. Pra, fjalët duhet të lidhen në njësi të ndërmjetme duke respektuar të gjitha ligjet e gjuhës, e më pas këto bashkohen në fjali. Këto njësi mund të përbëhen nga një apo më shumë fjalë. Në rastin konkret kemi: *malet; në dimër; mbulohen; nga bora.* Si mund ta kuptojmë se ku kalon kufiri mes këtyre grupeve? Një prej kritereve më të rëndësishme që duhet të përmbushin është rendi i lirë i tyre. Ato mund të lëvizin lirisht në fjali: *Në dimër malet mbulohen nga bora. Malet mbulohen në dimër nga bora. Nga bora mbulohen malet në dimër.* etj. Këto grupe mund të zgjerohen me fjalë të tjera:

*Malet e larta mbulohen çdo fillim dimri nga bora e bardhë.*

**Vini re:** është zgjeruar si numri i fjalëve, ashtu dhe numri i gjymtyrëve të fjalisë, por jo numri i grupeve të fjalëve që mund të lëvizin lirisht në fjali. Përsëri kemi

katër grupe fjalësh: *malet e larta; mbulohen; çdo fillim dimri; nga bora e bardhë*. Asnjë prej fjalëve të këtyre grupeve nuk mund të shkëputet dhe të zhvendoset jashtë grupit në një vend tjetër: *Malet e larta e bardhë...*

Siç vihet re, folja del vetëm. Nëse shtojmë një fjalë apo grup fjalësh pranë saj, ato përbëjnë një grup më vete, edhe pse varen prej foljes, ashtu si grupet e tjera: *Malet e larta mbulohen nga maja në rrëzë, çdo fillim dimri, nga bora e bardhë*. Grupi 'nga maja në rrëzë' ashtu si grupet e tjera të fjalëve, mund të zhvendoset në krye, në mes apo në fund të fjalisë.

## USHTRIME

### 1 Rishkruani si duhet fjalitë e mëposhtme pasi të keni analizuar gabimet për secilën.

- Nuk m'piket ma ujë. \_\_\_\_\_
- A e di emnin atij? \_\_\_\_\_
- Unë mendoj që unë me shku nesër. \_\_\_\_\_
- Të gjitha ishin të gëzuar. \_\_\_\_\_
- Nesër vendosim ç'duhet bërë dje. \_\_\_\_\_

### 2 E vërtetë apo e gabuar ?

- |   |                          |                          |
|---|--------------------------|--------------------------|
| <input type="checkbox"/> Çdo fjali ka kryefjalë dhe kallëzues.                                      | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> |
| <input type="checkbox"/> Kryefjala qëndron gjithnjë në krye të fjalisë.                             | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> |
| <input type="checkbox"/> Fjalia mund të ndërtohet edhe me një fjalë të vetme.                       | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> |
| <input type="checkbox"/> Rendi i çdo fjale të fjalisë është i lirë.                                 | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> |
| <input type="checkbox"/> Folësi mund të ndërtojë fjali të sakta pa i njohur rregullat e gramatikës. | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> |

### 3 Dalloni dhe analizoni gabimet në fjalitë e mëposhtme.

Vajza, e cila takuam dje, do të vijë në festën tonë. Kur shkonim me pushime, marrim gjithnjë shumë gjëra me vete. Nëse nuk pushon shiu, as sot shkohet atje. Me të perënduar diellin, dolëm. Kush fëmijë po qan? Si sot kanë ardhur gjërat kështu?

### 4 Dalloni grupet e fjalëve dhe rishkruani fjalinë e mëposhtme duke ndryshuar rendin e tyre.

Sot, shumica e nxënësve, si rrallëherë, kishin ardhur në shkollë pa e lexuar librin e sugjeruar javë më parë nga mësuesi i letërsisë.

---



---

### 5 Zgjeroni fjalinë e mëposhtme duke ruajtur të njëjtin grup fjalësh.

Papritur, në qiell u mblodhën re të zeza.

### 6 Shkruani nga tri fjali për secilin rast të dhënë në tabelën e mëposhtme.

Fjali që nuk respektojnë rregullat gramatikore	Fjali që nuk plotësojnë rregullat drejtshkrimore	Si duhet
<i>Kërko falje atij.</i>	<i>Kërkoji falie atijë.</i>	<i>Kërkoi falje atij.</i>

# Funksionet gramatikore të fjalëve në fjali

Fjalja nuk është një shumë e çfarëdoshme fjalësh, përkundrazi, fjalët lidhen sipas rregullave të caktuara të gramatikës, duke formuar kështu *njësi të ndryshme sintaksore*, siç janë gjymtyrët e fjalisë dhe fjalja.



- Të hënën, nxënësit e takuan shkrimtarin në studion e tij.
  - E hëna, nxënësit e takuam shkrimtari në studios të tij.
  - Te henen, nxensit e takuan shkrimëtarin në studion e tijë.
  - Shkrimtarin, nxënësit e takuan të hënën në studion e tij.
- ✿ Cila prej fjalive është e saktë? Pse? Krahasoni variantet e gabuara: ç'i dallon ato prej njëra-tjetrës? Argumentoni përgjigjet tuaja.

Pra, vetëm fjalitë **a)** dhe **d)** janë të sakta, ndonëse fjalët nuk kanë të njëjtin rend në fjali. Në fjalinë **b)**, të njëjtat fjalë ruajnë të njëjtin rend si në fjalinë **a)**, por, pavarësisht kësaj, fjalja është e papranueshme. Çfarë i mungon kësaj fjalie?

## Kujdes

Fjalët mund të luajnë rol drejtues, ose të jenë të varura. Fjalët luajnë rol drejtues, kur u caktojnë fjalëve të tjera formën e shprehjes dhe rolin e tyre në fjali.

Fjalët duhet të lidhen mes tyre sipas rregullave gramatikore të gjuhës.

- ✿ Kështu, **mes kryefjalës dhe kallëzuesit** duhet të ketë *përshtatje në vetë dhe në numër*:
  - ▣ nxënësit takuan (*veta e tretë, numri shumë*)
- ✿ **Mes kallëzuesit dhe kundrinorit**, duhet të ketë *drejtim në rasë*:
  - ▣ e takuan shkrimtarin (Folja kalimtare "takoj" e kërkon emrin në rasën kallëzore dhe kështu emri luan rolin e kundrinorit të drejtë.)
- ✿ **Mes kallëzuesit dhe rrethorëve**, duhet të shprehet rrethana ose rrethanat, në të cilën kryhet veprimi:
  - ▣ e takuan të hënën / e takuan në studion e tij

Emri "studio" ka përpara një parafjalë të rasës kallëzore, ndaj nuk mund të vendoset në një rasë tjetër. Edhe përemri "e tij" duhet të përshtatet me emrin që ndjek.

Pra, lidhja e fjalëve në fjali bëhet në bazë të rregullave të caktuara gramatikore. Kjo lidhje mund të realizohet në mënyra të ndryshme. Në varësi të saj, përcaktohet edhe funksioni gramatikor i fjalëve.

Për shembull, i njëjti emër, mund të shprehet në forma të ndryshme dhe të ketë funksione të ndryshme në fjali, në varësi të lidhjes që ka me fjalën drejtuese të tij.

🌿 Vëreni me kujdes përdorimin e fjalës *mal* në fjalitë e mëposhtme.

- a) *Malet*, gjithnjë kanë një hije të rëndë prej murgu.
- b) *Malet* i njoh mirë.
- c) *Maleve* po shkrin bora.
- d) *Maleve* nuk mund t'ua zësh diellin.
- e) Zogjtë *e maleve* nuk i tremb asgjë.



Diskutoni rreth pyetjeve: Ç'funksione sintaksore kryen fjala *mal*? Kush ia cakton këtë funksion? A del ajo si fjalë e varur apo drejtuese? Argumentoni përgjigjet tuaja.

## Vini re:

*Fjala në vetvete nuk mbart ndonjë funksion sintaksor, por e fiton atë falë lidhjes që realizon me fjalën drejtuese.*

## Vini re:

Secila prej këtyre gjymtyrëve të shprehura me emrin *mal*, kryefjala, kundrinori i drejtë, kundrinori i zhdrejtë dhe rrethanori mund të zgjerohen me fjalë të tjera, kryesisht me vlerë përcaktore. Proveni të zgjeroni me fjalë apo grupe fjalësh këto gjymtyrë dhe analizoni rendin e tyre në fjali.

Në fjalitë **a)** dhe **b)**, fjala *mal* përdoret në të njëjtën formë, "malet", megjithatë nuk ka të njëjtin funksion sintaksor, sepse marrëdhënia që krijon me kallëzuesin është e ndryshme. Këtë na e bën më të qartë edhe pyetja që drejton kallëzuesi:

Cilat kanë hije të rëndë? - Malet (*kryefjalë*).

Kë/çfarë njoh mirë? - Malet (*kundrinor i drejtë*).

Në fjalitë **c)** dhe **d)**, fjala *mal* përdoret në formën "maleve" dhe ka si fjalë drejtuese kallëzuesin. Ky i fundit i shënon përkatësisht rolin e rrethanorit (**c**) dhe atë të kundrinorit të zhdrejtë (**d**):

Ku po shkrin bora? - Maleve (*rrethanor vendi*)

Kujt nuk mund t'ia zësh diellin? - Maleve (*kundrinor i zhdrejtë*)

Vetëm në fjalinë e fundit (**e**), fjala *mal* nuk lidhet drejtpërdrejt me kallëzuesin, por ka si fjalë drejtuese një emër, që shërben si kundrinor "zogjtë e maleve". Edhe pse fjala "e maleve" është pranë kallëzuesit, mes tyre nuk ka lidhje sintaksore. Në fakt, kallëzuesi nuk mund të drejtojë asnjë pyetje që t'i përgjigjet përcaktori "e maleve", sepse ky përcaktor ka fjalë drejtuese kundrinorin: *ç'zogj?* - *zogjtë e maleve*.

**1** Analizoni shembujt e mëposhtëm. Shpjegoni gabimet dhe klasifikojini ato sipas tabelës së dhënë.

- ▣ *Ndarja e mbetjeve ndihmojnë mrojtjen e mjedisit.*
- ▣ *Ndaria e mbetjeve ndihmonë mrojtjen e mjedisit.*
- ▣ *Ndarja ndihmon e mbetjeve mbrojtjen e mjedisit.*
- ▣ *E ndihmon mbrojtjen e mjedisit, ndarja e mbetjeve.*

Fjalë me gabime drejtshkrimore	Grup fjalësh pa lidhje sintaksore

**2** Cilat fjalë dalin si gjymtyrë të varura dhe cilat, drejtuese? Argumentoni përgjigjen tuaj.

- ▣ *Prerja e pemëve dëmton rëndë mjedisin tonë.*
- ▣ *Këtu nuk lejohet pirja e duhanit.*
- ▣ *Ngrohja globale është bërë tashmë një kërcënim serioz.*
- ▣ *A duhet të vazhdojë gjuetia e kafshëve të egra?*

**3** Ndërtoni pesë fjali, ku fjala “rrugë” të dalë si:

kryefjalë

---

kundrinor i drejtë

---

kundrinor i zhdrejtë

---

rrethanor

---

përcaktor

---

**4** Bëni analizën e gjymtyrëve në pjesën e mëposhtme.

– Ku është hyrja? – pyeti Mark Alemi. Njeriu tregoi me dorë anën e djathtë. Mënga e xhybes së tij ishte aq e gjerë, saqë ajo nuk mori aspak pjesë në tregimin e krahut. “O, Zot, ende me këto veshje,” – mendoi Mark Alemi duke ecur në drejtimin që i dha ajo dorë e hollë midis asaj mënge të përbindshme. Pas një copë here ndjeu përsëri ca hapa përbri tij. Ishte prapë njeriu me xhybe.



# Fjalitë e përbëra me bashkërenditje dhe ato me nënrenditje

## Kujtojmë

Fjalitë e thjeshtë ka vetëm një kallëzues. Fjalitë e përbëra ka dy ose më shumë kallëzues. Pjesët e fjalive të përbëra, formojnë fjali të përbëra me bashkërenditje, kur bashkohen me lidhëza bashkërenditëse dhe fjali të përbëra me nënrenditje, kur bashkohen me lidhëza nënrenditëse.

## Lexoni me kujdes fjalitë e mëposhtme.

1) *Me nisjen e shirave dhe nën kërcënimin e daljes së lumenjve nga shtrati me pasojë përmbytjen e mundshme të të gjitha zonave të ulëta të atij qarku, u mbloodh, si çdo vit, këshilli i emergjencës, për të diskutuar rreth masave parandaluese, si dhe evakuimin e banorëve në rast rreziku.*

2) *Vendosën të largoheshin.*

Cila prej fjalive është e thjeshtë dhe cila e përbërë? Argumentoni përgjigjen tuaj.

## Dallimi mes fjalisë së thjeshtë dhe fjalisë së përbërë

Siç bëhet e qartë nga përkufizimi i mësipërm, lloji i fjalisë nuk përcaktohet nga sasia e fjalëve që e përbëjnë atë, por nga numri i kallëzuesve, duke qenë se rreth kallëzuesit grupohen të gjitha grupet e fjalëve, për të krijuar një njësi të vetme kallëzuese.

Kështu, fjalia 1) sado të jetë e zgjeruar me grupe fjalësh, ka vetëm një kallëzues, foljen “u mbloodh”, ndaj e klasifikojmë si **fjali të thjeshtë**.

Fjalia 2) formohet prej vetëm dy fjalësh, të cilat janë folje (“vendos”, “largoj”) dhe secila prej tyre shërben si kallëzues. Pra, kemi dy kallëzues. Për rrjedhojë, fjalia 2) është një **fjali e përbërë**. Secili prej këtyre kallëzuesve mund të zgjerohet me fjalë a grupe fjalësh që kryejnë funksione sintaksore të ndryshme në varësi të lidhjeve që realizohen.

Zvogëloni aq sa është e mundur fjalinë 1) dhe zgjeroni sa më shumë fjalinë 2), duke ruajtur të njëjtin numër kallëzuesish. Diskutoni së bashku shembujt e krijuar.

## Llojet e fjalive të përbëra

Pjesët e fjalive të përbëra mund të kenë marrëdhënie të ndryshme mes tyre. Ato mund të shprehin lidhje barazie ose varësie. Lidhja e barazisë realizohet në ato raste, kur asnjëra nga pjesët e një fjalie të përbërë nuk varet prej tjetrës. Pra, secila mund të qëndrojë si fjali më vete.

🌸 Lidhni fjalitë e mëposhtme në një fjali të vetme.

*Asaj i pëlqen teatri.*

*Atij i pëlqen kinemaja.*



🌸 Si e gjykoni fjalinë e mëposhtme? Ç'ndodh nëse fjalën "teatri" e zëvendësojmë me fjalën "shumë"? A ka të bëjë kjo me kuptimin e fjalës apo rolin që kryen ajo në fjali?

📌 *Asaj i pëlqen shumë, kurse atij i pëlqen kinemaja.*

Nevojën e kallëzuesit të pjesës së parë mund ta përmbushë edhe një pjesë e tërë fjalie.

🌸 Si e gjykoni fjalinë e mëposhtme? Argumentoni përgjigjen tuaj.

📌 *Asaj i pëlqen ç'i pëlqen atij.*

**Fjalja** ▶  
**nënrenditëse**

**Kur mes pjesëve të një fjalie të përbërë vendosen lidhje varësie, kemi të bëjmë me fjali nënrenditëse.**

Lidhja e varësisë, nënkupton se njëra pjesë fjalie varet prej pjesës tjetër, e cila e drejton të parën.

🌸 **Vëreni me kujdes fjalitë e mëposhtme.**

**a)** *Nuk e di orarin, por do të pyes. Ose: Nuk e di orarin. Do të pyes.*

**b)** *Nuk e di se kur fillon mësimi. Ose: Nuk e di... Kur fillon mësimi?*

Pjesët e fjalisë **a)**: "nuk e di orarin; do të pyes", janë në marrëdhënie barazie me njëra-tjetrën, sepse foljet e tyre janë të plotësuara me gjymtyrët e domosdoshme, ndaj ato mund të qëndrojnë si fjali të thjeshta më vete.

Pjesa e parë e fjalisë **b)** nuk mund të qëndrojë e shkëputur nga pjesa e dytë, sepse foljes "di" i mungon gjymtyra e domosdoshme me vlerë kundrinori: "Çfarë nuk di?" Kësaj pyetjeje i përgjigjet e gjithë pjesa e dytë: "kur fillon mësimi". Nisur nga roli që kryejnë, këto pjesë emërtohen përkatësisht, pjesë kryesore dhe pjesë e varur e fjalisë së përbërë me nënrenditje.

## USHTRIME

**1 Dalloni fjalitë e thjeshta nga ato të përbëra. Nënvizoni kallëzuesit.**

Gjëja më e mirë është t'i shënosh ngjarjet çdo ditë. Të mbash ditar për të parë më qartë. Kështu nuk të shpëtojnë hollësitë, edhe pse duken të parëndësishme. Duhet të hedh në letër si e shoh këtë tryezë, rrugën, njerëzit, sepse janë pikërisht këto që kanë ndryshuar. Duhet përcaktuar pikë për pikë zgjatja dhe natyra e këtij ndryshimi.

**2 Dalloni fjalitë me bashkërenditje nga ato me nënrenditje. Argumentoni përgjigjen tuaj.**

- Frynte erë dhe gjethet binin.
- Gjethet binin, sepse frynte erë.
- Nuk mund ta kuptosh mësimin nëse je i pavëmendshëm.
- Nuk e kuptonte se kishte gabuar.
- Isha aty, por nuk dëgjova gjë.
- Nuk dëgjova ç'u tha aty.

bashkërenditëse	nënrenditëse

**3 Lidhni këto pjesë fjalish dhe shënoni llojin e tyre. Mund të përdorni lidhëza të ndryshme.**

Besoj	nuk ndaloi.
Ka shumë mundësi	ky është rreziku i mbajtjes së ditarit.
Treni arriti në stacion	t'ia fillosh nga e para.
Në mos qofsha gabim	të vonohet.
A ia vlen	javën tjetër ndryshon ora.

**4 Zëvendësoni format foljore të pashtjelluara me forma të shtjelluara dhe analizoni fjalitë e përfutuara.**

- Shpejtoi hapat për të mbërritur në kohë.*

---

- Një t'i rënë arbitri bilbilit, i gjithë stadiumi brofi në këmbë.*

---

- Duke parë e duke bërë.*

---

- Doli pa folur.*

---

**5 Zgjeroni kallëzuesit e fjalive të mëposhtme, me të gjitha llojet e gjymtyrëve që mund të marrin.**

- Vendosën të niseshin.* \_\_\_\_\_

- Nuk dinte si të sillej.* \_\_\_\_\_

- Iu lut të kthehej.* \_\_\_\_\_

- E kuptoi ç'duhej bërë.* \_\_\_\_\_

# Fjalitë e përbëra me bashkërenditje, llojet e tyre

Unë do të marr një picë *Margarita*, kurse ti zgjidhe vetë.



Pjesët e fjalisë së përbërë me bashkërenditje janë të pavarura prej njëra-tjetrës. Ato lidhen mes tyre me lidhëza bashkërenditëse ose pa lidhëza.

*Turistët shkuan në mal, **ndërsa** ne qëndruam në qytet.*

*Frynte erë e fortë, **retë** shtynin njëra-tjetrën me tërbim, **binte** shi i rrëmbyeshëm.*

Pjesët e këtyre fjalive mund të qëndrojnë edhe si fjali më vete: *Turistët shkuan në mal. Ne qëndruam në qytet.*

## Llojet e fjalive të përbëra me bashkërenditje

### 🌸 Fjali e përbërë me bashkërenditje shtuese

Pjesët e kësaj fjalie lidhen me lidhëza bashkërenditëse shtuese: *e, dhe, jo vetëm...por edhe, as...as* etj.

Beni vraponte **dhe** Arbri e ndiqte pas.

**Jo vetëm** të ndiejmë keqardhje për më të dobëtit, **por edhe** t'i ndihmojmë ata.

### 🌸 Fjali e përbërë me bashkërenditje kundërshtuese

Pjesët e kësaj fjalie lidhen me lidhëza bashkërenditëse kundërshtuese: *po, por, mirëpo, kurse, veçse* etj.

U mat të thoshte diçka, **por** nuk foli.

Mund të luash, **veç** mos u djersit.

### 🌸 Fjali e përbërë me bashkërenditje veçuese

Pjesët e kësaj fjalie lidhen me lidhëza bashkërenditëse veçuese: *ose, o, apo, ose...ose, o...o* etj.

Do të vish me ne **apo** do të qëndrosh këtu?

**O** bëhet kjo punë tani, **o** nuk bëhet më kurrë.

### 🌸 Fjali e përbërë me bashkërenditje përmyllëse

Pjesët e kësaj fjalie lidhen me lidhëza bashkërenditëse përmyllëse: *prandaj, ndaj, pra* etj.

Iliri kërkoi falje, **pra** është ndërgjegjësuar për gabimin.

## USHTRIME

## 1 Përcaktoni llojin e fjalive të bashkërenditura.

- Sot ra borë *dhe* unë u mbylla në shtëpi. \_\_\_\_\_  
 *por* unë nuk ndenja në shtëpi. \_\_\_\_\_  
 *kurse* për nesër parashikohet mot me diell. \_\_\_\_\_

- Jo vetëm ra borë, por filloi edhe një erë e ftohtë veriu.  
 Edhe binte borë, edhe frynte erë.  
 O do të bjerë borë, o do të bjerë shi.

## 2 Lidhni fjalitë e mëposhtme me lidhëza bashkërenditëse.

- Ai nuk erdhi në stërvitje \_\_\_\_\_ nuk mund të mos vijë në garën finale.  
 Muzeu hapet në orën 9:00 \_\_\_\_\_ mbyllet në orën 19:00.  
 Gjyshja ime ka shumë punë, \_\_\_\_\_ për mua, e gjen gjithnjë kohën.  
 \_\_\_\_\_ nuk erdhi, \_\_\_\_\_ nuk na njoftoi.  
 \_\_\_\_\_ puno më shumë, \_\_\_\_\_ hiq dorë nga kjo detyrë.

## 3 Plotësoni pjesët e fjalive të dhëna me pjesë të bashkërenditura.

- \_\_\_\_\_, por flet shumë.  
 \_\_\_\_\_ dhe më buzëqeshi.  
 \_\_\_\_\_ ose shkojmë në teatër.  
 \_\_\_\_\_ as nuk e dëshiroj një gjë të tillë.  
 \_\_\_\_\_ por as nuk më përshëndeti.

## 4 Lidhni pjesët e mëposhtme, përcaktoni llojin e fjalive.

- Zuri të bjerë shi \_\_\_\_\_ megjithatë do bërë kjo punë.  
 Arbri duket i mërzitur \_\_\_\_\_ dhe unë nuk kam marrë çadër.  
 Nuk kam shumë kohë \_\_\_\_\_ por nuk po shitet e vjetra.  
 Duhet të nxitojmë \_\_\_\_\_ kurse të tjerët flasin e qeshin.  
 Duam të blejmë një shtëpi të re \_\_\_\_\_ ose do të mbetemi pa vend.

## 5 Lidhni fjalitë e thjeshta duke i bashkërenditur me njëra-tjetrën.

- Kam uri. Do të doja të haja diçka. Frigoriferi është bosh.  
 \_\_\_\_\_  
 Bën shumë vapë. Netëve mezi fle. Më del gjumi herë pas here.  
 \_\_\_\_\_  
 Qyteti ka trafik të mbingarkuar. Për këmbësorët nuk ka kujdes. Për çiklistët jo e jo.  
 \_\_\_\_\_

## 6 Dalloni lidhëzat dhe tregoni ç'loj pjesësh të bashkërenditura janë fjalitë e mëposhtme.

- Gjyshi po lexon gazetën, kurse gjyshja po thur triko.  
 Gjyshja ka gatuar gjellën, por fëmijët nuk janë kthyer ende nga shkolla.  
 Fëmijët ia behin në derë dhe gjyshja i përqafoi me dashuri.  
 Macja herë fle në divan, herë vërtitet sa andej-këndej rreth gjyshes.  
 Jo vetëm i bën shoqëri, por herë-herë edhe e mërzit me tekat e saj.

# Përdorimi i presjes në fjalitë me bashkërenditje

## Ndahen me presje:

- Fjalitë e bashkërenditura me lidhëzat e përsëritura *edhe..., edhe; hem..., hem...; as..., as ...; o ..., o ...; ose..., ose...; ja..., ja...; herë..., herë...*  
*Dhe kënga kish mbaruar, / dhe mikrofoni ishte flakur, / dhe vetë këngëtari ndihej shumë i lodhur, / dhe me zor merrte frymë...*
- Fjalitë e bashkërenditura me lidhëzat dyshe *jo vetëm..., por edhe...; le që..., por edhe...*  
*Le gomari që na ngordhi, por s'na lënë rehat edhe mizat.*
- Fjalitë e bashkërenditura me lidhëzat kundërshtore *po (por), kurse, ndërsa, veçse, veç, vetëm se...*  
*Në mëngjes zgjohej qëmenatë, kurse në mbrëmje e zinte gjumi herët.*
- Fjalitë e bashkërenditura me lidhëzat përmbyllëse *prandaj, andaj, ndaj:*  
*Kishin veshur atlete, prandaj nuk u dëgjua zhurma e tyre.*
- Fjalitë e bashkërenditura me lidhëzën *pa:*  
*Ta kisha parë edhe një herë, pa ç'të ishte!*

## USHTRIME

### 1 Vendosni presjet në vendin e duhur. Shpjegoni rastin e përdorimit të tyre.

- As unë nuk shkova as ai nuk më kërkoi.
- Mësuesja shpjegonte por ai nuk e kishte mendjen.
- Vera kishte ardhur para kohe prandaj njerëzit ishin me veshje të lehta.
- Jo vetëm erdhi vonë por nuk kërkoi as falje.
- Të luaja edhe një herë pa të shkoja.

### 2 Shpjegoni rastin e përdorimit të pikës dhe presjes në fjalitë e mëposhtme.

- Binte shi, por ata e mbanin çadrën mbyllur.*
- Edhe iu jepja të drejtë atyre, edhe i kritikoja.*
- Ose shtrëngonte acari i akullit, ose vërshonin nga malet valët e shkumëzuara.*






### 3 Lidhni shembullin me rastin.

Ndahen me presje:	Shembull /Shto shembull tjetër
Fjalitë e bashkërenditura me lidhëzat dyshe: <i>jo vetëm..., por edhe...; le që..., por edhe...</i>	<i>Guri pëlçet, po njeriu s'pëlçet.</i> .....
Fjalitë e bashkërenditura me lidhëzat kundërshtore: <i>po (por), kurse, ndërsa, veçse, veç, vetëm se...</i>	<i>Le çanta që na humbi, por na morën edhe çelësat.</i> .....
Fjalitë e bashkërenditura me lidhëzat përmbyllëse: <i>prandaj, andaj, ndaj...</i>	<i>Vetëm të vinte me ne, pa të bëhej ç'të bëhej!</i> .....
Fjalitë e bashkërenditura me lidhëzën <i>pa.</i>	<i>Ishte e pamundur që të ecnim nëpër atë rrugë, prandaj i ramë gjatë.</i> .....

# Fjalitë e përbëra me nënrenditje ffilluese: kryefjalore, kundrinore

Nisur nga lloji i lidhjes dhe marrëdhënies që vendoset mes pjesëve, fjalitë e nënrenditura mund t'i klasifikojmë në tri grupe.

**Tabela e tipareve dalluese të fjalive të përbëra me nënrenditje**

Fjali me pjesë të varur	Lidhja mes pjesës kryesore dhe asaj të varur	Shembull	pjesë kryesore + pjesë e varur
ftilluese	Pjesa e varur është e domosdoshme dhe plotëson kallëzuesin e pjesës kryesore.	<p> <i>Mendoj se janë nisur.</i></p> <p> <i>U vendos të ktheheshin.</i></p>	Mendoj + se janë nisur. U vendos + të ktheheshin.
rrethanore	Pjesa kryesore mund të qëndrojë edhe pa pjesën e varur.	<p> <i>Nuk dola sot, sepse binte shi.</i></p> <p> <i>Do të dal më vonë, kur të pushojë shiu.</i></p>	Nuk dola sot, + sepse binte shi. Do të dal më vonë, + kur të pushojë shiu.
përcaktore	Pjesa e varur përcaktore nuk lidhet me kallëzuesin e pjesës kryesore, por me një gjymtyrë emërore të saj.	<p> <i>E lexova librin që më dhurove.</i></p>	E lexova librin + që më dhurove.

## Fjalitë e përbëra me pjesë të nënrenditura ffilluese

Fjalitë e përbëra me pjesë të nënrenditura ffilluese përbëjnë një grup më vete brenda fjalive të nënrenditura. Në këto fjali, pjesa e varur është e lidhur ngushtësisht me kallëzuesin e pjesës kryesore, si pjesë e domosdoshme e tij.

Për të kuptuar këtë lloj lidhjeje, së pari kujtojmë se edhe në fjalinë e thjeshtë, kallëzuesi, kërkon një numër të caktuar gjymtyrësh të domosdoshme, në varësi të llojit të foljes me të cilën shprehet.

### Vëreni me kujdes shembujt e mëposhtëm.

- Vetëtin.*
- Peshqit notojnë.*
- Ajo ndezi*
- Ata i dhuruan*

### Si i gjykoni këta shembuj? Përse shembujt c) dhe d) janë të paplotë? Ç'gjymtyrë kërkon kallëzuesi për secilin rast?

Kallëzuesve në fjalitë **a)** dhe **b)** mund t'u shtojmë rrethanorë, por jo kundrinorë. Kështu mund të themi: *Peshqit notojnë grupe-grupe, të shkujdesur, në det.*

Por nuk mund të shtojmë asnjë kundrinor, sepse kjo folje nuk e pranon atë, pra nuk mund të themi: *Peshqit notojnë detin/notin etj.*

Përkundrazi, në shembujt **c)** dhe **d)** sado ta zgjerojmë kallëzuesin me rrethanorë, fjalia nuk qëndron, sepse këta kallëzues kërkojnë të plotësohen me kundrinorë, pavarësisht në ka apo jo rrethanorë të shprehur. Kështu, kallëzuesit "ndezi" mund t'i shtojmë disa rrethanorë, por fjalia nuk qëndron:

*Ajo ndezi menjëherë, në dhomë...* Kallëzuesi shtron pyetjen ç'ndezi? – Ajo ndezi dritën.

## Fjalë me pjesë të varur ffilluese, kryefjalore

Edhe kallëzuesit e pjesëve kryesore të fjalive ffilluese kanë të njëjtat veçori. Atyre u mungon kryefjala ose kundrinori, por në ndryshim nga fjalitë e thjeshta, funksionin e kryefjalës apo të kundrinorit, nuk e përmbush një gjymtyrë, por një pjesë fjalië.



🌸 U kuptua që s'ishte aspak e lehtë.

### Vini re:

Nëse kallëzuesit të pjesës së parë i shtojmë një kryefjalë, atëherë nuk ka vend për pjesën e varur kryefjalore, sepse ky rol përmbushet nga gjymtyra e fjalisë. Pra, nuk mund të themi: *Gjithçka u kuptua që s'ishte aspak e lehtë.*

Kjo është një fjali e përbërë, ku dallojmë pjesën kryesore "u kuptua" dhe pjesën e varur ffilluese "s'ishte aspak e lehtë". Pjesët lidhen me lidhëzën **që**. Kallëzuesit "u kuptua" i mungon kryefjala, ndaj rolin e saj e kryen pjesa e varur ffilluese: ç'u kuptua? - që s'ishte aspak e lehtë. Nisur nga funksioni i saj, kjo pjesë quhet **pjesë e varur kryefjalore**.

## Fjalë me pjesë të varur ffilluese, kundrinore

Përveç kryefjalës, kallëzuesit të pjesës kryesore mund t'i mungojë edhe një kundrinor i drejtë apo i zhdrejtë. E riformulojmë fjalinë e mësipërme:

📌 E kuptuan që s'ishte aspak e lehtë.

Në këtë rast, kallëzuesit të pjesës kryesore mund t'i vendosim një kryefjalë dhe fjalia të mos priset: *Ata e kuptuan që s'ishte aspak e lehtë.*

Kallëzuesi "kuptuan" kërkon një kundrinor të drejtë, por nuk mund ta shtojmë në fjali. Pse?

Rolin e kundrinorit e luan pjesa e varur ffilluese: çfarë kuptuan ata? - që s'ishte aspak e lehtë. Nisur nga funksioni i saj, kjo pjesë quhet pjesë e varur kundrinore. Zakonisht, pjesët e fjalive ffilluese lidhen me lidhëzat **që**, **se**, por mund të bashkohen edhe **pa lidhëza**:

që	Nuk e dija që flisje frëngjisht.
se	Merrej me mend se sa keq ndihej.
pa lidhëza	Më thuaj, nga se ke frikë.
	Shikoni si ngjan liqeni mbrëmjeve.



## USHTRIME

## 1 Plotësoni shembujt e dhënë me nga një pjesë të varur kryefjalore.

- Ishte e qartë \_\_\_\_\_
- I është thënë \_\_\_\_\_
- Këtu ndalohej \_\_\_\_\_
- Sot nuk është e mundur \_\_\_\_\_
- Atyre nuk u pëlqen \_\_\_\_\_
- Në këto raste këshillohet \_\_\_\_\_

## 2 Plotësoni shembujt e dhënë me nga një pjesë të varur kundrinore.

- Të vjetrit thonë \_\_\_\_\_
- Më në fund, e panë \_\_\_\_\_
- Nuk e di mirë \_\_\_\_\_
- Të gjithë e besojnë \_\_\_\_\_
- Mjekët këshillojnë \_\_\_\_\_
- Të gjithë u zotuan \_\_\_\_\_

## 3 Në fjalitë fthilluese të mëposhtme, gjeni pjesën kryesore dhe pjesën e varur, duke përcaktuar llojin e saj.

Ata nuk e dinin ç'e ardhme i priste. Nuk u shkante ndër mend se sa çoroditëse ishte koha në të cilën jetonin. Hanin, pinin dhe argëtoheshin siç bën rëndom njeriu. Më vonë do të kuptonin si qëndronin punët, ku zinte fill molepsja e tyre, pse nuk ishin treguar syçelët që në krye.

## 4 Ktheni fjalitë pyetëse në pjesë të varura fthilluese të një fjalie të përbërë.

Shembull: Fjali pyetëse: **Sa është ora?** Pjesë e varur fthilluese: **Nuk e di sa është ora.**

- Kur fillon mësimi?  
\_\_\_\_\_
- Nga dilet matanë lumit?  
\_\_\_\_\_
- Pse nuk më telefonove?  
\_\_\_\_\_
- Ku do të takohemi?  
\_\_\_\_\_
- Kush trokiti në derë?  
\_\_\_\_\_

## 5 Plotësoni tabelën sipas modelit të dhënë.

të shtohet	Më pëlqen...	Nuk e pranoj...	Merrej me mend...
një fjalë	- muzika		
një grup emëror	- muzika klasike		
një pjesë fjalie	- të dëgjoj muzikë		

# Fjalitë e përbëra me nënrenditje, rrethanore: kohore, vendore

Fjalitë e varura rrethanore tregojnë rrethanën e kryerjes së veprimit të shprehur nga folja e pjesës kryesore.

- ❑ Oborri i shkollës u boshatis, **kur** filloi mësimi. \_\_\_\_\_ rrethana e kohës
- ❑ Oborri i shkollës u boshatis, **sepse** filloi mësimi. \_\_\_\_\_ rrethana e shkakut
- ❑ Oborri i shkollës boshatiset, **nëse** fillon mësimi. \_\_\_\_\_ rrethana e kushtit

## Vini re:

Pjesët e fjalive të përbëra rrethanore kanë një lidhje më të dobët se ato të fjalitë fthilluese (kryefjalore dhe kundrinore). Krahasoni rolin e pjesës **kur filloi mësimi** në lidhje me pjesën kryesore të fjalitë e mëposhtme.

<b>kundrinore</b>	Nuk e di (çfarë?)	<i>kur filloi mësimi</i>
<b>kryefjalore</b>	Nuk dihej (çfarë?)	
<b>rrethanore</b>	Oborri i shkollës u boshatis (kur?)	

## Mbani mend

Roli i pjesës së nënrenditur varet nga lloji i lidhjes dhe i marrëdhënies që realizon me pjesën kryesore. Një rol të posaçëm luajnë edhe mjetet lidhëse. Në varësi të rrethanës që shpreh pjesa e varur e fjalive të përbëra në raport me pjesën kryesore, ato grupohen në fjali të varura: kohore, vendore, shkakore, qëllimore, mënyrore, krahasore, kushtore, rrjedhimore, lejore, krahasore (sasiore).

## Fjalitë me pjesë të nënrenditur kohore

Në këto fjali, mes pjesës kryesore dhe asaj të varur vendoset marrëdhënia rrethanore e kohës së kryerjes së veprimit.

🌸 Të gjithë erdhën, (kur?) **kur** shkoi ora tetë.

Pjesa e nënrenditur "*kur shkoi ora tetë*" tregon kohën kur ndodh veprimi (ngjarja e shprehur nga kallëzuesi në pjesën kryesore). Pjesa e nënrenditur mund të ketë tri pozicione në lidhje me kryesoren.

- 1) Vendoset **pas** pjesës kryesore: *Zogjtë ia fillojnë këngës, kur zbardh dita.*
- 2) Vendoset **para** pjesës kryesore: *Kur zbardh dita, zogjtë ia fillojnë këngës.*
- 3) Vendoset **në mes** të pjesës kryesore: *Zogjtë, kur zbardh dita, ia fillojnë këngës.*

Për lidhjen e pjesëve të fjalisë mund të shërbejnë lidhëza e shprehje lidhëzore të ndryshme, si: *kur, tek, sa, gjersa, derisa, ndërsa, ndërkohë që, para se.*

## Fjalitë me pjesë të nënrenditur vendore

Në këto fjali, mes pjesës kryesore dhe asaj të varur vendoset marrëdhënia rrethanore e vendit dhe e hapësirës së kryerjes së veprimit.

🌸 Kalaja ngrihet (ku?) **tek** puqet Drini me Bunën.

Pjesa e nënrenditur "*tek puqet Drini me Bunën*" vihet në marrëdhënie rrethanore vendore me pjesën kryesore "*kalaja ngrihet*". Në disa raste, kallëzuesi i pjesës kryesore mund të marrë edhe rrethanor vendi, kuptimi i të cilit zërthehet në pjesën e varur.

🌸 Kalaja ngrihet (ku?) aty **ku** puqet Drini me Bunën.

Pjesa e nënrenditur vendore mund të ketë tri pozicione në lidhje me kryesoren.

- 1) Vendoset **pas** pjesës kryesore: Liria ime mbaron *ku fillon liria jote*.
- 2) Vendoset **para** pjesës kryesore: *Ku fillon liria jote*, aty mbaron liria ime.
- 3) Vendoset **në mes** të pjesës kryesore: Liria ime, *ku fillon e jotja*, mbaron.

Për lidhjen e pjesëve të fjalisë mund të shërbejnë lidhëza e shprehje lidhëzore të ndryshme, si: *ku, kudo që, ngado që, te/tek, nga* etj.

## USHTRIME

**1** Plotësoni tabelën e mëposhtme, pasi të keni bërë dallimin mes rrethanorëve të kohës dhe fjalive të varura kohore.

Me të marrë lajmin, doli vrik nga shtëpia. Në kodrat përreth shtëpisë, kishte rënë hija e malit. Sa herë që binte shi, banorët i kthenin sytë nga sipërfaqja e lumit. Mbrëmjeve, kur ndizeshin dritat e qytetit, burri me kitarë i drejtohej urës së vjetër. Duhet të nisemi sa s'është vonë.

rrethanor kohe	fjali e varur kohore

**2** Plotësoni tabelën e mëposhtme, pasi të keni bërë dallimin mes rrethanorëve të vendit dhe fjalive të varura vendore.

*Ashtu dhe zëmra ime më le këtu tek jam mua,  
Vjen me vrap e me dëshirë aty nër viset e tua.  
Tek buron ujët e ftohtë edhe fryn veriu në verë,  
Tek mbin lulja me gas shumë dhe me bukuri e m'ëre,  
Ku i fryn bariu xhurasë, tek kullosin bagëtija,  
Ku mërzen cjapi me zile, atje i kam ment e mija.  
Atje lint diell' i qeshur edhe hëna e gëzuar,  
Fat' i bardh' e mirësija në atë vënt janë mbluar;  
Nat' atje'shtë tjetër natë edhe dita tjetër ditë,  
Në pyjet' e gjelbëruar, atje rrinë perënditë.*

rrethanor vendi	fjali e varur vendore

**3** Bëni dallimin mes fjalive të varura fthiluese dhe atyre kohore. Analizoni rolin e fjalës "kur".

- 📌 Nuk më kujtohet kur u nis.
- 📌 Të gjithë ishin aty, kur u nis.
- 📌 Atje bëhet festë, kur mblidhen të korrat.
- 📌 E gjen dot kur mblidhen të korrat?
- 📌 Kur e mori letrën, kërcente nga gëzimi.
- 📌 Se kur e mori letrën, këtë nuk di t'ua them.

fthiluese	kohore

**4** Zëvendësoni rrethanorët me fjalinë e varur përkatëse.

- 📌 Në pranverë, e gjithë natyra qesh. \_\_\_\_\_
- 📌 Kjo nuk do të ndodhë kurrë. \_\_\_\_\_
- 📌 Rrugët shkretoheshin me të rënë nata. \_\_\_\_\_
- 📌 Ata na prisnin afër stacionit. \_\_\_\_\_
- 📌 Nga krahu i majtë i pistës, u ul një avion i madh. \_\_\_\_\_
- 📌 Matanë lumit, ngriheshin ca shtëpi të vogla. \_\_\_\_\_

# Fjalitë e përbëra me nënrenditje, rrethimore: shkakore, qëllimore

## Fjalitë me pjesë të nënrenditur shkakore

**Mbani mend** ▶ Mes pjesëve të fjalive me nënrenditje shkakore vendoset marrëdhënia shkak-pasojë. Pjesa e varur shpreh shkakun apo arsyen e asaj që thuhet në pjesën kryesore.

Sytë i kishte të ënjtur,  
**sepse** s'kishte vënë gjumë  
në sy.



Në këtë fjali dallojmë pjesën kryesore "sytë i kishte të ënjtur" dhe pjesën e varur "s'kishte vënë gjumë në sy", të cilat lidhen me anë të lidhëzës shkakore **sepse**. Pjesa e varur tregon shkakun e asaj që ndodh në pjesën kryesore.

Si mjete lidhëse mund të shërbejnë lidhëza dhe shprehje lidhëzore, si:

- ngaqë** Ngaqë ishte ngricë e madhe, fluturimet kishin vonesë.
- se/sepse** Mos i fol aq rëndë, se/sepse është ende i vogël.
- meqë** Meqë ka, le të marrin të gjithë.
- meqenëse** Mendoj të shkojmë në piknik, meqenëse është kohë e bukur.
- duke qenë se** Ai u ngrys dhe s'hapi gojë, duke qenë se i prenë fjalën disa herë.
- nga frika se** Ecte në majë të gishtave, nga frika se mos e dëgjonin.

Pjesa e nënrenditur shkakore mund të ketë tri pozicione në lidhje me kryesoren.

- 1) Vendoset **pas** pjesës kryesore: Fluturimet kishin vonesë, *ngaqë ishte ngricë e madhe*.
- 2) Vendoset **para** pjesës kryesore: *Ngaqë ishte ngricë e madhe*, fluturimet kishin vonesë.
- 3) Vendoset **në mes** të pjesës kryesore: Fluturimet, *ngaqë ishte ngricë e madhe*, kishin vonesë.

Pjesa e varur ndahet me presje nga pjesa e kryesore dhe futet mes presjesh kur është në mes të saj.

## Fjala me pjesë të nënrenditur qëllimore

Në këto fjali, mes pjesës kryesore dhe asaj të varur vendoset marrëdhënia rrethimore e qëllimit. Pjesa e varur tregon qëllimin për të cilin kryhet veprimi i shprehur në pjesën kryesore.

### Diskutoni:

Ku dhe si shprehen marrëdhëniet qëllimore në vargjet e mëposhtme?  
Si lidhen pjesët e varura me ato kryesore?

*Në mes tuaj kam qëndruar  
e jam duke u përvëluar,  
që t'u ap pakëzë dritë,  
natënë t'ua bënj ditë.  
Do të tretem, të kullohem,  
të digjem, të përvëlohem,  
që t'u ndrinj mir' e të shihni,  
njëri-tjatërin të njihni.*

Si mjet lidhës për pjesët e fjalive qëllimore, zakonisht shërben lidhëza **që**, e cila shpeshherë mund të mos jetë e pranishme, kur pjesa e varur fillon me folje në mënyrën lidhore.

- 🎯 U ktheva **që** të përshëndes edhe një herë nënën.
- 🎯 Erdhi të takonte shokët.

Shpeshherë, marrëdhëniet qëllimore realizohen edhe me përdorimin e formave foljore të pashtjelluara.

*Për të kryer studimet e larta jashtë vendit, duhet të njohësh mirë së paku një gjuhë të huaj.*



🌸 Si e gjykoni këtë fjali? Sa kallëzues vëreni aty? Ç'rol luan paskajorja dhe cilat gjymtyrë varen prej saj?

Pjesa e nënrenditur qëllimore mund të ketë tri pozicione në lidhje me kryesoren.

- 1) Vendoset **pas** pjesës kryesore: Toka duhet mirëmbajtur, *në mënyrë që të mos i kundërvihet njeriut.*
- 2) Vendoset **para** pjesës kryesore: *Me qëllim që të mos i kundërvihet njeriut,* toka duhet mirëmbajtur.
- 3) Vendoset **në mes** të pjesës kryesore: Toka, *që të mos i kundërvihet njeriut,* duhet mirëmbajtur.

## USHTRIME

### 1 Ndërtoni pesë fjali shkakore, duke përdorur lidhjet e mëposhtme.

- vonë / humbas trenin \_\_\_\_\_
- zemërohem / pranoj dhuratën \_\_\_\_\_
- nuk flet / nuk njih gjuhën \_\_\_\_\_
- rrëshqas / shapka \_\_\_\_\_

### 2 Zëvendësoni rrethanorët e shkakut me pjesë të varura shkakore.

- Gjethet binin nga era. \_\_\_\_\_
- Për shkak të vështirësive, hoqën dorë nga ky mision. \_\_\_\_\_
- Ata e humbën lojën nga një pakujdesi e vogël. \_\_\_\_\_
- Nuk dilet në rrugë për shkak të trafikut të rënduar. \_\_\_\_\_

### 3 Ktheni format foljore të pashtjelluara në pjesë të varura qëllimore.

- Për të fituar këtë garë, lipset stërvitje e stërmundimshme.
- Njerëzit duhet të reflektojnë rreth të shkuarës së tyre, për të pasur një të ardhme më të mirë.
- Më duhet pëlqimi i prindërve, për të marrë një kafshë në shtëpi.
- Ai ngacmonte më kot fytyrën, si për të fituar kohë pas çdo pyetjeje.

### 4 Rishkruani tekstin në gjuhë standarde dhe analizoni mënyrën e shprehjes së marrëdhënieve shkakore e qëllimore në të dy variantet.

*Ngase ecte në karrocë, e ndiente veten si të ndrymë në një kosh hekuri. Shikonte përjashta tue mprehtë sytë me diktue tym zjarmi përmbi curra apo banditë tue nga në kuaj nëpër çuba e gur për me i dalë karrocës përpara. Mbasi kaloi disa gryka të vetmueme, u qetësue edhe ngase dita e asaj vjeshte ishte e kthjellët.*

### 5 Dalloni marrëdhëniet shkakore dhe qëllimore mes fjalive dhe gjymtyrëve të tyre. Analizoni format e ndryshme të shprehjes së tyre. Plotësoni tabelën e mëposhtme.

*- Kapiten, - tha drejtori i postës, duke hapur kutinë, po vetëm përgjysmë, nga frika se mos ndonjë nga fqinjët fuste aty gishtërinjtë... Kapiteni mend fluturonte nga gazi. Nga gazi, merni vesh, zuri të kërcejë nëpër trotuar. Hyri në pijetore për të hedhur një gotë vodkë, shkoi të hajë drekë dhe porositi t'ia mbushnin tavolinën plot e përplot. Në mbrëmje shkoi të shihte teatër.*

Rrethanor shkak	Fjali shkakore	Rrethanor qëllimi	Fjali qëllimore

### 6 Shkruani një tekst të shkurtër, në të cilin të trajtoni çështje që mbartin situata shkak/pasojë dhe tregojnë rrethana qëllimore. Vëreni si reflektohen ato në fjalitë që keni përdorur. Përdorni lidhëza, si: *se, sepse, ngaqë, meqë, duke qenë se, për shkak se, nga frika se; që, me qëllim që, në mënyrë që* etj.

# Fjalitë e përbëra me nënrenditje, rrethimore: mënyrore, rrjedhimore

## Fjalitë me pjesë të nënrenditur mënyrore

Në fjalitë me pjesë të nënrenditur mënyrore, pjesa e varur tregon mënyrën se si kryhet veprimi apo si paraqiten faktet në pjesën kryesore.

Ta duam këtë skuadër, *siç e kanë dashur prindërit tanë*.



Kjo është një fjali e përbërë, ku dallojmë pjesën kryesore “ta duam këtë skuadër”, e cila drejton pjesën e varur “*siç e kanë dashur prindërit tanë*”. Si mjet lidhës, shërben lidhëza mënyrore *siç*. Mes tyre vendosen marrëdhënie rrethimore mënyrore.

Si mjete lidhëse mund të shërbejnë lidhëza dhe shprehje lidhëzore, si:

### Kujdes

Pjesa e varur nuk ndahet gjithnjë me presje nga pjesa e kryesore, kur kjo e fundit është para të parës. Ajo ndahet gjithnjë me presje kur pjesa e varur qëndron para ose futet në mes të pjesës kryesore.

*si/siç*

*Bëj si të duash.*

*ashtu si/siç*

*Ashtu si erdhi, ashtu u largua, sa hap e mbyll sytë.*

*kështu si/siç*

*Nuk flet njeriu, kështu si flet ti.*

*sikur*

*Bënte naze, sikur të ishte fëmijë i vogël.*

*sikurse*

*Veproni, sikurse ju kanë porositur.*

*sikundër*

*Ajo nuk fitoi, sikundër besonte shumica.*

Në shumicën e rasteve, rendi i pjesës së varur mënyrore në lidhje me kryesoren është i lirë. Pra, pjesa e varur mënyrore mund të qëndrojë para pjesës kryesore, pas saj dhe rrallëherë edhe në mes të saj, si në fjalinë:

- ▣ Disa njerëz i trajtojnë kafshët shtëpiake *si të ishin anëtarë të familjes*.
- ▣ *Si të ishin anëtarë të familjes*, i trajtojnë disa njerëz kafshët shtëpiake.
- ▣ Disa njerëz, *si të ishin anëtarë të familjes*, i trajtojnë kafshët shtëpiake.

## Fjalitë me pjesë të nënrenditur rrjedhimore

**Mbani mend** ▶ Në fjalitë me pjesë të nënrenditur rrjedhimore shprehet marrëdhënia mes faktit a ngjarjes së shprehur në fjalinë kryesore dhe përfundimit logjik të saj, të shprehur në fjalinë e varur.

Trafiku ishte i rënduar, *ndaj* mbërritëm me shumë vonesë.



Diskutoni: Ç'marrëdhënie kuptimore vendoset mes pjesës kryesore dhe asaj të varur?

## Fjalë me pjesë të nënrenditur rrjedhimore

Në fjalinë e mësipërme, mbërritja me vonesë vjen si rrjedhojë e trafikut të rënduar.

Si mjet lidhës për këtë fjali shërben lidhëza nënrenditëse rrjedhimore *ndaj*. Krahas saj, si mjete lidhëse mund të shërbejnë edhe lidhëzat: *sa, sa që, aq sa, që, kështu që* etj.

- ▣ *Ra shi si asnjëherë më parë, aq sa ura u përpi nga shtrati i lumit.*
- ▣ *Biletat ishin shitur të gjitha, kështu që na u desh të ktheheshim duarbosh.*

Shpeshherë në ndërtimin e fjalive rrjedhimore, vihet re një bashkëlidhje mes lidhëzave dhe fjalëve të veçantë, si *aq, kaq* etj., lidhje kjo që dikton një strukturë tjetër në fjali, si p.sh.:

- ▣ Zëri vinte *aq* i dobët, *sa* nuk kuptohej gjë prej gjëje.

Fjalë e varur rrjedhimore vendoset pas fjalisë kryesore. Ato ndahen gjithnjë me presje.

## USHTRIME

1 Plotësoni shembujt e mëposhtëm me nga një pjesë të varur mënyrore.

- ▣ *Si të jetë fara* \_\_\_\_\_
- ▣ *Është mirë që njeriu të sillet* \_\_\_\_\_
- ▣ *Këtu, kafshët trajtohen* \_\_\_\_\_
- ▣ *Era frynte* \_\_\_\_\_

2 Dalloni pjesët e fjalive të mëposhtme dhe shtoni një mjet lidhës aty ku është e mundur. Përcaktoni llojin e tyre.

Të merresh rregullisht me sport, është e shëndetshme për trupin dhe për mendjen. Kishte ndryshuar shumë, nuk njihej më. Nuk e njoha, kishte ndryshuar shumë. I flet vajzës të dëgjojë nusja.



## USHTRIME

## 3 Dalloni rrethanorët nga fjalitë me pjesë të nënrenditur rrethanore. Plotësoni tabelën.

Rrinte me orë të tëra mbështetur e rehatuar në divanin kundruall dritares pa bërë as gëk as mëk. Rrinte si të ishte i zënë në faj. Duhej të ishim stërvitur më mirë. Vraponin si t'i ndiqte kush nga pas. E shikonte duke përplasur qerpikët shpesh e më shpesh. Ashtu si thamë, u bë. Shpesh, njeriu, si bën, gjen.

Rrethanor mënyre	Fjali e varur mënyrore	Mjeti i lidhjes

## 4 Nga çdo dy fjali të thjeshta, formoni dhe shkruani një fjali të përbërë me pjesë të nënrenditur rrjedhimore.

- Era ishte shumë e fortë. Ajo përmbysi vazot e luleve.
- Ky ishte një argument i fortë. Drini nuk do të kundërshtonte më.
- Drita ishte e dobët. Rruga nuk dukej.
- Analiza ishte e imtësishme. Zgjati tetë orë.
- Fëmijët bënë zhurmë. Studiuesi u çorientua.

## 5 Plotësoni pjesët e mëposhtme duke i kthyer në fjali të përbëra rrjedhimore.

- \_\_\_\_\_ sa të gjithë u çuditën.
- \_\_\_\_\_ kështu që askush nuk i besonte më.
- \_\_\_\_\_ që e ardhmja të jetë më e mirë.
- \_\_\_\_\_ aq sa nuk mbushej dot me frymë.

## 6 Dalloni fjalitë e thjeshta nga ato të përbëra. Analizoni këto të fundit.

- Mallrat e konsumit kushtojnë më tepër nga ç'vlejnë.*
- Shtri këmbët sa ke jorganin.*
- Erdhi sa për sy e faqe.*
- Fjalët janë si qersh, merr një, vijnë tri.*
- Më mirë të punosh kot, se të rrish kot.*

## 7 Ndërtoni pesë fjali të përbëra me pjesë të nënrenditura mënyrore duke përdorur lidhëza të ndryshme.

- \_\_\_\_\_
- \_\_\_\_\_
- \_\_\_\_\_
- \_\_\_\_\_
- \_\_\_\_\_

## 8 Hartoni një tekst të shkurtër ku fjalitë të shprehin marrëdhënie mënyrore dhe rrjedhimore. Analizoni fjalitë, pjesët e tyre përbërëse si dhe mjetet e lidhjes.

# Fjalitë e përbëra me nënrenditje, rrethimore: kushtore, lejore

## Fjalitë me pjesë të nënrenditur kushtore

*Të paskështa vrapn' e veriut, të kisha krahë pëllumbi,  
Nxitimn' e lumit me valë, q'ikën me vërtik si plumbi,  
E të vija në gjit tuaj, nj' ujë të ftohtë të pinja,  
Edhe nëpër ato hije një copë herë të rrinja.*



**Diskutoni:** Në cilat vargje shprehet kushti që është i perealizueshëm për autorin?

### Fjali me pjesë të nënrenditur kushtore

Në fjalitë me pjesë të nënrenditur kushtore, shprehet marrëdhënia kusht-pasojë. Veprimet apo gjendjet që shprehen në dy pjesët e fjalisë janë të ndërvarura. Veprimi apo mosveprimi të njëra, kushtëzon kryerjen apo moskryerjen e veprimit të tjetra.

✿ *Nëse njeriu e keqtrajton tokën, toka do t'i kundërvihet atij.*

☐ **Si shprehet marrëdhënia kusht-pasojë në këtë fjalë? Në cilën pjesë të fjalisë gjejmë kushtin dhe në cilën pasojën?**

Pjesa kryesore "toka do t'i kundërvihet atij" lidhet me pjesën e varur "njeriu e keqtrajton tokën" nëpërmjet lidhëzës kushtore **nëse** dhe marrëdhënies kushtore që vendoset mes tyre. Kështu, veprimi i pjesës kryesore ndodh vetëm nëse kryhet veprimi në pjesën e varur. Pra, ai rrjedh si pasojë e tij.

Ky ndërtim dallon nga fjalitë në të cilat veprimi që mund të shmangej është kryer dhe për rrjedhojë pasojat janë të pashmangshme, si në fjalinë:

✿ *Po ta donin vërtet të gjithë paqen, nuk do të kishte pasur kaq shumë luftë.*

Foljet e përdorura në kohën e shkuar, tregojnë se veprimi, që mund të shmangej, i cili shprehet me folje në mënyrën kushtore, tashmë është kryer. Pjesa kryesore "nuk do të kishte pasur kaq shumë luftë", shpreh të kundërtën: "luftë ka pasur", si rrjedhojë e mosplotësimit të kushtit të shprehur në pjesën e varur "po ta donin vërtet të gjithë paqen", që nënkupton: jo të gjithë e duan atë.

Pjesët e fjalisë së përbërë kushtore mund të lidhen me lidhëza dhe shprehje lidhëzore, si:

<b>në/nëse</b>	<i>Në rëntë shi, s'vjen njeri.</i>
<b>në qoftë se</b>	<i>Nuk të kam shok, në qoftë se vazhdon të sillesh kështu.</i>
<b>po</b>	<i>Po të pikojë çatia, bie shtëpia.</i>
<b>po qe se</b>	<i>Po qe se hapet koha, nisemi menjëherë.</i>
<b>me kusht që</b>	<i>Dëmi paguhet, me kusht që të shmanget dënimi.</i>
<b>kur</b>	<i>Kur ikën macja, lozin minjtë.</i>

Rendi i pjesëve të fjalive kushtore është i lirë. Pra, pjesa e varur kushtore mund të qëndrojë para pjesës kryesore, pas saj dhe rrallëherë edhe në mes të saj. Mes pjesëve, zakonisht, ka një pauzë intonacioni që paraqitet me anë të presjes.

- ▣ *Po nuk foli i marri, nuk dallohet i urti.*
- ▣ *Nuk dallohet i urti, po nuk foli i marri.*
- ▣ *I urti, po nuk foli i marri, nuk dallohet.*

## Fjalial me pjesë të nënrenditur lejore

- ▶ Në këto fjali, veprimi apo gjendja që shprehet në pjesën e varur pritet të bëhet pengesë për atë të pjesës kryesore, por, në të vërtetë, veprimi kryhet.



*Ndonëse ishte ftohtë, u la në det.*

Pjesa kryesore “u la në det” lidhet me pjesën e varur me anë të lidhëzës lejore **ndonëse**. Kuptimi dhe marrëdhënia lejore shpjegohen me faktin që ai u la në det, në një kohë që, normalisht ky veprim nuk kryhet. Si mjete lidhëse për pjesët e fjalive lejore mund të shërbejnë lidhëza e shprehje lidhëzore, si:

<b>megjithëse</b>	<i>Ai zë na kumbonte në veshë, megjithëse kishte kaluar kaq kohë.</i>
<b>sado</b>	<i>Koha e së vërtetës vjen, sado e kopsitur të jetë gënjeshtër.</i>
<b>sido që</b>	<i>Sido që të jetë, prindërit janë prindër.</i>
<b>kudo</b>	<i>Nuk ecet me “kudo rafsha, mos u vrafsha”.</i>
<b>kushdo</b>	<i>Njeriu e ndihmon njerinë, kushdo qoftë.</i>

Pjesët e fjalisë lejore kanë rend të lirë, domethënë, pjesa e varur mund ta ndjekë, t'i paraprijë ose të futet në mes të pjesës kryesore:

- ▣ Ata nuk shfaqnin shenja pendese, *ndonëse kishin nëpërkëmbur një popull të tërë.*
- ▣ *Ndonëse kishin nëpërkëmbur një popull të tërë,* ata nuk shfaqnin shenja pendese.
- ▣ Ata, *ndonëse kishin nëpërkëmbur një popull të tërë,* nuk shfaqnin shenja pendese.

Në këtë lloj fjalish, zakonisht, pjesa e varur ndahet me presje nga pjesa kryesore.

## USHTRIME

### 1 Dalloni fjalitë kushtore, pjesët përbërëse të tyre dhe llojin e mjeteve lidhëse.

*Në pastë këtu në këtë mbledhje ndonjë mik me zemër të Cezarit, atij i thoni që Bruti e desh Cezarin jo më pak se ai. Dhe, në më pyettë ai mik përse Bruti u ngrit kundër Cezarit, përgjigjja ime është kjo: jo se e desha Cezarin më pak, po se e desha Romën më tepër. Në më quani të ndershëm, besomëni dhe quamëni mjaft të ndershëm sa të më besoni.*

### 2 Plotësoni pjesët e mëposhtme dhe analizoni fjalitë e përfuara.

- ▣ *Po të kisha shkopin magjik* \_\_\_\_\_
- ▣ *Në qoftë se nuk do të ishte interneti* \_\_\_\_\_
- ▣ *Sikur njerëzit të jetonin më gjatë* \_\_\_\_\_
- ▣ *Nëse kafshët do të flisnin* \_\_\_\_\_

### 3 Vijoni arsyetimin e shprehur me pjesë kushtore sipas modelit të dhënë.

Po të isha i pasur, do të bëja një udhëtim rreth botës. Po të udhëtoja rreth botës, do të bëhesha më i ditur. Po të isha më i ditur...

---



---



---



---



---

### 4 Plotësoni pjesët e mëposhtme dhe analizoni fjalitë e përfuara.

- ▣ *Ndonëse ia kam premtuar vetes disa herë* \_\_\_\_\_
- ▣ *Kushdo të jetë kundërshtari* \_\_\_\_\_
- ▣ *Sido që të vijnë punët* \_\_\_\_\_
- ▣ *Megjithëse nuk e kam ende të drejtën e votës* \_\_\_\_\_

### 5 Hartoni një tekst të shkurtër ku të shprehni marrëdhëniet kusht-pasojë, si dhe ato lejore. Analizoni fjalitë, pjesët e tyre përbërëse dhe mjetet e lidhjes.

# Fjalitë e përbëra me nënrenditje, rrethimore: krahasore

## Fjalitë me pjesë të nënrenditur krahasore

Në këto fjali, veprimi apo gjendja për të cilën bëhet fjalë në pjesën kryesore jepet me anë të një krahasimi në pjesën e varur.

✿ *Sa ç'dëshpërohej nga e keqja, po aq ngazëllehej nga e mira.*

Mes pjesëve të kësaj fjalie, vendosen marrëdhënie krahasore.

- **Si mendoni: cila pjesë e drejton tjetrën dhe me ç'mjet lidhës lidhen ato?**

Riformulojmë ndryshe fjalinë:

**a)** Dëshpërohej nga e keqja, po aq sa ngazëllehej nga e mira.

Ose:

**b)** Ngazëllehej nga e mira, po aq sa dëshpërohej nga e keqja.

Siç e vini re, pjesët e kësaj fjalie mund t'i këmbëjnë lehtësisht rolet me njëra-tjetrën, pra të bëhen masë shprehëse e krahasimit. Në këto raste, mjetet e lidhjes fitojnë një vlerë të veçantë, pasi ato i prijnë gjithnjë pjesës së varur. Kështu, falë pozicionit të shprehjes lidhëzore "po aq sa", kuptojmë që në fjalinë **a)** pjesë e varur është "ngazëllehej nga e mira", ndërsa në fjalinë **b)** si e tillë del "dëshpërohej nga e keqja".

Shpeshherë, është kuptimi i fjalisë ai që dikton rolin e pjesëve të saj dhe që kufizon përdorimin e lidhëzës, si në fjalinë e mëposhtme.

*Mësa flet muri, aq përgjigjet burri.*



Pjesa kryesore e kësaj fjalie "aq përgjigjet burri", nuk mund ta këmbëjë rolin me pjesën e varur krahasuese "mësa flet muri", ku **mësa** shërben si mjet lidhës mes pjesëve. Sigurisht, lidhëzën mund ta zhvendosim sa te njëra, te tjetra, sepse nuk ka kufizime formale, por kjo nuk është e mundur, për shkak të kufizimeve kuptimore. Fjalitë nuk ka kuptim, nëse e riformulojmë kështu:

✿ *Mësa përgjigjet burri, aq fliste muri.*

Pra, për lidhjen e pjesëve të një fjalie, ashtu si edhe të fjalëve në fjali, duhen respektuar si forma, pra, rregullat gramatikore, ashtu edhe ana kuptimore, domethënë, lidhja e saj kuptimore me realitetin.

Krahasimi nuk bazohet gjithnjë te kallëzuesit e fjalive, siç ndodh në shembujt e mësipërm, por mund t'i referohet një gjymtyre tjetër, kryesisht në shkallën krahasore:

▣ *Sot, lajmi merr dhenë më shpejt nga ç'mund të imagjinohej dikur.*

Rrethanori i mënyrës, i shprehur me ndajfoljen "shpejt" në shkallën krahasore, lidhet me kallëzuesin e fjalisë drejtuese: "Sot, lajmi merr dhenë më shpejt". Nëse ndajfolja do të dilte në shkallën pohore, nuk do të mund të realizohej struktura e krahasimit.

Pjesa e varur krahasore mund t'i zërë të tria pozicionet në lidhje me pjesën kryesore dhe zakonisht ndahet nga një pauzë intonacioni që në shkrim paraqitet me presje.

## Fjalitë me pjesë të nënrenditur krahasore (sasiore)

Në këto fjali shprehet rrethana e sasisë së veprimit të një sendi ose të një tipari që përmbahet te fjalia drejtuese. Për shembull:

- ▣ *Sa më shumë afroheshim, aq më trima bëheshim.*
- ▣ *Rezultatet e vlerësimit të shokut e mërzitën sa s'thuhet.*
- ▣ *Sa libra ka lexuar ai, ju s'keni ngrënë patate.*

## USHTRIME

### 1 Plotësoni pjesët e mëposhtme dhe analizoni fjalitë e përfutuara.

- ▣ Sa ç'është e bukur natyra, \_\_\_\_\_
- ▣ Ai më shumë flet \_\_\_\_\_
- ▣ Sa më shumë beson njeriu te vetja \_\_\_\_\_
- ▣ Duaji të tjerët \_\_\_\_\_
- ▣ Mësa flet muri \_\_\_\_\_

### 2 Rishkruani fjalitë duke këmbyer, ku është e mundur, rolin e pjesëve të tyre. Diskutoni rreth formës dhe kuptimit të të dy varianteve.

- ▣ *Sa ç'ishte i papërballeshëm i ftohti, aq ishte e padurueshme vapa.*
- ▣ *Sa më shumë afrohej dhelpira, aq më shumë dridhej lepuri.*
- ▣ *Sa më shpejt të mbyllet kjo punë, aq më mirë është.*
- ▣ *Më mirë të rrish vetëm sesa të shoqërohesh me të këqijtë.*
- ▣ *Më mirë të jesh se të kesh.*

### 3 Thoni nëse krahasimi bazohet te kallëzuesit e fjalive apo te ndonjë gjymtyrë tjetër

- ▣ Mbërriti më herët, nga ç'pritej.
- ▣ Punonte më mirë në grup, sesa kur ishte vetëm.
- ▣ Ishte më serioz kur qeshte, sesa kur rrinte vrenjtur.
- ▣ Na duhej më shumë kohë, nga ç'kishim në dispozicion.
- ▣ Moti u bë më i ftohtë, nga ç'qe më parë.
- ▣ Sa më të larta ngriheshin ndërtesat, aq më larg nesh fluturonin shpendët.

### 4 Gjeni dhe shkruani dhjetë fjali të urta ku të shprehen marrëdhënie krahasore. Analizoni ndërtimin dhe kuptimin e tyre, si dhe mjetet e lidhjes. Për mbledhjen e tyre, kërkoni edhe ndihmën e më të rriturve.

# Fjalitë e përbëra me nënrenditje, përcaktore

Në fjalitë përcaktore, pjesa e varur hyn në lidhje me një gjymtyrë emërore të pjesës kryesore dhe tregon një tipar apo veçori të saj.

▣ Më pëlqeu **libri që** lexova dje.

Pjesa e varur “*që lexova dje*” lidhet me emrin “*libri*”, i cili shërben si kryefjalë e pjesës kryesore.

Pjesa e varur përcaktore mund t’i referohet edhe një përemri:

Lexova **atë që** u botua së fundmi.



✿ Bëni dallimin mes fjalive të mëposhtme.

- a) Pashë një fëmijë që po luante vetëm në oborr.
- b) Pashë që fëmija po luante vetëm në oborr.

✿ Provoni të zëvendësoni mjetin lidhës “që”. Çfarë vini re?

Fjalja **a)** ndryshon nga fjalia **b)** sepse tek e para pjesa e nënrenditur “*që po luante vetëm në oborr*” lidhet me emrin “*fëmijë*” dhe jo me foljen, ndërsa në rastin e dytë, pjesa e varur “*që fëmija po luante vetëm në oborr*” plotëson kallëzuesin e pjesës kryesore “*pashë*”.

Me këtë shpjegohet edhe fakti që emri “*fëmijë*” kur lidhet me kallëzuesin e pjesës kryesore “*pashë*” del në rasën kallëzore, ndërsa kur lidhet me kallëzuesin e pjesës së nënrenditur “*po luante*”, del në rasën emërore. Kështu, në rastin e parë pjesa e varur është përcaktore, ndërsa në të dytin ftilluese, kundrinore.

## Mjetet e lidhjes

Si mjete lidhëse për fjalitë përcaktore mund të shërbejë përemri lidhor **që** ose **i cili/e cila**.

Nxënësit, **të cilët** nuk janë regjistruar, të paraqiten në sekretari.

Nxënësit, **që** nuk janë regjistruar, të paraqiten në sekretari.

Pjesët e varura përcaktore, që lidhen me përemrat lidhorë **i cili, e cila**, ndahen me presje. Kur paraprihen nga përemri lidhor **që**, zakonisht nuk ndahen me presje.

## Rendi i pjesëve në fjalitë përcaktore

Pjesa e varur përcaktore mund të qëndrojë pas pjesës kryesore dhe në mes të saj:

- ▣ Nuk e pashë filmin që u shfaq mbrëmë në kinema.
- ▣ Filmin, që u shfaq mbrëmë në kinema, nuk e pashë.

## Vini re:

Ashtu si në rastin e fjalive të tjera të varura (kryefjalore, kundrinore, rrethanore), edhe fjalia përcaktore mund të zëvendësohet me një grup emëror, duke e kthyer fjalinë e përbërë në fjali të thjeshtë: **Filmin e shfaqur mbrëmë në kinema, nuk e pashë.**

Folja "shfaq" është kthyer në një mbiemër ("e shfaqur") me vlerën e përcaktorit, ndaj fjalia e mësipërme është një fjali e thjeshtë, sepse ka vetëm një kallëzues të shprehur me foljen "pashë".

Shpeshherë, përemrat lidhorë **i cili/e cila** mund të shoqërohen me parafjalë: Ky është qyteti **për të cilin** të kam folur aq shumë.

## USHTRIME

**1** Plotësoni pjesët kryesore me nga një pjesë të varur përcaktore.

- Më kujtohen ende fjalët \_\_\_\_\_
- Përgjithësisht, më pëlqejnë filmat \_\_\_\_\_
- Ai ka një zakon \_\_\_\_\_
- Ka disa ngjarje në historinë e vendit \_\_\_\_\_
- Ai është i vetmi vend \_\_\_\_\_

**2** Dalloni përcaktorët nga pjesët e varura përcaktore. Plotësoni tabelën.

*Vajza, e lodhur nga leximi i tepërt, u largua nga biblioteka. Një i moshuar që po lexonte gazetën në park, e flaku papritur atë në një kosh pranë tij. Trikon e punuar me dorë nga gjyshja, nuk e heq nga dollapi. Punëtorët, të cilët bëjnë pastrimin e qytetit, janë banorët e tij të natës. E ndërtuar me gurë të bardhë, shtëpia dukej si në përralla. Shtëpia në të cilën mblidheshim të gjithë së bashku, ruan ende kujtimet e së shkuarës.*

Përcaktor	Fjali përcaktore	Mjeti i lidhjes

**3** Formoni pesë fjali ku lidhëza "që" të lidhë pjesët e një fjalie:

- përcaktore \_\_\_\_\_
- kryefjalore \_\_\_\_\_
- kundrinore \_\_\_\_\_
- qëllimore \_\_\_\_\_

**4** Zëvendësoni përcaktorët me pjesë të varura përcaktore dhe anasjellas.

Ana ishte një grua zemërdhembshur, që i vinte keq për mjerimet e tjetrit. I biri, një djalosh që shkonte në shkollë, e ndihmonte për të kryer punët shtëpiake. E bija, një vajzë e re, me sy të shkruar, flokë të gjatë kaçurrelë, hundë të drejtë, shtatlartë dhe kryelartë, me një veshje të patëmetë, punonte në zyrat qendrore të bankës së qytetit për të mbajtur familjen.

**5** Shkruani një tekst të shkurtër me temë "Ndërrimi i stinëve" ose "Intervistë me veten" ku të përdorni sa më shumë fjali përcaktore. Si mjete lidhëse përdorni përemrat lidhorë **që, i cili/e cila**, duke i shoqëruar këta të fundit edhe me parafjalë.



# Përdorimi i presjes në fjalitë me nënrenditje

## Ndahen me presje:

- a. Fjalitë e varura që ndodhen para kryesores:  
*Sa kishte folur, as ai vetë s'e dinte. Ç'të mbjellësh, do të korrësh.*
- b. Fjalitë e varura me përemrat lidhorë që, i cili dhe me ndajfoljen ku, kur vijnë pas kryesores:  
*Nisën të ndihen erëra të lagështa, që dukej se do të sillnin shiun.*
- c. Fjalitë e varura me lidhëzat *aq sa* dhe *kështu që*, kur vijnë pas kryesores:  
*Bukë s'kishim ngrënë, kështu që na u desh të nxitonim.*
- ç. Fjalitë e varura me lidhëzat *në, po, nëse, në qoftë se, në rast se, sikur, kur, po qe se, me kusht që*, kur vijnë pas kryesores:  
*Ne do të mbeteshim pa folur, po të mos na kishte tërhequr vëmendjen mësuesja.*
- d. Fjalitë e varura me lidhëzat *megjithëse, ndonëse, sado që, sido që, edhe pse*, kur vijnë pas kryesores:  
*Askush nuk e mendoj rrezikun, ndonëse rruga ishte me rreziqe të shumta.*
- dh. Fjalitë e varura me lidhëzat: *përveç që, në vend që*, kur vijnë pas kryesores:  
*Me hallin tim unë i mërzita të gjithë, në vend që t'i kisha lënë të qetë.*
- e. Fjalitë e bashkuara pa lidhëza:  
*Verës malin e përcëllon dhe e kris dielli, dimrit e pëlçet ngrica, stinëve të tjera e lajnë dhe e gërryejnë rrëketë.*

## Vihet midis presjesh:

- ë. Fjalja e varur që futet në mes të fjalisë kryesore:  
*Kënga e saj, sado që u interpretua bukur, nuk më la mbresa.*
- f. Fjalja e varur që hyn në mes të një fjalisë të bashkërenditur ose të varur:  
*Nëna u bë merak, por, kur mësoi të vërtetën, u qetësua.*

## USHTRIME

### 1 Shpjegoni rastin e përdorimit të presjes në secilën nga fjalitë e mëposhtme.

- ☐ Nuk do të ishim takuar, po të mos na kishte marrë në telefon Albani.
- ☐ Ç'sjell rastësia, nuk sjell një jetë e tërë.
- ☐ Ne pranuan të bashkëpunonim, ndonëse fryma e grupit linte për të dëshiruar.
- ☐ Me këmbënguljen time i stepa, në vend që t'i kisha nxitur.
- ☐ Askush nuk ndodhej në shtëpi, kështu që na u desh të ktheheshim mbrapsht.

### 2 Vendosni presjen në vendin e duhur në secilën nga fjalitë e mëposhtme.

- ☐ Kur u nis në udhëtim nuk e mendoj se do të ishte për një kohë të gjatë.
- ☐ Mos e ngarko vajzën me mësim sepse është ende e vogël.
- ☐ Erdhi me vrull nga dëshira për të takuar sa më parë shokun.
- ☐ Në mëngjes i duhet të shkojë në shkollë pas shkolle ndihmon prindërit pasdite bën detyrat në mbrëmje lexon.
- ☐ E mori me mend përfundimin që të gjithë e prisnin me padurim.

### 3 Në pjesën e leximit me titull "Ciklopi", tregoni dhe shpjegoni rastet e përdorimit të presjes.

# Fjalor

<b>alternativë</b>	secila nga mundësitë a rrugët e paraqitura, prej të cilave duhet zgjedhur vetëm njëra.
<b>analizoj</b>	shqyrtoj një tekst, një çështje etj., duke e zbërthyer dhe duke e parë nga të gjitha anët.
<b>argument</b>	arsyetim që përdoret për të vërtetuar ose për të kundërshtuar një mendim; provë që sillet për të mbrojtur ose për të hedhur poshtë diçka.
<b>baladë</b>	krijim në të cilin gjejmë rrëfimin e autorit/es dhe shprehjen e ndjenjave të tij/saj për një ngjarje, të cilat tregojnë një veprim që kërkon trimëri të veçantë. Ato tregojnë edhe botën emocionale të personazhit. Karakteristikë e baladave janë elementet fantastike.
<b>diskutim</b>	shkëmbim mendimesh për një çështje, në mënyrë që të gjendet zgjidhja më e mirë.
<b>element</b>	tipar dallues a i domosdoshëm i diçkaje.
<b>enigmë</b>	e ka origjinën në disa pyetje që i bëheshin një individ për të dëshmuar përkatësinë e tij ndaj një fisi të caktuar. Të fshehtë mund ta dinin vetëm anëtarët e fisit. Më vonë, enigmë u quajt çdo e fshehtë që ishte e vështirë për t'u zbuluar.
<b>fabul</b>	vetëm vargu i ngjarjeve kryesore, pra jo gjithçka që përmban vepra. Një vepër letrare përfshin brenda saj ngjarje, përshkrime, një shumësi ndjenjash, mendimesh, qëndrimesh etj. Të gjitha këto përbëjnë përmbajtjen e veprës. Përmbajtja përfshin gjithë materien e veprës, madje edhe titullin, ndërsa fabula shënon vetëm rrjedhën e ngjarjeve.
<b>fantastik</b>	që është pjellë e fantazisë, që mbështetet në imagjinatën krijuese, i trilluar.
<b>figura tingullore</b>	janë një grup figurash të cilat kanë të bëjnë me përsëritjen e tingujve brenda vargut, strofës, ose gjithë poezisë. Këto quhen ndryshe figura të përsëritjes.
<b>fjalë</b>	tërësi e pandashme e tingëllimit dhe e kuptimit, e formësuar nga ana gramatikore, që pasqyron në mënyrë të përgjithësuar e shënon sende e dukuri të realitetit dhe riprodhohet e veçohet kur flasim a kur shkruajmë.
<b>fjali</b>	një varg fjalësh (ose edhe një fjalë e vetme), të lidhura gramatikisht sipas ligjeve të një gjuhe për shprehjen e mendimit.
<b>fjali përmbledhëse</b>	fjali në të cilën jepet në mënyrë të përmbledhur kuptimi i disa fjalive të tjera.
<b>fjalor</b>	libër me fjalët e një gjuhe ose me termat e një fushe të caktuar të shkencës, të teknikës etj., të cilat renditen zakonisht sipas alfabetit dhe shpjegohen ose përkthehen në një gjuhë tjetër a në disa gjuhë.

<b>fjalorth</b>	listë fjalësh që jepen në fund të një teksti shkollor a të një botimi tjetër, të renditura sipas alfabetit dhe që shpjegohen ose përkthehen në një gjuhë tjetër.
<b>fragment</b>	pjesë e shkëputur a e mbetur nga një tekst.
<b>gramatikor</b>	që ka të bëjë me gramatikën e një gjuhe, që vështrohet e vlerësohet nga ana e gramatikës, që është karakteristik për njësitë e për kategoritë e gramatikës.
<b>grupoj</b>	ndaj në disa grupe, i klasifikoj në këto grupe.
<b>hero</b>	është personazhi kryesor i një vepre letrare. Teorikisht, heroi është ai që i lidh në mënyrë të pandashme pjesët e veçanta, motivet dhe njësitë e tjera të fabulës.
<b>hollësi</b>	e dhënë a rrethanë e imtësishme për një ngjarje, për një përshkrim, për një çështje etj.
<b>hyrje</b>	është pjesa e parë me të cilën fillon një tekst. në të mund të paraqiten personazhet, vendi dhe koha kur ndodh ngjarja. mund të përbëhet nga fare pak fjalë ose të jetë e pasur me informacione.
<b>imagjinoj</b>	përfytyroj, marr me mend.
<b>informues</b>	që të vë në dijeni për diçka, që të jep njoftime, informata a të dhëna për gjendjen e punëve në një fushë të caktuar, për veprimtarinë e dikujt, për një ngjarje etj.
<b>klasifikim</b>	ndarja e sendeve ose frymorëve sipas cilësive, veçorive e vetive të përbashkëta a të afërta që kanë.
<b>korrigjoj</b>	bëj ndreqjen e gabimeve.
<b>krijoj</b>	bëj diçka të re, që nuk ka qenë më parë, me punë mendore a fizike; shpik.
<b>kthej</b>	e ndryshoj rrënjësisht, i jap një pamje, një formë, një natyrë a një përmbajtje të re.
<b>legjendë</b>	është një rrëfim popullor për një ngjarje të së kaluarës, që mund të ketë një bazë të vërtetë, por që është zgjeruar me zbulime me elemente të reja.
<b>mbresë</b>	gjurmë që na lë në ndërgjegje diçka që e shohim a dëgjojmë, diçka që përjetojmë dhe që zakonisht ruhet për një kohë të gjatë.
<b>mbyllje</b>	është pjesa e fundit e një teksti. në të tregohet se si përfundon ngjarja. zakonisht është e shkurtër.
<b>mit</b>	lloj i veçantë i krijimtarisë gojore popullore - rrëfenjë për qenie të mbinatyrshme, për heronj legjendarë, për ngjarje e dukuri, ku pasqyrohen parafytyrimet primitive të njerëzve për prejardhjen e botës e të jetës mbi tokë, për natyrën dhe shoqërinë.

<b>motiv</b>	është njësia më e vogël tematike e krijimit letrar. Ky është një element shumë i rëndësishëm i krijimtarisë letrare. Motivi është shkak, nxitja, arsyeja, ngacmimi, që e ka shtyrë shkrimtarin/en të krijojë një vepër letrare.
<b>opinion</b>	mendim që kemi formuar për dikë a për diçka, gjykimi e vlerësimi ynë për të.
<b>organizoj</b>	vë rregull në një punë, në një veprimtari etj., e bëj që ajo të kryhet sipas një plani a sistemi të caktuar.
<b>personazh</b>	individualitet i krijuar nga shkrimtari/ja në një vepër nëpërmjet tipareve të të cilit mishërohen disa anë tipike të një karakteri shoqëror.
<b>përfundim</b>	mendim përgjithësues që nxirret pasi shqyrtohet e studiohet një çështje ose diçka tjetër, duke u mbështetur në të dhëna të ndryshme.
<b>përmbajtje</b>	brendia e një libri a e një teksti, ajo për të cilën flitet në një libër.
<b>përshkrim</b>	lloj teksti, në të cilin jepen tiparet e një njeriu, të një objekti, të natyrës etj.
<b>përshkruaj</b>	paraqit me shkrim a me gojë tiparet e dikujt a të diçkaje, veçoritë e një dukurie, rrethanat e zhvillimit të një ngjarjeje, dukurie etj.
<b>pjesë</b>	copë e vogël e një libri a e një shkrimi, që shkëputet prej tij e qëndron më vete.
<b>protagonist</b>	personazhi kryesor i një libri a i një teksti letrar.
<b>realist</b>	që merr parasysh kushtet e vërteta të jetës së tanishme ose të dikurshme dhe që shfaqet në përputhje me to.
<b>reflektoj</b>	mendoj gjatë me vete dhe e vlerësoj diçka nisur nga përjetimi im.
<b>rendit</b>	vë sipas një rendi, vë në radhë.
<b>rishkruaj</b>	e shkruaj përsëri diçka për ta dhënë më të pastër ose për ta ndryshuar.
<b>rol</b>	shkalla e pjesëmarrjes dhe e ndikimit të dikujt a të diçkaje në një veprimtari.
<b>rrjedhë e ngjarjes</b>	shtjellimi sipas mënyrës së zhvillimit të një ngjarjeje, të një veprimtarie a dukurie.
<b>sfinks</b>	qenie imagjinare në mitologjinë greke me krahë shpendi, me kokë gruaje, me trup luani ose qeni e me bisht gjarpri, që u jepte kalimtarëve gjëegjëza të vështira dhe i gëlltiste kur nuk i zgjidhnin dot.
<b>strukturë</b>	mënyra si janë vendosur dhe si janë të lidhura në mes tyre pjesët përbërëse të diçkaje.
<b>subjekt</b>	ka të bëjë me rendin që ndjek një vepër dhe me mënyrën se si janë zhvilluar dhe lidhur ngjarjet me njëra-tjetrën. Nëse prishet ky rend, atëherë humbet kuptimi i veprës. Shpesh ndodh që subjekti barazohet me fabulën. Në të vërtetë, fabula përfaqëson ngjarjet në rrjedhën e tyre, ndërsa subjekti është mënyra se si rrjedhin ngjarjet në veprën letrare.

<b>tema e një vepre letrare</b>	është e përbërë nga shumë njësi të vogla, që plotësojnë njëra-tjetrën, por mund të qëndrojnë edhe më vete, dhe quhen motive.
<b>term</b>	emërtim i përcaktuar mirë dhe i përpiktë i një nocioni të një fushe të shkencës, të teknikës, të artit, të jetës shoqërore etj., që shprehet me një fjalë ose me një grup fjalësh dhe që përdoret nga një grup i veçantë njerëzish të një profesioni.
<b>tezë</b>	pikëpamje a ide, që shtrohet si e vërtetë dhe mbrohet me anë të disa argumenteve.
<b>titull</b>	shkrim i shkurtër a mbishkrim në kapakun e një vepre letrare apo shkencore, në krye të një gazete, të një artikulli, të një vjershe, të një punimi, të një filmi etj., që tregon shkurt për çfarë flitet në të, që shërben si emër për të etj.
<b>udhëzim</b>	këshillë që i jepet dikujt për ta mësuar si duhet të veprojë a çfarë duhet të bëjë.
<b>zgjidhje</b>	rruga që duhet ndjekur për t'u zgjidhur një çështje, një problem etj.; përfundimi që i jepet një çështjeje.
<b>zhvillim</b>	është pjesa më e gjatë e një teksti, në të cilën tregohen ngjarjet që ndodhin dhe veprimet e personazheve të ndryshme.



# Referenca

- A. de Saint-Exupéry, *Princi i vogël*, Botimet Toena, Tiranë, 2008.
- A. Podrimja, *Buzëqeshje në kafaz*, poezi, Shtëpia Botuese e Lidhjes së Shkrimtarëve, Tiranë, 1993.
- Akademia e Shkencave e Shqipërisë, *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006.
- B. Beci, *Për një konceptim bashkëkohor të mësimit të gjuhës amtare në shkollë*, "Gjuha jonë", ASH, IGJL, Tiranë, 1993.
- Chaney, T. Burk, *Teaching Oral Communication in grades K-8*, 1998.
- E. Mekuli, *Midis dashurisë dhe urrejtjes*, poezi, Naim Frashëri, 1981.
- Gjuha letrare shqipe (Pjesë nga poezia shqipe dhe pasqyra gramatikore), Tiranë, 1989.
- Hivzi Sulejmani, *Fëmijët e lumit tim*, Naim Frashëri, Tiranë, 1972.
- <https://www.dreamstime.com/>
- J. Boçari, *Borfor: Provat e Askanos*, Shtëpia Botuese "Morava", Tiranë, 2010.
- J. K. Rowling, *Kafshët fantastike*, Ditura, Tiranë, 2018.
- K. Grillo, *Fjalor edukimi*, Tiranë, 2002.
- Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës e rishikuar, Prishtinë, gusht 2016.
- Kurrikula bërthamë e arsimit të mesëm të ulët të Kosovës, gusht 2016, Prishtinë.
- Kurrikula lëndore/programi mësimor për lëndën *Gjuhë shqipe 7*
- M. Kuteli, *Vepra letrare 5*, Shtëpia Botuese "Naim Frashëri", Tiranë, 1990.
- M. Tirta, *Mitologjia ndër shqiptarë*, Shkenca, Tiranë, 2004.
- N. Chamsky, *Aspects of the theory of Syntax* - MIT Press, Boston 1965.
- N. Mjeda, *Vjersha për të vegjël*, Naim Frashëri, Tiranë, Shqipëri 1967.
- O. Grillo, *Histori e Skënderbeut*, Shtëpia Botuese "Ditura", Tiranë, 2001.
- *Përralla popullore shqiptare*, Instituti i Shkencave, Tiranë, 1954.
- *Didaktika e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2009.
- *Prirja e sotme për mësimin e gjuhës shqipe*, Shkodër, 2003.
- *Modele të suksesshme mësimdhënieje*, Tiranë, 2008.
- *Probleme të sotme të mësimit të gjuhës shqipe në shkollë*, Tiranë, 2001.
- R. Elsie, *Gjirokastra nga udhëpërshkrimi i Evlija Çelebiut*, botuar në Albanica ekskluzive: revistë mujore për dije e kulturë, Prishtinë, nr. 66, 2007, f. 73-76 .
- R. Gjoshi, *Didaktika e gjuhës shqipe*, Prizren, 2017.
- R. Gjoshi, *Mësimdhënia e gjuhës shqipe në Kosovë (aspekte historike dhe didaktike)*, Prishtinë, 2016.
- R. Memushaj, *Shqipja standarde*, Botimet Toena, Tiranë, 2005.
- R. Qosja, *Antologji e lirikës shqipe*, Prishtinë, 1970.
- S. Krasniqi, *Besëlidhja shqiptare*, drama, Naim Frashëri, Tiranë, 1980.
- Sh. Rrokaj, *Çështje të gjuhës shqipe*, Tiranë, 2007.
- Standarde për tekstet shkollore Prishtinë, 2011
- Xh. Rodari, *Xhipi në televizor dhe ndodhi të tjera në orbitë*, Shtëpia Botuese Çabej, Tiranë, 2002.
- Z. Rrahmani, *Njohuri nga teoria e letërsisë*, Tiranë, 1996.

**Katalogimi në botim – (CIP)**

**Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”**

37.016:811.18(075.2)

Gjokutaj, Mimoza

Gjuhë shqipe 8 : për klasën e 8-të të arsimit 9-vjeçar /  
Mimoza Gjokutaj ... [etj.] ; ilustrues Elidor Kruja, Florinda  
Zonja. - Prishtinë : Pegi, 2024. - 262 f. : ilustr. ; 20.7 x 28 cm

1. Mullahi, Anila 2. Koleci, Flora 3. Babasuli, Tereza Basho  
4. Rakiplari, Elsa Skënderi 5. Kruja, Elidor 6. Zonja,  
Florinda

ISBN 978-9951-843-20-1





# Gjuhë shqipe 8

ISBN: 978-9951-843-20-1



9 789951 843201